



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË**

**PERIUDHA ME FJALI TË NËNRENDITUR
RRJEDHIMORE
NË PROZËN POPULLORE**

(për mbrojtjen e gradës Doktor)

**Punoi
Ma. Aida KURANI**

**Udhëheqës shkencor
Prof. dr. Ludmila BUXHELI**

Tiranë, 2014

DISERTACION

Paraqitur nga: **MA. AIDA KURANI**
(Për mbrojtjen e gradës shkencore: Doktor)
Specialiteti: **Sintaksë (Gjuhësi)**

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ludmila BUXHELI

Mbrohet në dt. ____ . ____ . 2014 përpara jurisë së përbërë nga:

1. _____ **Kryetar**
2. _____ **Anëtar**
3. _____ **Anëtar (oponent)**
4. _____ **Anëtar (oponent)**
5. _____ **Anëtar**

*Në kujtim të prindërve të mi,
që me shumë sakrifica më dhanë
jo vetëm mundësinë e studimit,
por edhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e tij!*

PARATHËNIE	7
FALËNDERIME	11
HYRJE	12

KREU I

ÇËSHTJE TË SINTAKSËS SË PERIUdhËS

1.1 Vështrim i përgjithshëm mbi konceptin e periudhës në teorinë sintaksore: emërtimi dhe trajtimi i saj.....	16
1.1.2 Fjalja.....	16
1.2 Emërtimi i njësisë ku bën pjesë fjalia e nënrenditur rrjedhimore.....	21
1.2.1 Gramatikat tradicionale.....	26
1.2.2 Gramatikat bashkëkohore.....	29
1.3 Cilat janë termat gjegjëse që përdorin gjuhët e tjera për të shënuar këto njësi sintaksore?	30
1.4 Cilit term do t' i përmbahemi në punim?.....	31
1.5 Tipat e periudhave: bashkërenditja dhe nënrenditja në periudhë.....	31
1.5.1 Periudha me bashkërenditje	35
1.5.2 Periudha me nënrenditje.....	35
1.6 Mjetet e formësimit të periudhave	42

KREU II

KLASIFIKIMI I PERIUdhAVE ME FJALI TË NËNRENDITUR DHE VENDI I FJALISË RRJEDHIMORE NË KLASIFIKIMET E PERIUdhAVE ME NËNRENDITJE NË GJUHËN SHQIPE

2.1 Klasifikimi i periudhave me fjali të nënrenditur në gramatikat dhe studimet për gjuhën shqipe.....	50
2.2 Kriteret e klasifikimit të periudhave me fjali të nënrenditura.....	63
2.3 Klasifikimi i periudhave me fjali të nënrenditur në gjuhësinë e huaj.....	69
2.4 Cilit kriter do t' i përmbahemi në këtë punim?.....	80
2.5 Vendi i periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore në klasifikimet e periudhave me nënrenditje në gjuhën shqipe.....	81

KREU III

RRETH DISA ÇËSHTJEVE TË FJALISË RRJEDHIMORE

3.1 Trajtimi i derisotëm i fjalisë rrjedhimore në gramatikat dhe studimet për gjuhën shqipe.....	93
3.2 Evolucioni i lidhëzave dhe lokucioneve lidhëzore rrjedhimore.....	100
3.3. Mënyrat e shprehjes së marrëdhënieve rrjedhimore.....	105
3.3.1 Shprehja e marrëdhënieve rrjedhimore në fjali të thjeshtë.....	106
3.3.2 Shprehja e marrëdhënieve rrjedhimore në periudha me bashkërenditje.....	107
3.3.3 Shprehja e marrëdhënieve rrjedhimore në periudha me fjali asindetike.....	108
3.3.4 Ngjyrimet rrjedhimore në periudha me fjali të tjera të nënrenditura.....	109
3.3.5. Marrëdhëniet rrjedhimore në nivel teksti.....	110
3.4 Klasifikimi i fjalive rrjedhimore.....	111

KREU IV

TIPAT SEMANTIKO-STRUKTURORË TË PERIUDHËS ME FJALI TË NËNRENDITUR RRJEDHIMORE NË PROZËN POPULLORE

4.1 Tipi me fjali rrjedhimore të bashkëlidhur (korrelative) në prozën popullore.....	118
4.1.1 Fjalja rrjedhimore jo e bashkëlidhur (korrelative) me lidhëzën sa	121
4.1.2 Fjalja rrjedhimore jo e bashkëlidhur (korrelative) me lidhëzën saqë	121
4.1.3 Fjalja rrjedhimore jo e bashkëlidhur (korrelative) me lidhëzën që	132
4.2 Tipi me fjali rrjedhimore të bashkëlidhur (jokorrelative) në prozën popullore.....	134
4.2.1 Periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën sa	134
4.2.2 Periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore me lokucionin lidhëzor aq sa	136
4.2.3 Periudhat rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën saqë	137
4.2.4 Periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lokucionin lidhëzor kështu që	138
4.2.5 Periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën që	141
4.3 Mjetet e lidhjes.....	148
4.3.1 Grafiku i shpërndarjes së lidhëzave në periudhat me fjali të nënrenditura rrjedhimore në prozën popullore.....	150

KREU V

RENDI I GJYMTYRËVE NË FJALINË RRJEDHIMORE DHE RENDI I FJALIVE NË PERIUdhËN ME FJALI TË NËNRENDITUR RRJEDHIMORE NË PROZËN POPULLORE

- 5.1 Vështrim i përgjithshëm për studimet gjuhësore mbi rendin në gjuhën shqipe.....152
5.2 Rendi i gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore në prozën popullore.....160
5.3 Rendi i fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore.....169

KREU VI

VËSHTRIM KRAHASUES I NDËRTIMEVE RRJEDHIMORE NË GJUHË TË NDRYSHME

- 6.1 Tipologji e mjeteve dhe e mënyrave të shprehjes së rrjedhimit.....174
6.2 Një vështrim i shkurtër ndërgjuhësor i ndërtimeve rrjedhimore.....176
6.3 Fjalitë rrjedhimore në anglisht.....180
6.4 Disa mendime mbi përkthimin e fjalive rrjedhimore nga anglishtja në shqip.....181
- PËRFUNDIME**.....186
- BIBLIOGRAFIA**.....192

PARATHËNIE

Struktura gramatikore e shqipes së sotme letrare, në vija të përgjithshme, pasqyron strukturën gramatikore të gjuhës popullore, ndaj në fazën e sotme të zhvillimit të shqipes standarde dhe me kërkesat që dalin përpara gjuhësisë shqiptare, rëndësi të veçantë merr studimi i gjuhës popullore si një domosdoshmëri për të njohur më mirë e më thellë strukturën gramatikore të gjuhës shqipe, origjinalitetin e saj. Në këtë kontekst është po aq me rëndësi të studiuarit e gjuhës së folklorit, i cili pasqyron identitetin kombëtar shqiptar, kulturën materiale dhe shpirtërore të tij përmes gjuhës së gjallë, ligjërimit të përditshëm.

Siç dihet, krijimtaria gojore e popullit tonë u ka shërbyer drejtpërsëdrejti studimeve gjuhësore dhe nuk është aspak e rastit që një pjesë e madhe e studiuesve të gjuhës shqipe janë ndër mbledhësit e botuesit më të zellshëm të folklorit.

Gjuha e folklorit na jep mundësi që ta njohim më thellë gjuhën tonë e veçanërisht strukturën e saj sintaksore. Sidomos përshkrimi sintaksor i saj ndihmon për të kapur më mirë e për të nxjerrë në pah veçori e ligjësi të gjuhës shqipe, që përcaktojnë individualitetin e saj në një gjendje të qartë, më pak të errësuar nga interferencat e gjuhëve të tjera e nga lëshimet e gjuhës së shkujdesur të përditshme¹.

Në fushën e sintaksës dialektore dhe veçanërisht në prozën popullore gjejmë një pasuri të madhe ndërtimesh nga më të larmishmet, me aftësi shprehëse të veçanta, vlera të shumta origjinale, të cilat nuk janë shfrytëzuar sa duhet e si duhet ose që nuk shfrytëzohen fare në gjuhën e shkruar e të folur letrare. Aty gjenden ndërtime e lidhje sintaksore që meritojnë të bëhen pasuri e përbashkët e gjuhës së sotme letrare².

Zhvillimi, pasurimi dhe përsosja e strukturës sintaksore shtron detyrën për të forcuar e thelluar më tej luftën kundër ndikimeve të huaja, të cilat me të drejtë në sintaksë janë parë si më të rrezikshmet e të dëmshme. Për këtë arsye shtrohet detyra të bëhet një studim i gjithanshëm e i thelluar i sintaksës popullore, për të nxjerrë prej saj ndërtime të reja sintaksore, shprehëse më të holla e më të përpikta vlerash e ngjyrimesh të caktuara sintaksore e stilistike. Njohja e pasurisë së mjeteve të saj shprehëse do të zgjerojë e do të thellojë njohjen e përgjithshme të gjuhës, duke vënë në pah mjete e mënyra me vlerë që meritojnë të përgjithësohen në gjuhën standarde.

Për një gjuhë me traditë shkrimi të vonë, si gjuha shqipe, studime të tilla sintaksore shërbejnë për të nxjerrë edhe fakte sintaksore të fazave të mëparshme. Krahasimi i strukturës sintaksore të dialekteve me strukturën e gjuhës shqipe standarde na ndihmon të përcaktojmë edhe prirjen e zhvillimit të strukturës së saj.³

Me një synim të tillë, objekt të punimit tonë kemi bërë pikërisht prozën popullore.

Duke u mbështetur në një lëndë të pasur faktike të vjelë në mënyrë shteruese në të gjashtë vëllimet e prozës popullore të botuara nga Instituti i Folklorit, në punimin tonë kemi synuar të japim një përshkrim tërësor të periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore, si nga ana

¹ Shih: M. Domi, *Çështje të gjuhës së epikës legjendare heroike sidomos në sintaksë*, Tiranë, 1983, f. 2.

² Shih: M. Domi, *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, SF 1984/4, f. 54; S. Floqi, *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, në BUSH, SShSh, 1958, nr. 3; Xh. Gosturani, *Disa ndërtime të periudhës në të folmen e Elbasanit*, Studime Filologjike.

³ M. Totoni, *Çështje të studimit të sintaksës dialektore*, Studime filologjike, 1978, f. 91-92.

kuptimore, ashtu edhe nga ana strukturore, duke u përpjekur të vëmë në dukje faktorët sintaksorë e faktorët e tjerë që ndikojnë në realizimin e strukturave të ndryshme; do të ndalemi hollësisht në përshkrimin e imët të mjeteve lidhëse, duke mos lënë jashtë asnjë lidhëz apo lokucion lidhëzor dhe, lidhur me këtë, do të shqyrtojmë hollësisht të gjithë tipat e fjalive rrjedhimore që dalin të ndërtuara me këto mjete lidhëse.

Gjithashtu do të shqyrtojmë korrelacionet e ndryshme mënyrore dhe kohore të fjalisë së varur rrjedhimore në lidhje të ngushtë me fjalinë drejtuese, karakterin e tyre, mënyrat e shprehjes së kuptimit të rrjedhimit etj.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve të veçanta jemi përpjekur të shikojmë si paraqitet periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore në prozën popullore, në krahasim me gjuhën letrare shqipe, ku përdoret më tepër, cila është prirja e kësaj njësie sot etj.

Punimi ynë edhe pse ndalet te periudha me fjali të nënrenditur në prozën popullore, nuk ka anashkalluar shumë çështje e koncepte teorike me të cilat punon sintaksa. Ne jemi mbështetur dhe kemi kërkuar ndihmë në shumë koncepte e çështje të rëndësishme të sintaksës, si: në konceptin për fjalinë si njësi themelore e analizës sintaksore, në konceptin e periudhës me nënrenditje, klasifikimin e saj në përgjithësi e klasifikimin e fjalisë së nënrenditur në veçanti, si dhe në shumë koncepte të tjera të rëndësishme.

Metodologjia: Këndvështrimi ynë metodologjik është kryesisht përshkrues dhe analizues, sipas veçorive të kapitujve. Duke u nisur nga parimet metodologjike të gjuhësisë krahasuese jemi përpjekur të japim një pasqyrim tipologjik të ndërtimeve rrjedhimore në gjuhë të ndryshme të botës, me bindjen se një gjë e tillë ndihmon për të përcaktuar vendin e shqipes në gjirin e këtyre gjuhëve për sa u përket ndërtimeve rrjedhimore në përgjithësi.

Krahasime të tilla, përveçse lejojnë të trajtohen dallimet në mes të gjuhëve, rrisin dhe vetëdijen gjuhësore të studentëve për një përvetësim jo spontan të saj. Studime të tilla janë të dobishme edhe për mësuesit që përballen me mësimin e gjuhës së huaj.

Gjithashtu është përdorur edhe metoda statistikore.

Për arritjen e këtij qëllimi jemi mbështetur në një bibliografi relativisht të pasur, nga autorë e studiues shqiptarë, ku përmendim monografitë dhe studimet e S. Floqit, M. Domit, M. Totonit, S. Priftit, Xh. Gosturanit, E. Lafes, S. Mansakut, Th. Dhimës e T. Topallit etj., si dhe në gramatikat e ndryshme, duke filluar që nga gramatikat shkollore e universitare të Xhuvanit, Sheperit, Rrotës, Cipos, Domit, Priftit e deri te gramatikat e sotme të Akademisë së Shkencave, por edhe nga autorë të veçantë.

Gjithashtu, për çështje e trajtime të ndryshme që vështrohen sipas koncepteve të reja të gjuhësisë bashkëkohore jemi mbështetur edhe në studimet e viteve të fundit nga studiuesit shqiptarë: R. Memushaj, J. Mitaj, L. Buxheli etj., si dhe në literaturë të huaj, tekste e gramatika të autorëve të huaj.

Natyrisht, duke qenë se asnjëherë nuk mund të flitet për një punë shteruese, sidomos duke pasur parasysh se teoritë e reja gjuhësore dhe çdo nënçështje e lidhur me to kërkon një studim të mëtejshëm e më të zgjeruar, shpresojmë se shqyrtimi dhe sugjerimet e paraqitura këtu mund të japin disa ide për mënyra të reja të trajtimit të disa çështjeve gramatikore që lidhen me periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore.

Struktura e punimit fillon me hyrjen, vijon me gjashtë krerë dhe mbyllet me përfundimet.

Në *kreun e parë* jemi ndalur në disa çështje të sintaksës së periudhës. Për arsye të vijueshmërisë së mendimit dhe trajtimit të koncepteve që lidhen ngushtë me periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore, me emërtimin dhe klasifikimin e saj, kemi menduar të paraqesim konceptet dhe hulumtimet në përgjithësi të disa njësive sintaksore e përbërësve sintaksorë si: fjali, periudhë, fjali e bashkërenditur, fjali e nënrenditur etj.

Në studime e tekste gramatikore ndër vite për periudhën gjejmë emërtime të ndryshme, si: *fjali e përbërë, frazë*, shpesh bazuar e ndikuar nga drejtime të ndryshme të teorisë sintaksore, por edhe nga emërtimet e përdorura nga gramatikanë të huaj.

Së bashku me trajtimin e *periudhës, frazës, fjalisë së përbërë* në tekstet tona, mendojmë të sjellim edhe terminologjinë e kësaj njësie sintaksore që i përmbahemi në punim.

Kreu i dytë vijon me trajtimin e disa çështjeve në lidhje me kriteret e klasifikimit të fjalive me nënrenditje. Për të parë se si është klasifikuar kjo njësi në gjuhën shqipe, kemi marrë në shqyrtim, në mënyrë kronologjike gramatikat, duke filluar nga më e hershmja e deri në ditët e sotme, si dhe studimet e bëra nga autorë të ndryshëm. Mënyrat e klasifikimit të fjalive të nënrenditura janë pjesë e diskutimeve të vazhdueshme edhe në kuadrin e gjuhësinë botërore. Ndër gramatikat e hulumtimeve të teoricienëve të ndryshëm vërejmë gjerësisht kritere të ndryshme klasifikimi. Në këtë kapitull e pamë të udhës të ndalemi edhe në qasjet e studiuesve të teorive më të fundit të huaja gjuhësore.

Fjalitë e nënrenditura rrjedhimore janë trajtuar në kuadrin e sintaksës së periudhës dhe, në veçanti, atyre rrethore. Duke i vështruar në rend kronologjik, objekt i *kreut të tretë* është paraqitja e një vëzhgimi historiko-kritik të fjalive të nënrenditura rrjedhimore, duke gjurmuar origjinën dhe evoluimin e këtij termi, si dhe trajtimin e kësaj njësie sintaksore bazuar në gramatikat dhe studimet për gjuhën shqipe. Në vëmendjen e këtij kreu do të jenë gjithashtu, edhe evoluimi i lidhëzave rrjedhimore, mënyrat e shprehjes së marrëdhënieve rrjedhimore, si edhe klasifikimi i fjalive të nënrenditura rrjedhimore.

Kreun e katërt të punimit ua kemi kushtuar tipave kryesorë ndërtimorë me të cilët del periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore në prozën popullore. Fjalitë e nënrenditur rrjedhimore mund të jetë e bashkëlidhur, pra në fjalinë kryesore mund të ketë një fjalë të bashkëlidhur (si *aq, kaq* etj.) ose jo e bashkëlidhur, domethënë pa ndonjë fjalë bashkëlidhëse në fjalinë kryesore. Do të shqyrtojmë strukturat përkatëse të këtyre dy lloj tipave të periudhës rrjedhimore, si edhe kuptimet që shprehin ato.

Rendi i fjalive përbërëse të periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore në prozën popullore, si edhe vetë rendi i fjalëve në këto fjali do të jetë objekti i *kreut të pestë* të këtij punimi. Rendi i fjalive në periudhën me nënrenditje rrjedhimore në prozën popullore, ashtu si dhe në gjuhën standarde, është përgjithësisht i ngulitur; fjalitë e nënrenditur pason fjalinë kryesore, duke iu përgjigjur rendit të gjërave në realitetin jashtëgjuhësor, ku shkak ose fakti vjen përpara pasojës a rrjedhimit.

Koncepti filozofik i marrëdhënies **shkak-pasojë** nuk ekziston në të gjitha kulturat, ndaj, si rrjedhim, jo çdo gjuhë e kodifikon këtë koncept, çka do të thotë se ka gjuhë që nuk kanë ndërtime rrjedhimore. Megjithatë, mund të thuhet se ndërtimet rrjedhimore janë të zakonshme në shumicën e gjuhëve, por këto gjuhë e konceptualizojnë kuptimin e rrjedhimit në mënyra të ndryshme, ndaj ka si ngjashmëri, ashtu edhe ndryshime qoftë ndërmjet familjeve të ndryshme gjuhësore, qoftë edhe brenda së njëjtës familje.

Ndaj në *kreun e fundit* të punimit jemi ndalur në modelet e ndryshme sintaksore sipas të cilave e kodifikojnë kuptimin e rrjedhimit disa gjuhë që u përkasin familjeve të ndryshme, me bindjen se një gjë e tillë ndihmon për të përcaktuar vendin e shqipes në gjirin e këtyre gjuhëve, për sa u përket ndërtimeve rrjedhimore në përgjithësi. Do të nisim me një tipologji të shkurtër të këtyre fjalive në gjuhë të ndryshme, duke u ndalur veçanërisht me një përshkrim të tyre në anglisht (si gjuhë ndërkombëtare, por edhe si gjuha e parë me të cilën shqipja përballet sot në çdo çast dhe në çdo fushë të jetës shkencore, ekonomike, kulturore, politike, ushtarake etj.), do të japim edhe disa sugjerime që i mendojmë si të dobishme për një shprehje sa më të saktë formale të kuptimeve rrjedhimore në këto gjuhë.

Krerët ndiqen nga pjesa e fundit, ku jepen përfundimet e nxjerra në lidhje me çështjet e trajtuara dhe bibliografia.

FALËNDERIME

Falënderime për Prof. dr. Ludmila Buxheli, që më udhëhoqi në përgatitjen e këtij punimi.

Falënderoj gjithashtu departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, drejtuar nga Prof. Dr. Aljula Jubani, që ka krijuar një mjedis të përsosur për kualifikimin akademik.

Do të doja të shprehja gjithashtu falënderimet e mia ndaj të gjithë atyre që më dhanë në mënyra të ndryshme ndihmesën e tyre në përgatitjen e këtij punimi. Falënderoj veçanërisht Nertilën, që nuk u lodh duke më nxitur në mënyrë të vazhdueshme deri në hartimin përfundimtar të këtij punimi.

Së fundi, falënderime dhe miradije për vëllain tim, i cili, pandërprerë, më mbështeti gjatë këtij rrugëtimi.

Aida Kurani
Tiranë, shtator 2014

HYRJE

Vështrim i përgjithshëm mbi studimet gjuhësore për periudhën me nënrenditje në prozën popullore

Nuk na takon neve të përcaktojmë përmbajtjen e nocionit *prozë* dhe *prozë popullore*; ajo njihet. Nuk na takon as të bëjmë klasifikimin e prozës popullore. Por duam të theksojmë se klasifikimi i saj ka rëndësi shkencore të dorës së parë, sepse jo vetëm tiparet e jashtme, por edhe vetë përmbajtja e rrëfimit popullor është e ndryshme në lloje të ndryshme të prozës popullore. Çështja e klasifikimit të prozës popullore ka të bëjë jo vetëm thjesht me përmbajtjen, por, krahas saj, edhe me stilin e përgjithësisht me gjuhën e rrëfimit popullor. Në ç'mënyrë? Çështja e stilit lidhet me çështjen e marrëdhënieve të asaj që rrëfëhet me realitetin objektiv. Këtu mbështetet fantastika e rrëfimit, që është një burim për të studiuar gjuhën e popullit. Ajo është një burim i madh studimesh për gjuhësinë, historinë, një burim i pasur për shkrimtarët dhe artistët⁴.

Studiuesit që janë marrë me problemet në fushën e gramatikës së gjuhës shqipe, janë përpjekur të pasqyrojnë edhe anë të veçanta të gjuhës së folklorit në veçanti.

Nisur nga një vështrim i përgjithshëm, studimet për strukturën e gjuhës shqipe mund t'i ndajmë në dy periudha të mëdha: periudha e parë, që fillon me *Osservazioni gramaticali nella lingua Albanese (Vërejtje gramatikore në gjuhën shqipe dhe drejtshkrimi i saj)*, e njohur si gramatika e parë e gjuhës shqipe, shkruar në italisht nga Francesco M. da Leçe, në Romë, më 1716 e që vjen deri në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe, periudha e dytë që fillon në gjysmën e dytë të shekullit XX e deri në ditët e sotme.

Të dyja këto periudha përbëjnë pjesë të pashkëputura të një historie të vetme, por që kanë dhe dallime të rëndësishme ndërmjet tyre. Në periudhën e parë, me studimin e gjuhës shqipe, të strukturës gramatikore të saj në veçanti, janë marrë studiues vendës dhe të huaj. Janë studime kryesisht në morfologjinë e gjuhës shqipe, ndërsa studimet që trajtonin strukturën sintaksore janë më të pakta. Megjithatë, ato janë me interes për përpjekjet që kanë bërë autorët e tyre në pasqyrimin e gjuhës popullore.

Përmendim *Gramatikën e De Radës*⁵, e cila është mbështetur kryesisht në të folmen arbëreshe me shembuj të shumtë nga autorë të ndryshëm shqiptarë e arbëreshë⁶; *Gramatikën e J. Vretos*⁷, e cila pasqyron të folmen e toskërishtes verilindore e veçanërisht zonën e Leskovikut⁸; *Gramatikën e Dozonit*⁹, e cila na jep të dhëna për disa lidhëza nënrenditëse, si p.sh.: *që, as, kur, si, posa, ndonëse, tek, tani që* etj.¹⁰

⁴ Për tepër shih: H. Shehu, *Rreth leksikut të prozës tregimtare popullore* (vepër në dorëshkrim).

⁵ Shih më shumë: J. Kastrati, *Gramatika shqipe e De Radës e vitit 1870-71*, në "Buletini Shkencor" të Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, Prishtinë, 1978, f. 53-62.

⁶ *Po aty*, f. 73.

⁷ Shih për më shumë: M. Domi, *Gramatika e Jani Vretos e vitit 1886 dhe kontributi i tij në përpunimin e terminologjisë gjuhësore të Rilindjes*, në *Gjurmime Albanologjike*, Prishtinë, 1978.

⁸ M. Domi, *Gramatika e Jani Vretos e vitit 1886 dhe kontributi i tij në përpunimin e terminologjisë gjuhësore të Rilindjes*, në *Gjurmime Albanologjike*, Prishtinë, 1978, f. 53-63.

⁹ Auguste Dozon, *Manuel de la langue chqipe ou albanaise*, Paris, 1879.

¹⁰ Shih më shumë: J. Kastrati, *Histori e Gramatologjisë Shqiptare (1635-1944)*, Prishtinë: Rilindja, 1980, f. 456.

Ndihmesa të tjera të çmuara për gjuhën shqipe, ku janë trajtuar çështje sintaksore, janë edhe tekstet e Dh. Kamardës¹¹, Z. Jubanit¹², Th. Mitkos¹³, S. Dines¹⁴, S. Pecit¹⁵, G. Mikelit¹⁶, I. D. Sheperit¹⁷, J. Rrotës¹⁸, J. G. Hanit¹⁹, K. Kristoforidhit²⁰, S. Frashërit²¹, G. Majerit²², H. Pedersenit²³ etj.

Një kontribut të rëndësishëm në studimet e sintaksës shqipe ka dhënë A. Xhuvani. Në hartimin e teksteve të tij ai është mbështetur edhe në gjuhën popullore. Studimin e sintaksës së gjuhës shqipe Xhuvani e ka parë të lidhur ngushtë me problemet e pastërtisë së saj, si dhe me zhvillimin e pasurimin e saj sipas veçorive dhe ligjeve që e karakterizojnë. Xhuvani ka luftuar vazhdimisht për një gjuhë standarde të mbështetur mirë në gjuhën e gjallë të popullit, sepse këtu gjenden ndërtimet dhe mjetet gramatikore të shqipes²⁴.

Sintaksat e Xhuvanit shënojnë një hap përpara, pasi gramatikat e botuara më parë si nga autorë vendës, ashtu edhe të huaj, kishin trajtuar kryesisht morfologjinë dhe e kishin prekur shumë shkurt, pak ose aspak strukturën sintaksore. Në tërësinë e saj, sintaksa u trajtua për herë të parë në “*Njohurit e para të syntaksës shqipe. Pjesë e parë*”, botuar nga A. Xhuvani më 1922.

Një ndihmesë me vlerë paraqesin edhe studimet e albanologut të shquar M. Lamberci. Ai është ndër të parët që u mor me studimin e gjuhës së folur popullore e veçanërisht me “*Ciklin e kreshnikëve*”, duke vënë në dukje pasurinë dhe larminë e mjeteve shprehëse të epikës sonë legjendare.

Ai është ndër të parët që i kushtoi vëmendje të veçantë studimit të gjuhës popullore, duke u mbështetur në një lëndë të pasur, të vjelë nga tekstet e vjetra dhe folklori.

Me studimet e Lambercit u hodhën hapat e parë në fushën e studimeve të sintaksës shqipe²⁵.

Si përfundim mund të themi se hulumtimi i sintaksës popullore në gramatikat dhe studimet për sintaksën popullore në këtë periudhë nuk ka një paraqitje tërësore dhe sistematike. Një

¹¹ Dh. Kamarda, *Appendice al sargie di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866.

¹² Z. Jubani, *Raccolta di canti popolari e rapsodie di poemi albanese*, Trieste, 1987.

¹³ Th. Mitko, *Alvannici molica (Bëleta shqypëtare)*, Aleksandri, 1978; Th. Mitko, Vepra, Tiranë, 1981.

¹⁴ S. Dino, *Valët e detit*, Sofje, 1908.

¹⁵ S. Peci, *Viti premtar i gramatikës*, Korçë, 1912.

¹⁶ G. Mikelit, *Gramatika e gjuhës shqipe*, shtypshkronja “Nikaj”, Shkodër, 1916.

¹⁷ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927.

¹⁸ A. J. Rrota, *Sintaksa e gjuhës shqipe (ose Sintaksi i shqipes 1942)* për klasën II, III, IV të shkollave të mesme, Shkodër, shtypshkronja A. Gj. Fishta, Shkodër, 1943.

¹⁹ Johan Georg von Hahn, *Albanesische studien, beitraege zu einer grammatik der toskischen dialektes* (Studime mbi shqiptarët, konstrukte për një gramatikë të toskërishtes), 1854.

²⁰ Kostandin Kristoforidhi, *Grammatiki tis albanikis glossis*, 1882.

²¹ Sami Frashëri, *Shkronjëto e gjuhës shqip*, 1886.

²² Gustav Meyeri, *Kurzgefasste albanesische grammatik*, 1888.

²³ Holger Pedersen, *Albaneisische texte mit glosar*, 1895.

²⁴ A. Xhuvani, *Vepra I*, 1980, f. 110-115; shih edhe: E. Lafe, *Pikëpamjet e Aleksandër Xhuvanit për kulturën e gjuhës*, Studime filologjike, Tiranë, 1980, nr. 1, f. 87-89.

²⁵ Shih: E. Lafe, *Maksimilian Lamberci - studime të gjuhës shqipe*, “Studime filologjike”, 1982, nr. 4, f. 180-181. M. Totoni, E. Hysa, *Rezultate në fushën e fonetikës dhe gramatikës së shqipes së sotme gjatë 25 vjetëve të Çlirimit*, “Studime filologjike”, 1969, nr. 4, f. 30.

pjesë e konsiderueshme e gramatikave përqendrohen më shumë në tipare dialektore dhe jo në tipare të përgjithshme të shqipes, duke mos fituar kështu tiparet e një gramatike të mbarë shqipes. Një pjesë e mirë e studimeve të kësaj periudhe, veçanërisht ato të gjuhëtarëve të huaj, karakterizohen nga një paraqitje skematike, për shkak të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës shqipe.

Siç pohon dhe J. Kastrati, disa studiues kanë shkruar për strukturën gramatikore të shqipes, duke i marrë të dhënat gjuhësore nga të tjerët, pa rënë në kontakt me gjuhën e popullit²⁶.

Një mangësi tjetër e rëndësishme e këtyre studimeve është se ato nuk u orientuan drejt normës gjuhësore kombëtare. Megjithatë ato u mbështetën në lëndë dialektore dhe në folklor, duke lënë një trashëgimi me vlerë dhe duke hapur njëkohësisht rrugën për studime më të thelluara²⁷.

Periudha e dytë nis me vitet '40 të shekullit XX. Si gjithë gjuhësia, edhe sintaksa e gjuhës shqipe u zhvillua në lidhje të pandarë me problemet e mëdha të kulturës kombëtare dhe si pjesë e zhvillimit shoqëror e kulturor. Nis kështu studimi më i thelluar e sistemor i strukturës sintaksore të shqipes. Në vitin 1952 botohet sintaksa²⁸ e K. Cipos. Shembujt e sjellë gjatë trajtimit të çështjeve sintaksore janë marrë si nga letërsia shqipe, ashtu edhe nga gjuha popullore. Vepra e Cipos u ndoq nga tekste të tjera, si: *Sintaksa*²⁹ e M. Domit, ku gjeti shprehje dhe u pasqyrua më mirë gjuha e prozës popullore me shembujt e sjellë për ilustrim në trajtimin e njërive sintaksore, ndër to edhe për fjalinë e nënrenditur rrjedhimore: *Mërzitet me plasë* dhe i thotë. (Prralla Kombtare)³⁰

Veçanërisht në sintaksën e S. Priftit merret në analizë një lëndë e gjerë gjuhësore jo vetëm nga letërsia artistike, por edhe nga gjuha e folklorit. Për shembull, në trajtimin e raporteve rrjedhimore autori përdor shembuj si nga letërsia artistike, ashtu edhe nga folklori: *Hingëllon gjogu, qi a dridhë ashti*. (Këngë popullore legjendare)³¹

Në këtë periudhë studimet në fushën e sintaksës bëhen gjithnjë e më sistematike e më të thelluara përmes punimeve monografike dhe artikujve të ndryshëm studimorë. Studimet synojnë gjithnjë e më tej të paraqesin strukturën sintaksore të shqipes në përgjithësi dhe të sintaksës popullore në veçanti. Në këto studime, në ndryshim nga tekstet mësimore, studiohet në mënyrë më të thelluar e shkencore struktura e gjuhës së popullit. Përmendim këtu studimet për periudhat me fjali të nënrenditura kryefjalore, kundrinore, përcaktore, rrjedhimore, shkakore, lejore, krahasore, kushtore etj.

S. Floqi, në trajtimin e tij "*Periudha e varur rrjedhimore*"³², në mjaft të folme bën krahasime dhe vlerësime për gjuhën e folur popullore. Për tipin lidhëzor jokorrelativ të fjalive të nënrenditura rrjedhimore autori thekson përdorimin e tyre dhe në gjuhën e popullit. Për raste të tjera më specifike të strukturës dhe të kuptimit të fjalive të nënrenditura rrjedhimore, autori sjell shembuj të ndryshëm nga folklori, ashtu siç janë mbledhur nga H. Pedersen, Th. Mitko,

²⁶ J. Kastrati, *Histori e Gramatologjisë Shqiptare (1635-1944)*, Prishtinë: Rilindja, 1980, f. 20-21.

²⁷ Q. Haxhihasani, *Kontributi i Maksimilian Lambercit në fushën e folkloristikës shqiptare*, "Studime filologjike", 1982, nr. 4, f. 187-191.

²⁸ K. Cipo, *Sintaksa* (Tekst për Institutin Pedagogjik), Tiranë, 1951.

²⁹ M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.

³⁰ M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 109.

³¹ S. Prifti, *Sintaksa e Gjuhës Shqipe*, 1971, f. 419.

³² S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965, nr. 2.

D. Kurti etj.: *Djali vehet me kujdes me i ba punët e shpis, tuj shi e tuj dliirë, kështu qi u hin në hatër aq sa nisin me ia lanë në dorë cilcat e odave.* (D. Kurti, “Prralla kombtare...”) ³³

Edhe në punimin e S. Mansakut “*Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare*” ³⁴ vihen re përqsjet që bën autori mes gjuhës popullore dhe gjuhës standarde. Autori nxjerr në pah raportet kushtore që gjejnë shprehje në gjuhën e folur, në ndërtimet tautologjike në periudhat e ndërtuara me lidhëza bashkërenditëse përqsore – kundërshtore *po, por*, si dhe në periudhat me fjali të nënrenditura kohore me lidhëzën *si*. Autori sjell shembuj të ndryshëm nga proza popullore: *S’të ha i thotë macja, po të veç filan pallat; te porta, të nxjerrç një çik brumë.* (Proza III, 85) ³⁵

Një rëndësi të veçantë i kushtojnë prozës popullore në trajtimin e periudhave me fjali të nënrenditur edhe shumë autorë të tjerë, si Xh. Gosturani ³⁶, K. Kapllani ³⁷, M. Gero ³⁸ etj.

Në këtë periudhë në leksik hyjnë fjalë dhe shprehje që rrojnë në ligjërimin popullor, zgjerohen e specializohen mjetet sintaksore ³⁹. Ndër to mund të përmenden: 1) Shtimi i numrit të parafjalëve, sidomos me parafjalë emërore e ndajfoljore; i numrit të lidhëzave, me krijimin e më shumë lidhëzave të përbëra a të lokucioneve lidhëzore. 2) Zgjerimi i emrave prejfoljorë me prapashtesat *-im* dhe *-je* me një emër në gjinore dhe me një emër me parafjalë, të quajtura ndërtime me emra foljorë, që karakterizohen edhe nga lidhje emërore, edhe nga lidhja foljore. 3) Ndërlikimi i ndërtimeve me forma të pashtjelluara, që ka shtuar mundësitë e lidhjeve të tyre dhe ka pasuruar marrëdhëniet që shprehin. 4) Përpunimi i një varg strukturash të veçuara me vlerën e një ndërtimi gjysmëpredikativ, kryesisht në stilin e letërsisë artistike, por edhe në publicistikë. 5) Kufizimi i renditjes së lirë të gjymtyrëve dhe saktësimi i vendosjes së tyre në përshtatje me veçoritë e strukturës morfologjike dhe të ngarkesës kumtuese. 6) Pasurimi i skemave të frazave të ndërlikuara me më shumë se dy fjali. 7) Krijimi i një sistemi të tërë fjalësh modale etj., që vendosin lidhje të ndryshme të folësit me atë që kumton ⁴⁰.

Nga kjo paraqitje e shkurtër që iu bë studimeve për periudhën me nënrenditje në prozën popullore, del se është e domosdoshme që kjo njësi sintaksore të studiohet e plotë dhe në mënyrë më sistemore.

Një mungesë e tillë përlligjte studimin e periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore në prozën popullore objekt të një trajtimi të veçantë, që duhej të hidhte dritë ⁴¹ mbi natyrën e kësaj periudhe, veçoritë e saj dhe çështjet që presin ende për t’u zgjidhur.

³³ S. Floqi, *Vepër e cituar*, f. 78.

³⁴ S. Mansaku, *Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare*, Studime filologjike, Tiranë, 1996, nr. 3.

³⁵ S. Mansaku, *Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare*, Studime filologjike, Tiranë, 1969, nr. 3, f. 153-169.

³⁶ Xh. Gosturani, *Periudha me fjali të varur lejore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1972, nr. 1.

³⁷ K. Kapllani, *Periudha me fjali krahasore të barazisë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1985; K. Kapllani, *Periudha me fjali krahasore korrelative të pabarazisë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1986.

³⁸ M. Gero, *Ndërtime me lidhëzën se te periudha me fjali të varur kundrinore në prozën popullore*, Buletini shkencor, Shkodër, 1983, nr. 2.

³⁹ M. Domi, *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, Studime filologjike, 1984, nr. 4, f. 60.

⁴⁰ Shih për këtë: M. Totoni, *Struktura sintaksore e gjuhës letrare shqipe dhe probleme të normës së saj*, Gjuha jonë, 1995/1-4, f. 42.

⁴¹ M. Domi, *Çështje të epikës legjendare heroike* (Referat), Tiranë 1983, f. 5; Q. Haxhihasani, *Folklori dhe gjuha letrare kombëtare*, “Gjuha jonë”, 1984, Nr. 2, f. 47: Në prozën popullore gjenden ndërtime e lidhje sintaksore që vlejnë të bëhen pasuri e përbashkët e gjuhës së sotme letrare. Studimi i vëmendshëm i tyre do të ndihmojë të dalin në dritë vlera të reja të gjuhës sonë.

KAPITULLI I

ÇËSHTJE TË SINTAKSËS SË PERIUDHËS

1.1 Vështrim i përgjithshëm mbi konceptin e periudhës në teorinë sintaksore: emërtimi dhe trajtimi i saj

Përpara se të ndalemi në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore në prozën popullore, mendojmë të paraqesim përkufizimet dhe hulumtimet e ndjekura në gramatikat shqipe dhe studimet e gjuhëtarëve të ndryshëm për periudhën.

Për arsye të vijueshmërisë së mendimit dhe trajtimit të koncepteve që lidhen ngushtë me periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore, me emërtimin dhe klasifikimin e saj kemi menduar të paraqesim konceptet dhe hulumtimet në përgjithësi të disa njësive sintaksore e përbërësve sintaksorë si: fjali, periudhë, fjali e bashkërenditur, fjali e nënrenditur etj.

Ndër vite, në studime e tekste gramatikore të ndryshme për periudhën gjejmë emërtime të ndryshme, si: *fjali e përbërë*, *frazë*, shpesh bazuar e ndikuar nga drejtime të ndryshme të teorisë sintaksore, por edhe nga emërtimet e përdorura nga gramatikanë të huaj.

Së bashku me trajtimin e *periudhës*, *frazës*, *fjalisë së përbërë* në tekstet tona, mendojmë të sjellim edhe terminologjinë e kësaj njësie sintaksore që i përmbahemi në punim.

1.1. Fjalia

Studimi i periudhës në gjuhësinë tonë është bërë në kuadrin e studimit të fjalisë. Përcaktimi i nocionit të fjalisë ka qenë dhe mbetet një nga çështjet më të ndërlikuara sintaksore⁴². Teori dhe drejtime të ndryshme gjuhësore kanë dhënë përkufizime të ndryshme të fjalisë duke u nisur nga këndvështrime logjike, strukturore, apozicionale, semantike etj. Përkufizimet e bëra në lidhje me të përpiqen të ngërthejnë si aspektin gramatikor, ashtu edhe atë semantik. Ana gramatikore (formale) ka të bëjë me lidhjen e fjalëve sipas ligjeve të një gjuhe (gjuha shqipe, angleze, italiane etj.), sipas llojeve të marrëdhënieve sintaksore që vendosen në fjali dhe sipas intonacionit të mbarimit. Ndërsa ana kuptimore lidhet me faktin se në një fjali formësohet dhe shprehet një gjykim, një pyetje, një ndjenjë a një dëshirë, që do të thotë një kuptim i plotë.

Fjalitë gjatë ligjërimit futen në marrëdhënie me njëra-tjetrën. Edhe këto lloj marrëdhëniesh, ashtu si fjalia, duhen trajtuar në dy aspekte a këndvështrime: aspekti sintaksor dhe ai semantik (ose semantiko-pragmatik), të dy në varësi të ndërsjellë me njëri-tjetrin.

⁴² Vetëm për nocionin "fjali" janë mbledhur më se treqind përkufizime, të dhëna në rrjedhë të shekujve nga studiues të ndryshëm të sintaksës. Kjo duhet të jetë e mjaftueshme për të treguar se një koncept i tillë është problematik. (Shih më shumë: Giorgio Graffi, Sintaksa, Tiranë, 2003, f. 42.)

Givoni shpjegon qartë arsyen se përse duhen trajtuar si aspekti sintaksor, ashtu dhe ai semantik. Ai thotë: “*Sintaksa nuk është thjesht tërësia e rregullave sipas të cilave organizojmë e përftojme fjalitë në mënyrë të pavarur, por degë e gjuhësisë e cila ndërvepron me disiplinat e tjera të saj, si semantika dhe fonologjia. Ajo është një tërësi funksionalisht e motivuar*”⁴³.

Fjalja është parë herë si njësi strukturore statike e herë si njësi strukturore dinamike. Gramatika tradicionale, e cila e sheh gjuhën si shprehje të drejtpërdrejtë të mendimit, e përkufizon fjalinë si formë gjuhësore që shpreh një mendim të plotë. Ajo e lidh atë me gjykimin, që është kategori logjike, kurse fjalinë vetë e sheh si një kategori gramatikore që duhet ta studiojë gramatika. Pra, çdo gjykim shprehet me fjali, por jo çdo fjali shpreh gjykim.

Gjykim shprehin fjalitë dëftore, kurse fjalitë e tjera, si fjalitë nxitëse, pyetëse dhe dëshirore, s’mund të shprehin gjykime. Gjykimi ka strukturë dyshe, *subjekt* dhe *predikat*, kurse fjalja mund të ketë vetëm njërin nga grupet, emëror ose foljor, që përfaqësojnë kryefjalën dhe kallëzuesin. Nga ana tjetër, mendimi është një kategori që përkufizohet pavarësisht nga gjuha dhe si i tillë nuk mund të përfshihet në përkufizimin e fjalisë.

Gjuhësia strukturore i sheh këto përkufizime si të pasakta dhe e bazon përkufizimin e fjalisë në kriteret aksiomatike të formës dhe të distribucionit (përndarjes). Fjalja është forma gjuhësore më e gjerë gramatike dhe e pavarur.

Strukturalisti amerikan L. Blumfeld,⁴⁴ duke përqafuar deri diku teorinë e Sosyrit mbi linguistikën, shkencën e gjuhës njerëzore, pranon se ndryshon nga ai, pasi e bazon analizën gramatikore të *fjalja* e jo të *fjala*⁴⁵. Ai e përkufizon fjalinë si *një formë gjuhësore e cila nuk përmban elemente gramatikore që të hyjnë në ndonjë formë gjuhësore më të gjerë*. Për të, fjalja është njësi bazë e analizës sintaksore. Ajo përkufizohet si *struktura e thënies*, që do të thotë se brenda një thënieje ajo nuk është pjesë e një strukture më të madhe.⁴⁶

Pra, strukturalizmi e pa fjalinë, në përgjithësi, si njësi të gjuhës. Ajo shihet si kuintesenca e ligjërimeve, pra, si një strukturë modelore.

Gjuhëtarët e mëvonshëm nisën ta shohin fjalinë si njësi të ligjërimit, pra, si një produkt të aktit kuptimor. Për Emil Benveniste⁴⁷ *fjalja është një formim i papërcaktuar, e cila ndryshon pambarimisht si vetë gjuha në ligjërime*. Sipas këtij gjuhëtar, për fjalinë nuk ekzistojnë as ligjet e distribucionit, as ligjet e përdorimit.

⁴³ T. Givon, *On Understanding Grammar*, published by Academic Press, New-York, 1979, f. 208,

⁴⁴ L. Blumfeld, *Language*, 1933, f. 20.

⁴⁵ The Linguistics *Encyclopedia, second edition*, Routledge, London and New-York, 2002.

⁴⁶ R. Memushaj, *Gjuhësia Gjenerative*, Shblu, Tiranë, 2008, f. 35.

⁴⁷ E. Benveniste, *Problèmes de linguistique générale*, Paris, 1966, I. f. 129.

Ndërsa, Hallidei⁴⁸, themeluesi i Gjuhësisë Funktionale Sistemike thotë: *Nuk ka kufij maksimalë në gramatikë, por tradicionalisht ne ndalojmë te fjalia*⁴⁹. Sipas tij, *fjalia* është e njëjta njësi sintaksore, pavarësisht nëse funksion e vetme, e pavarur apo si pjesë përbërëse e një strukture më komplekse, siç është *periudha*. Konteksti siguron lidhjen midis situatës edhe formës dhe fonologjia lidhjen midis formës dhe tingullit.

Konteksti sintaksor përbëhet pikërisht nga fjalia për të mbërritur te fjala. Për Hallidein, *fjala* dhe *fjalia* nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës, të dyja janë përbërëse të gramatikës. Fjalët dhe fjalitë janë elemente të organizimit gjuhësor, i cili qëndron pas strukturave të paraqitura konkretisht nga simbolet në gjuhën e shkruar dhe tingujt në ligjërim.

Xhefri Liç afron dy interpretime për *fjalinë*⁵⁰ duke e përkufizuar atë në përjasje me periudhën: fjalia e thjeshtë, e pavarur, në ndryshim nga periudha e cila përbëhet nga dy a më shumë fjali (njësi kallëzuesore), përbëhet nga një e tillë. Ai bën dallimin e fjalive (sentences) dhe thënieve (propositions). Sipas tij, fjalitë janë *njësi sintaksore* dhe thëniet *njësi semantike*⁵¹. Ai shpjegon se dykuptimësia është tipar i fjalive dhe jo i thënieve. Një fjali pohore me dy kuptime përkufizohet si një fjali e cila përmban më shumë se një thënie.

Këtu ai jep shembullin⁵²: Hugo is drawing a cart.
Ky shembull mund të interpretohet në dy mënyra:

- a. Hugo is drawing [the picture of] a cart.
(Hugo po vizaton një karrocë.)
- b. Hugo is drawing [pulling] a cart.
(Hugo po tërheq një karrocë.)

Në semantikë është e nevojshme analiza e predikativitetit, i cili përkufizohet *si njësia kryesore e interpretimit të kuptimit të fjalive*⁵³. Ajo që e bën predikativitetin njësi kryesore të analizës semantike është fakti se ai është elementi semantik i përbashkët i thënieve, pyetjeve

⁴⁸ Halliday, M. A. K. 1987. "Language and the Order of Nature". Nigel Fabb, Derek Attridge, Alan Durant and Colin MacCabe (eds.) *The Linguistics of Writing: Arguments between Language and Literature*. Manchester University Press. f. 135-154. Ai përshkruan tri funksione kryesore të gjuhës:

a) *Funksionin ideor, i cili na lejon në përfaqësimin e perceptimeve dhe përvojave tona, mendimit tonë për realitetin në të cilin jetojmë për të interpretuar çfarë ndodh përreth nesh.*

b) *Funksionin ndërpersonal, përmes të cilit ne ndërveprojmë me të tjerët, komunikojmë, shkëmbejmë informacionet, mendimet, kujtimet dhe dëshirat tona, duke kërkuar të ndikojmë, rregullojmë dhe kështu me radhë.*

c) *Funksionin tekstual, i cili na lejon që të organizojmë diskutimin dhe të krijojmë një gjendje në të cilën çdo gjë është e lidhur së bashku në një mënyrë koherente.*

Funksioni tekstual lejon zhvillimin e dy lloj aftësisish bazë: aftësinë e interpretimit dhe aftësinë shprehëse - dy operacione shumë krijuese në lidhje me arritjen "e mundshme për kuptimin" e gjuhës përmes dekompozimit dhe kompozimit të tekstit. Teksti mund të jetë me shkrim ose me gojë. Të dy kanë karakteristika dhe funksione me rëndësi të madhe në procesin e të mësuarit dhe të zhvillimit intelektual.

⁴⁹ Halliday, M. A. K. An Introduction to Functional Grammar, St. Edmundsbury Press Ltd Suffolk, 1991, f. 25.

⁵⁰ Quirk, R. -Greenbaum, S. -Leech, G. -Svartvik, J., A Comprehensive Grammar of English Language, Longman, London and New-York, 1985, f. 719.

⁵¹ G. Leech, Semantics, Penguin books, 1981, f. 79.

⁵² G. Leech, *po aty*, f. 79.

⁵³ G. Leech, *po aty*, f. 7-9.

dhe urdhrave. Analiza e predikativitetit bën të mundur lidhjen midis llojeve të ndryshme të kuptimit. Por duhet theksuar se predikativiteti nuk përmban e shpreh tipare të vërtetësisë apo pavërtetësisë së perceptimit të realitetit nga ana e folësit, në të kundërt thëniet e pohimet e bëjnë këtë gjë. Ky hendek i krijuar mes predikativitetit dhe thënieve plotësohet nga elementi logjik. Është përbërësi logjik ai që mundëson lidhjen e predikativitetit me qëndrimin ndaj realitetit.

Duke u bazuar në rregullat e strukturës së sintagmave, N. Çomski (Noam Chomsky) paraqet në formën e një peme lidhjen hierarkike të tyre. Ai përdor simbolin tradicional S (sentence) për t'iu referuar fjalisë si *simbol fillestar* në nyjat e çdo peme të varësisë, e cila përshkruan strukturën hierarkike të përbërësve të sintagmës. Në përcaktimin S të një gjuhe L mendohet se një gramatikë gjeneron fjalitë L duke gjeneruar në këtë mënyrë vetë L.

Në veprën e tij *Strukturat Sintaksore* (Syntactic Structures, 1957) ai dallon përbërësin sintagmatik, i cili përfshin: rregullat e të rishkruarit - transformimet ose një tërësi rregullash transformuese; rregullat morfo-fonologjike që përbëjnë bërthamën fonetike të një fjalie të dhënë. Teoria e Çomskit përbëhet nga rishkrimi i rregullave të njëpasnjëshme, ndër të cilët i pari ishte:

[S \Rightarrow NP- VP] ku SP (Sintagmë Emërore) funksionon si kryefjalë dhe SV (Sintagmë Foljore), e cila funksionon si kallëzues.

Çomski⁵⁴ parashtron një rregull i cili reflekton zhvillimet e mëvonshme që ai i bën teorisë së tij:

[S \Rightarrow NP – aux- VP] \rightarrow [F

Ai trajton fjalitë e nënrenditura si “fjali të ndërkallura”. Për të pozicionuar shprehje lidhëzore me rend fillestar në fjali u paraqit një zgjerim i S: S' (“S-bar”) e cila është një “projeksion” i S dhe paraqitet në mënyrë grafike: [S \Rightarrow Com-S].

Në fjalinë *Ai tha se Xhoni qeshi*, sipas këtij rregulli: [se{Xhoni qeshi}] është fjali e nënrenditur dhe dallon nga fjalia e mëvetësishme: [Xhoni qeshi].

Sipas gjenerativistëve, një fjali ka një strukturë unike dhe, si e tillë, nuk duhet të paraqesë paqartësi strukturore. Paqartësia strukturore ose dykuptimësia mund të shkaktohet nga mungesa e strukturës sintaksore. Kjo është arsyeja përse segmenti i fjalëve kërkon një rregull gramatikor, i cili përcakton organizimin strukturor dhe jo renditjen drejtvizore të tyre. Studiuesi Methius⁵⁵ nuk është dakord me dy çështjet sintaksore të Gjuhësisë Gjenerative Transformuese:

- a) Fjalia përbëhet nga një strukturë hierarkike sintagmash, të cilat paraqiten në një pemë varësie.
- b) Sintagmat përbëhen nga një element kokë dhe elemente të tjera të cilat janë elemente të varura të saj.

⁵⁴ N. Chomsky, *Syntactic Structures*, The Hague: Mouton, 1957.

⁵⁵ P. H. Matthews, *Syntactic Relations: A Critical Survey*, Cambridge, 2007.

Ai argumenton se këto koncepte nuk janë aq të rëndësishme sa paraqiten në këtë teori. Marrëdhëniet sintaksore janë më të larmishme.

Siç mund ta shohim edhe nga kjo paraqitje e mendimeve të gjuhëtarëve të ndryshëm në lidhje me termin *fjali*, përcaktimi dhe përkufizimi i kësaj njësie gjuhësore sjell debat mes tyre. Shkak i këtij debati është se ata u përkasin shkollave e drejtimeve të ndryshme teorike e me pikëpamje të ndryshme mbi natyrën e njësive gjuhësore. Ata argumentojnë herë duke i mëshuar aspektit *sintaksor*, herë atij *semantik* e herë të *dy aspekteve njëkohësisht*.

Pavarësisht këtyre debateve mbështetur në përkufizimet dhe hulumtimet e gjuhëtarëve, arrijmë në përfundimin se fjalia është njësia bazë për analizën sintaksore. Ajo duhet të përkufizohet duke u marrë parasysh si aspekti gramatikor (formal), ashtu dhe ai semantik (kuptimor) i përbërësve sintaksorë.

Fjalia është mjete kryesor, mënyra kryesore e formësimit, e shprehjes dhe e kumtimit të mendimit. Ajo është fragment i ligjërimit, e përbërë zakonisht prej dy a më shumë fjalësh kuptimplota të bashkuara sipas raportesh të caktuara, në bazë të ligjeve të një gjuhe, në një tërësi të vetme kuptimore, gramatikore e intonacionore⁵⁶.

Ajo është njësia më e vogël kumtuuese dhe del zakonisht me një bërthamë të vetme kallëzuesore, e përbërë prej dy a më shumë fjalësh (*kryefjalë + kallëzues*) të ndërlidhura sintaksorisht. Kallëzuesia është tipari kryesor i fjalisë, e cila vendos lidhjen ndërmjet asaj për të cilën flitet (*tema*) me atë që thuhet për të (*rema*). Janë këto tiparet dalluese, të cilat karakterizojnë përgjithësisht konceptet dhe përkufizimet që i bëhen njësisë sintaksore, *fjalisë*.

Pra, krahas kundërvënies gjuhë/ligjërim⁵⁷, ku termi *periudhë* përcaktohet si kategori e gjuhës dhe termi *frazë* si kategori e ligjërimit, kemi kundërvënien fjali (njësi e gjuhës) / fjali (njësi e ligjërimit), fjali si njësi statike (formulë minimale) dhe fjali si njësi dinamike (kumtuuese). Si njësi statike fjalia shihet si një njësi predikative, thjesht gjuhësore dhe jashtë pjesëmarrjes së folësit dhe konsituatës, kurse si njësi dinamike shihet e lidhur me folësin dhe situatën konkrete të realizimit të saj. Në këtë mënyrë, i njëjti ndërtim statik, në varësi të folësit konkret e të situatës konkrete dhe në bashkëveprim të intonacionit, rendit të fjalëve dhe të elementeve gjuhësore specifike, mund të marrë kuptime të ndryshme.

1.2. Emërtimi i njësisë ku bën pjesë fjalia e nënrenditur rrjedhimore

Në gjuhësinë tonë *fjalia* është termi që përdoret për të shënuar njësinë më themelore kumtuuese-komunikative e intonacionore të ligjërimit. Ndërsa njësia më e lartë se fjalia është shprehur me terma të ndryshëm, si: *fjali e përbërë*, *periudhë* dhe *frazë*, të cilat përdoren ndërkëmbyerazi.

Pothuajse në të gjitha gramatikat e shqipes ku trajtohet periudha, ajo është përkufizuar si një ndërtim sintaksor që përbëhet prej dy a më shumë fjalish kallëzuesore dhe formon një njësi kumtuuese, gramatikore dhe intonacionore. Ajo çka vërehet dhe shkakton debat midis

⁵⁶ M. Domi, M. Çeliku, S. Floqi, S. Mansaku, R. Përnaska, S. Prifti, M. Totoni, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 2002, f. 60.

⁵⁷ F. de Sosyr, *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 2002, f. 74.

gjuhëtarëve tanë është *emërtimi* i saj. Në fushën e terminologjisë sintaksore të gjuhës shqipe është përdorur herë njëri e herë tjetri term, shpesh bazuar dhe ndikuar edhe nga emërtimet e përdorura nga gjuhëtarë të huaj.

Përveçse në gramatikat akademike e universitare a në tekstet shkollore, periudha është trajtuar edhe në punime të veçanta, ku përmendim studimet e Spiro Floqit⁵⁸, Mahir Domit⁵⁹, Stefan Priftit⁶⁰, Menella Totonit,⁶¹ Thoma Dhimës⁶² etj. apo edhe në disa artikuj të botuar në revista e buletine të ndryshme gjuhësore.

Rrjedhën e studimeve të gjuhës shqipe në përkufizimin e periudhës e kemi grupuar sipas dy këndvështrimeve: a) tradicional dhe b) bashkëkohor, por duke nënkuptuar se kjo ndarje nuk është copëtim i saj me kufij të prerë.

1.2.1. Gramatikat tradicionale

Me sa dimë, termin *periudhë* e ka përdorur i pari Aleksandër Xhuvani në sintaksën e tij⁶³. Për prof. Xhuvanin, periudha është “bashkim i dy a ma shumë fjalive të lidhuna me një mënyrë, qi të rrëfejnë një mendim të plotë, sikurse: *Zogjt’ fluturojnë n’erë e peshqit bajnë not n’ujë*⁶⁴”. Ai vë në dukje se në një periudhë janë aq fjali, sa janë dhe kallëzuesit foljorë: p. sh., te periudha “Të gjitha lulet qi *mbuellëm u-vyshkën, pse nuk u-ujitën*”, kemi tre kallëzues foljorë: *mbuellëm, u vyshkën, u ujitën*. Pra, edhe fjalitë janë tri: 1. të gjitha lulet u vyshkën; 2. qi mbuellëm; 3. pse nuk u ujitën⁶⁵.

Prof. Xhuvani i ndan fjalitë e një periudhe në *të renditura bashkë* dhe *të lidhuna bashkë*. Sipas tij, fjalitë janë *të renditura bashkë*, kur mund të qëndrojnë në mënyrë të mëvetësishme, pa u varur nga njëra-tjetra. Ndër fjalitë e *renditura bashkë*, atë që vjen e para Xhuvani e quan “*e parë e palidhur*”, kurse atë që ndodhet pas “*e parë e renditur bashkë*”. Në anën tjetër, fjalitë e *periudhës* quhen *të lidhuna bashkë*, kur njëra ose disa prej tyre varen nga një fjali tjetër, e cila quhet e parë; të tjerat quhen të dyta a të varme⁶⁶.

Në të njëjtën hulli me Xhuvanin shkon dhe Ilia D. Sheperi.⁶⁷ Në gramatikën e tij, krahas termit *bashkëlidhje*, hasim dhe termin *periudhë*. Sipas Sheperit, njësia sintaksore që shfaq një mendim të plotë dhe ku bashkohen dy a më shumë fjali kryesore të thjeshta ose të plotësuar, quhet *periudhë*. Më pas ai sqaron se një fjali përbën një periudhë, kur e shfaq mendimin të

⁵⁸ S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative*, Studime filologjike, 1967/3, f. 21-30.

⁵⁹ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Sintaksa, Tiranë, 1997, f. 492.

⁶⁰ S. Prifti, *Klasifikimi i fjalive të varura*, Studime filologjike, 1972/2, f. 137-152.

⁶¹ M. Totonit, *Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditur*, Studime filologjike, 1990/2, f. 21-27; *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000, f. 9-15.

⁶² Th. Dhima, *Disa koncepte sintaksore në gramatikat e shqipes të gjysmës së parë të shekullit XX*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 23/1, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë 2004, f. 289-290.

⁶³ A. Xhuvani, *Njohurit e para të Syndakës shqipe, pjesë e parë për klasat e nalta të filllores*, Vlorë, 1922.

⁶⁴ *Po aty*, f. 32-33.

⁶⁵ A. Xhuvani, *Njohurit e para të Syndakës shqipe, pjesë e parë për klasat e nalta të filllores*, Tiranë, 1938, f. 2.

⁶⁶ A. Xhuvani, *Njohurit e para të Syndakës shqipe, pjesë e parë për klasat e nalta të filllores*, Tiranë, 1938, f. 24-25.

⁶⁷ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927.

plotë. Gjatë shtjellimit të periudhës autori bën këtë ndarje: “Sipas shërbimit që kryejnë në periudhë fjalit janë kryesore ose të pavarme dhe të varme ose të dyta.”⁶⁸

Sipas lidhjes që kanë me njëra-tjetrën fjalitë e periudhës, Ilia D. Sheperi i klasifikon në të bashkërenditura dhe të bashkëlidhura. Te lidhëzat bashkërenditëse ai numëron lidhëzat shtuese, dalluese, kundërshtore, përmbylltore, të cilat lidhin pjesë homogjene të fjalisë ose periudhës, kurse lidhëzat e tjera i quan lidhëza të bashkëlidhjes.

Sipas tij, fjalitë e periudhës janë të bashkërenditura “kur lidhen dy (a më shumë) fjali duke qenë që të dyja kryesore ose që të dyja të varura nga fjalia kryesore”. P.sh.: *Djali erdhi mori librat dhe shkoi; Djali erdhi të merrte librat dhe të shkonte.*⁶⁹ Ndërkohë, fjalitë e bashkëlidhura “lidhen në mënyrë që njëra varet nga tjetra si plotës i sajë, ose si fjali e varme. P. sh.: *Erdhi të merrte librat.*”⁷⁰

Në varësi të karakterit të mjeteve të lidhjes sintaksore, fjalitë e bashkërenditura Sheperi i ndan më tej në të lidhura (lidhëzore) dhe të palidhura (jolidhëzore)⁷¹.

Fjalitë e bashkërenditura të lidhura lidhen me anë të:

- a) lidhëzave shtuese;
- b) lidhëzave dalluese;
- d) lidhëzave kundërshtore;
- e) lidhëzave përmbyllëse.

Këto lidhëza, vëren autori, lidhin pjesë homogjene të fjalisë ose të periudhës me bashkërenditje. Ndërsa në fjalitë e periudhave të palidhura Sheperi përfshin edhe ato që ai i quan “fjali të ndërhyra” (fjalitë e ndërmjetme). P.sh.: *Erdhi, më thanë, që pa gdhirë.*

Studiuesi Justin Rrota i përdor, nga ana e tij, si termin *fjali e përbërë*, ashtu edhe termin *periudhë*, por jo ndërkëmbyerazi. Ai thekson se fjalia është një grup fjalësh që rrëfejnë një mendim të plotë dhe që mund të gjendet ose veçmas (*fjali e veçuese*), ose e lidhur me fjali të tjera (*fjali e përbame*). Rrota vëren se *fjalitë e përbame*, siç i quan pra ai, janë ato që kanë dy a më shumë fjali të lidhura midis tyre (të cilat ai i quan gjymtyrë), që shprehin një kuptim të tërësishëm dhe të plotë. Kushti themelor është që duhet të jenë më së paku dy kallëzues foljorë të pavarur njëri nga tjetri.

Fjalitë e varura Rrota i quan edhe *fjali të dyta* dhe sipas tij “(n)ji *fjali e përbame*, e cila, pose *fjalisë së parë*, ka edhe një a më shumë *fjali të dyta* a të *mvarshme*, thirret: *Fjali e përbame prej fjalish të dyta*”.⁷²

Justin Rrota dallon njësinë sintaksore që del vetëm me dy fjali, njëra kryesore dhe tjetra e varur, prej atyre që në përbërjen e tyre kanë tri, katër ose edhe më shumë fjali të varura e të pavarura. Ato që kanë vetëm dy fjali, ai i quan thjesht *fjali të përbame*, ndërsa ato me tri, katër e më shumë fjali i quan *fjali të përbame shumëfishe*, duke i konkretizuar me një numër shembujsh, si: *Burrnia dhe forca e vullëndetit, të cilat Skënderbeu i kish fitue qyshë në të rit e*

⁶⁸ *Po aty*, f. 168.

⁶⁹ *Vepër e cituar*, f. 163.

⁷⁰ *Po aty*, f. 163.

⁷¹ Fjalitë e palidhura në gramatikat e mëvonshme do të quhen fjalitë asindetike. (Shënimi ynë.)

⁷² At J. Rrota, *Sintaksi i shqipes, për klasat II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, 1942, f. 65.

vet, e përcollnë fatosin djeri në dekë; edhe i duel kështu burrit të botës me e mbajtun larg nga atdheu, për 24 vjet tiranin e Azis.⁷³

Sipas Justin Rrotës, vetëm *fjalitë e përbame shumëfishe* mund të jenë periudha, duke u munduar të bëjë këtë dallim ndërmjet tyre dhe fjalive të përbëra: “*Sado qi nën këtë emën perjudhë dikush thërret edhe fjalin, qi na ma nalt e quejtëm fjali të përbame; prap, ma fort, perjudhë thirret najai grumbull fjalish, ndërtume me të madhe mjeshtri e art, qi përmban në veti një mendim të vetëm, por të kryem plotësisht*”⁷⁴.

Siç shihet, për shkak të dykuptimisë së termit *fjali e përbame* [si term gjenerik për të gjitha njësitë sintaksore të përbëra prej dy a më shumë gjymtyrësh (fjalish) dhe si term për të emërtuar vetëm fjalinë e përbërë të thjeshtë prej vetëm dy gjymtyrësh] dhe marrëdhënieve hiponimike / hiperonimike që kanë, pra, këto dy kuptime me njëri-tjetrin, vetëm mund të hamendësojmë që, sipas Rrotës, dallimi mes fjalisë së përbërë dhe periudhës nuk është (vetëm) sasiar, por (edhe) cilësor. Pra, periudha për autorin është një fjali e përbërë prej më shumë se dy fjalish me mëtime artistike, duke dalë kështu tej kufijve të një njësie thjesht sintaksore a gjuhësore në përgjithësi.

Kristaq Cipo, nën ndikimin e gramatikanëve neolatinë, në gramatikën e tij përdor termin “*periodë*”, e cila, sipas tij, është “një radhë fjalish me kuptim të plotë e të vazhduar dhe simetrikisht të ndrequna”⁷⁵. Këtu ai jep shembullin: *Hamza i qahet Sulltanit se Skënderbeu nuk i dha pjesën e principatës së Matit që i binte jo vetëm si trashëgim nga i ati po dhe si çpërblim të mundimeve dhe betejave pranë tij; e dyta, shpresa që ti trashëgonte të gjitha sa fitoi Skënderbeu humbi, porsa ay u martua dhe bëri një djalë; e treta, kishte frikë që Skënderbeu, dyke zbatuar politikën e tij do të gjente një shkak që ti rrëmbente edhe atë krahinë të vockël që i kish falur në një cep të Shqipërisë, nga turpi i botës që të mos e lente të ngordhë për bukë.*

Por për Cipon *periodë* mund të jetë edhe një fjali e vetme, kur është mjaft e zgjeruar dhe shpreh kuptim të plotë, si p. sh.: *Gëzimi i kësaj fitore të çkëlqyer u turbullua nga lajma e zezë e vdekjes së Pal Dukagjinit.*

Por më pas ai thotë: “*Nuk ka perioda të formuara vetëm me fjali të varura, aqë më pak me fjali të varura të pashjtella*”⁷⁶. Sipas drejtimit logjik-gramatikor kuptohet si periudhë edhe një fjali e vetme, konceptim që e gjejmë dhe te Cipo. Një vështrim i tillë në studimet e sotme gjuhësore është kapërcyer.

Për Cipon, kufijtë e periudhës përcaktohen me anë të pikës në gjuhën e shkruar dhe me anë të pushimit të gjatë në gjuhën e folur. Edhe gjatë trajtimit të fjalive të varura ai i përmbahet termit *periodë*.

Mahir Domi, në një prej gramatikave të tij të hershme shkollore,⁷⁷ krahas termit “*periudhë*” përdor dhe termin “*frazë*”. Ai nënvizon: “*Këto grupe fjalish që shërbejnë për të treguar një mendim të plotë, më të plotë se mendimi që shpreh një fjali, i quajmë periudha ose fraza*”⁷⁸.

⁷³ At J. Rrota, *po aty*, f. 66.

⁷⁴ At J. Rrota, *po aty*, f. 66.

⁷⁵ K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952, f. 15.

⁷⁶ K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952, f. 15.

⁷⁷ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare*, Tiranë, 1955.

⁷⁸ M. Domi, *po aty*, f. 35.

Me sa jemi në dijëni, prof. Domi për herë të parë në studimet tona gjuhësore përdor termin *frazë*. Më vonë,⁷⁹ prof. Domi është prirur drejt zbutjes së dallimit ndërmjet fjalisë dhe periudhës, duke theksuar se mes tyre nuk ka ndryshime themelore. Të dyja, sipas tij, janë njësi kumtuese. Prof. Domi vëren se ka gramatika që përdorin për to të njëjtin term, *fjali*, duke dalluar *fjalinë e thjeshtë*, që i përgjigjet fjalisë dhe *fjalinë e përbërë*, që i përgjigjet periudhës. Ndryshimi për autorin është më tepër strukturor: “*fjalia është e përbërë prej fjalësh a togje fjalësh, fraza prej fjalish*”⁸⁰.

Po këtu, prof. Mahir Domi argumenton: “Disa quajnë *periudhë* vetëm frazën e gjatë, me shumë fjali, me ndërtim pak a shumë të ndërlikuar. Ka gramatika, sidomos shkollore, që pranojnë se mund të ketë *frazë të përbërë* edhe prej një fjalie dhe quajnë *frazë* edhe një fjali të veçantë”.⁸¹ Për autorin, si fjalia, si fraza përbëjnë tërësi kuptimore e gramatikore të ngjashme.

Më tej prof. Mahir Domi vëren: “*Në gjuhë të tjera duke u mbështetur në ndryshimin struktural, ndonjëherë edhe më tepër se kaq, të këtyre dy njësive sintaktike, përdoren terma të ndryshëm. E tillë është edhe tradita e gramatologjisë shqipe.*”⁸²

Sipas tij, përpjekjet e bëra nga ndonjë studiues shqiptar, si p. sh. J. Rrota etj., për të zëvendësuar termin “*frazë*” me termin “*fjali e përbërë*”, nuk kanë qenë të qëlluara dhe nuk kanë zënë vend në përdorim.

Në Gramatikën e Akademisë, në kapitullin e parë të punuar po nga prof. M. Domi, periudhë quhet “*njësia e tërësishme e lidhur kuptimore, strukturore e intonacionore, e përbërë prej dy a më shumë njësisish kallëzuesore në formë fjalie, në raporte të caktuara midis tyre*”.⁸³

Në një artikull të tij të mëvonshëm⁸⁴ përkufizimin e mësipërm Mahir Domi e plotëson më tej: “*periudha karakterizohet nga një vijë e vetme intonacionore, nga një intonacion i vetëm i mbarimit që ndihet*”.⁸⁵

Edhe në gramatikën e gjuhës shqipe për shkollat shtatëvjeçare të L. Dodbibës e S. Spasses⁸⁶ përdoret termi “*frazë*”. Kundrina e drejtë dhe fjalia kundrinore, të dyja këto kategori, plotësojnë kuptimin e foljes kalimtare:

Tha *mësimin*.

Tha *se do të mësojë*.

Më të avancuara janë konceptet e Floqit për formësimin e periudhës dhe për mjetet gramatikore e leksikore të formëimit, si për sistemin lidhëzor, për fjalët lidhëse, për

⁷⁹ M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.

⁸⁰ M. Domi, *po aty*, f. 36.

⁸¹ M. Domi, *po aty*, f. 36.

⁸² M. Domi, *po aty*, f. 37.

⁸³ Gramatika e gjuhës shqipe II, *Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 60.

⁸⁴ M. Domi, *Çështje të përgjithshme të sintaksës*, Studime filologjike, 1980.

⁸⁵ M. Domi, *Çështje të përgjithshme të sintaksës*, Studime filologjike, 1980/3, f. 102.

⁸⁶ L. Dodbibë, S. Spasse, *Gramatika e gjuhës shqipe, tekst për klasën e V^{-të} dhe të VI^{-të} të shkollës shtatëvjeçare*, Tiranë, 1955.

vështrimin e foljes-kallëzues si bazë e fjalisë dhe zgjerimin e saj, koncepti për gjymtyrëzimin aktual, për rolin e kontekstit, të situatës, të intonacionit, të rendit të fjalëve dhe të fjalive në periudhë, për bashkëlidhjet mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues etj. Në një nga trajtesat e tij⁸⁷ ai thekson se **periudha dallohet prej fjalisë, sepse ajo ka së paku dy bërthama kallëzuesore (dy fjali), secila me modalitetin (mënyrën), kohën dhe vetën e vet**⁸⁸.

Ndërtimet me formë të pashtjelluar Floqi nuk i pranon si fjali, për arsye se ato nuk kanë kategoritë gramatikore karakteristike që ka një folje (pra, që nuk kanë *verbum finitum*). Të ashtuquajturat “*fjali të varura të pashtjella*” janë vetëm një nyje sinonimiko-funksionale që qëndron midis gjymtyrës së fjalisë dhe fjalisë së varur dhe i emërton ato si “**gjymtyrë të përbëra**”.⁸⁹ Duhet thënë se këto ndërtime anojnë nga fjalia, kur kanë kryefjalë të shprehur, p.sh.: në fjalinë “**Petriti iku/pa aguar dita**”, ne pranojmë se kemi dy fjali.

Më tej autori shënon se në sintaksën shqipe do të njihen dy nyje sinonimike funksionale: brenda fjalisë gjymtyrët e fjalisë (gjymtyrët e thjeshta dhe ato të përbëra), kurse në periudhë fjalia e varur.

Floqi mbështetet në gërshetimin e aspektit semantik me atë strukturor si në studimin e fjalisë, ashtu edhe të periudhës.

Selman Riza njësitë më të mëdha se fjalitë e thjeshta i quan *fjali të përbame*. Ato krijohen dhe formësohen nga sekuenca fjalish të thjeshta, bashkërendohen sipas ligjeve të gramatikës e të gjuhës, duke krijuar njësi më të mëdha⁹⁰.

S. Prifti në sintaksën e tij, të cilën e strukturon në dy pjesë të mëdha: *a.* sintaksën e fjalisë dhe *b.* sintaksën e fjalive (ose të periudhës), e përkufizon periudhën si “një sistem fjalish të lidhuna gramatikiisht midis tyre, që shprehin një mendim të plotë, të mbaruar”⁹¹.

Me fjalë të tjera, sipas tij, periudha është një njësi sintaktike predikative, komplekse, e përbërë nga njësi predikative të thjeshta, në të cilat mund të zërthehet.

Më poshtë autori shqyrton dallimin e fjalisë nga periudha. Në dallim nga fjalia, periudha, sipas tij, paraqet së pari një ndryshim sasior, për arsye se ajo përbëhet në përgjithësi nga jo më pak se dy fjali (kriteri sasior). Kur ky numër rritet, atëherë rritet dhe vetë periudha: ajo paraqitet më e zgjeruar dhe më e shtjelluar, më e ndërlikuar dhe më e pasuruar.

Së dyti, prof. Stefan Prifti vëren se, në krahasim me fjalinë, periudha paraqet edhe një ndryshim cilësor jo vetëm në përbërjen e saj më të komplikuar, por edhe në aftësinë për të shprehur mendimin.

Në pjesën “Shënime” ai sqaron: “Në vend të termit tradicional **periudhë**⁹², është përdorur dhe përdoret edhe sot termi **frazë**. Të dyja këto janë fjalë të huaja greke. Fjala “**periudhë**” (apo *period*) është e përbërë nga *parashtesa* (parafjalë) “*peri*” dhe nga emëri “*hodhos*” (me theks në fund), që do të thotë në shqip “*udhë*”. Kuptimi fjalë për fjalë, pra i termit

⁸⁷ S. Floqi, Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme, Konferenca I e studimeve albanologjike, Tiranë 1965.

⁸⁸ S. Floqi, Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme, Konferenca I e studimeve albanologjike, Tiranë 1965, f. 220.

⁸⁹ S. Floqi, *Vepër e cituar*, f. 224.

⁹⁰ S. Riza, *Vepra 2*, botim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Prishtinë, 1997, f. 516.

⁹¹ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pjesa I, Dispensa I, 1971.

⁹² S. Prifti, *po aty*, f. 171.

“periudhë” do të ishte “rrugë, rreth”, rrugë që mbyllet në formë rrethi etj. Përdorimi në sintaksë i termit “periudhë” është i figurshëm, por fort i qëlluar dhe konkretizonjës: ai shpreh idenë dhe e bën të qartë pohimin se mendimi ynë që, përmbillet në periudhë, shprehet i përfunduar, i mbaruar...” Përkundrazi termi “frazë” është emër foljor (frasis) prej foljes “frazein”, që do të thotë “flas, shpreh, them”; ai ka kështu kuptimin e të folurit në përgjithësi, e të shprehurit, e të treguarit me fjalë të atyre që mendojmë. E thonë periudhën edhe “fjali e ndërlikuar apo e përbërë”, por periudha dhe fjalia nuk mund të identifikohen, sikurse nuk mund të identifikohet pjesa me të tërën, gjymtyra e fjalisë me vetë fjalinë.

Në fund autori sugjeron ruajtjen e atij që e quan term tradicional “periudhë”.

Koncepti bashkëkohor për periudhën dhe fjalinë nuk përputhet me këtë pohim të S. Priftit.

Përkufizimi dhe veçoritë e periudhës jepen më të plota e shkencore në Gramatikën e Akademisë⁹³: “Periudhë është njësia e tërësishme e lidhur kuptimore, strukturore e intonacionore, e përbërë prej dy a më shumë njësisish kallëzuesore në formë fjalie, në raporte të caktuara midis tyre. Ajo karakterizohet nga një vijë e vetme intonacionore, nga një intonacion i vetëm i mbarimit, që ndihet në fjalinë e fundit.”⁹⁴.

Ndërmjet fjalisë së mëvetësishme dhe periudhës nuk ka ndryshime thelbësore: të dyja ato janë njësi kumtuese. Dallimi midis fjalisë dhe periudhës është më tepër strukturor. Ndaj ka gramatika që përdorin për to (për fjalinë e periudhën) të njëjtin term, fjali, duke dalluar fjalinë e thjeshtë - që i përgjigjet fjalisë së mëvetësishme - nga fjalia e përbërë, që i përgjigjet periudhës⁹⁵. Gjatë trajtimit të çështjeve të fjalisë në këtë tekst akademik normativ gjejmë të përdorur termin *periudhë*. Termat “frazë” dhe “fjali e përbërë” nuk gjejnë vend në këtë vepër.

1.2.2 Gramatikat bashkëkohore

Dekadat e fundit gjuhëtarët tanë kanë arritur të përvetësojnë konceptet e përparuara të gjuhësisë botërore dhe t’i aplikojnë në studimet sintaksore dhe jo vetëm.

Gramatika e gjuhës shqipe studiohet sipas teorive të fundit gjuhësore, por duke pasur në konsideratë specifikat e kësaj gjuhe. Tema dhe çështje të ndryshme të saj vështrohen sipas koncepteve të reja të gjuhësisë. Koncepte të tilla vërehen në studimet e R. Memushajt, M. Totonit, M. Çelikut, L. Buxhelit, F. Kolecit etj.

Në këtë periudhë kohore vërehet gjithashtu një përpjekje për zëvendësimin e gramatikës tradicionale me atë bashkëkohore. Përditësimi i terminologjisë gjuhësore përfshin dhe termat e sintaksës.

⁹³ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997.

⁹⁴ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 61.

⁹⁵ Akademia e Shkencave, *Gramatika...., po aty*, f. 61: *Fjalia ka zakonisht një bërthamë kallëzuesore, kurse periudha bashkëlidh dy a më shumë njësi kallëzuesore me raporte të caktuara kuptimore e gramatikore midis tyre në një tërësi të vetme. Si fjalia, veçanërisht fjalia e mëvetësishme, si periudha japin një kuptim të mbaruar a relativisht të mbaruar. Periudha, duke qenë e përbërë prej disa njësisish kallëzuesore, ka shpesh një përmbajtje më të pasur, më komplekse, ndonjëherë më të plotë se fjalia. Po kjo nuk është gjithmonë e vërtetë: më se njëherë edhe një fjali e mëvetësishme mund të japë një kuptim kompleks, po ashtu si **periudha**.*

Në punimet e prof. M. Totonit shohim një rikthim të termit “*frazë*”. Që në parathënien e artikullit “Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditura”⁹⁶, studiuesi shkruan: “*Fraza me fjali të nënrenditura është një nga kategoritë më të studiuara të sintaksës shqipe*”.⁹⁷ Edhe në vazhdim të trajtimit të problemeve dhe veçorive të frazës, ai përdor termin “*frazë*”, si: *frazë vendore, frazë kohore, frazë mënyrore, frazë rrjedhimore etj.*

Sipas studiuesit, me “*frazë*” kuptohet njësi sintaksore ligjërimore që karakterizohet nga intonacioni i mbaruar dhe nga kuptimi i plotë brenda një konteksti të caktuar. Për prof. Totonin, fraza është njësi sintaksore e realizuar në një kontekst a situatë të caktuar. Ajo mund të përbëhet nga një ose më shumë fjali, por edhe nga një fjalë e vetme, e cila mund të plotësohet nga konteksti.

T. Topalli⁹⁸, ndër tre termat - *periudhë, frazë, fjali e përbërë* - mbështet termin *periudhë*, duke sjellë argumentet e mëposhtme:

a) etimologjikisht i përgjigjet më mirë përmbajtjes gjuhësore të përbërësve të saj;

b) është term i traditës së gjatë gjuhësore dhe me denduri të madhe përdorimi në gramatikat (sintaksat) e shqipes, prej rreth një shekulli;

c) shpreh mirë hierakinë e njësive sintaksore, duke shënuar edhe një kufi me paragrafin e tekstin si njësi mbisintaksore;

ç) nuk mund të krijojë pështjellim me njësi të tjera, ndryshe nga dy termat e tjerë;

d) gjatë analizës sintaksore zërthehet më mirë në fjali (jo në pjesë), të cilat në të shumtën e rasteve sot quhen njësi kallëzuesore, pasi u mungon intonacioni i përfunduar (atë e mban periudha), por kanë përherë predikativitetin e shprehur, si njëri nga dy tiparet e fjalisë.

Një qëndrim më pak të prerë lidhur me përdorimin e termave *periudhë, frazë* dhe *fjali e përbërë* duket se mban edhe Thoma Dhima. Në punimet e tij⁹⁹ hasim termat *frazë* dhe *fjali e përbërë*. Sipas studiuesit, fjali e përbërë quhet ajo njësi sintaksore që ka dy a më shumë bërthama kallëzuesore, rreth të cilave sillen elementet e tjera që i formësojnë ato, duke formuar një njësi të vetme kumtuese, intonacionore dhe sintaksore.

Dallimi midis fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë është vetëm strukturor. Pra, si fjalia e thjeshtë dhe ajo e përbërë kanë të përbashkët se kumtojnë njëllor fakte të plota nga realiteti, kanë kuptim të plotë, kanë intonacion të mbaruar dhe formësim të plotë nga ana gramatikore.¹⁰⁰

Një qëndrim të tillë duket se mban Mehmet Çeliku.¹⁰¹ Sipas M. Çelikut, *periudha*, së bashku me fjalinë e thjeshtë përbëjnë një njësi të vetme sintaksore. Ai e klasifikon periudhën si njësi të veçantë sintaksore dhe për këtë arsye, sintaksa e fjalisë së thjeshtë dhe e fjalisë së përbërë

⁹⁶ M. Totonit, *Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditura*, Studime filologjike, 1990/2, f. 21.

⁹⁷ M. Totonit, po aty, f. 98-107.

⁹⁸ T. Topalli, *Fjali e përbërë, frazë apo periudhë?*, Gjuha jonë, 1-4/2004, f. 83.

⁹⁹ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2008; Th. Dhima, *Fraza me nënrenditje kohore*, Tiranë, 2002.

¹⁰⁰ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2008, f. 134.

¹⁰¹ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe* (përbërësit sintaksorë), ILA, 2012.

duhet të trajtohen së bashku në bazë të marrëdhënieve sintaksore. Pra, kemi gjithsej dy njësi sintaksore (përbërësi sintaksor¹⁰² dhe fjalia), si dhe dy variante të shfaqjes së fjalisë (fjalia e thjeshtë dhe fjalia e përbërë a periudha). Fjalia e thjeshtë dhe periudha analizohen në aspektin strukturor dhe semantik. Gjymtyrët e fjalisë shihen si funksion i përbërësve sintaksorë dhe jo si njësi e veçantë sintaksore.¹⁰³

Dallimi i vetëm i periudhës nga fjalia e thjeshtë është se periudha përmban më shumë bërthama predikative. Bërthamat predikative të periudhës ai i quan *sifjali* ose *përbërës sifjali*¹⁰⁴.

Në tekstet e mëvonshme të sintaksës për nivele të ndryshme shkollimi e në të gjitha ribotimet e mëvonshme me autorë R. Përnaskën, A. Jasharin, L. Hariton, L. Bubanin, N. Dakon e S. Bobratin, N. Pepivanin etj., është futur në përdorim gjerësisht termi *fjali e përbërë*, duke zëvendësuar termin *periudhë* dhe termi *pjesë e nënrenditur* për të zëvendësuar termin *fjali e varur*.

Ndërsa në *Fjalorin e Shqipes së Sotme* (2002) gjejmë këtë përkufizim të fjalës *periudhë*: 1) **periudhë**: njësi e ligjërimin, e cila përbëhet nga dy a më shumë fjalë që formojnë një tërësi të vetme nga ndërtimi gramatikor, nga kuptimi dhe nga intonacioni; fjali e përbërë. *Periudha me fjali të varura kushtore (shkakore, kohore)*; 2) **frazë**: tërësi fjalësh të lidhura sipas rregullave gramatikore të cilat shprehin një mendim të plotë; 3. *gjuh. periudhë. Sintaksa e frazës. Ndërtimi i frazës. Përbërja e një fraze*.

Për Rami Memushajn¹⁰⁵, termi gjegjës në gjuhën shqipe i asaj çka shënon fjala *phrase* në gjuhën angleze është “*sintagmë*”. Por prof. Memushaj vëren se këta dy terma nuk duhet të ngatërrohen me njëri-tjetrin. Ai shprehet se në analizën tradicionale sintaksore që ndiqet në Gramatikën e Akademisë sonë të Shkencave, fjalia zberthehet në *togfjalësha* që përkufizohen si lidhje nënrenditëse fjalësh emërtuese të cilat përbëjnë edhe gjymtyrët e togfjalëshit, ndërsa analiza e përbërësve sintaksorë (constituents), që përdoret nga gjuhësia moderne, e zberthen fjalinë në përbërës që mund të jenë togfjalësha, gjymtyrë fjalie ose pjesë gjymtyrësh. Pra, *togfjalëshi* dhe *sintagma* nuk përputhen plotësisht midis tyre. Sintagma ose fraza mund të jenë një *togfjalësh* ose të përfshijnë edhe dy a më shumë togfjalësha, thekson Memushaj, por mund të jenë edhe një gjymtyrë fjalie.

Për prof. Memushajn “*sintagma është njësi me madhësi të papërcaktuar; si sintagmë mund të shërbejë një fjalë e vetme, por edhe një fjali e varur. Sintagma është më fort një njësi pune e gramatikës gjenerative dhe nuk duhet ngatërruar me togfjalëshin e sintaksës tradicionale*”.¹⁰⁶

Në tekstin e nivelit universitar *Fonetika e shqipes standarde*, po ky autor¹⁰⁷ me termin “*frazë*” quan edhe *fjalinë*, edhe *periudhën*. Pavarësisht se e identifikon termin *frazë* edhe me *fjalinë*, edhe me *periudhën*, ai e përkufizon këtë të fundit si *bashkim i fjalive të thjeshta*. Në

¹⁰² Termin përbërës sintaksor autori e përdor si barasvlerës i termave “*sintagmë*”, “*frazë*” a “*grup fjalësh*”. Shih më tej: M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILAR, 2012, f. 1-2.

¹⁰³ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILAR, 2012, f. 3.

¹⁰⁴ M. Çeliku, *Vepër e cituar*, f. 333.

¹⁰⁵ R. Memushaj, *Gjuhësia Gjenerative*, Tiranë, 2003.

¹⁰⁶ R. Memushaj, *Gjuhësia Gjenerative*, Tiranë, 2003, f. 100.

¹⁰⁷ R. Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Tiranë, 2010, f. 167.

një nga tekstet¹⁰⁸ e tij ai përmend gjithashtu termin “embedded” apo parimi i nënrenditjes, sipas të cilit një fjali e pavarur mund të bëhet pjesë e një fjalie të përbërë¹⁰⁹.

Por, në Gramatikën¹¹⁰ e hartuar prej tij për nivelin parauniversitar përfshihet edhe *sintaksa e periudhës, e cila merret me rregullat e bashkimit të fjalive të thjeshta në një periudhë (fjali të përbërë) dhe me strukturën e periudhave.*

1.3. Cilat janë termat gjegjës që përdorin gjuhët e tjera për të shënuar këto njësi sintaksore?

Nëse hedhim një vështrim panoramik lidhur me emërtimin e këtyre njësive sintaksore në gjuhë të ndryshme, vërejmë:

Termi *frazë* rrjedh nga fjala greke φράσις (“shprehje”, “stil”, “tekst”, “mënyrë të foluri”) dhe nga folja φράζω (“bëj të qartë”, “tregoj me shenjë”, “them”, “shpjegoj”, “sqaroj”).¹¹¹

Gjuhësia frënge njësinë më të madhe kumtuuese, gramatikore e intonacionore të përbërë prej dy apo me shumë njësish kallëzuesore e emërton *phrase*¹¹², e cila më pas veçohet në *phrase simple* (frazë e thjeshtë) dhe *phrase complexe* (frazë e përbërë). Gjegjës i togfjalëshit *phrase simple* në gjuhën shqipe mund të jetë fjalia e thjeshtë, që zakonisht del me një Se dhe SF bërthamë të vetme kallëzuesore; domethënë vetëm me një grup emëror dhe një grup foljor:

Ajo **erdhi**.

Ndërsa *phrase complexe* (frazë e përbërë) konsiderohet si bashkim i dy a më shumë *phrase simple* (frazave të thjeshta). Ajo erdhi **kur u err**.

Në gramatikat angleze përdoret termi *sentence complex*.¹¹³ Ndërsa *frazë* konceptohet si njësi gramatikore që mund të përbëhet prej një a më shumë fjalësh dhe që është një nga klasat e përbërësve në të cilat mund të ndahen fjalitë e thjeshta.

Gjuhësia gjermane përdor termin *Satz* për njësinë sintaksore që përmban zakonisht një bërthamë kallëzuesore dhe termin *Periode* për njësinë sintaksore që zakonisht përmban dy a më shumë fjali kallëzuesore e që ka një unitet kuptimor dhe një intonacion të përfunduar¹¹⁴.

Në gramatikat e gjuhës italiane periudha¹¹⁵ (*il periodo*) është një bashkim kompleks i ligjëritimit, i përbërë nga disa fjali të thjeshta (*proposizioni*) të kombinuara në një strukturë të vetme që ka kuptim. Një periudhë mund të ndahet në fjali të thjeshta që janë të barabarta me numrin e foljeve.

¹⁰⁸ R. Memushaj, *Gjuhësia Gjenerative*, Tiranë, 2003.

¹⁰⁹ R. Memushaj, *Gjuhësia Gjenerative*, Tiranë, 2003, f. 80-81.

¹¹⁰ R. Memushaj, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, maket, f. 115.

¹¹¹ D'Achille, *L'italiano contemporaneo*, f. 169.

¹¹² Nouvelle grammaire française: Grammaire, Volume 103. Front Cover. Maurice Grevisse, André Goosse. De Boeck Secondaire, 1995, f. 72.

¹¹³ Leech, G.- Svartvik, J. (1991) *A communicative grammar of English*, Longman, f. 288.

¹¹⁴ Duden 4, *Die Grammatik*, 1984, f. 609-61.

¹¹⁵ Maurizio Dardano, Pietro Trifone *La nuova grammatica della lingua italiana*, Bolonja, 2001, f. 385.

Pra, një periudhë ka aq fjali sa dhe folje. *Fraza* mund të përkufizohet si një shprehje gjuhësore ndërtuar në përputhje me rregullat e përgjithshme të gjuhës, që shpreh një koncept edhe jashtë një teksti dhe një situatë komunikuese. Kuptimi i këtyre shprehjeve gjuhësore gjithmonë do të jetë shumë i përgjithshëm dhe i interpretuar në mënyra të ndryshme jashtë një teksti apo një situatë komunikuese¹¹⁶. Fjalitë e nënrenditura, të quajtura edhe fjali të dyta, mund të varen nga fjalia kryesore.

1.4. Cilit term do t'i përmbahemi në punim?

Duke u nisur nga këto përkufizime, vijmë në përfundimin se termi *periudhë* është më i përhapur në gjuhësinë shqiptare për njësinë sintaksore komunikative që shënon. Pothuajse në të gjitha gramatikat e shqipes ku trajtohet *periudha*, ajo është përkufizuar si një ndërtim sintaksor që përbëhet prej dy a më shumë fjalish kallëzuesore dhe formon një njësi kumtuese, gramatikore dhe intonacionore.

Fjalia bashkohet me fjali të tjera me mjete e raporte të ndryshme dhe formon njësi më të mëdha sintaksore, periudhën. Një periudhë mund të përbëhet nga dy a më shumë fjali. Ajo përkufizohet si njësi kuptimore e intonacionore e përbërë prej dy a më shumë njësisht kallëzuesore në formë fjalie me raporte të ndryshme sintaksore¹¹⁷.

Nga ana përmbajtësore si *fjalia*, edhe *periudha* japin kuptim të përfunduar. Duket qartë që *kriteri kuptimor* nuk luan rol në dallimin fjali/periudhë. Atëherë dallimi është strukturor.

Ka fjali, folja e të cilave nuk plotësohet nga fjalë të tjera:
Petriti **iku**. Ajo **qau**.

Ka dhe fjali, folja e të cilave ndiqet nga një emër:

Petriti lexoi **librin**.

Ka dhe fjali, folja e të cilave plotësohet nga një fjali:
Ajo qau **sa plasi**.

Por, si kur ndiqet nga një emër, si kur ndiqet nga një folje, mendoj se kemi të bëjmë me një fjali e cila përmban dy grupe/sintagma kryesore, një SE (sintagmë emërore) dhe një SF (sintagmë foljore). SF mund të marrë ose të mos marrë fjalë plotësuese. Këto mund të jenë të domosdoshme: Bleu **librin**.

Por mund të mos jenë **të domosdoshme**:
Ajo qau (**sa plasi**).

Ndërsa nga ana strukturore, meqenëse periudha përbëhet nga më shumë se një bërthamë kallëzuesore, mund të dalë në disa forma dhe të ketë përbërje të ndryshme. Periudha ka strukturë më të gjerë, përmbajtje më të pasur e të plotë. Fjalia e thjeshtë ka përmbajtje kumtuese minimale, por të mjaftueshme për komunikimin.

¹¹⁶ Agostiniani L. et alii, 1983, *La lingua tra norma e scelta*, Padova, Liviana editrice.

¹¹⁷ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 2002, f. 60.

Theksi vendoset në tiparet kryesore që karakterizojnë një periudhë: fakti që ajo përbën një entitet sintaksor e semantik, i cili përbëhet nga më shumë se një fjali a njësi kallëzuesore, si dhe fakti që mes këtyre përbërësve të periudhës vendosen marrëdhënie a raporte të ndryshme sintaksore (marrëdhënie bashkërenditëse e nënrenditëse).

Edhe në mbështesim termat *periudhë*, *fjali e nënrenditur*, duke u bazuar në paralelizmin që bëhet mes fjalive të nënrenditura dhe pjesëve të ligjëratës apo gjymtyrëve të fjalisë.

Në këtë punim do të parapëlqenim përdorimin e termit *periudhë* për të shmangur çdo lloj paqartësie e pështjellimi të panevojshëm: periudha përbëhet nga dy a më shumë njësi kallëzuesore dhe formon një unitet kumtesor, gramatikor dhe intonacionor. Ajo gjatë analizës sintaksore zërthehet në *fjali dhe jo në pjesë*¹¹⁸, të cilat përgjithësisht quhen *njësi kallëzuesore*. Këto njësi mund të mos kenë plotësinë kuptimore e intonacionin e mbarimit të fjalisë së mëvetësishme, por kanë predikativitetin e shprehur si një nga tiparet e rëndësishme të fjalisë.

Nga ana tjetër, nuk mendojmë se zëvendësimi i një termi me një tjetër zgjidh edhe problematikën konceptore që lidhet me to. Sipas këndvështrimit tonë, teoria e periudhës, frazës dhe fjalisë së përbërë në gjuhën shqipe ka nevojë për rishikim e rianalizim, në mënyrë që të pasqyrojë evoluimin e gjuhës shqipe dhe karakteristikat dalluese të saj.

1.5 Tipat e periudhave: bashkërenditja dhe nënrenditja në periudhë

Në të gjitha gjuhët natyrore fjalitë mund të kombinohen me njëra-tjetrën për të formuar fjali më komplekse. Kombinimi i fjalive mund të përfshijë në përgjithësi kategori të njëjta, karakteristikë e *bashkërenditjes* ose kategori të ndryshme, *tipar i nënrenditjes*.

Tradicionalisht njihen vetëm dy lloj raportesh sintaksore që lidhen me konceptin e pavarësisë dhe varësisë: raportet e barazisë janë ato në të cilat njësitë e vëna në lidhje midis tyre qëndrojnë në të njëjtin rrafsh, pa u varur njëra prej tjetrës dhe raportet e varësisë ku njësitë qëndrojnë në rrafsh të ndryshme dhe varen njëra prej tjetrës. Këto dy kategori raportesh gjejnë shprehje në përshtatjen e marrëdhënieve midis fjalive përbërëse të periudhave me bashkërenditje dhe periudhave me nënrenditje.

Por, koncepti absolut i pavarësisë në mes të njërive që lidhen e kombinohen në mes tyre për të ndërtuar periudhën është i papranueshëm, pohon Prifti, sepse nuk mund të pranohet ekzistenca e pavarësisë (absolute) në mes dy a më shumë elementeve kur ato lidhen e bashkohen¹¹⁹. Edhe në jemi të mendimit se në ndërtimin e një periudhe të gjitha elementet që e përbëjnë atë kanë një ekzistencë më vete, vetëm sa pa u përfshirë në fjali, por, kur ato kombinohen me elemente të tjera, e humbasin pavarësinë e tyre.

Atëherë lind pyetja: Nuk kemi pavarësi gramatikore?

¹¹⁸ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 2002, f. 60: “Fjalja që është pjesë e periudhës, s’i ka të gjitha tiparet e fjalisë së mëvetësishme... Si rrjedhim, njërive kallëzuesore që përbëjnë periudhën iu është mohuar karakteri i fjalisë duke u quajtur në traditat gramatikore të disa vendeve e nga disa studiues pjesë të “fjalisë së përbërë”.

¹¹⁹ S. Prifti, *Sintaksa e Gjuhës Shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 178.

Ashtu si fjalia ka qendrën e saj organizuese kryefjalën dhe kallëzuesin, edhe periudha ka qendrën organizuese të saj, që janë fjalitë kryesore apo drejtuese, rreth të cilave grumbullohen dhe kombinohen fjalitë e tjera.

Pavarësia gramatikore kuptohet kështu si një lidhje barazie ndërmjet dy a më shumë fjalive të periudhës dhe nga funksioni gjithashtu i barabartë apo i njëjtë që projekton më pas një raport të barabartë mes tyre. Lidhja e barazisë mund të ekzistojë jo vetëm ndërmjet fjalive kryesore, por edhe atyre jokryesore, të varura. Gjendja e barazisë, si aspekt i pavarësisë gramatikore, mund të ekzistojë jo vetëm ndërmjet gjymtyrëve themelore apo kryesore, por edhe ndërmjet atyre të varura.¹²⁰ Këndej rrjedh dhe shkallëzimi i varësisë gramatikore nëpërmjet fjalive të varura. Për shembull, në periudhën “Ai vajti në pazar që të blejë vezë dhe t’i sjellë në shtëpi”, dy fjalitë e fundit varen nga fjalia e parë, por në mes tyre janë të pavarura, në raport të barabartë.

Në periudhë dy a më shumë fjali kryesore mund të jenë në raporte barazie midis tyre, por në raporte barazie mund të jenë midis tyre edhe dy a më shumë fjali të varura. Në këtë mënyrë krijohen brenda periudhës njëherazi marrëdhënie pavarësie dhe varësie.

Në ndryshim nga gramatikat tradicionale, ku vetëm dy mjete analizuese janë të përshtatshme për përshkrimin e marrëdhënieve, bashkërenditja dhe nënrenditja, hulumtimet e fundit propozojnë tri lloje raportesh¹²¹: bashkërenditje, nënrenditje dhe bashkë-nënrenditje ose bashkë-varësia (co-subordination), e cila kuptohet si një bashkërenditje e varur.

Folei dhe Van Valin propozojnë një lidhje të përshkallëzuar, duke filluar nga niveli më i ulët deri te niveli më i lartë i segmentit të tyre¹²². Në fillim të këtij segmenti qëndron bashkërenditja¹²³, e cila nuk ndërthet as varësinë, as ndërkalljen. Me ndërkallje kuptohet procesi ku një fjali përfshihet në indin e një fjalie tjetër.

Folei dhe Van Valin identifikuan tri lloje të kësaj lidhjeje përmes varësisë dhe ndërkalljes:

Bashkërenditjen, e cila nuk përfshin as varësinë, as ndërkalljen.

Nënrenditjen, e cila i përfshin të dyja, varësinë dhe ndërkalljen.

Bashkë-nënrenditjen ose bashkë-varësinë, e cila përfshin varësinë, por jo ndërkalljen.¹²⁴

¹²⁰ S. Prifti, *Vepër e cituar*, f. 179.

¹²¹ Givón, Talmy, 1979, *On Understanding Grammar*. Ch. 5, Syntactization. New-York: Academic Press, f. 208.

¹²² Givón, Talmy, 1990, *Syntax. A Functional-Typological Approach*. Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins, f. 826: Në fundin e shekullit XX, studimet në llojet e lidhjeve sintaksore ndërmjet fjalive tregojnë për një humbje të kufijve të cilët mirëpërcaktojnë marrëdhëniet e ndryshme strukturore të fjalive. Ideja kryesore është ekzistenca e një lidhjeje shkallëzimi që varion nga ndërvarësia minimale deri në një ndërvarësi maksimale të fjalive të kombinuara në periudhë, që në fakt Givoni e përcakton si lidhje e përshkallëzuar në integrimin e fjalive.

¹²³ R. G. Huddleston - G. K. Pullum et al. *The Cambridge grammar of the English Language*, Cambridge, Cambridge University Press, 2008, f. 66.

¹²⁴ Foley, William A. and Valin, Robert D. Van 1984. *Functional Syntax and Universal Grammar*. Cambridge: Cambridge University Press, f. 84.


Nisur nga ky fakt, këtë lloj lidhjeje ata e ilustronjë si më poshtë:

Bashkërenditje:

[-ndërkallje, -varësi]

(Co-ordination:

[- embedding, - dependence]




Nënrenditje:

[+ndërkallje, +varësi]

Subordination:

[- embedding, -dependence]




Bashkë-nënrenditje:

[-ndërkadhje, +varësi]

Co-ordination:

[- embedding, +dependence]



Ashtu si Van Valin, edhe Hopper dhe Traugot dallojnë një segment të fjalive të bashkuara, i cili, duke u nisur nga e majta në të djathtë, tregon shkallë gjithnjë e më të lartë të lidhjes së fjalive. Ata ndanë në tri pika kombinimet e fjalive, të cilat duke u nisur nga e majta në të djathtë, shfaqin një shkallë gjithnjë e më të lartë të lidhjes së fjalive¹²⁵:

Bashkërenditje → *Nënrenditje* → *Ndërkallje*
parataxis → *hypotaxis* → *embedding*

[- ndërkallje].....[+ndërkallje]
[-nënrenditje.....[+ndërkallje]

Pra, siç u vu re edhe më sipër, mund të themi se sintaksa e lidhjes së fjalive shihet si një spektër i mundësive strukturore, të cilat qëndrojnë midis dy skajeve që tregojnë nivel më të ulët dhe nivel më të lartë të lidhjes së fjalive.

Downing dhe Locke dalluan 2 tipa lidhjeje mes fjalive: lidhjen e barazisë (*parataxis*) dhe lidhjen e varur (*hypotaxis*), në të cilën ata identifikuan dhe ndërkalljen¹²⁶.

Ndërsa Lehmann e përkufizon bashkërenditjen dhe nënrenditjen në termat e varësisë gramatikore¹²⁷. Sipas tij, varësia është vëzhguar vetëm në fjalitë me nënrenditje dhe bashkërenditja është analizuar duke përfshirë marrëdhënie të barabarta ndërmjet lidhëzave apo mjeteve lidhëse. Kohët e fundit, analiza sintaksore sipas sintaksës gjenerative ka hedhur si hipotezë se gjuhët natyrore kanë një strukturë sintaksore hierarkike, me varësi gramatikore të shprehura në nivele të ndryshme të gramatikës.

Megjithatë, kërkimet e bëra në gjuhën e folur kanë treguar se çështja për dallimin e varësisë nuk është kaq e drejtpërdrejtë. Ashtu siç e tregon Haspelmath¹²⁸, ndonjëherë është e vështirë të dallosh bashkërenditjen nga nënrenditja, pasi mund të ndodhin mospërputhje, ku dy pjesë përbërëse të rastësishme janë në marrëdhënie barazie, në mënyrë semantike, por në mënyrë sintaksore janë në marrëdhënie varësie me njëra-tjetrën ose anasjelltas.

Në rastin e gjuhës së shenjave, e cila konsiderohet si një gjuhë relativisht “e re” (*younger*), nuk mund të varemi gjithmonë nga mjetet morfo-sintaksore për identifikimin dhe diferencimin e bashkërenditjes dhe nënrenditjes, sepse këto mjete nuk shfaqen zakonisht në gjuhët me shenja, siç është parë deri tani. Atyre u mungon një formë e shkruar e cila inkurajon zhvillimin e mjeteve lidhëse dhe plotësuesve të tyre si mjete ndihmëse morfo-sintaksore për kombinimin e fjalive¹²⁹. Mjetet morfo-sintaksore, si lidhëzat, fjalët lidhëse etj. janë shenja të zakonshme për të identifikuar strukturat bashkërenditëse dhe nënrenditëse në gjuhët e folura.

¹²⁵ Hopper, Paul and Elizabeth Closs Traugott 2003, *Grammaticalization*, Cambridge: Cambridge University Press, f. 169.

¹²⁶ Downing, A. and Locke, F. A. (1992): *A University Course in English Grammar*, Prentice Hall International (UK).

¹²⁷ Haiman, John and Thompson, Sandra A. (eds.), *Clause combining in grammar and discourse*. Amsterdam and Philadelphia: J. Benjamins (Typological Studies in Language, 18) in Conference on 'Clause Combining'; 1-3.11.1985, Albany, Rensselaerville Institute, f. 181-225.

¹²⁸ Haspelmath, Martin, 2004, Does linguistic explanation presuppose linguistic description? *Studies in Language* 28. 554–579.

¹²⁹ Matthieson, C. and Thompson, S. A. 1988. The structure of discourse and “subordination.” In *Clause Combining in Grammar and Discourse*, J. Haiman and S. A. Thompson (eds.), 275–333. Amsterdam: John Benjamins.

1.5.1 Periudha me bashkërenditje

Periudha me fjali të bashkërenditura përbëhet nga dy a më shumë fjali me raporte kuptimore barazie, bashkërenditje ndërmjet tyre, të bashkuara me anë të lidhëzave bashkërenditëse, ndonjëherë me fjalë a lokucione të barasvlershme me to.

Ato dallohen prej atyre me nënrenditje nga katër tipare kryesore:

a) Në periudhat me bashkërenditje fjalitë lidhen me lidhëza bashkërenditëse, të cilat qëndrojnë midis fjalive pa u përfshirë në indin e tyre dhe nuk mund të dalin në fillim të periudhës; përkundrazi, në periudhat me nënrenditje fjalitë lidhen me lidhëza nënrenditëse, të cilat qëndrojnë në krye të fjalive të varura, janë pjesë e domosdoshme e fjalive të varura dhe mund të dalin edhe në krye të periudhës bashkë me fjalinë të cilës i përkasin.

b) Fjalitë e periudhave me bashkërenditje lidhen vetëm me lidhëza bashkërenditëse, ndërsa fjalitë e periudhave me nënrenditje mund të lidhen jo vetëm me lidhëza nënrenditëse, por edhe me fjalë leksikore lidhëse, siç janë përemrat lidhorë dhe ndajfoljet lidhore.

c) Fjalitë e periudhave bashkërenditëse mund të bashkohen me lidhëza të përsëritura në krye të çdo fjalie, si: ose...ose; herë...herë; as...as; kurse periudhat me nënrenditje nuk mund të bashkohen me lidhëza të përsëritura.

d) Fjalitë e periudhave me bashkërenditje nuk mund të futen në indin e njëra-tjetrës, kurse në periudhën me nënrenditje ndodh që një fjali, e varur a kryesore, të hyjë në mes të një tjetre.

Nga këto tipare vetëm i pari është gjithëpërfshirës, d.m.th. përfshin gjithë tipat e periudhave, ndërsa tiparet e tjera janë karakteristike vetëm për disa tipa të caktuar periudhash. Nënrenditja është lidhje sintaksore, sepse marrëdhënia bëhet e qartë nga lidhëzat, ndërsa bashkërenditja është edhe lidhje sintaksore, edhe lidhje leksikore, pasi marrëdhënia që lind ndërmjet fjalive nuk gjen shprehje të njëkuptimshme të lidhëza, por karakterizohet në një mënyrë të përgjithshme¹³⁰.

1. 5. 2 Periudha me nënrenditje

Periudha me nënrenditje është e përbërë së paku prej dy fjalish që janë në raporte varësie midis tyre. Fjalja që shërben si bazë e periudhës quhet fjali kryesore, kurse fjalja që e plotëson, sqaron atë ose një gjymtyrë të saj, quhet *e nënrenditur* ose *e varur*.

Dihet se koncepti *nënrenditje* tradicionalisht lidhet për nga kuptimi me konceptin e varësisë. Në përkufizimin tradicional të fjalisë së nënrenditur gjuhëtarët janë mbështetur në:

- Llojin e lidhjes mes fjalisë kryesore dhe fjalisë së nënrenditur (lidhja e varësisë).
- Pamundësinë e fjalisë së nënrenditur për të qëndruar më vete, e pavarur.
- Paralelizmin e periudhës me fjalinë dhe atë të fjalive të nënrenditura me gjymtyrët e fjalisë.
- Rendin e fjalisë së nënrenditur në një periudhë duke theksuar lidhjen e varësisë që karakterizon fjalinë e nënrenditur kundrejt fjalisë kryesore.

¹³⁰ Shih më shumë: M. Çeliku, M. Domi, S. Floqi, S. Mansaku, R. Përnaska, S. Prifti, M. Totoni, Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, 2002, II, f. 439-501.

Varësia shihet si një marrëdhënie asimetrike - si në gjuhësi, edhe në jetën e përditshme. Nëse A është e varur nga B, atëherë B nuk mund të varet nga A. Por B mund të jetë e varur dhe nga një njësi e tretë C dhe kështu me radhë. Kjo do të thotë se B është në një pozicion më të lartë në strukturën kryesore.

Gjuhëtarët e kanë konceptuar nënrenditjen nga këndvështrime të ndryshme. Prishiani përdori konceptin e nënrenditjes (varësisë) për të dalluar kategorinë e emrave, foljeve dhe përemrave nga fjalët e tjera, pasi këto të fundit përdorshin në lidhje sintaksore të varura nga emrat ose foljet¹³¹.

Gramatikanët mesjetarë, modistët, mbështetur te gramatikat e Prishianit dhe Donatusit, duke depërtuar në strukturën e fjalisë dalluan marrëdhëniet sintaksore nga ato sipërfaqësore, të përcaktuara me anë të eptimit dhe analizuan marrëdhëniet sintaksore ndërmjet fjalive apo përbërësve të tyre me termat e varësisë dhe përfundimit (plotësimit) të varësisë. Kështu, një fjali konsiderohet si e tillë, nëse klasat e fjalëve ndërtojnë një strukturë sintaksore, p.sh. emër + folje. Duke pasur parasysh rendin e fjalëve në fjali, ata përdorën termat “kalimtar - jokalimtar” për disa marrëdhënie sintaksore ndërmjet përbërësve të fjalisë; p.sh. marrëdhënia emër - folje është jokalimtare, kurse marrëdhënia folje - emër është kalimtare.

Termtat “varësi” dhe “përfundim” modistët i përdorën edhe për të dalluar fjalitë e nënrenditura nga ato kryesore.¹³²

Sipas Jespersenit, fjalia e nënrenditur vendoset përballë asaj që ai e quan fjali kryesore (principal clause).¹³³ Koncepti kryesor jo gjithmonë lidhet me atë që ne e përkufizojmë si fjali kryesore, pohon ai. P.sh., në periudhën *It is true that he is very learned*,¹³⁴ fjalia kryesore *it is true* mund të zëvendësohet nga *certainly* dhe si rezultat të kemi një fjali tjetër, si: *Certainly he is very learned*. Është e vërtetë që ai është i ditur, *I tell you that he is mad* dhe *He is mad, as I tell you*. **Sigurisht**, ai është i ditur. Si rrjedhim, fjalia e nënrenditur kthehet në kryesore duke mbartur dhe kuptimin kryesor.

Hadëlstoni e përkufizon nënrenditjen si *lidhje sintaksore varësie e cila shënjohehet nga një lidhëz nënrenditëse*.¹³⁵

Hulumtimet e mëvonshme sjellin një përkufizim të nënrenditjes si lidhje sintaksore e cila shënjohehet nga një lidhëz nënrenditëse¹³⁶. Sipas Quirk, Greenbaum, Leech, varësia është karakteristikë e fjalive komplekse.¹³⁷

Fjalia e varura nuk mund të qëndrojnë më vete, kësisoj kanë nevojë për një tjetër fjali mbështetëse. Raportet në një periudhë me nënrenditje krijojnë shkallë të ndryshme të varësisë. Kështu, varësia mund të jetë 1°, 2° e 3° e shkallës së parë, të dytë a të tretë.

¹³¹ R. H. Robins. *A short History of Linguistics*, Longman Group Limited, London, 1967, f. 61.

¹³² R. H. Robins. *A short History of Linguistics*. Longman Group Limited, London, 1967, f. 78.

¹³³ Logman Dictionary of Contemporary English, (2003), f. 1054.

¹³⁴ Jespersen, O., *The Philosophy of Grammar*, London: Allen and Unwin, 1935, f. 136.

¹³⁵ Huddleston, R.- Pullum, G. (2008), *The Cambridge Grammar of English Language*, Cambridge University Press, f. 948; Quirk, R.- Greenbaum, S. -Leech, G. -Svartvik, J. 91985). *A Comprehensive Grammar of English Language*, Longman, London and York, f. 719.

¹³⁶ Lecch, G. -Svartvik, J. (1991), *A communicative grammar of English*, Longman, f. 294.

¹³⁷ Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Svartvik, J. (1985): *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman Group UK Limited, f. 60.

Ajo nuk mund të qëndrojë e mëvetësishme, por përbën një fjali, kur bëhet pjesë ose bashkohet me një fjali të pavarur (të thjeshtë)¹³⁸, p.sh.: Ajo u gëzua [kur dëgjoi që ra zilja]. Fjalja e nënrenditur lidhet me kryesoren me anë të lidhëzave nënrenditëse, të cilat tregojnë lidhjen semantike që vendoset midis tyre.¹³⁹

Lehmann¹⁴⁰ synon të përcaktojë parametrat më kryesorë të cilët duhen analizuar në formimin e periudhave. Ai propozoi gjashtë parametra për analizën e strategjive të lidhjes së fjalive:

1. Struktura hierarkike e fjalisë së nënrenditur: bashkë-nënrenditje ----nënrenditje.
2. Shkalla e varësisë mes fjalisë së nënrenditur dhe fjalisë kryesore.
3. Shpërbërja (desemantizimi) e fjalisë së nënrenditur, humbja e karakteristikave të saj, të tilla, si intonacioni, aspekti etj.
4. Gramatikalizimi i foljeve kryesore, i cili na orienton drejt strukturave të fjalive të thjeshta.
5. Kombinimi i fjalive.
6. Lidhja e shprehur me anë të mjeteve lidhëse: lidhje sintetike dhe lidhje asindetike.

Studimet e tij gjuhësore kontribuuan në krijimin e një tipologjie të lidhjes së fjalive që mund të aplikohet në periudha të ndryshme historike të një gjuhe.

Kriteri i tij për shkallën e qartësisë së lidhjes së strukturave sintaksore është pothuajse i njëjtë me atë të Hopper dhe Traugott. Sipas tij, kohezioni maksimal del jo vetëm nga përfshirja e një numri të madh të shënjesve gramatikorë, por dhe nga heqja e elementeve të tepërta, si përsëritjet dhe përemrat përgjithësues.

[-ndërkallje..... [+ndërkallje]
[-nënrenditje.....[+nënrenditje]
[+qartësi e lidhjes.....[-qartësi e lidhjes]

Përfaqësuesit e gjuhësisë funksionaliste Andruj, Kristofaro, Longreis, Nunan, Stasen etj. pohojnë se funksionet dhe jo strukturat janë pika e tyre e nisjes në një fjali me nënrenditje.

Kështu, Kristofaro në studimin e saj bazuar në gjuhësinë funksionale¹⁴¹, ku dallon 18 nënklasa semantike të nënrenditjes, thekson se forma e fjalive përcaktohet nga karakteristikat e marrëdhënieve semantike të tyre. Llojet e marrëdhënieve të vendosura mes fjalive të nënrenditura dhe atyre kryesore janë:

- a) Marrëdhënie të vendosura mes një gjymtyre emërore të fjalisë kryesore dhe fjalisë së nënrenditur (fjalitë lidhore).
- b) Marrëdhënie të cilat përcaktohen nga semantika e foljes kallëzues të fjalisë kryesore (fjalitë emërore).
- c) Marrëdhënie rrethore (fjalitë ndajfoljore).

Gjuhëtarët e Gjuhësisë së Rolit dhe Referencës operojnë me termin “bërthamë” [-e varur] për fjalinë e pavarur, kryesore dhe cak, kufi [+ e varur] për fjalinë e nënrenditur.

Si rrjedhim, kemi këto lloj bashkime fjalish:

a. bërthamë + bërthamë ----bashkërenditje

¹³⁸ Hornby, A. S. (1989/1999/2010), Oxford Advanced English dictionary, Oxford University Press, f. 1292.

¹³⁹ Carter, R.- McCarthy, M. (2006), Cambridge Grammar of English, Cambridge University Press.

¹⁴⁰ Lehmann, Christian 1988, "Towards a typology of clause linkage." Haiman, John and Thompson, Sandra A. (eds.), *Clause combining in grammar and discourse*. Amsterdam and Philadelphia: J. Benjamins (Typological Studies in Language, 18); 181-225.

¹⁴¹ Shih më shumë: Cristofaro, S. (2003). *Subordination*. Oxford: Oxford University Press;
Cristofaro, S. (2008). Asymmetric events, subordination, and grammatical categories. In B. Lewandowska-Tomaszczyk (Ed.), *Asymmetric events*, pp. 151-72. Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.

b. bërthamë + skaj, kufi-----nënrenditje

Shkalla më e lartë e nënrenditjes identifikohet si ndërkallje e fjalisë.

Sa më i lartë të jetë niveli i qartësisë së lidhjes, aq më i ulët është niveli i varësisë.

Fillimi i segmentit= [-varur, - ndërkallje]¹⁴²-----kombinim i dy fjalive me raporte të barabarta (bashkërenditje).

Në ekstremin tjetër të segmentit gjejmë:

Fundi i segmentit= [+varur, + ndërkallje] -----kombinim i dy fjalive me raporte të pabarabarta (ndërkallje).

Pjesa e mesme e segmentit përbëhet nga periudha përbërësit e të cilave nuk shfaqin vlera ekstreme të parametrave.

Nisur nga përcaktimi i shkallëzuar i parimit të varësisë apo lidhjes së fjalive në periudha, fjalitë e bashkërenditura dhe fjalitë e nënrenditura klasifikohen në: a. Fjali me nivel zero të varësisë (fjali të bashkërenditura), p.sh.: *Ajo hëngri bukë dhe shkoi në punë.*

b. Fjali me nivel të mesëm të varësisë, që nënkupton fjalitë e nënrenditura me nivel të mesëm të varësisë, që mund të hiqen nga kjo e fundit, pasi shërbejnë si informacion shtesë për të (fjalitë lidhore), p.sh.: *Unë kam mësuar shumë nga tregimet [që shkruan ai].*

c. Fjali me nivelin më të lartë të varësisë, fjalitë e ndërkallura, të cilat nuk mund të shpëputen nga fjalia kryesore, pasi përbëjnë një element të rëndësishëm në kuptimin e periudhës si një e tërë. *Ishte ai [që e donte Albanin drejtor].*

Si përfundim, mund të themi se tipari thelbësor i periudhës me fjali të nënrenditur është se elementet përbërëse të saj lidhen me njëra-tjetrën me anë të mjeteve lidhëse dhe krijojnë lidhje varësie mes tyre. Nënrenditja formalisht gjen shprehje në lidhëzat, në lokucionet nënrenditëse dhe në fjalët lidhëse, që zakonisht i prijnë fjalisë së varur dhe e lidhin me fjalinë kryesore.

Në këtë mënyrë fjalitë e nënrenditura, ndryshe nga fjalitë kryesore, nuk mund të qëndrojnë më vete për nga kuptimi dhe ana formale, nuk shërbejnë si njësi sintaksore të pavarura dhe nuk janë të barabarta me fjalinë e thjeshtë.

Ndryshe nga studiuesit e gjuhësisë gjenerative, të cilët shpeshherë e anashkalojnë përbërësin semantik në analizën e fjalive dhe periudhave, duke i parë ato në formë skematike (lidhjet gramatikore, skema x-bar)¹⁴³, përfaqësuesit e Gjuhësisë Tradicionale dhe ata të Gjuhësisë së Rolit dhe Referencës bëjnë një studim semantiko-sintaksor të tyre.

Për shembull, në fjalinë e dhënë nga Halliday dhe Matthiessen gjatë trajtimit që u bëhet ndërtimeve rrjedhimore *Pat chopped the carrot into peces*¹⁴⁴ (*Pati copëtoi karotat në copa*), bëhet një analizë semantike e fjalisë që përshkruan një proces i cili përfshin një *veprues* dhe një *pësues*.


¹⁴² Shenja - tregon se kësaj fjalie i mungon tipari për të cilin bëhet fjalë (niveli minimal i shprehjes së tiparit bashkërenditës a nënrenditës).

¹⁴³ N. Chomsky, 1970. Remarks on nominalization. Readings in English transformational grammar, ed. by Roderick A. Jacobs and Peter S. Rosenbaum, 184-221. Waltham, Massachusetts: Ginn.

¹⁴⁴ Halliday, A. K. and Christian Matthiessen. 2004. *Introduction to Functional Grammar*. London: Edward Arnold, 183-194.

Te fragmenti i fjalisë *Pati copëtoi karotat* përshkruhet fillimisht procesi i kalimtarisë e më pas përzgjidhen elementet kuptimore. Elementi *copëtoi* konsiderohet si një lloj *zhvillimi*. Rrjedhimi i këtij përshkrimi ilustron në skemën e mëposhtme:

Skema nr. 1




Kryefjala dhe kundrinori gjenerohen duke u përshkruar dy herë nënsistemi i sendit, pra, *Pati* dhe *karotat* duke na dhënë fjalinë *Pati preu karotat*.

Për Halliday dhe Matthiessen kur përzgjidhet një folje që tregon zhvillim veprimi, atëherë futet menjëherë një tjetër nënsistem, i cili përcakton rezultatin e procesit. Plotësi gjenerohet duke hyrë në nënsistemin e cilësisë. Nga përzgjedhja e përbërësve të duhur kuptimorë do të prodhohet edhe *në copa*. Kësisoj përftohet fjalia e plotë *Pati copëtoi karotat në copa*.

Ndërtimi rrjedhimor prodhohet duke përshkruar nënsistemin e kalimtarisë, me qëllim që të gjenerojmë fjalinë *Pati copëtoi karotat në copa*.

Skema nr. 2



Nëse do të përqendroheshim vetëm në strukturat sintaksore dhe semantike do të përftohej analiza e mëposhtme:

<i>Pat</i> (<i>Pati</i>)	<i>chopped</i> (proces)	<i>the carrot</i> <i>Pësues</i>	<i>into peces</i> (<i>në copa</i>)
Actor (Veprues)	Process (Proces)	<i>Pësues</i>	<i>Plotës</i>
Nominal grup (Grup emëror)	Verb grup (Grup foljor)	Nominal grup (Grup emëror)	Quality group (Grup cilësor)

Ata hedhin poshtë formatet standarde të paraqitjes së strukturës së periudhës me fjali të nënrenditur, me argumentin se ato nuk janë universale dhe nuk mund të veprojnë në çdo gjuhë. Ndryshe nga Çomski, ata janë të mendimit se nuk është i nevojshëm asnjë mekanizëm i pavarur për përvetësimin e gjuhës.

Paraqitja sintaksore e sintaksës së fjalisë së nënrenditur quhet nga teoricienët e Gjuhësisë së Rolit e Referencës si struktura e shtresëzuar e një fjalie të nënrenditur, të cilën e kemi paraqitur në skemën 3.¹⁴⁵

¹⁴⁵ Robert D. Van Valin, Jr. A Summary of Role and Reference Grammar, në <http://www.acsu.buffalo.edu/~vanvalin/rrg/RRGsummary.pdf>, f. 2.

Sipas Van Valin dhe La Pola,¹⁴⁶ fjalitë dhe rendi janë universalë, ndërsa pozicioni i majtë i pavarur (PMP) dhe pozicioni i djathtë i pavarur (PDP), pozicioni paraprirës i njësisë bazë (PPrNjB) dhe ai pasues i njësisë bazë (PPsNnB) janë pozicione sintaksore jouniversale. Këto varen nga renditja në një vijë të drejtë e elementwve tw njw fjalie.

Sipas Van Valin, në fjalinë *Yesterday, what did John give to Mary in the library?*¹⁴⁷ (Çfarë i ka dhënë dje Xhoni Marisë në bibliotekë?, *yesterday* (dje) qëndron në pozicionin e majtë të pavarur (PMP), ndërsa *what* në pozicionin paraprirës të njësisë bazë (PPrNjB).

Në varësi të shkallës së lidhjes në periudhë bëhet dallimi midis dy pozicioneve. Në ndryshim nga *yesterday*, fjala *what* (çfarë) nuk mund të ndahet me presje apo nëpërmjet intonacionit me pjesën tjetër të fjalisë.

Pozicionet paraprirëse dhe pasuese të njësisë bazë janë pjesët e brendshme të fjalisë, ndërsa pozicioni i djathtë i pavarur (PDP) dhe pozicioni i majtë (PMP) janë pjesë e brendshme e periudhës, por pjesë e jashtme e fjalisë. Në këtë skemë janë paraqitur aspekti, statusi, koha, modaliteti dhe qëllimi i thënies së një periudhe, të cilat janë elemente që ndikojnë në shtresëzimet e ndryshme përbërëse të periudhës a fjalisë.

Gjuhëtarët tradicionalë bëjnë një dallim të prerë mes *bashkërenditjes* dhe *nënrenditjes* duke i parë si raporte të cilat nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, ndërsa përfaqësuesit e Gjuhës së Rolit e Referencës e paraqesin *bashkërenditjen* dhe *nënrenditjen* si përbërës të një segmenti, ku shkalla e varësisë vjen duke u theksuar nga e majta në të djathtë. Ne mendojmë se midis bashkërenditjes dhe nënrenditjes ka pika afrimi dhe raste kalimtare, kur fjalia e bashkërenditur është shumë afër fjalisë së varur ose e anasjella. Kjo ndodh sidomos kur në fillim të njëres fjali ndodhet një lidhëz nënrenditëse dhe në fillim të fjalisë tjetër një lidhëz bashkërenditëse (fjalitë lejore, shkakore).

Ne mbështesim mendimin se marrëdhëniet mes fjalive është mirë të analizohen si një vijimësi e integritimit strukturor. Një konceptim i tillë nuk bie në kundërshtim me atë të gjuhësisë tradicionale, por vetëm i pasuron ato duke i sjellë në një mënyrë tjetër. Ekzistojnë shumë mundësi të ndryshme strukturore, të vendosura në bazë të shkallëve të ndryshme të realizimit të karakteristikave përkatëse, por mundësitë më të shpeshta, siç u vu re, janë ato që paraqiten në ekstremet e grafikut të propozuar (Huper e Traugot), pra fjalitë e bashkërenditura dhe të nënrenditura gjejnë përdorim më të shpeshtë se ato që janë në mes të grafikut.

1.6 Mjetet e formësimit të periudhave

Periudha është njësi kumtuese gramatikore e intonacionore e përbërë prej dy a më shumë njësisish kallëzuesore. Këto njësi kallëzuesore nuk janë krejtësisht të ngjashme me fjalitë e thjeshta, sepse nuk kanë as intonacion të plotë, të mbaruar, as kuptim relativisht të plotë e ndonjëherë nuk kanë as skemë strukturore si ajo e fjalive të pavarura.

Mjetet kryesore që shërbejnë për formësimin e periudhës janë:

a) Intonacioni, që shpesh shërben për të shprehur marrëdhëniet semantike-gramatikore midis fjalive përbërëse të periudhës, sidomos të periudhës asindetike. Për shembull, po të marrim

¹⁴⁶ Shih më tej: Van Valin, Robert D., Jr. and Randy J. LaPolla. 1997. *Syntax: structure, meaning and function*. Cambridge: Cambridge University Press.

¹⁴⁷ Robert D. Van Valin, Jr. A Summary of Role and Reference Grammar, në <http://www.acsu.buffalo.edu/~vanvalin/rrg/RRGsummary.pdf>, f. 2

periudhën asindetike “*S’na flasin, s’u flasim*”, mund të kemi lloje të ndryshme marrëdhënies sipas intonacionit me të cilin e shqiptojmë këtë periudhë:

1. Po ta shqiptojmë me intonacion numërimi, do të kishim një fjali të barasvlershme me “*S’na flasin dhe s’u flasim*”.
2. Po ta shqiptojmë me intonacion kushtëzimi, do të kishim një fjali me marrëdhënie kushtore, si “*Nëse s’na flasin, s’u flasim*”.
3. Nëse vendosim marrëdhënie shkakore, do të kishim fjali të ngjashme me: *S’na flasin, sepse (ose meqë) s’u flasim*.

b) Bashkëlidhja e trajtave kohore e mënyrore të foljeve - kallëzues.

Në disa lloje periudhash ekziston një bashkëlidhje e caktuar e trajtave kohore e mënyrore të foljeve - kallëzues të fjalive përbërëse. Kështu, në fjalitë kohore, për të treguar njëkohësi në të tashmen, të dyja foljet - kallëzues të fjalive të periudhës duhet të jenë në të tashmen e dëftores: *Kur ikën macja, lozin minjtë*.

Në fjalitë kryefjalore, kallëzuesore, përcaktore etj. mënyra e foljes kallëzues së fjalisë së nënrenditur mund të përcaktohet nga modaliteti leksikor i fjalisë kryesore. Nëse folja kallëzues e fjalisë kryesore tregon dëshirë a shprehje vullneti, folja - kallëzues e fjalisë së varur vihet në lidhore: *Dua të vij dhe unë*.

Mënyra dëftore përdoret në fjalinë e nënrenditur, kur kjo ka të bëjë me emra a mbiemra që tregojnë një vlerësim objektiv si fakt etj. (*Është fakt që nuk kemi bërë sa duhet*.)

Përmendim këtu se ka një zgjerim të përdorimit të lidhores në fjalitë e nënrenditura në dëm të dëftores. P.sh.: *E pashë të vinte*. Kur ka kuptim kohor, në vend të mënyrës lidhore mund të përdoret mënyra dëftore me lidhëzat tek kur, ndërsa. *E pashë tek (kur) vinte*. Lidhësia duhet të përdoret kur fjalia shpreh marrëdhënie rrethore, p.sh.: *E pashë që (= me qëllim që) të vinte*. Prandaj mendojmë se është i gabuar në këto raste përdorimi i lidhores.

c) Rendi i fjalive

Rendi i fjalive të periudhës është i rëndësishëm për strukturën dhe vlerën e periudhës. Periudhat me bashkërenditje kanë rend të ngulitur dhe të pandryshueshëm për arsye semantike. Ndryshimi i tyre do të çonte në ndryshimin e marrëdhënies semantike të mëparshme. P.sh., në fjalinë “*Kishte nxehtë dhe i pihej ujë*”, nuk mund ta kthejmë në rend të anasjellë, sepse do të prisheshin marrëdhëniet kuptimore, gjë që e bën të paqartë lidhjen kuptimore. Në ndonjë rast tjetër, ky rend nuk mund të ndryshojë për arsye strukturore, d.m.th. në fjalinë e dytë ka fjalë që përmendin a i referohen një fjale që gjendet në fjalinë e parë dhe rendi i anasjellë do të ishte e pakuptimtë, p.sh.: “*Urbani u ndal në qendër të qytetit dhe prej tij zbritën pasagjerët*”. Togu “prej tij” përmend këtu emrin “urban”, kështu që nuk mund të kemi rend tjetër. Ndërrimi i rendit, në këtë rast, do të ndryshonte rrjedhën logjike të ngjarjeve.

Rendi i fjalive të bashkërenditura nuk mund të ndërrohet, edhe kur kemi marrëdhënie të pasimit në kohë, p.sh.: “*Ajo hodhi dru në sobë dhe u ul pranë meje*.”

Karakteristikë e fjalive të nënrenditura është rendi i lirë. Ato mund të kenë rend:

1. të paravendosur (fjalitë e varura i paravendosen fjalisë kryesore a drejtuese);

2. të prapavendosur (fjalitë e varura i prapavendosen fjalisë kryesore a drejtuese);
3. të ndërvendosur (fjalitë e varura futen në mes të fjalisë kryesore), sipas llojit të tyre ose sipas karakteristikave të ndryshme stilistikore. Ka dhe fjali të nënrenditura të cilat zakonisht kanë rend të ngulitur (fjalitë rrjedhimore).

Rendi i zakonshëm i gjymtyrëve të fjalive nga e cila përbëhet periudha me nënrenditje është *kryefjalë+kallëzues+kundrinor+rrethanor*, por ai mund të ndryshojë, pa ndryshuar raportet sintaksore.

Njësitë kallëzuesore të saj, si fjalia kryesore edhe ajo e nënrenditur, përbëhen nga po ato gjymtyrë (kryefjalë, kallëzues, kundrinor, rrethanor etj.). Fjalia mund të fillojë edhe me kallëzuesin, me kundrinorin apo me rrethanorin. Por si në fjalitë kryesore, ashtu edhe në ato të nënrenditura mund të mungojnë gjymtyrë. Fjalia e nënrenditur mund të ketë të njëjtën kryefjalë me atë kryesore ose një kryefjalë të ndryshme nga ajo, p.sh.: *Ajo e shikonte me gëzim teksa (nipi) luante.*

Rendi i fjalive asindetike (jolidhëzore) është zakonisht i ngulitur. Rendi i anasjellë është shumë i përdorur në gjuhën shqipe. Ndërimi i tij mund të sjellë ndryshime të karakterit stilistik, duke vënë theksin mbi këtë ose atë fjali, por nuk ndikon mbi raportet sintaksore.

d) Mjetet e lidhjes

Në bazë të mjeteve lidhëse periudhat tradicionalisht janë ndarë në dy grupe: në periudha lidhëzore dhe në periudha lidhëzore asindetike. Periudhat lidhëzore, sipas llojit të lidhjes dhe mjeteve shprehëse të tyre, klasifikohen më tej në periudha me bashkërenditje dhe nënrenditje. Këta dy tipa lidhjesh përbëjnë bazën strukturore e semantike të periudhave dhe klasifikimit të tyre. Nga karakteri i mjeteve të lidhjes sintaksore, periudha ndahet në dy grupe të mëdha: periudha lidhëzore (me lidhëza, me fjalë lidhëse) dhe në periudha jolidhëzore (asindetike)¹⁴⁸.

Në Gramatikën e Akademisë klasifikimi i periudhave bëhet duke vënë në bazë *karakterin e mjeteve të lidhjes sintaksore të përbërësve*. Por, ka autorë, si Mehmet Çeliku që klasifikimin e periudhave e bëjnë duke vënë si kriter bazë *karakterin e lidhjeve sintaksore të përbërësve*¹⁴⁹, që janë: lidhjet bashkërenditëse dhe lidhjet nënrenditëse.

Pra, tipat *periudha lidhëzore* dhe *periudha jolidhëzore*, sipas Çelikut nuk mund të konsiderohen dy grupet e mëdha të klasifikimit të periudhave, por dy nëntipa të periudhave bashkërenditëse; periudhat me bashkërenditje dhe nënrenditje nuk janë nëndarje të periudhave lidhëzore; gjithashtu, periudhat jolidhëzore (asindetike) nuk duhen studiuar më vete si grup i veçantë semantiko-strukturor, nuk duhen njohur si një kategori e tretë e periudhave me bashkërenditje dhe nënrenditje, por si një nëntip i fjalive të përbëra bashkërenditëse.

Në mjetet e lidhjes hyjnë lidhëzat, përemrat e ndajfoljet lidhore, si *që, i cili, ku, kur* etj. dhe fjalët e bashkëlidhura (korrelative). Lidhëzat janë mjeti kryesor i bashkimit të fjalëve në periudhë. Në dallim prej tyre, përemrat e ndajfoljet lidhore (të quajtura me një emër të përbashkët fjalë lidhëse) jo vetëm lidhin dy fjali, por njëkohësisht janë dhe gjymtyrë të fjalive të varura ku ndodhen. Ndërsa fjalët e bashkëlidhura përdoren përbrenda fjalisë kryesore dhe

¹⁴⁸ Akademia e Shkencave, "Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa", Tiranë, 1997, f. 437.

¹⁴⁹ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe* (përbërësit sintaksorë), ILA, 2012, f. 2.

shënojnë diçka, përmbajtja e së cilës zbulohet konkretisht në pjesën tjetër. Si të tilla përdoren kryesisht ndajfoljet aq, kaq, ashtu, kështu etj., përemrat dëftorë ai, ky etj.

Lidhëzat përgjithësisht klasifikohen në lidhëza bashkërenditëse, që shërbejnë për të vendosur marrëdhëniet e barazisë mes gjymtyrëve a fjalive dhe lidhëza nënrenditëse, që shërbejnë për të vendosur marrëdhëniet e varësisë të emërtuara komplementuese në gjuhësinë gjenerative. Nga pikëpamja e kuptimit ato ndahen në dy grupe: lidhëza semantike dhe josesantike¹⁵⁰.

Në teorinë x-bar,¹⁵¹ propozuar nga Çomski dhe zhvilluar më tej nga Jackendoff, përdoret termi *komplementues* për të shënuar lidhëzat në periudhat me nënrenditje.

Në studimet e viteve të fundit hasim termin *konektor*, ku përfshihen pjesëzat dhe lidhëzat bashkërenditëse e ato nënrenditëse. Në lëmin e studimit të gjuhësisë së tekstit konektorët zënë një vend shumë të rëndësishëm si elemente bazë të konektivitetit të brendshëm të tekstit.


Duke qenë se lidhëzat përbëjnë grupin kryesor të konektorëve (konektorët përfshijnë klasa të ndryshme fjalësh, si lidhëza, pjesëza, pasthirrma, ndajfolje etj.), ato analizohen si mjete lidhëse shërbyese përtej njësisë komplekse strukturore të periudhës. Përtej periudhës, ato shihen si një element i rëndësishëm jo vetëm strukturor, por edhe semantiko-logjik i një teksti.

Ato shërbejnë për të garantuar qëndrueshmërinë e kuptimit të tekstit në tërësinë e tij dhe ndihmojnë në ndërtimin e kohezionit (aspekti semantik i tekstit), si dhe të koherencës tekstuale (vazhdimësia a përvijimi kuptimor në tekst) dhe realizojnë krahas të tjerave lidhjen logjike të pjesëve të tij.¹⁵² Vlera që mbartin si elemente të domosdoshme në organizimin e tekstit dhe roli që lidhëzat luajnë në interpretimin e tij, bëjnë që të jenë në qendër të vëmendjes së gjuhëtarëve të ndryshëm.

Duke qenë se punimi ynë është periudha dhe jo teksti, atëherë edhe termi i përdorur për t'iu referuar mjetit që realizon lidhjen mes fjalive të një periudhe do të jetë *lidhëz* dhe jo *konektor*. Shembulli i mëposhtëm ilustron komplementuesin dhe rolin e tij në një periudhë me fjali të nënrenditur rrjedhimore.

Skema nr. 4

Tom u egërsua, *sa i dridhej tërë trupi*.



sa i dridhej tërë trupi

¹⁵⁰ Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë, 1995, f. 398.

¹⁵¹ Shih më tej: Chomsky, Noam (1970). Remarks on nominalization. In: R. Jacobs and P. Rosenbaum (eds.) *Reading in English Transformational Grammar*, 184-221. Waltham: Ginn.;

Jackendoff, Ray (1977). *X-bar-Syntax: A Study of Phrase Structure*. Linguistic Inquiry Monograph 2. Cambridge, MA: MIT Press.

¹⁵² K. Dibra - N. Varfi, *Gjuhësi teksti*, ShBLU, Tiranë, f. 64.

Skema e mësipërme ilustron atë që në gjuhësinë gjenerative njihet si paraqitja e skemës x-bar të periudhës me fjali të nënrenditur, ku komplementuesi (lidhëza) luan rol parësor, pasi ai përcakton tipin e fjalisë nga e cila do të ndiqet. Kështu, në këtë shembull lidhja e fjalive në periudhë realizohet me anë të komplementuesit sa, i cili projekton një sintagmë a një fjali të nënrenditur (sa i dridhej tërë trupi). Kjo sintagmë është një projekcion i sintagmës komplementuese, ku *sa* projektohet në pozicionin kokë të kësaj të fundit (sintagmës), duke realizuar në këtë mënyrë lidhjen mes fjalive përbërëse të periudhës.

Përgjithësisht është pranuar se fjalitë e nënrenditura të cilat formojnë periudhën, mund të bashkohen me mjete lidhëse ose drejtpërdrejt pa to me raporte nënrenditjeje a varësie. Mjetet lidhëse i prijnë fjalisë së varur dhe e lidhin atë me fjalinë kryesore. Lidhëzat lidhin fjalinë e varur (e cila nuk mund të funksionojë e pavarur) me atë drejtuese, ndërsa përemrat e ndajfoljet lidhore janë dhe gjymtyrë fjalie.

Debati midis gjuhëtarëve përqendrohet nëse lidhëzat dhe parafjalët duhet të trajtohen si dy kategori të mëvetësishme sintaksore.

Jespersen i përfshin ndajfoljet dhe parafjalët në një grup të vetëm¹⁵³ dhe sqaron: “Lidhëza s’është gjë tjetër veçse një parafjalë e cila i prin fjalisë. Përdorimi i së njëjtës fjalë në dy kontekste të ndryshme ndodh për shkak të natyrës së plotësisht nga i cili ajo ndiqet dhe jo për ndonjë arsye tjetër. Ashtu sikurse foljet nuk ndahen në folje të cilat ndiqen nga një emër dhe në folje të cilat ndiqen nga një fjali, ashtu dhe parafjalët nuk duhet t’i klasifikojmë në fjalë që qëndrojnë përpara një emri (parafjalë) dhe fjalë të cilat prijnë një fjali (lidhëza). Edhe në qoftë se bëjmë një klasifikim të tillë, kjo ndodh për shkak të traditës dhe jo për shkak të ndonjë domosdoshmërie shkencore. Kështu nuk duhet t’i pranojmë lidhëzat si një grup i veçantë i pjesëve të ligjëratës”¹⁵⁴.

Duke sjellë shembujt e mëposhtëm, si:

<i>Ndajfolje</i>	<i>Parafjalë</i>
Ai shkoi larg.	Ndodhet larg qendrës.
E hodhi matanë.	U hodh matanë gardhit.

ai argumenton se fjalët *larg*, *matanë* në disa raste *dalin të plota në vetvete* dhe në disa raste të tjera ndiqen nga një *plotës a një kundrinor*.

Në shembullin: *Ai shkoi larg*, ndajfolja *larg* nuk ndiqet nga një plotës.

Për sa u takon fjalëve “*edhe*, *dhe*”, Jesperseni shprehet se ato janë konektorë bashkërenditës. Fakti që ato shprehin marrëdhënie bashkërenditëse, përbën dhe dallimin mes lidhëzave dhe parafjalëve.

¹⁵³ G. Jespersen, *The Philosophy of Grammar*, London, Allen and Anwin, 1924, f. 88-89.

¹⁵⁴ G. Jespersen, *The Philosophy of Grammar*, London, Allen and Anwin, 1924, f. 88-89.

Edhe Hocket,¹⁵⁵ ashtu si Jesperseni i përfshin parafjalët dhe lidhëzat nënrenditëse në një kategori, por, ndryshe nga ky i fundit, i emërton “*pjesëza drejtuese*” (*directives particles*). Këto pjesëza kanë funksion shënjuës (*parking function*) nga njëra anë dhe nga ana tjetër funksion drejtues (*function as a director*).¹⁵⁶ Në fjalinë *Libri mbi tavolinë* parafjala “*mbi*” kryen dy funksione: ajo është shënjuese dhe njëkohësisht drejtuese e lidhjes së saj me fjalën “*tavolinë*”.

I njëjti argument jepet dhe për lidhjen e vendosur mes lidhëzës “*se*” dhe fjalisë nga e cila ajo ndiqet në shembullin *The fact that she was happy* (*Fakti se ajo ishte e lumtur*). Pra, sipas tij, lidhëzat nënrenditëse kryejnë dy funksione sintaksore: janë shënjuese të nënrenditjes dhe elemente nënrenditëse. Këtu ai jep shembullin e lidhëzës “*that*” (*se*) që është shënjuese e lidhjes së të tërës, *The fact that she was happy* me “*the fact*”, por funksionon edhe si pjesës drejtuese brenda njësisë “*That she was happy*”.

Hadëlstoni, Pullum dhe gjenerativistë të tjerë në vazhden e Jespersenit janë të mendimit për një rishikim të konceptit tradicional të kategorive gramatikore të *lidhëzave nënrenditëse, parafjalëve dhe ndajfoljeve*¹⁵⁷.

Ashtu si Jesperseni, Hadëlstoni i klasifikon ato si *parafjalë* dhe jo *lidhëza*. Në fjalitë “*Zbriti nga mali i lartë*” dhe “*Do të vete nga të më thuash ti*”, fjala *nga* në të dyja rastet shikohet si parafjalë. Për autorin dallimi është ky: në fjalinë e parë fjala *nga* është një parafjalë e cila ndiqet nga një *sintagmë emërore*, ndërsa në fjalinë e dytë ajo është një parafjalë (jo lidhëz) që ndiqet nga një *fjali e nënrenditur*. Dallimi këtu nuk bazohet në faktin që fjala *nga* mund të ndiqet nga një *sintagmë emërore* apo një *fjali e nënrenditur*, por në karakterin semantik të foljes së fjalisë drejtuese.

Sipas tij, është folja drejtuese ajo që përcakton nëse projektohet një *sintagmë emërore* apo një *fjali e nënrenditur*. Disa folje mund të ndiqen si nga plotësa të shprehur me *sintagma emërore*, ashtu edhe nga plotësa të shprehur me *fjali të nënrenditura*. Por ka edhe folje, kuptimi i të cilave, thekson ai, lejon që kjo e fundit të ndiqet vetëm nga njëri prej plotësive, p.sh.:

We complained that they didn't consult the staff.
Ne u ankuam që ata nuk u konsultuan me stafin.

We complained the lack of consultation with the staff.
Ne u ankuan për mungesën e konsultimit me stafin.

He prevented that they consulted with the staff.
Ai pengoi që ata të konsultoheshin me stafin.

He prevented any consultation with the staff.
Ai pengoi çdo lloj komunikimi me stafin.

¹⁵⁵ C. F. Hocket, *A course in modern linguistics*, New-York, 1958, f. 22.

¹⁵⁶ C. F. Hocket, *Two Models of Grammatical Description*, New-York, f. 56.

¹⁵⁷ R. G. Huddleston - G. K. Pullum et al. *The Cambridge grammar of the English language*, Cambridge, Cambridge Universit Press, 2002.

Dallimi këtu qëndron në foljet “complain” (ankohem) dhe “prevent” (pengoj). Folja “complain”, sipas tij, projekton një fjali të nënrenditur dhe jo një sintagmë emërore, ndërsa folja “prevent” ndiqet nga një fjali e nënrenditur, por jo nga një sintagmë emërore¹⁵⁸.

Sipas Hadëlstonit, parafjalët janë fjalë që shënojnë nocione, ato kanë kuptim leksikor dhe është semantika e tyre që përcakton funksionin dhe përndarjen e fjalisë që projektohet prej tyre.¹⁵⁹ Parafjalët ndryshojnë nga lidhëzat në dy aspekte: nga njëra anë, janë shënjuese të nënrenditjes dhe nga ana tjetër, në ndryshim nga lidhëzat, ato kryejnë funksionin e kokës së fjalisë së nënrenditur që vjen pas saj. Kjo e fundit kryen funksionin e plotësit të parafjalës.¹⁶⁰

Argumenti i Hadëlstonit, teoricienit që qëndron në kapërcyell të gjenerativizmit dhe funksionalizmit, mbi lidhëzat nënrenditëse si elemente jo kokë të fjalisë së nënrenditur, bie në kundërshtim me atë të Çomskit, i cili i shikon fjalitë dhe periudhat si struktura të prira nga një kokë ose si projeksione të fjalëve kokë. Pra, ashtu sikurse një sintagmë shërben si projeksion minimal i një sintagme maksimale (p.sh. sintagma foljore *ju përgëzojmë* është një sintagmë maksimale e foljes *përgëzoj*), ashtu dhe fjalitë janë projeksione të komplementuesit (ku përfshihen mjetet lidhëse, lidhëzat), i cili shërben si kokë e fjalisë së nënrenditur dhe është përbërës jo leksikor i saj.

Me fjalë të tjera, fjalitë përbëhen nga një hyrës i saj i quajtur komplementues, si kokë e të cilit janë lidhëzat nënrenditëse. Për shembull, në periudhën me fjali të nënrenditur *Nuk mund të them se do vij me ju*, “*se do vij me ju*” është një projeksion i komplementuesit “*se*”. Fjalja e nënrenditur dhe periudhat, ashtu si sintagmat, janë ndërtuese të fjalive kokë. Hadëlstoni arrin, kështu, në përfundimin se fjalitë dhe periudha janë thjesht lloje të veçanta sintagmash. Lidhëza është një përbërës i varur dhe jo kokë e fjalisë së nënrenditur, pasi ajo është element fakultativ në ato periudha ku gjendja e nënrenditur e fjalisë mund të përcaktohet nga një përbërës i fjalisë kryesore (semantika e foljes kallëzues të fjalisë kryesore); p.sh.: *E pashë që të shkonte.*; *E pashë të shkonte.*

Studiuesi Leech¹⁶¹ kundërshton këtë shkrim që i bëhet këtyre dy kategorive gramatikore. Ai argumenton se një fjalë mund t’i përkasë më shumë se një kategorie gramatikore. Kjo do të thotë se fjala *nga* është parafjalë kur paraprin një emër, përemër a një sintagmë emërore dhe është lidhëz kur lidh dy fjali të një periudhe me fjali të nënrenditur. *Zbriti nga mali dhe Do të vete nga të më thuash ti.*

Van Lier, përfaqësues i Gjuhësisë së Rolit dhe Referencës, i klasifikon mjetet lidhëse në dy grupe kryesore. Në grupin e parë bëjnë pjesë mjetet lidhëse: lidhëzat nënrenditëse, përemrat lidhorë, ndajfoljet lidhore. Ndërsa në grupin e dytë bëjnë pjesë pjesëzatat a mbaresat e formave të pashtjelluara të foljes. Mjetet lidhëse janë të rëndësishme në strukturën e fjalive të nënrenditura¹⁶².

¹⁵⁸ R. G. Huddleston - G. K. Pullum et al. The Cambridge grammar of the English language, Cambridge, Cambridge universit Press, 2002, f. 1012.

¹⁵⁹ Ne pranojmë se parafjalët kanë kuptim leksikor, por kuptimi leksikor i tyre qartësohet vetëm në fjali, kur lidhen me fjalë të tjera. Për shembull, parafjala *me* në fjalinë “*shkoj me shoqen*” mbart, në lidhje me emrin të cilit i paraprin, kuptimin e shoqërimit, ndërsa në fjalinë “*udhëtoj me makinë*”, parafjala *me* mbart, në lidhje me emrin të cilit i prin, kuptimin e mjetit.

¹⁶⁰ R. G. Huddleston - G. K. Pullum et al. The Cambridge grammar of the English language, Cambridge, Cambridge Universit Press, 2002.

¹⁶¹ Leech, G. N. (2004), A Gray’s Anatomy on English Grammar, English Language and Linguistics 8.

¹⁶² Hengeveld, K. - E. H. Van Lier, (2008), Parts of speech and dependent clauses in Functional Discourse Grammar, Studies in Language, f. 753-785.

Përmes këtyre qasjeve studimore dalim në përfundimin se një fjalë mund t'i përkasë më shumë se një kategorie gramatikore dhe dallohet prej tyre vetëm nga funksioni. Në analizën e dallimit midis parafjalës dhe lidhëzës nënrenditëse pohojmë se kjo e fundit shërben si kokë e një fjalisë nënrenditëse, ndërsa parafjala shërben si kokë e një sintagme parafjalore.

Kjo do të thotë se një fjalë është parafjalë kur paraprin një emër, përemër a një sintagmë emërore dhe është lidhëz kur lidh dy fjali të një lloji ose një fjali të varur me fjalinë prej së cilës varet. Ato mund të shprehin si marrëdhënie barazie (fjalitë e bashkërenditura) dhe marrëdhënie jobarazie (fjalitë nënrenditëse). Lidhëzat nënrenditëse janë element sintaksor i treguesit të nënrenditjes. Lidhëzat nënrenditëse shprehin raporte varësie dhe janë të varura për dy arsye:

Së pari, ato janë elemente jo të detyrueshme në fjali (edhe pse jo në të gjitha rastet).

Së dyti, ato nuk mund të qëndrojnë pa fjalinë e nënrenditur. Si nga pikëpamja kuptimore, ashtu edhe nga pikëpamja strukturore ato i përkasin fjalisë a njësisë kallëzuesore që i prijnë. Në përjasjen e këtyre kategorive ne vëmë theksin se ato elemente gjuhësore të cilat bëjnë pjesë si në klasën e lidhëzave, ashtu edhe në klasën e parafjalëve do të dallohen nga njëra-tjetra sipas funksionit që kryejnë në fjali.

KREU II

KLASIFIKIMI I PERIUDHAVE ME FJALI TË NËNRENDITUR DHE VENDI I FJALISË RRJEDHIMORE NË KLASIFIKIMET E PERIUDHAVE ME NËNRENDITJE NË GJUHËN SHQIPE

2.1. Klasifikimi i fjalive të nënrenditura në gramatikat dhe studimet për gjuhën shqipe

Përcaktimi dhe klasifikimi i fjalive të nënrenditura vijon të shihet ende sot si një nga çështjet më problemore të sintaksës. Ai është bërë në mënyra të ndryshme, që lidhen me drejtime të ndryshme të teorisë sintaksore të përgjithshme ose me pikëpamjet e veçanta të sintaksologëve të ndryshëm që i kanë shprehur nëpër gramatikat apo studimet e tyre.

Për të parë se si është klasifikuar kjo njësi në gjuhën shqipe kemi marrë në shqyrtim, në mënyrë kronologjike, gramatikat duke filluar nga më e hershmja e deri në ditët e sotme, si dhe studimet e bëra nga autorë të ndryshëm.

Po le t'i shohim konkretisht kriteret e zbatuara në gramatikat e shqipes:

A. Xhuvani në "*Sintaksa shqipe II*"¹⁶³ i përcakton fjalitë e nënrenditura si *fjali të lidhuna bashkë*.¹⁶⁴ Ato mund të lidhen me fjalinë e parë me anë të lidhëzave ose përemrave lidhore dhe mund të jenë kryefjalë, kundrinë ose mund të dëftojnë kohë, shkak, kusht, rrjedhim etj. P. sh.: *Dallëndyshja asht një zog (fjali kryesore) që vjen në vendet t'ona në premdverë (fjali e varur)*.¹⁶⁵

Xhuvani dallon *fjalitë e pashtjellme* (që ndërtohen me paskajore dhe përcjellore) nga fjalitë që i kanë foljet-kallëzues në forma të shtjelluara dhe që kështu ai i quan *fjali të shtjellme*¹⁶⁶. Ai nuk i trajton më vete *fjalitë e pashtjellme*, por i analizon brenda secilit lloj të fjalisë së varur ku ato mund të bëjnë pjesë.

Sipas prof. Xhuvanit, fjalitë e nënrenditura mund të shërbejnë si kryefjalë të fjalisë së parë, si kundrinë të saj ose mund të dëftojnë kohë, kusht, shkak, qëllim; prandaj këto fjali marrin emna të ndryshme¹⁶⁷.

Duke u nisur nga funksioni, ai i ndan fjalitë në: *kryefjalore, kundrinore, kohore, mënyrore, vendore, shkakore, lidhore, qëllimore, ndërmjetëse, krahasore, kushtore, rrjedhore dhe konçesive (lejore)*¹⁶⁸. Ndër llojet e numëruara mungon *fjalitë kallëzuese*.

¹⁶³ A. Xhuvani, *Sintaksa shqipe II*, Tiranë, 1938, f. 24.

¹⁶⁴ *Po aty*, f. 24.

¹⁶⁵ *Po aty*, f. 24.

¹⁶⁶ *Po aty*, f. 25.

¹⁶⁷ A. Xhuvani, *Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillorese për t'ultat e Shkollavet të Mesme*, Tiranë, 1938, f. 31.

¹⁶⁸ A. Xhuvani, *Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për klasët e nalta të fillores*, Vlorë, 1934, f. 40-41.

Kur analizon llojet e fjalive sipas ndarjes që u është bërë sipas kriterit që ka ndjekur, i vendos si lloj më vete *fjalitë lidhore*¹⁶⁹ (kriteri i mjeteve të lidhjes), duke ndërthurur kështu parimin funksional me atë strukturor formal.

Ashtu si Xhuvani, edhe Sheperi klasifikimin e fjalive të varura e bën në analogji me fjalitë e thjeshta¹⁷⁰. Siç shihet, edhe Ilia D. Sheperi në klasifikimin e fjalive të nënrenditura është nisur përgjithësisht nga kriteri funksional. Fjalitë e varura ai i barazon me gjymtyrët kryesore. Por ai nuk përmend dhe trajton fjalinë **rrjedhimore**. Edhe Sheperi, ashtu si Xhuvani nuk dallon *fjalinë e varur kallëzuesore*.

Ndër fjalitë e dyta Sheperi trajton në mënyrë të veçantë fjalitë *e caktimit*¹⁷¹, që ndahen në *fjali kryefjalore, fjali kallëzuesore dhe fjali kundrinore*, si edhe fjalitë rrethore, ku ai fut fjalitë e varura *qëllimore, shkakore, kohore, kushtore e kundërshtore*.

Sipas Sheperit, fjalitë e varura *të caktimit* janë ato që kufizojnë ose caktojnë kuptimin e gjerë të foljes kryesore dhe lidhen me të me anë të lidhëzave *që* dhe *se*.

Fjalitë *e caktimit* përdoren:

- a) si kryefjalë të fjalisë kryesore: *Duket se nuk do të vijë*;
- b) si kallëzues: *E pashë që erdhi*;
- c) si kundrinor: *Më thanë se erdhi; e di që do të vijë*;
- d) si shpjegim i foljes: *Më bëri një të mirë, që më dërgoi librat*¹⁷².

Ndërkaq, fjalitë *përmendëse (relative)*¹⁷³ që në gramatikat e mëvonshme do të quhen *fjali përcaktore*, ai i trajton më vete dhe tregon funksionin e tyre në raport me fjalinë. Ato janë fjali të varura që plotësojnë kuptimin e ndonjë gjymtyre të fjalisë kryesore, si p. sh.: *E gjeta librin, që kërkonim*. Në këtë periudhë *E gjeta librin* është fjali kryesore dhe fjalia e varur përcaktore është *që kërkonim* (= librin e kërkuar). Fjalitë e këtilla mund të jenë të prira nga një përemër lidhor ose përemër pyetës.

Siç vërehet nga çka u tha më lart, në klasifikimin e fjalive të nënrenditura Ilia D. Sheperi është nisur përgjithësisht nga kriteri funksional. Fjalitë e varura ai i barazon me gjymtyrët kryesore. Por trajtimi më vetë i fjalive *përmendëse (relative)* që bashkohen me *përemra a ndajfolje lidhore*, duke treguar dhe funksionin e tyre në raport me fjalinë kryesore, na bën të mendojmë nëse ai i ka ndërthurur të dy kriteret (*funksional dhe strukturor*) në klasifikimin e fjalive të nënrenditura.

¹⁶⁹ A. Xhuvani, *Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillorese për t'ultat e Shkollavet të Mesme*, Tiranë, 1938, f. 3: *Fjalitë e varme që lidhen me fjalinë e parë me anë të përemrave lidhorë që, i cili, e cila, ç', quhen lidhore*.

¹⁷⁰ Ilia D. Sheperi, *Vepër e cituar*, f. 139: Sipas shërbimit që bëjnë në periudhë fjalitë *e varme* ose *të dyta zënë vendin e kryefjalës, e kallëzuesit, e kundrinës, e ndajshimit, e një mbiemri dhe më pas të një plotësi qëllimi (fjali qëllimi), shkaku (fjali shkaku), kushti (fjali kushti) dhe të një plotësi që shfaq të kundërtën (fjali kundërshtore)*.

¹⁷¹ *Po aty*, f. 173.

¹⁷² *Po aty*, f. 173.

¹⁷³ Ilia D. Sheperi, *Vepër e cituar*, f. 177.

Justin Rrota¹⁷⁴ konstaton se fjalitë që përbëjnë *fjalinë e përbërë* (periudhën) janë të pavarura nga njëra-tjetra, atëherë ato quhen *fjali të para* (të pamvarshme: *parataksë*), ndërsa kur kanë raporte varshmërie, d.m.th. kuptimi i njëres varet nga fjalia e parë, atëherë ato quhen *fjali të dyta* (të mvarshme: *hipotaksë*)¹⁷⁵. Këtu Rrota sjell edhe shembuj të tipit *Ha pshesh nd' ujë e baj kujdesin e huej*, në të cilin si njëra fjali, ashtu dhe tjetra janë krejtësisht të pavarura nga njëra-tjetra dhe quhen *fjali të pamvarshme*. Ndërkohë, në Rueje zogun *sa t'a kesh në dorë*, siç vëren ai, fjalia e dytë varet prej së parës, nuk ka kuptim më vete, një kuptim të plotësuar, po u shkëput prej saj.

Fjalitë e dyta, shton Rrota, nuk kanë qëllim tjetër përveçse të përcaktojnë e të plotësojnë më mirë kuptimin e fjalive të para prej të cilave varen. Te fjalia *Rueje zogun* ka një lloj pavarësie kuptimore, por megjithëkëtë kjo pavarësi nuk është e plotë, sepse në njëfarë mase plotësohet më mirë nga fjalia e dytë. Ndërkaq, fjalia e dytë - *sa ta kesh në dorë* - pa fjalinë e parë nuk ka kuptim; për këtë arsye quhet *fjali e dytë* ose *fjali e mvarshme*.

Rrota thekson se fjalitë e përbëra, të cilat, pos fjalisë së pavarur, kanë edhe një a më shumë fjali të dyta të mvarshme, quhen *fjali të përbame nga fjalitë e dyta*. Fjalitë e dyta lidhen me fjalitë kryesore nëpërmjet lidhëzave nënrenditëse, të tilla si: *se, mbasi, në, prejse, sadoqi, sa* etj. Një lidhje tjetër, sipas tij, mund të jetë ajo me përemra lidhorë, si për shembull: *kush, shka (çka), qi (që), i cili, ai qi* etj. Lidhja e fjalisë së varur me fjalinë kryesore mund të bëhet edhe me përemrat pyetës: *kush, shka, cili* ose me ndajfolje të marra si përemra pyetës, p.sh.: *ku, kur, si, pse* etj.

Një fjali e varur, vëren Rrota, mund të lidhet me fjalinë kryesore pa lidhëza nënrenditëse. Në raste të këtilla ato nuk kanë më raporte nënrenditëse, por vlerësohen si periudha me fjali të pavarura, p. sh.: *Po ra shi? Si do t'ia bajmë?*

Ai thekson: “*Kemi prandaj njaqë farë fjalish së dyta, sa janë farët a gjymtyrvet të fjalisë së thjeshtë, d.m.th.: Fjali subjektivit, f. predikativit, f. atributivit e f. advërbjarit.*”¹⁷⁶ Kështu, fjalitë e varura vendore, kohore etj., në kuadër të fjalisë së përbërë, luajnë rolin që luan plotësi i rrethanës së vendit, kohës etj. në fjalinë e zgjeruar.

Ky shpjegim i Rrotës tregon se ai i përmbahet tërësisht *parimit funksional* për klasifikimin e fjalive të dyta.

Fjalitë e nënrenditura Rrota fillimisht i përfshin në 4 grupe të mëdha me nënndarje të tyre: 1) *fjali vendore (lokale)*; 2) *fjali kohore (temporale)*; 3) *fjali mënyrore (modale)* dhe 4) *fjali shkajkore (kauzale)*¹⁷⁷.

¹⁷⁴ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, ASHRSh, IGjL, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 493; *Syntaksa e gjuhës shqipe (ose Sintaksi i shqipes, 1942) për klasën II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, shtypshkronja A. Gj. Fishta, 1943.

¹⁷⁵ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, ASHRSh, IGjL, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 493.

¹⁷⁶ J. Rrota, *Vepër e cituar*, f. 65.

¹⁷⁷ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, ASHRSh, IGjL, Botimi I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 510: Po me atë kuptim që kanë, dhe atë shërbim që bëjnë ndajfoljorët në fjalinë e smadhueme, njetë kanë fjalitë e ndajfoljorit në fjalinë e përbame, d.m.th. caktojnë vendin, kohën, mënyrën dhe shkajkun. Kështu kemi 4 farë fjalish ndajfoljorit: fjali adverbial vendore, f. kohore, f. mënyrore e f. shkajkore.

Grupin e fjalive kohore ai e ndan më tej sipas shtrirjes kohore të marrëdhënieve në a) njëkohore, b) parakohore dhe c) mbaskohore; grupi i fjalive mënyrore: a) fjali krahasore (komparative), b) fjali rrjedhore (konsekutive) dhe c) fjalitë e vërteta mënyrore (modale).

Ndërsa në grupin e fjalive ndajfoljore të shkakut ai rendit: a) fjalitë e njëmendta të shkakut, b) fjalitë qëllimore (finale) dhe c) fjalitë kushtore (kondicionare).

Fjalinë e nënrenditur **rrjedhimore** Rrota e përfshin në nëngrupin e fjalive mënyrore.

Megjithëse vë shenjë e barazisë ndërmjet fjalive të varura dhe gjymtyrëve të fjalisë edhe në numër, ai nuk i përmbahet tërësisht këtij parimi kur flet për fjalitë e pashtjelluara, të cilat i quan *fjali të zgjidhuna*.

Këto fjali autori i analizon veçmas, në secilën formë (paskajore, përcjellore dhe pjesore) dhe i dallon në lloj sipas funksionit dhe kuptimit të tyre. Ato mund të zëvendësojnë edhe fjali të ndryshme kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore, rrethanore etj. Shembujt që jep janë: *Dam për ty me i folë këto fjalë. Tue kthye* (ndërsa kthejshem) në shtëpi, më ra në mend puna jote. *Tue ma* pague mirë, (n' e ma paguesh mirë), ndoshtja më mbushet mendja me shitë.

Ndryshe nga Xhuvani dhe Sheperi, ai dallon *fjalinë e varur kallëzuesore*. Edhe pse përmend format e pashtjelluara të foljes që dalin si gjymtyrë fjalie, ai i grupon në kategorinë e fjalive të varura. Në Gramatikën e Akademisë këto analizohen si fjali të varura vetëm kur kanë kryefjalën të shprehur¹⁷⁸.

K. Cipo, në “Sintaksën”¹⁷⁹ e tij i quan *fjali të varura* fjalitë që varen nga kryesorja ose nga një tjetër fjali e varur. Ai vë në dukje se këto fjali lidhen me fjalitë nga varen me anë të lidhëzave nënrenditëse ose të lokucioneve lidhëzore, me përemra lidhorë dhe me ndajfolje dhe kuptimi i tyre plotësohet nga një fjali tjetër.

Cipo sjell shembuj të tipit: *Kur mësoi që ushtria turke ishte nisur nga Ederneja, dolli jashtë Krujës*. Në këtë periudhë kemi tri fjali: një kryesore dhe dy të varura.

Sipas Cipos, nëse fjalia e varur lidhet drejtpërdrejt me fjalinë kryesore, ajo është fjali e varur e shkallës së parë. E kështu në këtë periudhë del fjalia *Kur mësoi*. Fjalia e varur mund të lidhet me fjalinë kryesore jo drejtpërdrejt, por edhe nëpërmjet një fjalie tjetër të varur dhe quhet *fjali e varur e shkallës së dytë*; në këtë rast del fjalia: *që ushtria turke ishte nisur nga Ederneja*.

Në klasifikimin e fjalive të varura Cipo ndjek parimin funksional të paralelizmit të fjalive të nënrenditura me gjymtyrët e fjalisë dhe i klasifikon këto fjali në fjali subjektore, objektore, shkakore, kohore, vendore, krahasore, qëllimore, të mënyrës, lejore, kushtore, **rrjedhore**, kufizore.

¹⁷⁸ Shih më shumë: Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002, f. 490.

¹⁷⁹ K. Cipo, *Gramatika e gjuhës shqipe për klasat e V-ta, VI-ta, VII-ta të shkollave 7-vjeçare*, Tiranë 1949; *Sintaksa*, Tekst për Institutin Pedagogjik, Tiranë, 1951, botim i Ministrisë së Arsimit dhe *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952, f. 52.

Nga ky klasifikim ai shkëput fjalitë lidhore dhe fjalitë *pyetëse të çdrejta* dhe *dubitative a dyshimore*, të cilat i quan “lari të fjalisë objektore”¹⁸⁰ dhe i analizon më vete, megjithëse për fjalinë lidhore ai sqaron se mund të jetë:

a) subjektore, nëse shërben si kryefjalë e fjalisë me të cilën është lidhur. P.sh.: *Puna që bëhet shkel’ e shko s’ ka grat*. Në këtë periudhë fjalia *Puna që bëhet shkel e shko* është fjali lidhore subjektore;

b) objektore, kur është objekt i fjalisë me të cilën është lidhur. P.sh.: “Nuk më ka rënë në dorë libri që më ke dërguar me postë.” Në këtë rast fjalia *që më ke dërguar me postë* është fjali lidhore objektore, ku përemri *që* luan funksionin e kundrinorit të drejtë të fjalisë lidhore;

c) ndajshtimore, kohore, vendore¹⁸¹.

Kështu, del qartë se ai kombinon kriterin funksional me kriterin strukturor dhe me atë të modalitetit.

Edhe S. Prifti në *Sintaksën*¹⁸², si dhe në punimin e tij *Klasifikimi i fjalive të varura*¹⁸³, fjalinë e nënrenditur e quan *fjali të varur*¹⁸⁴. Tipari dallues i saj është se ajo duhet të jetë me çdo kusht në *raporte varësie* me fjalinë, kuptimin e së cilës plotëson dhe nga e cila varet.¹⁸⁵ Por ajo mund të jetë njëkohësisht edhe e plotësuar nga një fjali tjetër e varur. Më tej, Prifti shpjegon se fjalitë e shqyrtuara në periudhë fitojnë:

a) *aspektin gjymtyral*, që i bën këto fjali të konsiderohen gjymtyrë të periudhës, aspekt që nuk mund ta kenë nëse studiohen më vete;

b) *aspektin funksional*, sipas të cilit kryejnë në periudhë një funksion të caktuar;

c) *aspektin e raportit*, i cili i dallon në të pavarura, në kryesore dhe në të varura.

Në këtë mënyrë ai përpiket të arsyetojë klasifikimin e mbështetur mbi bazën e analogjisë funksionale me gjymtyrët e fjalisë¹⁸⁶.

Në bazë të këtij parimi **S. Prifti** propozon ndarjen e fjalive të varura në dy grupe të mëdha:

1) Fjali të varura emërore (nominale), në të cilat përfshin:

- fjalitë kryefjalore (ose subjektore);
- fjalitë kallëzuesore (ose predikative);
- fjalitë cilësore;
- fjalitë ndajshtimore;
- fjalitë kundrinore.

2) Fjali të varura **ndajfoljore** ose **rrethanore**, ku bëjnë pjesë:

- fjalitë vendore;

¹⁸⁰ *Po aty*, f. 98.

¹⁸¹ *Po aty*, f. 98.

¹⁸² S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pjesa I, Dispensa I, 1962.

¹⁸³ S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura në periudhë*, Studime filologjike, 1972/2.

¹⁸⁴ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pjesa I, Dispensa I, 1962, f. 194.

¹⁸⁵ *Po aty*, f. 194.

¹⁸⁶ S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura në periudhë*, Studime filologjike, 1972/2, f. 144.: Analogjia funksionale ndërmjet gjymtyrëve të fjalisë dhe të fjalive në periudhë është element real me shumë rëndësi, që formon një vijë kuptimore të fuqishme për grumbullimin dhe lidhjen në mes tyre të fakteve sintaktike, e cila i shërben fort edhe përvehtësimit sa më të lehtë të sintaksës.

- fjalitë kohore;
- fjalitë shkakore;
- fjalitë qëllimore;
- fjalitë mënyrore;
- fjalitë krahasore;
- fjalitë kushtore;
- fjalitë lejore;
- fjalitë **rrjedhimore**;
- fjalitë kufizuese.

Me interes në këtë klasifikim është pranimi nga ana e autorit i *fjalive ndajshtimore*, ku përfshihen fjalitë e nënrenditura që lidhen me një gjymtyrë emërore, mbiemërore apo ndajfoljore të fjalisë kryesore.

M. Domi në tekstet e tij¹⁸⁷ përdor termin *fjali të nënrenditura* dhe quan të tilla ato fjali që varen njëra prej tjetrës e lidhen mes tyre me anë të lidhëzave nënrenditëse, me anë të përemrave e ndajfoljeve lidhore.

Fjalitë e nënrenditura ai i ndan në *pesë grupe*:

1. kryefjalore;
2. kallëzuesore;
3. kundrinore;
4. përcaktore;
5. rrethanore.

Fjalitë rrethanore ai i grupon më tej në: vendore, kohore, mënyrore, shkakore, **rrjedhimore**, qëllimore, kushtore, lejore.

Edhe këtu fjalia e nënrenditur **rrjedhimore** vendoset në grupin e fjalive rrethanore.

Në klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur ai ndjek *kriterin funksional*, duke i klasifikuar periudhat me fjali të varur sipas funksionit që ato kryejnë në raport me fjalinë kryesore, në bazë të raporteve sintaksore që ato vendosin me këto të fundit, si dhe duke u mbështetur në paralelizmin me gjymtyrët e fjalisë.

Vëmë re që Domi në klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur ndërthur *kriterin funksional* deri diku me *kriterin strukturor*. Ai thotë: “*Klasifikimin e periudhave me nënrenditje ne do ta bëjmë duke vështruar së pari funksionin, pse ky lejon të jepen në mënyrë më të sistematizuar e përgjithësuese raportet sintaksore. Do të vështrohen raportet kuptimore të fjalive të varura me fjalitë kryesore a drejtuese të tyre në atë vijë që vështrohet ai i gjymtyrëve brenda në fjali.*”¹⁸⁸

¹⁸⁷ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa* (Tekst për shkollat shtatëvjeçare e shkollat e mesme), Tiranë, 1954; M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.

¹⁸⁸ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa* (Tekst për shkollat shtatëvjeçare e shkollat e mesme), Tiranë, 1954, f. 495-496; M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 52.

S. Floqi në punimet e tij¹⁸⁹ ndjek kriterin *semantiko-strukturor* për klasifikimin e fjalive të nënrenditura duke u nisur nga elemente të strukturës për të arritur te kuptimi dhe përshkruan tiparet karakteristike të tyre:

- a) Mjeti i lidhjes së fjalisë së varur me kryesoren janë më të shumtën e herës *lidhëzat* e më rrallë *përemrat* a *ndajfoljet lidhore*.
- b) Këtyre lidhëzave a përemrave nuk mund t`u përgjigjet kurrsesi një fjalë korrelative në fjalinë kryesore.
- c) Fjalia e varur ka të bëjë, sipas tipit, ose me një fjalë të vetme a togfjalësh frazeologjik të fjalisë kryesore (fjala mbështetëse), ose me tërë fjalinë kryesore nëpërmjet kallëzuesit dhe grupit të tij në fjalinë kryesore.
- d) Shkalla e lidhjes së fjalive në periudhë varet ose nga vetitë semantiko-gramatikore, ose semantiko-strukturore të fjalisë së plotësuar dhe atëherë kemi një periudhë ku fjalitë janë bashkuar shumë ngushtë nga pikëpamja kuptimore dhe gramatikore-intonacionore ose varet nga vetitë semantike të fjalisë kryesore, kur fjalia e varur ka të bëjë me gjithë brendinë e fjalisë kryesore dhe atëherë shkalla e lidhjes së fjalive në periudhë është më e çlirët dhe e tillë është edhe lidhja gramatikore-intonacionore.

Nga prania ose jo e korrelatëve në fjalinë kryesore, ai i ndan periudhat me fjali të varur në tri grupe:

- 1) Në grupin e parë përfshin ato periudha, mjetet e lidhjes së të cilave kanë domosdo korrelatë të vet në fjalinë kryesore.
- 2) Në grupin e dytë zënë vend ato periudha tek të cilat mjeti i lidhjes s`ka dhe s`mund të ketë kurrsesi korrelat në pjesën kryesore.
- 3) Në grupin e fundit përfshihen ato tipa periudhash me fjali të varur, ku mjeti i lidhjes ka ose mund të ketë në mënyrë fakultative korrelatin e vet në fjalinë kryesore.

Siç shihet, në bazë të klasifikimit të fjalive të nënrenditura S. Floqi vë mjetin e lidhjes dhe korrelatin. Jashtë këtij klasifikimi kanë ngelur fjalitë përcaktore që paraprihen nga një emër a togfjalësh¹⁹⁰.

Fjalinë e nënrenditur **rrjedhimore** e shohim të pozicionuar në grupin e parë.

Te periudha me fjali të nënrenditur *rrjedhimore* ai dallon 3 tipa: 1. tipi korrelativ lidhëzor-përemëror (*aq...*, *sa...* dhe *i tillë, që...*, ku korrelati *aq* mund të dalë si përcaktor ose rrethanor sasive, ndërsa *i tillë* si gjymtyrë emërore e kallëzuesit ose si përcaktor dhe 2. tipi jokorrelativ.

¹⁸⁹ S. Floqi, *Disa tipe semantike strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative*, Studime filologjike, 1967/3, f. 21- 31; S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 15-21 nëntor, Tiranë, 1965, f. 225.

S. Floqi, *Disa tipe semantike strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative*, Studime filologjike 1967/3, f. 21: Me fjalë mbështetëse S. Floqi nënkupton fjalën tek e cila mbështetet fjalia e varur.

¹⁹⁰ Kur korrelati është në funksionin e kundrinorit a të gjymtyrës emërore të kallëzuesit, këto struktura përfshihen te periudha me fjali të varur kundrinore a kallëzuesore.

M. Camaj në gramatikën e tij¹⁹¹, ashtu si J. Rrota, fjalitë rrjedhimore (rezultative) i përfshin në llojet e periudhave me fjali të bashkërenditura. Ato lidhen me pjesën kryesore me anë të lidhëzave: *andáj, prandáj, prá*, p.sh.: Ndreu çohet herët në mëngjes, *andáj shkon herët të flejë*.¹⁹²

Këto periudha në Gramatikën e Akademisë¹⁹³ cilësohen si periudha me *fjali përmblylëse*.

Njësia që shërben si bazë organizuese e periudhës me nënrenditje, quhet fjali kryesore, ndërsa ajo që e plotëson, e sqaron atë që është e varur gramatikisht prej saj, quhet fjali e nënrenditur ose fjali e varur¹⁹⁴. Është ky emërtimi dhe përkufizimi që jepet në Gramatikën e Akademisë për fjalinë e nënrenditur. Dallimi mes fjalisë së nënrenditur dhe fjalisë së mëvetësishme është se kjo e fundit karakterizohet nga intonacioni i mbaruar, kuptimi relativisht i plotë, gjë të cilën nuk mund ta themi për periudhën, pasi bërthamat kallëzuesore të saj nuk kanë intonacionin e fjalisë së mëvetësishme dhe përbërësit leksiko-gramatikorë të njësive kallëzuesore të periudhës shpeshherë nuk përkojnë me fjalinë, ashtu si dhe skema strukturore e cila shpesh nuk përkon.

Klasifikimi i periudhave me fjali të nënrenditur në Gramatikën e Akademisë bazohet kryesisht në kriterin funksional, por duke i dhënë rëndësi edhe anës strukturore e semantike të tyre¹⁹⁵. Fjalitë e nënrenditura, në bazë të funksionit të raporteve sintaksore me fjalitë kryesore a drejtuese dhe të paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë, ndahen në:

1. Fjali kryefjalore. (*Ç'erdh një herë, s'vjen përherë.*)
2. Fjali kallëzuesore. (*Siç ka qenë ashtu është edhe tani.*)
3. Fjali kundrinore të drejtë dhe të zhdrejtë. (*E pyes si e quajnë, nga vjen dhe në ç'klasë është.*)
4. Fjali përcaktore. (*Ishte darka e fundit që po kaloja në shtëpinë time*)
5. Fjali rrethanore. (*Ishte zgjuar shumë herët, kështu që i flihej gjumë.*)

Fraza me nënrenditje në sintaksën¹⁹⁶ e M. Totonit shikohet fillimisht si frazë e thjeshtë, e përbërë nga një fjali kryesore a drejtuese dhe një fjali e nënrenditur me lidhëza, përemra a ndajfolje lidhore. Nëse kjo e fundit i referohet fjalisë kryesore a drejtuese në tërësi, ka zgjerim të jashtëm, ndërsa, kur i referohet një plotësi së saj, ka zgjerim të brendshëm.

Sipas mënyrës se si i drejtohet fjalia e nënrenditur fjalisë kryesore, frazat me nënrenditje klasifikohen në 2 grupe të mëdha:

¹⁹¹ M. Camaj, *Albanian grammar: with exercises, chrestomathy and glossaries*. Wiesbaden: Harrassowitz, 1984.

¹⁹² M. Camaj, *Albanian grammar: with exercises, chrestomathy and glossaries*. Wiesbaden: Harrassowitz, 1984, f. 244-245.

¹⁹³ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002. f. 472.

¹⁹⁴ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002. f. 479.

¹⁹⁵ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002, f. 492.

¹⁹⁶ M. Ttoni, *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000.

1) Fraza me nënrenditje pa fjalë mbështetëse¹⁹⁷, pra me zgjerim të jashtëm, me rend të lirë fjalish dhe aktualizim të frazës. Frazat pa fjalë mbështetëse ndahen më tej në dy nënklasa sipas mjetit lidhës: në fraza pa fjalë mbështetëse lidhëzore dhe në fraza pa fjalë mbështetëse përemërore (sintetike). Në grupin e parë përfshihen frazat ffilluese, karakterizuese, kohore, vendore, mënyrore, sasiore, qëllimore, shkakore, **rrjedhimore**, kushtore, lejore, përqsasore e përjashtimore.

2) Fraza me fjalë mbështetëse ose zgjerim të brendshëm, me rend të ngulitur të fjalisë së nënrenditur, pas fjalës mbështetëse që lëviz brenda fjalisë kryesore e bashkë me të edhe aktualizimi. Këto fraza klasifikohen më tej sipas mjetit të lidhjes në dy nëngrupe: fraza me fjalë mbështetëse përemërore (që lidhen me përemra lidhorë të caktuar e të pacaktuar) dhe në fraza me fjalë mbështetëse lidhëzore, të cilat nëngrupohen sipas marrëdhënies në krahasuese, ffilluese, saktësuese dhe fraza me marrëdhënie të tipit të frazave pa fjalë mbështetëse¹⁹⁸.

Me kuptim të frazës me fjali të nënrenditura, sipas tij, do të kuptohet marrëdhënia që vendoset në mes të fjalisë së nënrenditur dhe fjalisë kryesore në tërësi ose përbërësve të saj. Kuptimi i frazës është i lidhur me kuptimin e fjalive që formojnë frazën, para së gjithash të atyre që formojnë qendrën kallëzuesore të fjalisë. Plotësia leksikore e fjalive është baza mbi të cilën formohet kuptimi i frazës. Kuptimi i frazës gjen shprehjen e vet në strukturën e saj: te mungesa ose prania e fjalës mbështetëse, te rendi i fjalive, te rendi i gjymtyrëve të fjalisë, te korrelacioni kohor e mënyror i foljeve kallëzues e, sidomos, te mjetet e lidhjes, të cilat, kur janë të njëkuptimshme, e minimizojnë rolin e mjeteve të tjera, janë pra të vetëmjaftueshme për të shprehur marrëdhënien. Por, kur lidhëzat janë polisemantike, marrëdhënia bëhet e qartë nga bashkëveprimi edhe i mjeteve të tjera që formojnë frazën.

Siç shihet, autori mbështetet në kriterin *semantiko-strukturor*. Sipas tij, ky lloj kriteri e sheh frazën edhe në lidhjet e saj kontekstuale dhe bën më të qarta kalimet nga një tip në tjetrin. Kjo lejon të vihet re që prirjet e lëvizjeve janë nga frazat me fjalë mbështetëse në fraza pa fjalë mbështetëse, nga frazat sintetike në frazat analitike.

Edhe T. Topalli në veprën e tij¹⁹⁹ ndjek kriterin funksional dhe klasifikimi i fjalive të nënrenditura është po ai që paraqitet dhe renditet nga Gramatika e Akademisë.

Sipas Thoma Dhimës, fjalia e përbërë me nënrenditje është njësia sintaksore e formuar prej dy a më shumë pjesësh të ngjashme me fjalinë e thjeshtë me raporte nënrenditjeje midis tyre. “*Pjesa kryesore*” e fjalisë së nënrenditur shërben si bazë organizuese e saj, ndërsa “*pjesa e nënrenditur*” varet gramatikisht nga kryesorja dhe e plotëson atë²⁰⁰.

¹⁹⁷ Me fjalë mbështetëse nga prof. Totoni kuptohet gjymtyra e fjalisë kryesore që shprehet me çdo pjesë emërtuese të ligjëratës, përveç foljes vetore në funksionin e kallëzuesit, dhe që prin një fjali të nënrenditur. Folja vetore nuk merret si fjalë mbështetëse, kur me të drejtpërdrejt lidhet një fjali e nënrenditur, sepse, duke qenë baza e fjalisë, përfaqëson gjithë fjalinë. Si fjalë mbështetëse mund të dalë një emër, përemër, mbiemër, ndajfolje dhe një formë e pashtjelluar e foljes. Fjala mbështetëse, sipas tij, është mjet i organizimit të frazës: fjalia e nënrenditur në pozicionin e gjymtyrës plotësuese të fjalës mbështetëse ka vend të fiksuar pas saj; natyra leksiko-gramatikore e saj përcakton strukturën e fjalisë së nënrenditur, lidhjen dhe marrëdhënien që vendoset me të. (Shih më shumë: M. Totoni, *Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditura*, Studime filologjike, Nr. 2, f. 25.)

¹⁹⁸ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000, f. 7-19.

¹⁹⁹ T. Topalli, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sintaksa e fjalisë, Shkodër, f. 201.

²⁰⁰ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2008, f. 149.

Klasifikimi i fjalive të nënrenditura në sintaksën²⁰¹ e Thoma Dhimës është pothuajse i njëjtë me atë të Gramatikës së Akademisë, vetëm se ai përfshin në një grup, në atë të *fjalive filluese*: fjalitë kryefjalore, kallëzuesore dhe kundrinore. Gjithashtu, duke u nisur nga mjeti lidhës, ai dallon dy tipa strukturorë: a) tipi lidhëzor dhe b) tipi përemëror ose sintetik.

M. Çeliku fjalitë e nënrenditura i emërton *sifjali*,²⁰² duke bërë kështu një paralelizëm mes fjalive të nënrenditura dhe atyre kryesore. Sipas tij, këto pjesë emërtohen *sifjali*, në vijën intonacionore të plotë të periudhës, sifjalia kryesore ose e varur përbën vetëm një fragment.

Në kriterin funksional mbështetet edhe klasifikimi i fjalive të nënrenditura në gramatikën²⁰³ e M. Çelikut, por me një ndryshim: klasifikimin e nënklasifikimin e periudhave ai e mbështet në karakterin e lidhjeve të përbërësve sintaksorë, lidhje të cilat janë të njëjta si në fjalinë e thjeshtë, ashtu edhe në periudhë, p.sh: PF + SiVa (Përbërës Foljor + Sifjali e Varur plotësore - e domosdoshme); PE + SiVa (Përbërës Emëror + Sifjali e Varur përcaktore - fakultative); SiDR + SiVa (Sifjali Drejtuese + Sifjali e varur rrethanore)²⁰⁴. Ky klasifikim mbështetet në lidhjen dyshe të varësisë së përbërësve sifjali dhe në teorinë e valencës së foljes, e shtrirë kjo edhe në periudhë.

Sipas këtij kriteri, sifjalitë e varura nënrenditëse janë tre llojesh:

- 1) Sifjali nënrenditëse *plotësore* që plotësojnë në mënyrë të domosdoshme një folje a një emër të sifjalisë kryesore; si plotësorë të foljes mund të jenë: kryefjalore, kundrinore, kallëzuesore. Si plotësorë të emrit janë sifjali përcaktuese dhe dalluese.
- 2) Sifjali nënrenditëse *përcaktore-lidhore shitesore (fakultative)* që modifikojnë një përbërës emëror të fjalisë kryesore (përcaktore përshkruese, ndajshimore e vlerësuese; kjo e fundit modifikon gjithë sifjalinë drejtuese).
- 3) Sifjali nënrenditëse *rrethanore shitesore* që modifikojnë gjithë sifjalinë drejtuese. Fjalia e nënrenditur zë vend në grupin e fundit²⁰⁵.

Kwshtu, nënklasifikimi i fjalive bashkërenditëse mbështetet në mjetin e lidhjes së përbërësve sifjali, ndërsa nënklasifikimi i periudhave me nënrenditje mbështetet në karakterin e lidhjeve të sifjalive të varura me përbërësit folje a emër.

Siç vihet re, nga sa u parashtrua më sipër, klasifikimi i fjalive të nënrenditura në gramatikën tona është bërë duke u bazuar në disa kriterë. Varianti më i pranueshëm dhe më i përdorshëm është kriteri funksional, që nisët nga paralelizmi funksional midis fjalive të varura dhe gjymtyrëve të fjalisë së thjeshtë.

Ky klasifikim konsiston në analogjinë e fjalive komplekse me fjalitë e thjeshta: fjalitë kryefjalore shprehin një lloj analogjie me kryefjalën, kundrinori me fjalinë kundrinore dhe kështu me radhë

²⁰¹ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2008.

²⁰² M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILAR, Tiranë, 2012, f. 333-334: Termi *sifjali* (anglisht *clause*) zëvendëson termat tradicionale “pjesë”, “njësi”, “fjali” për nënndarjet e periudhës, të cilët janë të papërshtatshëm (termi pjesë ka një kuptim shumë të gjerë, termi “njësi” përdoret në terminologjinë gjuhësore për të emërtuar nocione të tjera, termi “fjali” nënkupton njësinë sintaksore me intonacion të përfunduar, çka i mungon pjesës së periudhës).

²⁰³ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILAR, Tiranë, 2012.

²⁰⁴ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, Ilar, Tiranë, 2012, f. 335-336.

²⁰⁵ *Vepër e cituar*, f. 336.

Duke u bazuar në këtë paralelizëm, fjalitë e nënrenditura emërtohen nga gjymtyrët e fjalisë me të cilat janë funksionalisht dhe kuptimisht sinonimike, ndaj këto janë quajtur fjali të nënrenditura kryefjalore, kallëzuesore, përcaktore, kundrinore dhe rrethanore. Fjalitë e nënrenditura rrethanore ndahen më tej, sipas kriterit semantik, në fjali të nënrenditura kohore, vendore, rrjedhimore etj.

Gjuhëtarët tanë, edhe pse në periudha të ndryshme kohore, bëjnë një klasifikim të periudhave duke u mbështetur në kriterin **funksional** dhe duket se bashkohen në këtë pikë.

Pavarësisht pikëpamjeve të ndryshme, fjalitë e nënrenditura, në bazë të funksionit të raporteve me fjalinë kryesore dhe paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë në gjuhën shqipe, ndahen në pesë grupe:


1. Fjali të nënrenditura kryefjalore.
2. Fjali të nënrenditura kallëzuesore.
3. Fjali të nënrenditura kundrinore.
4. Fjali të nënrenditura përcaktore.
5. Fjali të nënrenditura rrethanore.

Nga ky rregull bëjnë përjashtim klasifikimet e bëra nga S. Floqi, M. Totoni, Th. Dhima e M. Çeliku, të cilët, si rezultat i ndërthurjes së kriterit semantik krahas atij strukturor dhe funksional, bëjnë një ndarje disi më ndryshe me më shumë nëntipa periudhash me fjali të nënrenditura. Në disa gramatika grupe të fjalive të nënrenditura përfshihen dhe trajtohen së bashku nën termin fjali ftilluese a plotësuese (Th. Dhima).

Krahas klasifikimit të fjalive të nënrenditura, çështje e debatueshme mbetet edhe emërtimi *i termave të tyre*, megjithëse konceptet teorike kryesore duken të përafërta. Nisur nga sa u përmend më sipër, termat e përdorur janë: *njësi predikative, bërthamë kallëzuesore, pjesë e varur, fjali e varur, sifjali, frazë e nënrenditur, fjali e nënrenditur* etj. Në Gramatikën e Akademisë gjejmë termat *njësi kallëzuesore, bërthamë kallëzuesore, fjali e nënrenditur*. Përgjithësisht në studimet tona sintaksore nuk parapëlqehet termi *pjesë*²⁰⁶ për emërtimin e njësive të periudhës.

Të njëjtin mendim ndan dhe T. Topalli. Sipas tij nuk është mirë të përdoret fjala “pjesë” si *term i sintaksës*²⁰⁷.

Prof. Xhuvani në tekstet e tij i emërton *fjali të para*²⁰⁸;




²⁰⁶ L. Dodbiba, S. Spasse, *Gramatika e gjuhës shqipe, Fillimet e Sintaksës*, Tiranë, 1951, f. 15.


²⁰⁷ T. Topalli, *Fjali e përbërë, frazë apo periudhë?*, *Gjuha jonë*, 1-4/2004, f. 92.

²⁰⁸ A. Xhuvani, *Njohunit e para të Syndaksës Shqipe (pjesa e parë për klasët e nalta të Fillores)*, Vlorë, 1922, f. 35.


Sheperi i quan *fjali të varme*, si pjesë të *fjalive kryesore*²⁰⁹;




Rrota - *fjalija e subjektit dhe fjalija e objektit*²¹⁰;



K. Cipo: *fjalitë/ fjalit e varura*²¹¹;



L. Dodbiba, S. Spasse²¹² - *fraza dhe farët e fjalive*;




²⁰⁹ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskënishtes, për shkollat e mesme*, Vlorë, 1927, f. 172.

²¹⁰ At Justin Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër, 1942, ribotim Shkodër, 2005, f. 7.


²¹¹ K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952, f. 86.

²¹² L. Dodbiba, S. Spasse, *Gramatika e gjuhës shqipe, Fillimet e Sintaksës*, Tiranë, 1951, f. 15


S. Prifti²¹³ - *fjalitë e varura / fjalitë e nënrenditura (apo plotësorë)*;




M. Domi²¹⁴ - *fjali e nënrenditur*;



Gramatika e Akademisë;



M. Totoni²¹⁵ - *fjali e nënrenditur e frazës*;




²¹³ Justin Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër, 1942, f. 77.


²¹⁴ M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, 1970, f. 20.

²¹⁵ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000, f. 7-19.

Th. Dhima²¹⁶ - pjesa e nënrenditur;



M. Çeliku²¹⁷ - sifjali:



2. 2 Kriteret e klasifikimit të fjalive të nënrenditura

1) Kriteri funksional

Klasifikimi funksional përqendrohet në funksionet që përmbushin fjalitë e nënrenditura në raport me fjalinë kryesore, në marrëdhënien sintaksore midis tyre. Varianti më i përhapur i këtij klasifikimi është ai që mbështetet në paralelizmin e periudhës me fjalinë, të funksioneve të fjalive të nënrenditura me ato të gjymtyrëve të fjalisë.

Duke u mbështetur në këtë paralelizëm, fjalitë e varura emërtohen sipas gjymtyrëve të fjalisë me të cilat janë funksionalisht sinonimike, sipas analogjisë e afërsisë për nga ana funksionale-kuptimore. Në analogji me gjymtyrët kryesore të fjalisë (kallëzuesin dhe kryefjalën) dhe me gjymtyrët e dyta (përcaktorin, kundrinorin dhe rrethanorin), studiues të ndryshëm i kanë emërtuar përkatësisht fjalitë e nënrenditura me të njëjtët terma: fjali të nënrenditura kryefjalore, kallëzuesore, përcaktore, kundrinore dhe rrethanore.

Këto të fundit, sipas kriterit semantik, ndahen më tej në: rrethanore, vendore, kohore, mënyrore, shkakore, rrjedhimore, qëllimore, kushtore, lejore. Stefan Prifti, kur flet për

²¹⁶ S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 15-21 nëntor, Tiranë, 1965.

²¹⁷ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, Ilar, Tiranë, 2012, f. 333.

klasifikimin e fjalive të varura sipas kriterit funksional²¹⁸, përmend dhe emrat e autorëve të huaj që janë përkrahës dhe zbatues të këtij kriteri.

Ai vëren se, sipas këtij kriteri, gramatikanët francezë i klasifikojnë fjalitë e varura në tre grupe kryesore: a) fjali emërore (propositions nominales); b) fjali mbiemërore (propositions adjectives); c) fjali rrethore (propositions circonstancielles), duke pohuar se “*fjalitë e nënrenditura kryejnë në periudhë të njëjtat funksione me ato të gjymtyrëvet të fjalisë në fjali dhe pasi shpjegojnë se ato mund të kenë vlerën e një emri, të një mbiemri apo të një ndajfolje*”.²¹⁹

Fjalitë emërore kryejnë funksionin analog të një fjalie emërore ose të substantivuar të fjalisë në përgjithësi, d.m.th. të kryefjalës, të kallëzuesit emëror, të ndajshimit, të kundrinës dhe të një plotësi ose përcaktori emëror; fjalitë mbiemërore kanë funksionin e një përcaktori mbiemëror dhe fjalitë rrethore funksionin e një plotësi ndajfoljor ose rrethor.²²⁰

Po një parim të tillë ndjek për rusishten Gvozdevi, kur studion “fjalitë e përbëra të nënrenditura” apo A. Gaindiglio për latinishten.²²¹

Ky klasifikim, i cili e ka burimin te drejtimi logjik-gramatikor, siç e vumë re dhe më sipër, është zbatuar në shumicën e sintaksave të shqipes.

Po cilat janë sipas studiuesve mangësitë dhe kufizimet e klasifikimit funksional?

Këtij klasifikimi i janë bërë vërejtje të ndryshme, ndonjëherë dhe nga vetë zbatuesit e tij.

Përkrahës e zbatues i këtij kriteri është S. Prifti. Ai rendit disa karakteristika të ngjashme të fjalive të nënrenditura me ato të gjymtyrëve të fjalisë, sipas strukturës e kuptimit, siç janë:

- a) Varësia.
- b) Funksioni (fjalitë e varura, ashtu sikurse gjymtyrët e dyta, i shërbejnë zgjerimit, thellimit, përcaktimit dhe sqarimit të fjalisë nga varen).
- c) Zëvendësimi reciprok i fjalive të varura nga plotësori dhe anasjelltas.
- d) Bashkërenditja.
- e) Kalime fjalish të varura në gjymtyrë fjalie.

Por ai vëren se nuk ka analogji identike midis gjymtyrëve të fjalisë dhe fjalive të varura, duke vënë në dukje se ka fjali që nuk gjejnë gjegjëset e tyre te gjymtyrët e fjalisë dhe këtu sjell si shembull mosnjohjen e plotësive ***të rrjedhimit***.²²²

Edhe S. Floqi thekson se midis funksionit të gjymtyrëve të fjalisë dhe funksionit të fjalisë së varur nuk ka përputhje të plotë. Ka marrëdhënie që shprehen në periudhë, por nuk shprehen në fjali.²²³ Ka gjymtyrë fjalie që s’gjejnë gjegjëset e tyre te fjalitë e varura, si plotësi i sasisë, i shoqërimit, i mjetit etj. Pra, ka plotësor sasië, por nuk njihet ndonjë fjali e nënrenditur e sasisë.

²¹⁸ S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura*, Studime filologjike, Nr. 2, 1972.

²¹⁹ *Po aty*, f. 142.

²²⁰ S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura*, Studime filologjike, Nr. 2, 1972, f. 142.

²²¹ Cituar nga S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura*, Studime filologjike, Nr. 2, 1972, f. 142.

²²² S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura*, Studime filologjike, Nr. 2, 1972, f. 143.

²²³ S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukture të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 15-21 nëntor, Tiranë, 1965, f. 225.

Gjithashtu ai thekson se nuk ka ndonjë lidhje kuptimore ndërmjet përmbajtjes së fjalisë së varur kryefjalore dhe kryefjalës si gjymtyrë fjalie. Ky klasifikim zbulon vetëm sinoniminë funksionale midis gjymtyrëve të fjalisë së varur, por lë në hije strukturën e periudhës, si dhe anën semantike të fjalisë kryesore dhe asaj të nënrenditur.

Sipas prof. Totonit, “nëpërmjet paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë vështrohet ngjashmëria e rrafsheve të strukturës sintaksore dhe tregohet kalimi nga struktura më e thjeshtë te më e ndërlikuar”²²⁴. Kjo i ka dhënë këtij klasifikimi përhapje të madhe jo vetëm në gramatikat shkollore, por edhe në studimet sintaksore.

2) Kriteri *formal gramatikor ose strukturor*

Ky kriter bazohet në mjetet e ndryshme gramatikore (lidhëzat, përemrat, ndajfoljet lidhore) që përdoren për realizimin e lidhjes sintaksore të fjalive të varura me fjalitë e plotësuara prej tyre. Sipas këtij kriteri, fjalitë e nënrenditura ndahen në **fjali lidhëzore** dhe në **fjali lidhore** ose **relative**. Në grupin e fjalive **lidhëzore** hyjnë fjalitë e varura që lidhen me fjalinë drejtuese me lidhëza të ndryshme nënrenditëse, kurse në grupin e dytë hyjnë fjalitë e bashkuara vetëm me fjalë lidhëse:

*Kur arriti djali në shtëpinë e tij, kishin kaluar tre vjet, tre muaj dhe tre ditë, **kështu që** vajza atë ditë ishte martuar me një tjetër.*

(Proza popullore VI, f. 95)

Ama kishte një kalë ç'i s'ja xhinje shokun.

(Proza popullore II, f. 21)

Sipas S. Priftit, ky aspekt strukturor²²⁵ lejon një ndarje vetëm *dihotomike*, më dysh: në fjali me lidhëza ose sindete dhe në fjali pa lidhëza ose asindete. Sindete vjen nga greqishtja “*syndetos*” = i lidhur bashkë, “*syndesmos*” greq.-lidhëz. Asindete vjen po nga greqishtja “*asyndetos*” = i palidhur bashkë (me lidhëza e fjalë lidhore). Në grupin e fjalive sindete hyjnë fjalitë e lidhura me lidhëza e fjalë lidhëse, kurse në grupin e dytë hyjnë fjalitë e bashkuara vetëm me anë të intonacionit. Ata që ndjekin këtë lloj klasifikimi e vazhdojnë ndarjen në nëngrupe e në farë fjalish më të veçanta, sipas kategorisë gramatikore të secilës fjalë lidhëse, në fjali lidhëzore dhe në fjali lidhore ose relative.

Fjalitë e nënrenditura lidhëzore ndahen më tej sipas kategorive semantike të lidhëzave (lidhëza kohore, vendore, shkakore, rrjedhimore etj.).

Po cilat janë mangësitë dhe kufizimet e formal gramatikor ose strukturor?

Klasifikimi formal gramatikor ose strukturor kufizohet vetëm në mjetet gramatikore të lidhjes. Mjetet e lidhjes së fjalisë së varur me kryesoren janë, vërtet, një element i domosdoshëm i strukturës së periudhës, por ato nuk janë gjithçka. Elemente të tjera të rëndësishme që përcaktojnë strukturën e periudhës, trajtat mënyrore e kohore të foljeve kallëzues, bashkëlidhja e trajtave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues, rendi i fjalive në periudhë anashkalohen.

²²⁴ M. Totonit, *Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditura*, Studime filologjike, 1990/2, f. 22.

²²⁵ S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura*, Studime filologjike, Nr. 2. 1972, f. 138.

Dihet se dallimi i fjalive lidhëzore nuk është vetëm formal, por gërshetohet me aspektin funksional e semantik apo logjiko-gramatikor në përgjithësi. Emërtimi i lidhëzave nënrenditëse dhe dallimi i tyre në lloje të ndryshme nuk bëhet në baza krejt formale, por edhe kuptimore, kurse emërtimi i përemrave lidhorë dhe ndajfoljeve lidhore mbështetet në baza funksionale. Nga ana tjetër, për fjalitë kryefjalore, kallëzuesore e kundrinore nuk ekzistojnë lidhëza të veçanta, ndaj këto lloj fjalish nuk mund të lihen jashtë studimit.

Megjithëse lidhëzat janë formuar nga përemrat lidhorë dhe ndajfoljet lidhore, këto të fundit kanë edhe funksion sintaksor, pra shërbejnë si gjymtyrë të fjalisë ku ndodhen, në dallim nga lidhëzat, që shërbejnë vetëm për të bashkuar pjesët e periudhës. Kështu, përcaktohen më mirë raportet sintaksore që ato shprehin dhe jepet qartë natyra e fjalisë së varur që fillon me këto fjalë lidhëse.

Ndarja e fjalive të lidhura me fjalë lidhëse në pyetëse të zhdrejta dhe në lidhore nuk është i mjaftueshëm; ai përziën modalitetin me formën e lidhjes. Struktura e fjalive të varura duhet të vështrohet në tërë shtrirjen e saj, si në trajtat e foljes, në mënyrat dhe në kohët e saj etj. Këto anë të strukturës nuk duhet të mbeten jashtë studimit të tyre.

Nga ana tjetër, lidhëzat nga pikëpamja e kuptimit ndahen në dy grupe: në lidhëza semantike dhe josesantike. Rrjedhimisht, nga kjo ndarje do të kishim dy grupe: njëri që përfshin periudhat, fjalitë e të cilave bashkohen me lidhëza semantike (periudhat bashkërenditëse këpujore, veçuese, kundërshtuese dhe përmbyllëse) dhe grupi tjetër ku do të grupoheshin vetëm një numër i kufizuar periudhash (periudhat nënrenditëse vendore, shkakore, qëllimore, kushtore, krahasore, mënyrore, rrjedhimore, lejore).

Theksojmë se marrja parasysh e mjetit lidhës, ndërmjet të cilit shprehen raportet kuptimore mes fjalisë së nënrenditur dhe fjalisë kryesore, është i rëndësishëm në studimin e periudhës me fjali të nënrenditur. Por, mendojmë se kriteri strukturor nuk mund të merret i shkëputur nga funksioni i fjalisë me nënrenditje, për shkak të natyrës polisemantike të shumë lidhëzave.

Në gjuhësinë tonë ky kriter ka gjetur zbatim në sintaksën e Xhuvanit (fjalitë lidhore). Ne pajtohemi me mendimin e S. Priftit²²⁶ që ky klasifikim nuk siguron dot shtrirjen e tij edhe në klasifikimin e gjymtyrëve të fjalisë. Për këtë arsye, ai nuk mund të shërbejë si kriter i njësuar për klasifikimin e fjalive të nënrenditura.

3) *Kriteri semantik*

Kriteri semantik, dekadat e fundit, në gramatikën tonë është pranuar si më i miri, pasi ai lejon të zbulohen të gjitha veçoritë strukturore dhe semantike të periudhës (mjetin e lidhjes, faktin nëse fjalia e varur i referohet një fjale a një togfjalëshi apo fjalisë drejtuese në tërësi, bashkëlidhjen e trajtave mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues. Fillimisht në gjuhësinë tonë ky kriter klasifikimi është propozuar nga S. Floqi²²⁷.

Sipas Floqit, ky kriter klasifikimi duhet të ketë parasysh të klasifikojë jo më fjalitë e varura, por njësinë sintaksore tërësore, periudhën me fjali të varur, duke marrë për bazë:

²²⁶ Shih më shumë: S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura*, Studime filologjike, Nr. 2, 1972, f. 138.

²²⁷ S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 15-21 nëntor, Tiranë, 1965; S. Floqi, *Disa tipe semantike strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative*, Studime filologjike, 1967/3.

- a) elementet konstruktive të periudhës me fjali të varur, d.m.th. strukturën e fjalisë së varur dhe njëkohësisht edhe atë të fjalisë kryesore;
- b) shkallën e lidhjes sintaksore të fjalive;
- c) në të ka të bëjë fjalia e varur me një gjymtyrë të vetme të fjalisë kryesore, me një togfjalësh apo me tërë fjalinë kryesore;
- d) marrëdhënien kuptimore (semantike) që shprehet në periudhë midis fjalive përbërëse.

S. Prifti është i mendimit se në këtë klasifikim ai ka mbajtur parasysh së pari strukturën dhe pastaj kuptimin. Kjo është arsyeja që ai e ka quajtur semantik-strukturor²²⁸. Sipas M. Totonit, S. Floqi nisat nga elemente të strukturës për të arritur te kuptimi, por, në të vërtetë, kriteri përcaktues, sidomos për dallimin e tipave, është kuptimi²²⁹.

Mangësitë dhe kufizimet e klasifikimit semantik

Klasifikimi *semantik*, edhe pse është pranuar si më i miri, është kritikuar fillimisht nga S. Prifti, së pari në diskutimin rreth kumtesës²³⁰ së S. Floqit për disa tipa të periudhës me fjali të varur që rezultojnë pas zbatimit të klasifikimit sipas kriterit semantiko-strukturor. S. Prifti thekson se klasifikimi²³¹ i propozuar nga Floqi kufizohet në problemin e klasifikimit të periudhës së varur. Klasifikimi i periudhave me fjali të varur dhe jo më fjalitë e varura nuk e thjeshton, por e vështirëson edhe më problemin e klasifikimit në sintaksë, duke pasur parasysh që ky parim të shtrihet edhe në pjesën e parë të saj, në teorinë e fjalisë.

Ky klasifikim nuk e siguron dot vijën unike në tërë shtrirjen e sintaksës. Duke e parë periudhën të përbërë vetëm nga një fjali kryesore dhe fjali e nënrenditur, lihen jashtë klasifikimit periudhat komplekse, të përbëra nga fjali të nënrenditura shumëllojesh. Pra, mungon vija unifikuese tërësore si në fjalitë e varura, ashtu dhe në tërësi në klasifikimin e gjithë lëndës së sintaksës. Të njëjtat vërejtje ai i parashtron dhe në punimin “*Klasifikimi i fjalive të varura*”²³².

Sipas E. Shijakut, kriteri semantiko-strukturor:

- a) Vështirëson studimin e sintaksës dhe sidomos nga pikëpamja metodiko-shkollore paraqet vështirësi për analizën logjike të periudhës, e cila lehtësohet nga kriteri funksional dhe sistemi i pyetjeve.

²²⁸ S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura*, Studime filologjike, 1972/2, f. 149.

²²⁹ M. Totonit, *Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditura*, Studime filologjike, 1990/2, f. 23.

²³⁰ S. Prifti, Diskutim rreth kumtesës së S. Floqit; *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 15-21 nëntor, Tiranë, 1965, f. 379- 381.

²³¹ S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 15-21 nëntor, Tiranë, 1965: Sipas tij, klasifikimi duhet të jetë jo i fjalive të varura, por i periudhave me fjali të varura.

²³² Shih më shumë: S. Prifti, *Klasifikimi i fjalivet të varura*, Studime filologjike, 1972/2.

b) Ndjekja e këtij klasifikimi dyfishon a trefishon numrin e llojeve të fjalive të varura, gjë që do të vështirësonte edhe më shumë studimin e sintaksës jo vetëm në shkollë, por edhe jashtë saj²³³.

Në vështrimin kritik që M. Totoni²³⁴ i bën klasifikimit semantiko- strukturor të zbatuar nga Floqi në periudhat me fjali të varur theksohet se ky klasifikim nuk është i plotë. Floqi nuk ka parashtruar grupin e tretë me nënndarje të mëtejshme dhe si përfundim:

1. Mbeten jashtë klasifikimit fjalitë përcaktore që kanë si paraprijës një emër a një togfjalësh dhe fjalitë rrethore që saktësojnë një gjymtyrë të fjalisë kryesore.

2. Struktura e frazës, ndonëse është kuptuar mjaft gjerë dhe janë vënë në dukje përbërësit e saj, nuk është zbuluar në çdo rast vlera e tyre në përcaktimin e tipit të frazës e sidomos të kuptimit të saj. Roli dhe vlera e një korrelati nuk janë të njëjtë si kur ndodhet para fjalisë së nënrenditur, edhe kur ndodhet pas saj e në lidhje me këtë s'është i njëjtë edhe kuptimi i frazës. Ato ndikojnë në kuptimin e periudhës, në varësi të pozicionit që zënë në raport me fjalinë e nënrenditur: nëse korrelati ndodhet para fjalisë së nënrenditur, ftillohet dhe sqarohet nga ajo, por nuk sqarohet se ç'ndodh kur korrelati ndodhet pas saj dhe, për rrjedhim, mospërfshirja e këtyre dy tipave të frazave në të njëjtin grup. Dallimi i këtyre dy tipave në bazë të kuptimit të korrelatit nuk sjell asgjë të veçantë as nga pikëpamja e strukturës, as nga pikëpamja e kuptimit të frazës.

3. Fjalët që trajtohen si korrelatë nuk janë homogjene, ato kanë kuptime dhe funksione të ndryshme dhe u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës: përemra dëftorë, të pacaktuar, ndajfolje sasive etj.

4. Natyra leksiko-gramatikore e fjalës me të cilën lidhen fjalitë e nënrenditura nuk paraqet ndonjë dallim të rëndësishëm nga ana strukturore ndërmjet tipave korrelativë përemërorë-përemërorë dhe frazave ku fjalia përcaktore lidhet me një emër, prandaj mund të përfshihen mirë në një grup të dy këta tipa.

5. Lidhja e fjalisë së nënrenditur me korrelatin nuk është e njëjtë e kjo ka rëndësi për kuptimin e frazës.

Kriteri semantiko-strukturor, që Floqi propozon për periudhën, nuk zbatohet në fjali, pasi dhe vetë ai mbështet kriterin semantiko-funksional, duke kombinuar kriterin semantik me kriterin e paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë.

Pranimi i funksionit të korrelatit si tipar klasifikimi sjell shpërndarje të tjera të fjalive me organizim formal të njëjtë, sepse funksioni i korrelatit nuk përcakton veçoritë e ndërtimit të fjalisë së nënrenditur dhe marrëdhëniet që vendosen ndërmjet fjalive.

Gjithashtu, nxjerrja në plan të parë herë e kriterit strukturor, herë e kriterit semantik e herë e kriterit funksional gjymtyror nuk i jep një karakter të njësuar këtij klasifikimi.

²³³ E. Shijaku, Diskutim rreth kumtesës së S. Priftit: *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 15-21 nëntor, Tiranë, 1965, f. 384.

²³⁴ M. Totoni, *Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditura*, Studime filologjike, 1990/2, f. 23-25; *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000, f. 13.

Për mënjanimin e të metave të klasifikimeve të mësipërme M. Totoni propozon si kriter fillestar për ndarjen e frazave me fjali të nënrenditura *mungesën ose praninë e fjalës mbështetëse*²³⁵, “që shërben si mjet i organizimit të frazës dhe natyra leksiko-gramatikore e saj përcakton strukturën e fjalisë së nënrenditur, lidhjen dhe marrëdhënien që vendoset me të.”²³⁶

Ai dallon fjalën mbështetëse nga korrelati: fjala mbështetëse drejton një fjali të nënrenditur, ndërsa korrelati kryen në fjalinë kryesore po atë funksion që mund ta kryejë edhe fjalia e nënrenditur. Korrelati mund të jetë fjalë mbështetëse vetëm kur qëndron para fjalisë së nënrenditur, ndërsa, ndryshe nga fjala mbështetëse që ka rend të paravendosur, korrelati mund të dalë edhe pas fjalisë së nënrenditur duke rimarrë përmbajtjen e saj në fjalinë kryesore.

2.3 Klasifikimi i fjalive të nënrenditura në gjuhësinë e huaj

Mënyrat e klasifikimit të fjalive të nënrenditura janë pjesë e diskutimeve të vazhdueshme edhe në kuadrin e gjuhësisë botërore dhe ndër gramatikat e hulumtimit e teoricienëve të ndryshëm vërejmë gjerësisht kritere të ndryshme klasifikimi. Duke i konsideruar si ndihmesa me vlerë studimet e gjuhëtarëve tradicionalë, e pamë të udhës të ndalemi në qasjet e studiuesve të *Gjuhësisë Gjenerative*, të *Gjuhësisë Funktionale Sistemike* dhe të *Gjuhësisë së Rolit e të Referencës*.

Kështu, Leonard Blumfildin, një ndër përfaqësuesit e gjuhësisë strukturaliste amerikane dhe pararendës i gjuhësisë gjenerative ashtu sikurse autorët latinë, i përmbahet në klasifikimin e fjalive të nënrenditura kriterit *formal-gramatikor* dhe i klasifikon ato si *fjali të zhdrejta*. Sipas konceptimit të tij, një fjali në ligjëratë të zhdrejtë është pjesë përbërëse e një periudhe me nënrenditje. Fjalia e nënrenditur ndahet nga fjalia kryesore me anë të foljes së “thënies” që paraprin dhe ai e cilëson këtë dukuri “ligjëratë e zhdrejtë e zgjeruar”.

Sipas Blumfildit, fjalia në ligjëratë të zhdrejtë kryen funksionin e një kundrinori, rrethanori etj. ndaj fjalisë kryesore. Çdo pjesë përbërëse të periudhës ai e vështron si fjali.

Për ta konkretizuar, në një fjali si “*Ajo tha se ishte gëzuar shumë*”, sipas Blumfildit, duhet analizuar fillimisht fjalia në ligjëratë të drejtë, “*Unë gëzohem shumë*”, që sipas kriterëve të përcaktuara prej tij, mund të quhet fjali e *formës së drejtë*. Rregullat gramatikore dytësore e sjellin, më pas, secilën prej këtyre fjalive në *formën e zhdrejtë* përkatëse, sa herë që ato ndjekin a pasojnë: folje të thënies.²³⁷

²³⁵ M. Totoni, *Vepër e cituar*, f. 17: Me fjalë mbështetëse do të kuptohet gjymtyra e fjalisë kryesore që shprehet me çdo pjesë emërtuese të ligjëratës, përveç foljes vetore në funksionin e kallëzuesit, dhe që prin një fjali të nënrenditur... Si fjalë mbështetëse mund të dalë një emër, përemër, mbiemër, ndajfolje dhe një formë foljore e pashtjelluar.

²³⁶ M. Totoni, *Vepër e cituar*, f. 17.

²³⁷ Lyons, J., *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2001, f. 169.

Xheikëbs (Roderick A. Jacobs), po ashtu, vijon konceptin e Blumfildit duke iu përmbajtur kriterit formal dhe i sheh fjalitë e nënrenditura si fjali të zhdrejta, si dhe i ndan në dy grupe kryesore:

- 1) *Fjali të ndërkallura* [Embedded clauses] (fjalitë kryefjalore, kundrinore dhe lidhore).
- 2) *Fjali ndajfoljore* [Adverbial clauses] (fjalitë rrethimore).²³⁸

Pavarësisht këndvështrimeve të tij gjenerativiste, ai gjykon si tradicionalistët se fjalitë e nënrenditura kundrinore e kryefjalore mund të zëvendësohen nga një sintagmë emërore. Duke marrë si shembull fjalinë “*U provua se ky poet u përkiste të gjitha kohërave*”, si dhe duke pohuar mundësinë e zëvendësimit të saj me sintagmën emërore “*poet i kohërave*”, ai arrin në përfundimin se sintagma emërore dhe fjalitë e nënrenditura vendosin të njëjtat lidhje gramatikore me foljen e fjalitë kryesore. Sipas tij, të tilla fjalitë e nënrenditura mund të quhen të ndërkallura, pasi janë fjali që vendosen brenda një fjali tjetër, asaj kryesore, të cilën Xheikëbsi e quan “*container clause*” (fjalitë mbajtëse). Kurse fjalitë ndajfoljore për të është “*subordinate clause*” (fjalitë e nënrenditura), pasi lidhet me fillimin apo fundin e një fjali tjetër. Po sipas Xheikëbsit, ndryshimi midis fjalitë të ndërkallura dhe fjalitë ndajfoljore është se të parat fillojnë një folje kallëzues, ndërsa të dytat jo, ndaj edhe ato nuk mund të dalin në funksionin e kryefjalës apo të kundrinorit.²³⁹

Idetë e gjuhëtarëve tradicionalë i mbështet edhe gjenerativisti Huard Xhekson (Howard Jackson),²⁴⁰ që gjithashtu i quan fjalitë e nënrenditura “fjalitë të ndërkallura”²⁴¹*. Fjalitë e ndërkallura, në këndvështrimin e tij, janë fjali të nënrenditura apo të përfshira në një fjali tjetër dhe mund të kenë funksionin e një kryefjale, të një kundrinori apo të një kallëzuesori a rrethimori. Xheksoni është i mendimit se fjalitë janë të përbëra nga disa “*kuti funksionesh*” që mund të mbushen nga kategori të caktuara. P.sh., kutia e kallëzuesit mund të mbushet nga një folje, ajo e kryefjalës dhe e kundrinorit nga një emër, sintagmë emërore apo nga një fjali e ndërkallur dhe ajo e rrethimorit me një ndajfolje e kështu me radhë.²⁴²

Xhon Sinkler (John Sinclair)²⁴³ i klasifikon fjalitë e nënrenditura në tri grupe kryesore:

1. Fjalitë zhdrejta: *Ajo tha se ai film i pëlqente shumë.*
2. Fjalitë nënrenditura lidhore (relative clause): *Vajza që sapo erdhi, është shoqja ime.*
3. Fjalitë nënrenditura ndajfoljore: *Ishte vonë, kur e mbylli mbledhjen.*²⁴⁴

²³⁸ Jacobs, R., *English Syntax: A Grammar for English Language Professionals*, Oxford University Press, Oxford, 1995, f. 76.

²³⁹ *Vepër e cituar*, f. 75-78.

²⁴⁰ Krahaso: Jackson, H., *Discovering Grammar: Language Teaching Methodology Series*, Pergamon Press, Oxford (Oxfordshire), 1985.

²⁴¹ *Vepër e cituar*, f. 108. *Mendojmë se në këtë rast autori i është përmbajtur kriterit formal-strukturor. (Shënimi ynë.)

²⁴² *Vepër e cituar*, f. 109.

²⁴³ Sinclair, J., *Collins Cobuild English Grammar: Helping learners with real English*, The University of Birmingham, Collins, 1990, f. 313-362.

²⁴⁴ Krahaso: *Vepër e cituar*, f. 313-362.

Sinkleri, në ndryshim nga autorë të tjerë, si Kuirk, Grinbaum, Lic, Svartvik, fjalitë e zhdrejta i emërton fjali emërore.²⁴⁵ Ndryshe nga gjuhëtarë të tjerë, që nisen nga drejtimi funksional për të klasifikuar fjalitë e nënrenditura, Sinkleri bën një ndërthurje të këtij drejtimi me atë formal-gramatikor. Kështu, në grupin e fjalive lidhore ai përfshin një lloj të veçantë të fjalive të nënrenditura, që i quan “*nominal relative clauses*” (fjali lidhore emërore). Edhe në këtë rast, Sinkleri i klasifikon fjalitë duke u mbështetur në ndërthurjen e këtyre dy drejtimeve.

Por duhet vërejtur se një fjali e nënrenditur nuk mund t’u përkasë njëkohësisht dy kategorive të ndryshme gramatikore, edhe emrave, edhe mbiemrave; çka do të thotë se një fjali e nënrenditur nuk mund të kryejë edhe funksionet sintaksore të emrave, edhe ato të mbiemrave.

Oto Jesperseni pohon se fjalia e nënrenditur nuk mund të përkufizohet si element përbërës i një periudhe²⁴⁶ që ka të njëjtën formë me të (si rregull, përbëhet nga një folje-kallëzues në formë të shtjelluar). Ai e mbështet këtë në faktin se pjesët e ligjëratës duhet të klasifikohen mbi bazën e dy kriterëve:

- a. Sipas funksionit që ato kryejnë si pjesë ligjëratare: emra, mbiemra, ndajfolje.
- b. Sipas rendit që këto pjesë ligjëratare zënë në fjali, kur hyjnë në marrëdhënie me fjalë të tjera për të krijuar struktura të mëdha.

Dhe kështu, në bazë të këtyre dy kriterëve, ai i klasifikon fjalitë si më poshtë:

1. fjali të para (fjali në funksionin e emrave: të kryefjalës dhe të kundrinorit);
2. fjali të dyta (fjali në funksionin e mbiemrave);
3. fjali të treta (fjali në funksionin e ndajfoljeve/rrethanorëve).

Ky klasifikim mbështetet në doktrinën e tij “triplanëshe”, në paralelizmin e njëjtë që ai i bën klasifikimit të grupeve të fjalëve (word group).²⁴⁷

Tradicionalisti Martin Parrot, nga ana e tij, mbështetet në kriterin funksional të fjalive të nënrenditura, por ai ka edhe pika të përbashkëta me autorët tradicionalë që bëjnë klasifikimin e fjalive të nënrenditura sipas kriterit formal-gramatikor²⁴⁸.

Në vështrimin e tij, fjalitë e nënrenditura klasifikohen në këto tri grupe kryesore:

1. Fjali të nënrenditura *emërore* (noun clause).
He asked her where she worked.
(Ai e pyeti se ku punonte.)
2. Fjali të nënrenditura *përcaktore* (plotësor) (complement clause).
I am sure she is coming.
(Unë jam i sigurt se ajo po vjen.)

²⁴⁵ Fjali emërore në Gramatikën e Akademisë konsiderohen ndërtimet sintaksore si: *Dimër, Heshtje, Verë e thatë, Ja shtëpia ime e lindjes* etj. (Shih më shumë: Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 379.)

²⁴⁶ Jespersen, O., *The philosophy of grammar*, Routledge, London & New-York, 2010, f. 103.

²⁴⁷ Jespersen, O., *Studies in the History of language sciences*, De Gruyter, Berlin & New-York, 2001, Volume 2, f. 184-186.

²⁴⁸ Krahaso: Parrot, M., *Grammar for English language teachers*, Cambridge University Press, Cambridge, 2000.

3. Fjali të nënrenditura *ndajfoljore*, që plotësojnë kuptimin e një foljeje apo ndajfoljeje (adverbial clause).²⁴⁹

Edhe Xhim Mileri (Jim Miller)²⁵⁰ bën të njëjtin klasifikim me Parrotin, ndërsa vë në dukje se strukturë e përbërësve, sipas tij, është organizimi i fjalëve në fraza, i frazave në fjali dhe i fjalive në periudha. Po sipas Milerit, në një periudhë, njëra fjali kryeson dhe të tjerat, fjalitë e nënrenditura, u nënshtrohen disa kufizimeve. Por ai dallon nga Parroti në përdorimin e termit “*fjali të nënrenditura përcaktore*” për t’iu referuar *fjalive emërore*, pasi në këndvështrimin e tij, një emërtim i tillë është pasqyrues më i mirë i lidhjes mes foljes drejtuese të fjalisë kryesore me fjalinë e nënrenditur.²⁵¹

1. Fjali të nënrenditura *përcaktore* (complement clause).

She regretted *that she had met Tom*
(Ajo u pendua që kishte takuar Tomin.)

We like the idea that the city centre will be pedestrianised.
(Neve na pëlqen mendimi që qendra e qytetit do të përshtatet vetëm për këmbësorë.)

2. Fjali të nënrenditura *lidhore* (relative clauses).

I like the book that you gave me.
(Më pëlqen libri që më dhe ti.)

3. Fjali të nënrenditura *ndajfoljore*.

When Fanny returned, she found Tom Bertrand very ill.
Kur Fani u kthye, ajo e gjeti Tom Bertrandin shumë të sëmurë.²⁵²

Autorët Randolph Quirk, Sidney Greenbaum, Geoffrey Leech dhe Jan Svartvik, në veprën e tyre gramatikore “*A Comprehensive Grammar of the English Language*”, i grupojnë fjalitë e nënrenditura në këto tri grupe:

1. Fjali të nënrenditura *emërore*.

That he must be guilty is obvious to everyone.
(Është e qartë për këdo që ai është fajtor.)

2. Fjali të nënrenditura *mbiemërore* (adjectival clauses).

They have all the equipment they need.
Ata kanë të gjitha pajisjet që u nevojiten.

3. Fjali të nënrenditura *ndajfoljore* (adverbial clauses).

The wether was so bad *that they cancelled the expedition*.
Moti ishte kaq i keq, sa ata e anuluan ekspeditën.²⁵³

²⁴⁹ Vepër e cituar, f. 334.

²⁵⁰ Miller, J., *An Introduction to English Syntax*, Edinburgh University Press, Edinburgh, 2002.

²⁵¹ Miller, J., *An Introduction to English Syntax*, Edinburgh University Press, Edinburgh, 2002, f. 67-71.

²⁵² Vepër e cituar, f. 70-71.

²⁵³ R. Quirk, S. Greenbaum, G. Leech, J. Svartvik, “*A Comprehensive Grammar of the English Language*”, Longman, London & New-York, 1985, f. 1049.

Sipas këtyre autorëve, fjalitë e nënrenditura kryejnë ndaj fjalisë drejtuese, prej së cilës varen, funksione të njëjta me pjesët e ligjëratës, si: *emri, mbiemri dhe ndajfolja*.

Për këtë arsye, ata mbështesin parimet e analogjisë funksionale që ekzistojnë mes fjalive të nënrenditura dhe tri kategorive gramatikore. P.sh., në fjalinë “*Është e qartë për këdo që ai është fajtor*”, fjalia e nënrenditur “*që ai është fajtor*” mund të zëvendësohet me sintagmën emërore “*faji i tij*” (Faji i tij është i qartë për këdo). E njëjta gjë ndodh edhe me fjalitë e mësipërme, që janë zëvendësuar me pjesët përkatëse të ligjëratës²⁵⁴:

Ata kanë të gjitha pajisjet e *nevojshme*. (mbiemër)

Moti ishte *jashtëzakonisht* i keq. (ndajfolje)

Ndër përfaqësuesit e gjenerativizmit, R. Hadëlstoni (Rodney Huddleston) mbështet idenë e Jespersenit dhe përdor termin “fjali ffilluese” a “plotësuese” (content clause²⁵⁵) për fjalitë e nënrenditura emërore. Ai shkruan: “Që klasifikimi ynë të plotësojë analizën funksionale që u bëhet strukturave në të cilat i hasim këto fjali, nuk mund të mbështetemi në klasifikimin tradicional të fjalive (fjali emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore), por na duhet të dallojmë funksionet nga klasat.”²⁵⁶

Studiuesi i ndan si më poshtë fjalitë që kanë në përmbajtjen e tyre një folje kallëzues të shtjelluar në 4 grupe kryesore:²⁵⁷

1. Fjali të nënrenditura lidhore (relative clauses).
2. Fjali të nënrenditura krahasore (comparative clauses).
3. Fjali të nënrenditura ndajfoljore (adverbial clauses conjunctions, clauses introduced by *as, because*).²⁵⁸
4. Fjali ffilluese ose plotësuese (content clauses).

Duke pohuar se termi “content clause”²⁵⁹ është përdorur nga Jesperseni, për Hadëlstonin termi “complement clauses” nuk është i përshtatshëm për arsyet që vijnë²⁶⁰:

a) Fjalitë ffilluese (content clauses) nuk i gjejmë vetëm në funksionin e kundrinorit të një foljeje. Ato mund të kryejnë edhe funksionin e një rrethanori, si p.sh.: “*What has happened,*

²⁵⁴ *Vepër e cituar*, f. 1014.

²⁵⁵ Huddleston, R., *Introduction to the Grammar of English*, Cambridge University Press, Cambridge, 1989, f. 392.

²⁵⁶ Huddleston, R., *Introduction to the Grammar of English*, Cambridge University Press, Cambridge, 1989, f. 392.

²⁵⁷ Huddleston, R. and Pullum, K., “*A Student’s Introduction to English Grammar*”, Cambridge University Press, London, 2005, f. 950: *Content clause* përdoret në tekste të ndryshme gramatikore të cilat u përkasin periudhave të ndryshme, por gjuhëtari që e përdori për herë të parë këtë term është Oto Jespersen, i cili e përkufizon si më poshtë: Fjali e nënrenditur plotësore (content clause) është një fjali e cila përmban një thënie. Ajo nuk është fjali e mëvetëshishme, por është pjesë e një fjalie tjetër. Kjo fjali lidhet me fjalinë kryesore me anë të lidhëzës “*that*” dhe kryen funksionin e kryefjalës, kundrinorit etj.

²⁵⁸ Sipas Hadëlstonit, fjalët “*because*” dhe “*before*” duhen klasifikuar si parafjalë (preposition) dhe jo si lidhëza (conjunctions). Pikërisht këtu qëndron dhe dallimi midis fjalive të grupit të tretë e të katërt. Për më tepër, shih: Huddleston, R., *Introduction to the Grammar of English*, Cambridge University Press, Cambridge, 1989, f. 98.

²⁶⁰ *Krahaso*: Rodney Huddleston, Geoffrey K. Pullum *The Cambridge Grammar of English Language*, 2003, f. 1017.

that you are looking so worried?” (Çfarë ka ndodhur që dukesh kaq i shqetësuar?) dhe në rastin e fjalive pyetëse: *“You got paid whether business was good or bad.”* (Ti u pagove, pavarësisht nëse biznesi doli i mirë apo i keq.)

b) Duke iu referuar gjuhës angleze, fjalitë ffilluese nuk janë të vetmet që kryejnë funksionin e përcaktorit, pasi të njëjtin funksion mund ta shprehin edhe fjalitë krahasore me lidhëzat *“than”* apo *“as”*. Këto lidhëza mund të ndiqen si nga fjalitë ffilluese, ashtu edhe nga ato krahasore, si p.sh.: *“It’ not as good as it was last year.”* (Nuk është aq mirë sa ç’ ishte vitin e shkuar.), *“He felt as he was getting in the bath.”* (Ai u ndie sikur po hynte në dush.) (ftilluese)

Fjalitë ffilluese që i përkasin grupit të katërt, në gjykimin tonë, janë emërore. Prandaj edhe nuk mund të përfshihen këtu fjali që i klasifikojmë si të nënrenditura ndajfoljore. Fjalitë krahasore duhen përfshirë në grupin e tretë, në fjalitë ndajfoljore.

Përmes këtij klasifikimi, Hadëlstoni shpreh pikëpamje të ndryshme nga ato të tradicionalistëve. Vite më vonë, fjalitë e nënrenditura ai i klasifikon jo më në katër, por në tri grupe:

1. Fjali të nënrenditura lidhore
2. Fjali të nënrenditura krahasore.
3. Fjali të nënrenditura plotësuese, ffilluese.

Ndërsa fjalitë e nënrenditura emërore, sipas autorit, ashtu si fjalitë e thjeshta, mund të klasifikohen sipas llojit të kumtimit, si vijon:

1. Fjali të nënrenditura dëftore.

He says *they are in Paris.* (Ai thotë se ata janë në Paris.)

2. Fjali të nënrenditura pyetëse (tërësore, të pjeshme).

He asked *wether/if she is ill.* (Ai pyeti se mos/nëse ajo është e sëmurë.) I wonder *what he does.* (Pyes vetes çfarë bën ai.)

3. Fjali të nënrenditura thirrmore.

You know *what a liar he is.* (Ti e di ç’ gënjeshtar është ai.)

Ndryshe nga fjalitë e thjeshta, nuk kemi fjali emërore nxitëse.

Përveç Svartvikut dhe Hadëlstonit, edhe disa gjuhëtarë gjenerativistë kanë bërë përpjekje për një klasifikim të plotë funksional-strukturor dhe semantik të fjalive të nënrenditura.

Për shembull, Xhorxho Grafi (Giorgio Graffi) në veprën e tij mbi sintaksën dhe strukturat e ligjërimin, klasifikimin e fjalive të nënrenditura e bën sipas teorisë së valencës²⁶¹.

²⁶¹ Graffi, G., *Sintaksa: Strukturat e ligjërimin*, përkthyer nga B. Topalli (origjinali: Graffi, G., *Le strutture del linguaggio. Sintassi*, Bologna, 1994), Dituria, Tiranë, 2003, f. 150-151.

Ai mbështet klasifikimin tradicional të fjalive të nënrenditura në bazë të analogjisë me tri pjesë të ligjëratës: në fjali emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore²⁶² dhe propozon klasifikimin e tyre në bazë të teorisë së valencës. Disa fjali që sillen si argument, do të quhen fjali argumentuese, ndërsa disa që përfaqësojnë një përmbushje të nevojshme të valencave të foljeve të ndryshme, quhen fjali rrethanore.

Brintoni i klasifikon fjalitë e nënrenditura sipas kriterit strukturor-semantik.²⁶³ Pikësëpari, ai i ndan fjalitë e nënrenditura me formë të shtjelluar foljore nga ato me formë të pashtjelluar foljore. Më pas, sikurse Sinkleri e Perroti, fjalitë emërore i rendit sipas funksioneve të tyre përkatëse si vijon:

1. *Fjali të shtjelluara* (ku nënkupton ato me një folje-kallëzues në formë të shtjelluar foljore):
 - a. fjali fthilluese (- that clauses) (fjali kryefjalore/kundrinore/kallëzuesore).
 - b. fjali ndajfoljore (adverbial clauses) (rrethanor kohe, mënyre, qëllimi, rrjedhimi etj.).
 - c. fjali pyetëse (wh- clauses) (fjali pyetëse - wh, fjali lidhore, fjali pyetëse të zhdrejta).
2. *Fjali të pashtjelluara* (me folje-kallëzues të shprehur me një formë foljore të pashtjelluar).

Fjalitë pyetëse tërësore janë fjali drejtuese, ndërsa fjalitë lidhore dhe fjalitë pyetëse të zhdrejta janë fjali të nënrenditura.

Për sa i përket *kriterit funksional*, ai mbështetet në paralelizmin e funksionit të fjalive të nënrenditura me atë të kategorive të ndryshme gramatikore. *Kriteri strukturor-semantik* merr parasysh tërësinë e lidhjeve kuptimore e strukturore mes pjesës kryesore e asaj të nënrenditur. Ai lejon të zbulohen veçoritë semantike e strukturore të periudhës: mjetet e lidhjes, semantikën e foljes drejtuese, bashkëlidhjen e trajtave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues, raportet kuptimore themelore e dytësore të fjalisë kryesore me atë të nënrenditur etj.

Përfaqësuesit e *Gjuhësisë Funksionale Sistemike* dhe të *Gjuhësisë së Rolit e Referencës* kanë prirjen që t'i klasifikojnë fjalitë e nënrenditura duke i analizuar ato si nga aspekti sintaksor e semantik, ashtu edhe nga ai pragmatik, pra gjatë ligjërimit.

²⁶² Graffi, G., *Sintaksa: Strukturat e ligjërimit*, përkthyer nga B. Topalli (originali: Graffi, G., *Le strutture del linguaggio. Sintassi*, Bologna, 1994), Dituria, Tiranë, 2003, f. 150-152: “Disa gramatika tradicionale i dallojnë fjalitë e varura në bazë të analogjisë me fjalitë emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore. Në thelb, ky dallim qëndron, edhe pse çalon në terminologji dhe mund të riformulohet lehtësisht në kuptimin e teorisë së valencës për sa i përket fjalive emërore: Është e mundur që Xhani të niset nesër; Xhani ka thënë që do të niset nesër; Xhani nuk e di kush do të niset nesër - do të quhen fjali argumentuese, duke përdorur kështu një term që mbledh elementin e përbashkët të të gjitha njësive, qoftë foljore, qoftë emërore apo qoftë të një lloji tjetër, të cilat përfaqësojnë një përmbushje të nevojshme të valencave të foljeve të ndryshme. Kësisoj, fjalitë e varura mund të jenë argument jo vetëm i foljeve, por edhe i emrave argumentues. Fjalitë e përkufizuara tradicionalisht ndajfoljore (shkakore, kohore, qëllimore etj.) nxjerrin në pah veçoritë tipike të rrethanorëve, duke vërejtur, para së gjithash, se nuk duhet të jenë detyrimisht të pranishëm, në mënyrë që fjalia ku bëjnë pjesë të jetë gramatikore: *Pritëm ardhjen e Xhanit, me qëllim që të hamë darkë të gjithë së bashku; Pritëm ardhjen e Xhanit*. Pra, duket e arsyeshme t'i quajmë rrethanore edhe fjalitë e këtij lloji dhe ta zëvendësojmë me këtë përkufizim tradicional të “ndajfoljorëve”, sepse ky emërtim i fundit bëhet në të njëjtin nivel me atë të “emërorëve” të cilën e kemi zëvendësuar me “argumentuese” e përmbys pak logjikën e fakteve: fjalitë kohore, shkakore etj. dalin si ndajfolje, jo sepse janë në njëfarë kuptimi një imitim, por sepse të dyja këto klasa shprehesh realizojnë të njëjtën veçori të përgjithshme, atë që janë elemente rrethanore.

²⁶³ Brinton, I., *The structure of Modern English*, John Beniamins Publishing Company, Amsterdam & Philadelphia, 2000, f. 216.

Gjykimet e tyre hapin debat në lidhje me faktorët që shkaktojnë dallimet semantike të fjalive të nënrenditura. Kështu, nga njëra anë diskutohet mbi dallime semantike, ndërsa nga ana tjetër diskutohet mbi faktorë pragmatikë dhe strukturorë që shkaktojnë dallimet mes tyre.

Në grupin e parë, mes të tjerëve, bëjnë pjesë gjuhëtarë, si Kiparskët (Kiparsky and Kiparsky), që janë të mendimit se duhen analizuar tiparet strukturore-semantike si faktiviteti i foljes drejtuese.²⁶⁴

Ky tipar semantik themelor pasqyrohet në strukturën sintaksore të fjalisë së nënrenditur. Ai përcakton llojin dhe strukturën e fjalisë që përzgjedh folja nënrenditëse. Kiparskët dallojnë dy kategori foljesh që ndryshojnë nga njëra-tjera për shkak të kufizimeve semantike që vendosin për plotësat e tyre:

1. Folje faktike që shprehin një fakt: kuptoj, mësoj, kujtoj etj. Këto folje presupozojnë vërtetësinë e plotësit të tyre, fjalisë së nënrenditur.
2. Foljet jofaktike (ato që nuk e presupozojnë vërtetësinë, të tilla si: besoj, them, mendoj.

Kiparskët janë të mendimit se plotësat e ndryshëm të foljeve faktike, si sintagmat emërore, fjalitë e nënrenditura lidhen me këto të fundit, sepse përkon struktura e tyre e thellë, p.sh.:

a) Atij i vjen keq për faktin që Ira humbi. *Struktura e thellë dhe një strukturë sipërfaqësore e mundshme.*

b) Atij i vjen keq që Ira humbi.

Rrjedhojë e heqjes së fjalës fakt.

Atij i vjen keq për humbjen e Irës.

Përdorimi i emrit prejfoljor humbje.

Argumenti semantiko-sintaksor i Kiparskëve është që aktiviteti i foljes drejtuese përcakton dallimin mes llojeve të fjalive të projektuara prej saj. Kjo gjë vihet në dyshim nga gjuhëtarë që mendojnë se ka të dhëna ndërgjuhësore, të cilat dëshmojnë se aktiviteti jo gjithmonë mundëson një përcaktim të saktë të strukturës.

Huper dhe Tomson (Hooper and Thompson) mbështesin klasifikimin e propozuar nga Kiparskët, por pasqyrojnë më tej foljet e paraqitura nga ata jo vetëm në gjuhën angleze, por edhe në gjuhë të tjera.²⁶⁵

Edhe Dalina Kallulli e zhvillon më tej modelin sintaksor të Kiparskëve. Pavarësisht nëse përdorim strukturën sintaksore komplekse Em(emër)+Plotës apo një plotës të thjeshtë, në përfundim të njëjtin interpretim semantik.²⁶⁶

Besova se Beni shkoi (por në fakt ai nuk shkoi).

believed-I that Ben left (but in fact he not left).

‘I believed that Ben left (but in fact he didn’t).’

b. *E besova se Beni shkoi (*²⁶⁷por në fakt ai nuk shkoi).*

I believed-I that Ben left (but in fact he not left)

‘I believed the fact that Ben left (*but in fact he didn’t).’

²⁶⁴ Kiparsky, P., Kiparsky, C., (1970), *Fact*, In: M. Bierwisch & K. E. Heidolph (eds.), *Progress in Linguistic*, Mouton, The Hague, f. 143-173.

²⁶⁵ Hooper, J. & Thompson, S. (1973), *On the Applicability of Root Transformations*. Në: *Linguistic Inquiry* 4, f. 466-497.

²⁶⁶ Kallulli, D., *Triggering factivity: Prosodic evidence for syntactic structure*, In: D. Baumer, D. Montero and M. Scanlon (eds.), *Proceedings of the 25th West coast Conference on Formal Linguistics*, Somerville, MA, Cascadia Proceedings Project, 2006, f. 211-219.

²⁶⁷ * = jogramatikore.

Sipas këtij këndvështrimi, sintaksa, semantika dhe pragmatika bashkëveprojnë plotësisht me njëra-tjetrën; fjalia e nënrenditur e klasifikuar nga Kiparskët si një sintagmë emërore komplekse, e kthen një folje jofaktike në një folje faktike.

Edhe pse mbështetës të Kiparskëve Hengeveld dhe Van Lier,²⁶⁸ e shikojnë sintaksën në lidhje të ngushtë me gjuhën e folur gjatë komunikimit.

Në përpjekje për të shpjeguar funksionet shprehëse të gjuhës, ata japin tri elemente të saj, të cilat janë: *referenca* (reference), *modifikimi* (modification) dhe *predikativiteti* (predication). Funksionin e referencës e shprehin emrat, të kallëzuesisë foljet, mbiemrat shprehin atë të modifikimit të shprehjeve referenciale (emrave) dhe ndajfoljet modifikojnë predikativitetin a foljet. Fjalitë e nënrenditura sipas tyre klasifikohen në:

1. Fjali të nënrenditura përcaktore
2. Fjali të nënrenditura lidhore
3. Fjali të nënrenditura ndajfoljore

Sipas Van Lier-it²⁶⁹ fjalitë e nënrenditura klasifikohen:

1. Duke bërë paralelizmin mes tyre dhe funksioneve që kategoritë gramatikore kryejnë në një thënie. Këtu ai dallon dy tipa fjalish: a) fjali të balancuara; b) fjali të devijuara.

2. Sipas tipareve të brendshme morfo-sintaksore të foljeve drejtuese, kohë, aspekt, mënyrë dhe tipareve emërore të klasës dhe numrit.

a. John regrets [that Paul will move to Finland].

Xhonit i vjen keq që *Poli do të zhvendoset në Finlandë*.

b. John regrets [Paul's moving to Finland].

Xhonit i vjen keq për *shpënguljen e Polit në Finlandë*.

Kështu, fjalia e nënrenditur emërore **a** shpreh kohë të ardhme, ndërsa kryefjala Paul ka funksion e karakteristika të njëjlojta me ato të një kryefjale të një fjalie të thjeshtë. Këto fjali, formalisht të ngjashme me fjalitë e thjeshta të pavarura, quhen fjali të balancuara. Në ndryshim nga fjalia **a**, fjalia e nënrenditur emërore **b** ka një kallëzues të shprehur me formë të pashtjelluar foljore, *moving*, e cila devijon nga ajo e një fjalie të thjeshtë të pavarur, quhet fjali e devijuar.

Van Lier e çon më tutje analizën duke marrë në shqyrtim tipologjinë, karakteristikat e brendshme morfo-sintaksore dhe potencialin e sjelljes së fjalive të varura.

²⁶⁸ Hengeveld dhe Van Lier (1980) huazojnë klasifikimin nga Stassen (1985). Sipas Stassen-it, fjalitë e nënrenditura që ngjajnë me ato të thjeshta për nga struktura, quhen të balancuara. Ai i emërton këto fjali të varura të balancuara, pasi ato nuk shprehin karakteristika foljore të shtjelluara të njëjta me fjalitë e pavarura (kryesore). Ndërsa fjalitë e nënrenditura, forma e të cilave ndryshon nga ajo e një fjalie kryesore për shkak të kallëzuesit në formë të pashtjelluar, i quan fjali të nënrenditura të devijuara (deranked).

²⁶⁹ Shih: Cristofaro, Sonia. *Purpose Clauses*. In: Dryer, M. & Haspelmath, M. (eds.). *The World Atlas of Language Structures Online*. Max Planck Institute for Evolutionary Anthropology, Leipzig, 2013. (Gjendet në Internet: <http://2als.info/chapter/125>, përdorur së fundi më 2013-08-10.)

Kristofaro (Sonia Cristofaro)²⁷⁰ bën një përmbledhje të tipave strukturorë të fjalive të nënrenditura, si më poshtë:

1. Rënia e fleksioneve eptuese të kohës së aspektit dhe mënyrës së foljeve (TAM) nënkupton humbjen e përshtatjes së foljes në fjali.

2. Shprehja e tipareve emërore nënkupton humbjen e tipareve foljore në fjali.

Ajo propozon tre faktorë funksionalë që ndikojnë në marrëdhëniet e varësisë. Këto të fundit shkaktojnë humbjen e tipareve foljore në fjalitë e nënrenditura me një formë foljore të pashtjelluar, si dhe mungesën e plotësive. Por ato nuk kushtëzojnë shprehjen e tipareve emërore. Kristofaro është e mendimit që fjalitë e nënrenditura nuk janë ndërtime që shprehin procese të pavarura, por tipare dhe sende. Ky është edhe shkak i humbjeve të tipareve foljore dhe i shprehjes së atyre emërore.

Grupi i dytë është ai i gjuhëtarëve që nuk e përkrahin dallimin e fjalive të nënrenditura mbështetur në tiparin e faktivitetit të foljes drejtuese. Sipas tyre, është këndvështrimi si në aspektin empirik dhe në atë teorik ai që përpiket të nxjerrë shpjegimin e dallimeve sintaksore mes tipave të fjalive të vetë struktura e fjalisë së nënrenditur dhe jo mes foljeve që e projektojnë atë.²⁷¹

Sipas Hegartit (Hegarty), për të parashtruar ndryshimet sintaksore të fjalive të nënrenditura, nuk mjafton thjesht t'u referohemi foljeve të veçanta. Krahas të tjerave, ai vë në dukje faktin që foljet faktike nuk "sillen" njësoj në të gjitha rastet dhe thekson se ka raste kur një folje nuk shfaq të njëjtat tipare sintaksore me foljet e klasës që i përket.²⁷²

De Cuba dhe Urogdi ishin të parët që hodhën idenë se asnjëri nga faktorët e përmendur deri tani nuk ishin të përshtatshëm për të bërë dallimin mes dy llojeve të fjalive të nënrenditura. Kjo ndodh për shkak se as aktiviteti dhe as konteksti nuk luajnë një rol të drejtpërdrejtë në sintaksë.²⁷³

Tipari që, sipas tyre, bën dallimin mes dy llojeve të fjalive është referencialiteti. Ndryshe nga Kiparskët, që mendonin se faktiviteti reflektohet në strukturën e fjalisë, ata janë të mendimit që faktiviteti duhet të klasifikohet si tipar leksiko-semantik i foljes së fjalisë kryesore, që kufizon kushtet e vërtetësisë, por jo sintaksën (strukturën) e fjalisë së nënrenditur.

Edhe konteksti, si një element pragmatik, nuk parashikon as dallime semantike dhe as sintaksore, ndërsa De Cuba dhe Uordi mendojnë se struktura sintaksore e një fjalie të nënrenditur varet nga lloji semantik i saj. Ky i fundit përftohet nga leximi i fjalisë si një strukturë e pavarur nga faktorët e jashtëm, si për shembull folja drejtuese.

Nga sa u vu re më sipër, një prej kritereve më të përhapura për klasifikimin e fjalive të nënrenditura konsiston në përpjekjen për t'i përkitur strukturat e periudhës në ato të fjalisë së thjeshtë; prandaj edhe fjalitë kryefjalore do të tregonin njëfarë analogjie me kryefjalën, fjalitë kundrinore me plotësin kundrinor e kështu me radhë. Dallimi i përbërësve logjiko-

²⁷⁰ Cristofaro, S., *Subordination*, Oxford University Press, Oxford, 2013.

²⁷¹ *Po aty*, f. 69-77.

²⁷² Hegarty, M., *Familiar complements and their complementizers: On some determinants of A'-locality*, University of Pennsylvania, 1992, f. 111-152, dorëshkrim, cit. sipas: Aboh, E. and Guasti, M., *Locality*. Oxford University Press, Oxford, 2014, f. 220.

²⁷³ De Cuba, C. Urogdi, B., *Eliminating factivity from syntax: Semantial complements in Hungarian*. Në: *Approaches to Hungarian*, John Benjamins. Amsterdam and New-York, 2009.

gramatikorë të fjalisë së thjeshtë do të ishte një model i vlefshëm për analizën e të nënrenditurave, që nga ana e tyre do të merreshin si zgjerime të sintagmave foljore.

Sipas një qasjeje të tillë, të nënrenditurat mund të ndaheshin në tri grupe të mëdha: fjali plotësuese (kryefjalore, kundrinore, pohore dhe pyetëse të zhdrejta), fjali joplotësuese (shkakore, rrjedhimore, kohore, lejore...) dhe fjali përcaktore (lidhore).

Veç kësaj, një tjetër kriter klasifikimi merr parasysh valencën e foljes dhe dallon fjalitë argumentuese, që dalin si zgjerim i argumentit të foljes së fjalisë kryesore, si dhe fjalitë ndajfoljore, që do të përfaqësonin shtesa semantike ndaj fjalisë kryesore.

Në një model të tillë, fjalitë lidhore, si zgjerime të një sintagme emërore, do të mbeteshin jashtë të dyja kategorive.

Ndërsa modeli që bazohet në kriterin formal, i sheh fjalitë e nënrenditura sipas natyrës së fjalës lidhëse (lidhëz, përemër lidhor ose përemër pyetës) dhe sipas formës foljore (folje në mënyrë të shtjelluar, pjesore, paskajore, përcjellore).

Ashtu si në gjuhësinë tonë, edhe në atë të huaj vërejmë një mosndjekje të një kriteri unik për klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur. Pjesa më e madhe e gjuhëtarëve në klasifikimin e periudhave me nënrenditje bazohen në gërshetimin e kriterëve sintaksore (formale), semantike (kuptimore) dhe pragmatike (përdorimi në ligjërim). Gjuhëtarët tanë, edhe pse në periudha të ndryshme kohore, bëjnë një klasifikim të periudhave duke u mbështetur në *kriterin funksional* dhe duket se bashkohen në këtë pikë. Por, shpesh klasifikimi i fjalive të nënrenditura bazohet më shumë se në një kriter.

A. Xhuvani gërsheton *kriterin funksional me atë gramatikor-formal*, meqë ndër tipat e fjalive ai trajton edhe fjalinë lidhore; I. D. Sheperi, përveç kriterit funksional, duket se pleks edhe kriterin strukturor (fjalina përmendëse); K. Cipo kriterin funksional e ndërthur me kriterin strukturor dhe me të modalitetit; S. Floqi dhe M. Totoni, edhe pse vënë re se në sintaksën shqipe nuk është zbatuar një kriter unik në klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditura dhe flasin për domosdoshmërinë e një kriteri unik,²⁷⁴ i kanë ndërthurur kriteret e ndryshme, sepse, të marrë veç e veç, asnjëri prej tyre nuk arrin të përfshijë gjithë marrëdhëniet kuptimore që dalin midis fjalive të nënrenditura të periudhës.

Pavarësisht vërejtjeve që i janë bërë, *kriteri funksional*, i cili dhe është zbatuar nga pjesa më e madhe e sintaksologëve tanë, mbetet edhe sot më i përdorshmi në gramatikat shkollore dhe në studimet sintaksore. Nëpërmjet *paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë* pohohet ngjashmëria e rrafshëve të strukturës sintaksore dhe *tregohet kalimi nga struktura më e thjeshtë te më e ndërlikuara*²⁷⁵.

I nisur nga një kuptim më i gjerë i strukturës së fjalisë së nënrenditur, ky kriter ka ndihmuar të depërtohet më thellë në strukturën e saj dhe, në tërësi, të shihet më mirë karakteri i marrëdhënieve që vendosen ndërmjet fjalive.

²⁷⁴ S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhave me fjali të varura në shqipen e sotme*, Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1962, f. 226.

²⁷⁵ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000, f. 9.

Ndërsa kriteri *strukturor-semantik*, edhe pse është pranuar si më i miri, pasi ai lejon të zbulohen veçoritë strukturore dhe semantike të periudhës (mjetin e lidhjes, faktin nëse fjalia e varur i referohet një fjale a një grup fjalësh apo fjalisë drejtuese në tërësi, bashkëlidhjen e trajtave mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues, veçoritë intonacionore, raportet kuptimore themelore e dytësore të fjalisë së varur me kryesoren a drejtuesen) dhe është më i qëndrueshmi me të tjerët, ai nuk ka gjetur shtrirje në gramatikat tona.

2. 4 Cilit kriter do t'i përmbahemi në këtë punim?

Në punimin tonë do të përdorim termin *periudhë me fjali të nënrenditur*, duke u mbështetur në paralelizmin që bëhet mes fjalive të nënrenditura dhe pjesëve të ligjëratës apo gjymtyrëve të fjalisë, bazuar në *kriterin funksional*. Ky kriter na lejon të japim në mënyrë më të sistematizuar raportet sintaksore e raportet kuptimore të fjalive të varura me fjalitë kryesore drejtuese, ashtu si jepen edhe raportet e gjymtyrëve brenda një fjalie.

Paralelizmi midis fjalive të varura dhe gjymtyrëve të fjalisë mendojmë se është mjaft i përshtatshëm për të bërë përshkrimin e periudhës me fjali me nënrenditje e konkretisht të fjalisë me nënrenditje *rrjedhimore*.

Sipas mendimit tonë, te fjalia rrjedhimore nuk thyhet paralelizmi në funksione e në emërtim i gjymtyrëve të fjalisë e të fjalive të nënrenditura. Nëse ky kriter është “*tërësor e i plotë*” apo jo, për ne mbetet çështje e hapur²⁷⁶.

Por, ne mendojmë se nga kriteri funksional nuk përjashtohet fjalia rrjedhimore, pavarësisht se pohohet e kundërta.

Edhe pse në sintaksat tona rrethanori i rrjedhimit nuk përmendet si një nga gjymtyrët e dyta të fjalisë²⁷⁷, ne jemi të mendimit se edhe në shqip ka njësi sintaksore që mund të thuhet se kryejnë funksionin e rrethanorëve të rrjedhimit. E tillë, sipas gjykimit tonë, është për shembull fraza *për vdekje* në “rrah (godas, qëlloj) **për vdekje** (*dikë*)”, frazë e cila është sinonime me fjalinë e varur rrjedhimore (*aq sa e vdes*).²⁷⁸

²⁷⁶ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 493: Paralelizmi midis fjalive të varura dhe gjymtyrëve të fjalisë s'është tërësor e i plotë: ka ndonjë fjali të varur që shpreh raporte që nuk dalin në fjali, si raportet e rrjedhimit (kemi fjali të varura rrjedhimore, por jo plotës të rrjedhimit...).

²⁷⁷ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe, II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 493.

²⁷⁸ Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për ndërtimet e tipit “mërzis (bezdis) (*dikë*) për vdekje”, ku për vdekje përdoret në kuptim jo të drejtpërdrejtë dhe luan rolin e një rrethanori sasive a mënyre. (Shih për më shumë në kapitullin III.)

2.5 Vendi i fjalisë së nënrenditur rrjedhimore në klasifikimet e periudhave me nënrenditje në gjuhën shqipe

Skema nr. 4


A. Xhuvani

Klasifikimi sipas kriterit funksional-strukturor

Fjali të varme
kryefjalore
kundrinore
kohore
mënyrore
vendore
shkakore
lidhore
qëllimore
ndërmjetëse
krahasore
kushtore
rrjedhore
konçesive (lejore)

Skema nr. 5


I. D. Sheperi
Klasifikimi sipas kriterit funksional



Siç shihet nga skema, I. D. Sheperi nuk e pasqyron dhe nuk e trajton fjalinë e nënrenditur rrjedhimore.

Skema nr. 6

At J. Rrota
Klasifikimi sipas kriterit funksional



Skema nr. 7


K. Cipo
Klasifikimi sipas kriterit funksional

<u>Perioda</u>
subiektore
objektore
lidhore
pyetëse të zhdrejta
dvshimore
shkakore
kohore
vendore
krahasore
cëllimore
lejore
mënvrore
kushtore
rrjedhore
kufizore

Skema nr. 8

S. Prifti


Klasifikimi sipas kriterit funksional



Skema nr. 9

M. Domi


Klasifikimi sipas kriterit funksional strukturor-semantik



Skema nr. 10

S. Floqi

Klasifikimi sipas kriterit semantik strukturor-funksional



Skema nr. 11

Sintaksa e Akademisë

Klasifikimi sipas kriterit funksional

Fjali kryefjalore

- - lidhëzore ffilluese
- - përemërore
- - pyetëse e zhdrejtë

Fjali kallëzuesore

- - tipi lidhëzor
- - tipi përemëror
- - tipi ndajfoljor
- - tipi ndajfoljor pa fjalë të bashkëlidhura
(korrelative)

Fjali kundrinore

- - lidhëzore
- - përemërore
- - pyetëse e zhdrejtë

Fjali përcaktore

- - dalluese
- - përshkruese
- - ndajshimtare
- - filluese
- - shtesore

Fjali rrethimore

- - vendore
- - kohore
- - mënyrore
- - qëllimore
- - shkakore
- - **rrjedhimore**
- - kushtore
- - lejore
- - krahasore

Skema nr. 12

M. Totoni

Klasifikimi sipas kriterit strukturor semantik

**Fraza me fjalë mbështetëse
sintetike**

Ftilluese

- dëftore
- nxitëse a dëshirore
- pyetëse
- karakterizuese

Rrethimore

- kohore
- vendore
- mënyrore
- sasiore
- kushtëzuese
- shkakore
- qëllimore
- **rrjedhimore**
- kushtore
- lejore
- përqsore
- përjashtimore

Fraza pa fjalë mbështetëse sintetike

Fraza pa fjalë mbështetëse sintetike

- lidhëzore ftilluese
- dëftore
- nxitëse a dëshirore
- pyetëse

**Fraza me fjalë mbështetëse
lidhëzore saktësuese**


**Fraza me fjalë mbështetëse
lidhëzore krahasore**

**Fraza me fjalë mbështetëse
sintetike**

Skema nr. 13

Th. Dhima

Klasifikimi sipas kriterit strukturor-semantik dhe funksional



Nga të dhënat e nxjerra nga skemat e mësipërme ku janë paraqitur klasifikimet e bëra nga autorë të ndryshëm, mund të pohojmë se përgjithësisht fjalia e nënrenditur rrjedhimore është pjesë përbërëse e nënndarjes së fjalive rrethore, pra zë vendin e një rrethori rrjedhimi, edhe pse ky i fundit nuk përmendet si një nga gjymtyrët e dyta të fjalisë.

Si rrjedhim i kriterit semantiko-strukturor dhe atij funksional që ndjekin, M. Totoni dhe Th. Dhima bëjnë një klasifikim me më tepër nëntipa periudhash me fjali të nënrenditura, por, megjithatë, edhe për këta autorë fjalia e nënrenditur rrjedhimore është pjesë përbërëse e periudhave me fjali të nënrenditura rrethore.

KREU III

RRETH DISA ÇËSHTJEVE TË FJALISË RRJEDHIMORE

3.1 Trajtimi i derisotëm i fjalisë rrjedhimore në gramatikat dhe studimet për gjuhën shqipe

Siç u vështrua dhe më lart, fjalitë e nënrenditura rrjedhimore janë trajtuar në kuadrin e sintaksës së periudhës dhe, në veçanti, atyre rrethanore.

Sipas një vështrimi kronologjik, do të rendisim më poshtë çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e fjalive rrjedhimore, duke gjurmuar origjinën dhe evoluimin e këtij termi, si dhe trajtimin e kësaj njësie sintaksore bazuar në gramatikat dhe studimet për gjuhën shqipe, nga disa prej më të hershmeve e deri në ato të kohëve të fundit.

Prof. A. Xhuvani²⁷⁹ (i cili mendohet se është i pari ndër studiuesit shqiptarë që i ka vendosur emrin këtyre fjalive të nënrenditura) në tekstin e tij jep këtë përkufizim për fjalinë rrjedhimore: “Fjalitë rrjedhore kallëzojnë një përfundim, një rrjedhje të punës që tregohet në fjalinë e parë”. Ai vë në dukje përdorimin e lidhëzave që lidhin fjalinë kryesore me fjalinë e nënrenditur e konkretisht lidhëzën *saqë*, e cila vjen pas ndajfoljeve *kaq*, *aqë* dhe nëse në fjalinë kryesore mungon ndajfolja *kaq*, në fjalinë rrjedhore përdoret vetëm lidhëza *sa*. Këtu ai jep shembullin: *Fiton sa me jetue*.

Sipas Xhuvanit, në rast se ajo është e pashtjelluar, ndërtohet me anë të paskajores, p.sh.: *Punon sa me rrune gjallë*.²⁸⁰

Në sintaksën e tij Justin Rrota²⁸¹ fjalitë rrjedhimore (*konsekuitive*) i klasifikon në grupe: fjali të *pavarura* rrjedhimore dhe fjali të *varura* rrjedhimore.

Në periudhat me fjali të pavarura rrjedhore njëra fjali tregon rrjedhimin që buron nga përmbajtja e fjalisë së parë. Këto fjali lidhen në mes tyre me anë të lidhëzave të tipit: *pra*, *prandaj*, *për këtë arsye*, *kështu qi (që)* etj. Fjali të këtilla “të pavarura” i shohim edhe në sintaksat e mëvonshme, por në të tjera, si për shembull të *Gramatika* e Akademisë, cilësohen si periudha me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie përmyllëse²⁸².

Fjalitë e varura rrjedhore (*konsekuitive*), sipas Justin Rrotës tregojnë një përfundim, i cili është rrjedhim i veprimit që shprehet në fjalinë e parë kryesore, p.sh.: *Njikaq u hidhnuje sa s’dite ma shka flitte*. Burrnia asht një virtyt aq i bukur, *sa edhe armikut ia kemi lakmi*.²⁸³

Lidhëzat që dalin në këto lloje fjalish janë: *njëkaqë- sa*; *aqë-sa*; *kaqë- sa*; *njaqë- sa*, *qi*; *njaqë-qi*.

²⁷⁹ A. Xhuvani, *Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për klasët e nalta të fillores*, Vlorë, 1922; *Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillores e për t’ultat e Shkollavet të Mesme*, Tiranë, 1938; *Libri i gjuhës shqipe, pj. II për klasat e nalta të fillores dhe të parat e Qytetses*, Tiranë, 1942.

²⁸⁰ *Libri i gjuhës shqipe, pj. II për klasat e nalta të fillores dhe të parat e Qytetses*, Tiranë, 1942, f. 41.

²⁸¹ J. Rrota, *Syntaksa e gjuhës shqipe*, botimi i dytë, Shkodër, 1943; *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botimi I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 477-477.

²⁸² Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Syntaksa*, Tiranë, 1997, f. 60.

²⁸³ J. Rrota, *Syntaksa e gjuhës shqipe*, botimi i dytë, Shkodër, 1943, f. 88-89.

Fjalitë e nënrenditura rrjedhimore ai i klasifikon në grupin e fjalive me nënrenditje mënyrore²⁸⁴.

K. Cipo²⁸⁵ në veprën “*Sintaksa*” jep këtë përkufizim: “Fjalja rrjedhimore është fjalja që tregon rrjedhën e një veprimi të shprehur nga fjalja kryesore, ose nga një fjali tjetër prej së cilës varet rrjedhorja”²⁸⁶. Ai vëren se si mjete lidhëse përdoren lidhëza *sa* ose lidhëzat korrelative *aqë...sa*, *kaq...sa*, duke marrë si shembull një fjali të tillë si: “Thirri **aqë** lart *sa u ngjir nga zëri*”.

Në radhën e mjeteve të shprehjes së raporteve rrjedhimore, ashtu si Xhuvani, Cipo numëron edhe fjalitë e *pashtjella*, siç i quan ai format e pashtjelluara foljore, konkretisht ato me paskajore: *Ish bukë për t’ua hedhur pulave; ish gjellë për të mos un grenë; ç’ nuk bëri për t’ja arrirë qëllimit*.

Si raste të tjera të shprehjes së raporteve rrjedhimore Cipo përmend edhe ato ku korrelati mungon në fjalinë kryesore, duke sjellë si shembuj fjalitë: *hëngri sa s’desh më; foli sa u loth*.

Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore trajtohet në mënyrë më të plotë dhe më shkencore në gramatikat e hartuara nga Mahir Domi²⁸⁷. Përkufizimi i dhënë nga ai se “fjali e varur rrjedhimore quhet fjalja që tregon shkallën e një tipari a të mënyrës së një veprimi, masën a intensitetin e një veprimi, të një gjendjeje, ose masën e një sasive sendesh, duke shënuar një veprim, gjendje a tipar që është rrjedhim, pasojë e tyre, p.sh.: *Ishte shëndoshur aqë sa mezi e njoha*”²⁸⁸, për mendimin tonë paraqitet më i plotë sesa në gramatikat paraardhëse.

Ndër lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore me të cilat fjalja e nënrenditur bashkohet me kryesoren Domi përmend *sa*, *sa që*, *që*, të cilave “u përgjigjen në fjalinë tjetër fjalët korrelative *aqë*, *kaqë*, *qoftë si ndajfolje*, *qoftë si mbiemra e përemra të pakufishëm*. Ai punëtor punon **aqë** shpejt *sa normën e ditës e mbaron në tre orë*”.

²⁸⁴ J. Rrota, *Syntaksa e gjuhës shqipe*, botimi i dytë, Shkodër, 1943, f. 86: Fjalitë e ndajfoljorit të mënyrës i përgjigjen pyetjes si?, në ç’mënyrë?, sa?, në ç’masë?- dhe caktojn mënyrën, masën a shkallën e intensitetit të veprës së kallëzgjës:

1. *tue e krahasuem* me një kallëzgjës tjetër;

2. *tue diftue*, ase tue mohuem një *rrethanë përcjellse*;

3. tue prum një rrjedhim (konsekuencë), ase veprë që buron nga kallëzoja e fjalitë së parë. Prandaj, fjalitë e mënyrës janë tri farësh:

a) fjali krahasore (f. *komparative*),

b) fjali rrjedhimore (f. *konsekuitive*).

c) fjali vërtet mënyrore (f. *modale*).

²⁸⁵ K. Cipo, *Sintaksa*. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1952.

²⁸⁶ K. Cipo, *Sintaksa*, Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1952, f. 97.

²⁸⁷ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare*,

Tiranë, 1955; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa*, Tiranë, 1964; *Sintaksa e gjuhës shqipe II*, dispensë, Tiranë, 1969; M. Domi, “*Gramatika e gjuhës shqipe*”, *Sintaksa për shkollat e mesme*, Prishtinë, 1969 dhe 1971.

²⁸⁸ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare*, Tiranë, 1955, f. 192; M. Domi “*Gramatika e gjuhës shqipe*” *Sintaksa për shkollat e mesme*, Prishtinë, 1971.

Për nga ana strukturore, ai i ndan fjalitë rrjedhimore në fjali rrjedhimore me fjalë korrelative në fjalinë drejtuese dhe fjali rrjedhimore pa fjalë korrelative. Si fjalë korrelative, thotë Domi, mund të dalin edhe mbiemrat *i tillë, i këtillë* e në raste të veçanta edhe fjalë e shprehje të tjera, si fjala *gjer*, p.sh.: E bija e Pando Stefos i dha një të tillë shuplakë oficerit, *sa që flakë i duallnë nga sytë*. Heshtja ish e tillë, *sa që Tefta ndjeu mornica në trup*. Besa s'jam katandisur **gjer atje sa të më urdhërojë ai**.²⁸⁹ Domi vëren se raportet rrjedhimore mund të shprehen edhe me lloje të tjera fjalish, si ato lidhore të tipit *Paske blerë një bostan që s'u haka (të tillë që s'u haka)*.

Ai vë re që raporte rrjedhimore tregojnë edhe fjalitë e ndërtuara me lokucionet lidhëzore *ashtu që, në mënyrë që*, të cilat shfaqin mënyrën e një veprimi me anë të tregimit të pasojës së tij. Këtu ai analizon edhe rastet kur raportet rrjedhimore shfaqen me gërshetime nuancash të tjera kuptimore e konkretisht me nuanca mënyrore, qëllimore e krahasore.

M. Domi paraqet gjithashtu dhe raste të bashkimit jolidhëzor të fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur. Në këtë rast fjalia që shpreh rrjedhim gjendet përpara fjalisë kryesore. Kjo e fundit paraprihet nga një ndajfolje, si *aq, kaq*. Këtu ai jep shembujt: *Për pak atij desh i ra turta nga dora, kaqë u habit. Më vinte të flija aty në tavolinë, aqë të këputur e ndjeja veten*.

Për *aq* sa mund të lejonte një tekst mësimor, periudha me fjali të varur rrjedhimore në veprën e M. Domit ka gjetur trajtimin më të plotë nga të gjitha tekstet e mëparshme, që përmendëm më lart. Në mënyrë më të zgjeruar periudhën me fjali të varur rrjedhimore e trajton Spiro Floqi.²⁹⁰

Në përkufizimin për fjalinë rrjedhimore kjo e fundit paraqitet si fjali që tregon një pasojë, një rrjedhim a efekt të asaj që përmbahet në fjalinë nga e cila ajo varet.²⁹¹ Ai dallon tre tipa semantiko-strukturorë të fjalisë rrjedhimore²⁹², secili me nëntipat e tij:

- Tipi korrelativ lidhëzor-përemëror;
- Tipi korrelativ mungesor-përemëror;
- Tipi lidhëzor jokorrelativ.

Autori argumenton pamjaftueshmërinë e dallimit të fjalisë rrjedhimore vetëm nga mjeti i lidhjes, për shkak se:

a) rrjedhimi i shprehur nga fjalia e varur rrjedhimore mund të ngjyrohet nga ndonjë kuptim anësor që shprehet në fjalinë kryesore;

b) rrjedhimi mund të mos ketë ndonjë nuancë të tillë, por paraqitet *i thjeshtë*, si një pasojë logjike e asaj që thuhet në fjalinë kryesore;

²⁸⁹ M. Domi "Gramatika e gjuhës shqipe" Sintaksa për shkollat e mesme, Prishtinë, 1971, f. 109.

²⁹⁰ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 55- 97.

²⁹¹ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 55.

²⁹² S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 55: Përbrenda periudhës me fjali të varur rrjedhimore do të dallojmë këto tri tipe secila me nëntipat e veta, sipas faktit që: **a.** rrjedhimi i shprehur nga fjalia e varur rrjedhimore mund të ngjyroset nga ndonjë kuptim anësor që shprehet në fjalinë kryesore; **b.** rrjedhimi nuk ngjyroset nga ndonjë nuancë e tillë, por paraqitet "i thjeshtë", si një pasojë logjike, si një konkluzion i saj që thuhet në fjalinë kryesore; **c.** rrjedhimi është një nuancë suplementare që shtohet mbi funksionin themelor të fjalisë së varur dhe del krejtësisht në bazë të bashkëlidhjes së përmbajtjeve konkrete reale të fjalive të periudhës; marrëdhëniet midis fjalisë së varur dhe kryesores janë në radhë të parë përcaktore etj. me një nuancë eventuale të rrjedhimit.

c) rrjedhimi është një nuancë shtesë mbi funksionin themelor të fjalisë së varur dhe del krejtësisht në bazë të bashkëlidhjes së përmbajtjeve konkrete reale të fjalive të periudhës; marrëdhëniet midis fjalisë së varur dhe kryesores janë në radhë të parë *përcaktore* etj., me një nuancë të mundshme rrjedhimi.

Pra, Floqi pohon se mjeti i lidhjes nuk është i mjaftueshëm për të bërë të qartë kuptimin e fjalisë rrjedhimore, prandaj, sipas tij, duhet mbështetur edhe te plotësia leksikore e fjalive dhe bashkëlidhja kuptimore e brendive të tyre.

Në përkufizimin për fjalinë rrjedhimore kjo e fundit paraqitet si fjali që tregon një pasojë, një rrjedhim a efekt të asaj që përmbahet në fjalinë nga e cila ajo varet.²⁹³

Në këtë artikull S. Floqi, ndryshe nga autorët e lartpërmendur, nuk përfshin në periudhën me fjali të varur rrjedhimore konstruktet jopredikative (“fjalitë e pashtjella”) dhe as konstruktet predikative paralidhëzore (intonacionore).²⁹⁴

Ai bën dallimin e periudhave me fjali të nënrenditur rrjedhimore nga ato me fjali krahasore, kohore, qëllimore, duke argumentuar se rol të rëndësishëm së bashku me mjetet lidhëse luan edhe *konteksti*.

Mbështetur mbi një material më të gjerë, të marrë jo vetëm nga ligjërimi popullor, por edhe nga letërsia artistike, trajtohet fjalia rrjedhimore në sintaksën e S. Priftit²⁹⁵.

Për autorin në fjalë “*fjali rrjedhore quhet ajo fjali e varur, e cila shpreh raporte të rrjedhimit kundrejt fjalisë nga varet*”.²⁹⁶

Sipas formës së lidhjes, ai dallon:

1) Fjali rrjedhimore lidhëzore që ndërtohen:

- me lidhëzat apo ndajfoljet lidhore *sa, saqë*;

- me lidhëzën ftilluese që (*qi*);

- me lidhëzën qëllimore *që* dhe me foljen në mënyrën lidhore (apo edhe vetëm me lidhore të thjeshtë, pa lidhëzën *që*).

2) Fjali rrjedhimore asindetë që ndërtohen me paskajore, p.sh.: *A fry tëmthash shkjav, rrashta me i plasur*.²⁹⁷

Për autorin në fjalë, shprehja e rrjedhimit shfaqet në dy aspekte, në aspektin kuantitativ dhe në aspektin kualitativ. Lidhëzat *sa, sa që* përdoren për të shprehur *aspektin kuantitativ* të rrjedhimit, kurse lidhëzat e tjera shërbejnë zakonisht për të dhënë *aspektin kualitativ* të tij.

Mes të tjerash, për herë të parë autori i artikullit vëren si një tip më vete fjalinë *ndajshtimore të rrjedhimit*,²⁹⁸ e cila dallon nga fjalia e nënrenditur rrjedhimore.

²⁹³ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 55.

²⁹⁴ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 55.

²⁹⁵ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.

²⁹⁶ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 417

²⁹⁷ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 418.

²⁹⁸ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 418: Fjalia rrjedhore duhet dalluar nga fjalia ndajshtimore caktore e rrjedhimit. Kjo varet nga një pjesë emërore apo ndajfoljore, kuptimin e përgjithshëm të së cilës përcakton, p.sh. 1) “mësonjësi fliste aq bukur, *sa të gjithë mbetën gojë hapur*”.

2) Mësuesi foli me një mënyrë *që na mallëngjeu të gjithëve*”.

Për mungesë të pjesës emërore apo ndajfoljore të përcaktuar, fjalia ndajshtimore e rrjedhimit kthehet në fjali të pastër rrjedhimore d.m.th. në fjalë rrjedhore që varet drejtpërdrejt nga folja, p.sh. “Ng’ajy mall’ i shumë umpinë, *Sa të katrë u sëmurë*.”

Trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me fjalinë e varur rrjedhimore ai e vijon me gërshetimet funksionale të kësaj fjalie me fjali të varura kundrinore, qëllimore, për ta mbyllur me dallimin e periudhave me fjali të nënrenditur rrjedhimore nga ato me fjali krahasore e kohore.

Në Gramatikën e Akademisë përkufizimi dhe karakteristikat e fjalisë rrjedhimore jepen më të plota e më shkencore duke shpjeguar të gjitha nënlojet e marrëdhënies. Konkretisht thuhet se *është ajo periudhë ku shprehen ose marrëdhënie në mes një sasive, shkallës a intesitetit të madh të parashtur në fjalinë kryesore si shkak dhe pasojës a rrjedhimit që vjen pas saj, të shprehur në fjalinë e varur, ose marrëdhënie mes faktit e ngjarjes së shprehur në fjalinë kryesore dhe përfundimit logjik të tij, të shprehur në fjalinë rrjedhimore.*²⁹⁹

M. Totoni në studimin e tij “*Fraza me nënrenditje*”³⁰⁰ e paraqet fjalinë rrjedhimore si fjali që shpreh marrëdhënie shkak-rrjedhim: fjalia kryesore përmban një situatë si shkak për pasojën a rrjedhimin që përmbahet tek e nënrenditura. Ai e rendit frazën rrjedhimore në grupin e frazave kushtëzuese.

Fraza më fjali të nënrenditur rrjedhimore përfshihet në nënklasën e frazave pa fjalë mbështetëse analitike, e cila karakterizohet nga përdorimi i lidhëzave si mjete të bashkimit të fjalive. Një ndër llojet e frazave analitike, sipas kriterit kuptimor, është dhe fraza pa fjalë mbështetëse rrethanore, e cila ndahet më tej sipas marrëdhënieve të mirëfillta rrethanore.

Gjatë shtjellimit të çështjeve që kanë të bëjnë me mjetet e shprehjes së raporteve rrjedhimore, te ky autor hasim për herë të parë këtë klasifikim të lidhëzave: lidhëza me kuptim të padiferencuar (lidhëza *që, sa*) dhe me kuptim të diferencuar (lidhëzat *saqë, aq sa* dhe *kështu që*).

Mbi këtë bazë ai dallon fraza rrjedhimore me lidhëza me kuptim të padiferencuar dhe fraza rrjedhimore me lidhëza me kuptim të diferencuar. Në frazat me lidhëza me kuptim të padiferencuar, meqenëse lidhëzat *që, sa* nuk janë specifike si lidhëza rrjedhimore, marrëdhënia bëhet e qartë nga konteksti, nga modaliteti i fjalisë kryesore dhe nga prania e mjeteve leksikore. Nëse mjete të tilla mungojnë, marrëdhënia është rezultat i bashkëlidhjes kuptimore të fjalive.

Në paragrafët kushtuar fjalisë së varur rrjedhimore autori përmend se marrëdhënia rrjedhimore mund të jetë *reale* ose *e mundshme*. Mbështetëse të marrëdhënies janë lidhëzat dhe, sidomos, plotësia leksikore e fjalive, që bëjnë të qartë bashkëlidhjen e situatës së fjalisë së nënrenditur si rrjedhim.

Studimi për fjalinë rrjedhimore mbyllet me rendin e fjalive dhe aktualizimin e frazës rrjedhimore.

Për Th. Dhimën “Në fjalinë rrjedhimore shprehen marrëdhëniet shkak - rrjedhim”. Në pjesën kryesore përmbahet shkaku, kurse në të nënrenditurën rrjedhimi a pasoja e këtij shkaku. Duke i përgjithësuar edhe lokucionet lidhëzore në kategorinë e lidhëzave, ai numëron këto lidhëza

²⁹⁹ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 493.

³⁰⁰ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Tiranë, 2000.

nënrenditëse rrjedhimore: “Në fjalinë rrjedhimore pjesët kryesore bashkohen midis tyre me lidhëzat: që, sa, aq sa dhe kështu që.”³⁰¹

Sipas Th. Dhimës fjalia me nënrenditje rrjedhimore është dy llojesh: fjali e përbërë me nënrenditje rrjedhimore korrelative dhe fjali e përbërë me nënrenditje jokorrelative. Mes fjalive në periudhën me nënrenditje rrjedhimore jokorrelative vendosen dy lloje marrëdhëniesh: reale dhe joreale. Paralelisht me lidhëzat që përdoren për secilin lloj të marrëdhënies ai jep edhe trajtat kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhë.

Nga sa u vu re më sipër, shihet qartë që ai ndjek dhe mbështet M. Totonin. Edhe për M. Çelikun “periudhë me sifjali të nënrenditur rrjedhimore quhet ajo periudhë në të cilën shprehen marrëdhënie rrjedhimore midis veprimit të sifjalisë kryesore dhe sifjalisë së varur: në këtë periudhë sifjalia kryesore përmban shkakun, sifjalia e varur përmban rrjedhimin apo përfundimin logjik, d.m.th. në këtë tip ekziston lidhja *shkak + rrjedhim*.”³⁰²

Edhe për autorin e lartpërmendur fjalitë rrjedhimore dalin dy llojesh:

1. periudha rrjedhimore korrelative (me sifjali të bashkëlidhur me kryesoren edhe me një fjalë speciale lidhëse, përveç lidhëzës) dhe
2. periudha rrjedhimore jokorrelative (me sifjali jo të bashkëlidhur). Por ndryshe nga disa autorë të tjerë (Th. Dhima³⁰³), për M. Çelikun as periudha rrjedhimore nuk mund të kthehet në shkakore, as periudha shkakore nuk mund të kthehet në rrjedhimore.

Të dyja ato funksionojnë në gjuhë si dy struktura gramatikore të ndryshme, ku në njërin prej tyre shprehen marrëdhënie rrjedhimore, kurse në tjetrën marrëdhënie shkakore; pra këto janë thënie të ndryshme, ku gjymtyrët shprehen nga përbërës të ndryshëm.

Ne jemi të mendimit se pavarësisht faktit se fjalia e nënrenditur rrjedhimore dhe ajo shkakore funksionojnë në gjuhë si dy struktura të ndryshme, ku secila shpreh marrëdhënie të ndryshme.

Pra, në përgjithësi mund të themi se në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore shprehet pasoja e ngjarjes apo e gjendjes së treguar në fjalinë kryesore:

Ka rënë kaq shumë shi, saqë lumi ka dalë nga shtrati.

Në këtë shembull, fjalia kryesore shpreh një shkak (sasia e madhe e shirave), prej të cilit rrjedh pasoja e treguar në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore (dalja e lumit nga shtrati).

Marrëdhënia e pasojës mund të vlerësohet si realizim i veçantë i një marrëdhënieje shkakësie. Në fakt, mund ta riformulojmë shembullin e mësipërm, duke e kthyer në një rend: *fjali e nënrenditur shkakore + fjali kryesore*;

Meqë ka rënë shumë shi, lumi ka dalë nga shtrati.

Për ta shndërruar marrëdhënien rrjedhimore në një lidhje shkakore, është e nevojshme ta shprehim shkakun të fjalive të nënrenditur duke e zhvendosur shprehjen e pasojës të fjalive kryesore; veç kësaj, është shmangur ndajfolja (kaq) që në fjalinë *Ka rënë kaq shumë shi, saqë*

³⁰¹ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2005, f. 194.

³⁰² M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILAR, 2012, f. 401-402.

³⁰³ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2005, f. 194: Sikurse fjalia shkakore mund të kthehet në rrjedhimore, edhe rrjedhimorja mund të kthehet në fjali shkakore, pjesa kryesore e së cilës bëhet e nënrenditur për shkakoren, kurse e nënrenditura bëhet kryesore: Njerëz s'kishte në fshat, *kështu që dyert i gjetëm të mbyllura*--- Dyert i gjetëm të mbyllura, *sepse në fshat s'kishte njerëz*.

lumi ka dalë nga shtrati përforconte shkakun. Pikërisht prania e shkakut të përforcuar e dallon marrëdhënien e rrjedhimit:

U ndie keq, pasi hëngri shumë.
Hëngri aq shumë, saqë u ndie keq.

Në fjalinë *U ndie keq, pasi hëngri shumë*, fjalia e nënrenditur pasqyron arsyen e veprimit të paraqitur në fjalinë kryesore: mes dy fakteve nuk ruhet marrëdhënia e detyrimit si në fjalinë *Hëngri aq shumë, saqë u ndie keq*.

Marrëdhënia rrjedhimore nënkupton që pasoja nis në çastin kur shkakun mbërrin në pragun kritik. Duke përforcuar shkakun, pasoja merr një vlerë nevojë a domosdoshmërie.

Nga sa u vu re më lart, përkufizimi, tiparet e periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore jepen pak a shumë njësoj, pa shumë ndryshime.

Mund të themi se studimi i periudhës me fjali të varur rrjedhimore në gjuhën shqipe ka ecur duke hyrë më thellë në kuptimin e marrëdhënieve rrjedhimore dhe të mjeteve shprehëse të tyre.

Ndonëse secili nga autorët e lartpërmendur ka dhënë ndihmesën e vet në njohjen dhe trajtimin e periudhës me fjali të varur rrjedhimore, qëllimi mësimor dhe karakteri shpesh shkollor i këndvështrimit të tyre ka bërë që trajtimi i këtyre periudhave të jetë i paplotë.

Në trajtimin e kësaj njësie sintaksore nuk ka pasur asnjë studim të thelluar në gjuhën e popullit.

3.2. Evolucioni i lidhëzave dhe lokucioneve lidhëzore rrjedhimore

Sipas prof. Shaban Demirajt³⁰⁴, termi “*lidhëzë-a*” në gjuhësinë tonë është përdorur për herë të parë nga prof. Aleksandër Xhuvani.

Gjerësisht me këtë çështje është marrë studiuesi Emil Lafe. Mbështetur në një vjelje shteruese të veprës “*Meshari*” të Gjon Buzukut, si monumenti më i vjetër i letërsisë shqipe, ai ka studiuar *sistemin lidhëzor* të shqipes. Prof. Lafe thekson që, duke qenë se lidhëzat, për vetë veçorinë e funksionit që kryejnë, janë tregues i shkallës së zhvillimit të mjeteve të shprehjes së raporteve sintaksore, “studimi i tyre te Gjon Buzuku na ndihmon të marrim një ide pak a shumë të përgjithshme për *sintaksën e frazës në shqipen e shekullit XVI*”.³⁰⁵

Prof. Lafe vë në dukje se, duke ditur si paraqitet kjo pjesë e ligjëratës te libri i Buzukut, mund të kuptojmë më mirë se nga ç’bazë është nisur dhe si është zhvilluar sistemi i mjeteve lidhëzore që ka gjuha e sotme standarde.

Në artikullin e tij E. Lafe jep me statistika lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore rrjedhimore që janë përdorur te “*Meshari*” i Buzukut. Ai vëren se te Gjon Buzuku lidhëzat rrjedhimore përfaqësohen nga *qi*, e cila del vetëm dy herë; *sã*, që del dhjetë herë; *aqë së* shtatë herë, kurse lokucioni *ashtu qi* haset katër herë.

Autori në këtë artikull shpreh mendimin se *aqë sa* duhet të merret si lokucion lidhëzor i vjetër, ndryshe nga S. Floqi, i cili *aqë sa* e klasifikon ndër “mjetet lidhëse relativisht të reja”³⁰⁶.

Buzuku:

Lidhëza rrjedhimore

qi, së

Lokucione lidhëzore

aqë së, ashtu qi

Statistikat e nxjerra nga autori në punimin e tij për lidhëzat rrjedhimore dhe lokucionet lidhëzore rrjedhimore, tregojnë se lidhëza rrjedhimore *sã* është një ndër lidhëzat me dendurinë më të lartë të përdorimit nga lidhëzat që ka përdorur Gjon Buzuku në veprën e tij “*Meshari*”.

³⁰⁴ Sh. Demiraj, *Aleksandër Xhuvani si vazhdues i veprës së Konstandin Kristoforidhit*, Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, Tiranë, 1986, f. 129.

³⁰⁵ E. Lafe, *Mbi disa lidhëza nënrenditëse te Gjon Buzuku*, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike (12-18 janar 1968), Tiranë, 1969, f. 159.

³⁰⁶ Shih S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965. Nr. 2, f. 59.

A. Xhuvani³⁰⁷ i klasifikon lidhëzat në të thjeshta dhe të përngjitura dhe numëron si rrjedhimore lidhëzat:

sa, saqë

Në gramatikën e tij G. Mikeli *konjunkcion, lidhca* quan “ato fjalë lidhëse, qi vijnë me bashkue fjalë ose folje ndërmjet vedi”³⁰⁸. Si lidhëza rrjedhimore ai njih: *qi, kështu qi, aq sa*.

G. Mikeli:

Lidhëza rrjedhimore

qi

Lokucione lidhëzore

kështu qi, aq sa.

Justin Rrota³⁰⁹ i përfshin lidhëzat të “pjesët e palakueshme” të ligjëratës. Ai shprehet: “*Lidhsat (konjunkcioni), si t’a thotë fjala vetë, nuk ka një zyrë në fjali, sikur pjesët të tjera të ligjëratës. Gjithë puna e saj është të bashkojë a të ngjeshë fjalit apo pjesët e fjalit, ndërmjet vetes*”³¹⁰. Pra, Rrota thekson se lidhëzat nuk kanë aftësi për të kryer funksionet që kryejnë fjalët kuptimplota si gjymtyrë kryesore a të dyta të fjalive, por kanë vetëm aftësinë për të lidhur dy fjali bashkë ose një fjali me një gjymtyrë të fjalisë drejtuese a kryesore.

Ato mund të jenë dyfarëshe: *njërendore* (të bashkërenditura), kur lidhin dy fjali të pavarura, të cilat mund të qëndrojnë edhe veç. Të tilla janë lidhëzat *e, dhe, edhe, por, prejse* etj. Grupin e dytë të lidhëzave e përbëjnë lidhëzat *nënrendore* (të nënrenditura), të cilat Rrota i emërton edhe *subordinate*, sipas italishtes. Ai vëren se lidhëza të këtilla lidhin një fjali të varur me një fjali kryesore dhe përmend ndër të tjera lidhëzat *si, kur, ku, pse, mbasi, ndërsa, kurse, parase, porse, qi, aq sa* etj.

Më tej Rrota analizon funksionin e disa lidhëzave. Kështu, ai vëren se “lidhëzat e tipit *andej, këndej, pra, prandaj* diftojnë rrjedhim”³¹¹.

³⁰⁷ A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe për klasët e nalta të Fillores e të parat e Qytetes*, pjesa II, Tiranë, 1942.

³⁰⁸ G. Mikeli, *Gramatika e gjuhës shqype*, shtypshkronja “Nikaj”, Shkodër, 1916, f. 122.

³⁰⁹ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Shkodër, 2006.

³¹⁰ J. Rrota, *po aty*, f. 427.

³¹¹ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Shkodër, 2006, f. 154.

Mjetet lidhëse që shërbejnë për të lidhur fjalinë e varur rrjedhimore me kryesoren (të pavarëshmen), Justin Rrota i quan *fjalza*³¹² dhe njeh si të tilla: *sa, qi, saqi* të cilave u përgjigjen në fjalinë kryesore korrelatët *njëskaqë, njaqë, kaqë, aqë*.

Justin Rrota:

sa, qi, saqi

Në sintaksën e Kostaq Cipo³¹³ gjejmë këto lidhëza e lokucione rrjedhimore: *sa, që i gjengjen korrelatët , aqë, kaq.*

Kostaq Cipo:

Lidhëza rrjedhimore

sa

Mahir Domi në gramatikën e tij³¹⁴ paraqet këto lidhëza nënrenditëse rrjedhimore: *sa* e *që*, si edhe lokucionet rrjedhimore *sa që, ashtu që, në mënyrë që*.

Mahir Domi:

Lidhëza rrjedhimore

sa, që

Lokucione lidhëzore

*sa që, ashtu që, në
mënyrë që*

³¹² J. Rrota, *Sintaksa e gjuhës shqipe për klasën II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, shtypshkronja A. Gj. Fishta, 1943, f. 85.

³¹³ K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë, 1952, f. 95.

³¹⁴ M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 108-111.

Spiro Floqi, në trajtimin që i bën fjalisë së varur rrjedhimore, rendit si lidhëza nënrenditëse rrjedhimore *sa, që, sa që, aqë sa, kaqë sa, kështu që* e *në mënyrë që*.

Spiro Floqi:

Lidhëza rrjedhimore

sa, që

Lokucione lidhëzore

sa që, aqë sa, kaqë, sa, kështu që, në mënyrë që

S. Prifti në sintaksën³¹⁵ e tij, ashtu si edhe prof. Mahir Domi në veprën e përmendur më sipër, përfshin këto lidhëza e lokucione rrjedhimore: *sa, që* dhe *sa që*.

S. Prifti:

Lidhëza rrjedhimore

sa, që

Lokucione lidhëzore

sa që

Në Gramatikën e Akademisë³¹⁶ renditen këto lidhëza e lokucione lidhëzore rrjedhimore: *sa, sa që, aq sa, që* dhe *kështu që*. Aty, po ashtu, në raste të caktuara sintaksore, me funksione rrjedhimore mund të përdoret edhe lokucioni *në mënyrë që*.

Gramatika e Akademisë:

Lidhëza rrjedhimore

sa, që

Lokucione lidhëzore

aq sa, sa që, kështu që, në mënyrë që

³¹⁵ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.

³¹⁶ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 573.

Ndërsa prof. Menella Totoni, gjatë shtjellimit të çështjeve që kanë të bëjnë me mjetet e shprehjes së raporteve rrjedhimore³¹⁷, i ndan lidhëzat që shprehin raporte rrjedhimore në dy grupe: në *lidhëza me kuptim të padiferencuar*, ku ai përfshin lidhëzën **që**, dhe në *lidhëza me kuptim të diferencuar*, të cilat sipas prof. Totonit janë **sa** e **saqë**, si edhe lokucioni **aq sa**.

Studiuesi T. Topalli në sintaksën e tij³¹⁸ rendit këto lidhëza e lokucione lidhëzore: **që**, **sa**, **aq sa**, **kështu që**.

Th. Dhima në trajtimin që i bën fjalisë së përbërë me nënrenditje rrjedhimore, siç e quan ai, numëron këto lidhëza nënrenditëse rrjedhimore: **që**, **saqë**, **aq sa**, **kështu që**.³¹⁹

Pasqyrimi skematik i shpërndarjes së lidhëzave e lokucioneve lidhëzore rrjedhimore

Lidhëzat/ Autorët	Buzuku	Rrota	Cipo	Xhuvani	Domi	Floqi	Prifti	A. Shkenc. Gramatika e gjuhës shqipe II	Totoni	Topalli	Dhima
<i>qi</i>	+	+									
<i>sa</i>	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
<i>aqë sã,</i>	+					+					
<i>ashtu qi</i>	+										
<i>ashtu që</i>					+						
<i>sa që</i>	+				+	+	+				
<i>saqë</i>		+		+		+					+
<i>kaqë sa</i>						+			+		
<i>që</i>					+	+		+	+	+	
<i>aq sa</i>					+	+		+	+	+	+
<i>kaq sa</i>						+					
<i>kështu që</i>						+		+		+	+
<i>në mënyrë që</i>					+	+		+			

Duke krahasuar lidhëzat në librin e parë të njohur shqip, “Mesharin” e Gjon Buzukut, dhe shembujt e marrë nga punimet e autorëve të ndryshëm për fjalitë e varura rrjedhimore, mund të nxjerrim si përfundim se nuk ka dallime të theksuara të lidhëzave rrjedhimore në fazat e ndryshme të zhvillimit të shqipes.

³¹⁷ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Tiranë, 2000, f. 95.

³¹⁸ T. Topalli, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa e fjalisë*, Shkodër, 2011, f. 69.

³¹⁹ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, Tiranë, 2010, f. 194.

Kështu, mund të thuhet se kategoria e lidhëzave rrjedhimore, që te Buzuku përfaqësohet nga dy lidhëza *qi* e *sã* dhe lokucionet lidhëzore *aqë sã* dhe *ashtu qi*, ka pësuar më shumë zhvillime e ndryshime në formë (ndryshime fonetike e ortografike), pa u zgjeruar nga pikëpamja sasiore.

Vërehet se, në vend të lokucionit rrjedhimor *ashtu qi*, sot përdoret lokucioni *kështu që*. Relativisht i ri del dhe lokucioni *në mënyrë që*, që, siç u përmend më sipër, mund të përdoret për të shprehur rrjedhimin, veçanërisht në stilin publicistik e në atë shkencor.

Nga shpërndarja e lidhëzave dhe lokucioneve rrjedhimore që është pasqyruar në tabelën e mësipërme, vërejmë se lidhëza *sa* dhe lokucioni lidhëzor *aq sa* janë më të përhapura. Me një shpërndarje pa shumë diferencë nga njëra-tjetra takohen lidhëza *që* dhe lokucioni lidhëzor *saqë*.

Lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore rrjedhimore janë studiuar pothuajse në të gjitha gramatikat e ndryshme të gjuhës shqipe. Në to, lidhëzat rrjedhimore janë klasifikuar zakonisht në grupin e lidhëzave sintaksore.

3. 3 Mënyrat e shprehjes së marrëdhënieve rrjedhimore

Marrëdhëniet rrjedhimore shprehen në mënyra të ndryshme. Përveç periudhave me *fjali të nënrenditura*, ato mund të shprehen edhe me *fjali të thjeshta*, *periudha me fjali të bashkërenditura*, *periudha me fjali asindetike*, si edhe përtej periudhës, në *nivel teksti*. Ngjyrimet rrjedhimore ngërthejnë edhe një numër periudhash të tjera me fjali të nënrenditura.

Në këtë punim edhe termin “*periudhë rrjedhimore*” e përdorim në një kuptim më të gjerë se ai i zakonshmi, duke përfshirë në të jo vetëm periudhën me fjali të varur rrjedhimore, por edhe periudhat me fjali asidentike që shprehin rrjedhim, si edhe periudhat me fjali përmbyllëse dhe ato ku fjalia e varur lidhet me kryesoren me lidhëzat *sa*, *derisa*, *gjersa* etj. Nga ana tjetër, ndonjëherë janë lënë jashtë përfshirjes në periudhat me fjali të varura rrjedhimore edhe disa tipa periudhash ku, për mendimin tonë, marrëdhënia rrjedhimore është kryesorja. E kemi fjalën, para së gjithash, për periudhat me fjali që bashkohen me lidhëzat **sa**, **derisa** etj.

Në disa gramatika të shqipes, si për shembull tek ajo e Martin Camajt (1984), këto fjali klasifikohen si rrjedhimore, por në të tjera, si për shembull te *Gramatika II (Sintaksa)* e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, cilësohen si periudha me fjali të varur kohore me ngjyrimet rrjedhimore.

Mendojmë se për interpretimin e tyre duhet mbajtur parasysh deri diku vërejtja që bëhet po në *Gramatikën II*³²⁰ sipas së cilës, nëse në këto fjali mbizotëron kuptimi kohor apo ai rrjedhimor, kjo varet nga konteksti a situata.

Kështu, periudha “*Qeshi sa i dolën lot nga sytë*” duhet të merret si rrjedhimore (mund ta perifrazojmë me një periudhë me fjali të varur rrjedhimore si: *Qeshi aq shumë, sa i dolën lot nga sytë*, por jo me një kohore që tregon kohëzgjatje si: **Qeshi për aq kohë sa i dolën lot*),

³²⁰ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002, f. 574.

por tek *E skuqim qepën sa të marrë ngjyrë të verdhë* është e vështirë të thuash nëse kryesor është kuptimi kohor apo kuptimi rrjedhimor (si parafraza *E skuqim qepën për aq kohë sa të marrë ngjyrë të verdhë*, ashtu edhe *E skuqim qepën aq sa të marrë ngjyrë të verdhë* janë njësoj të përshtatshme).

Sidoqoftë, mund të thuhet me siguri se këtij tipi periudhe mund t'i bëhet gjithherë një interpretim rrjedhimor, gjë që s'mund të thuhet edhe për atë kohor, ndaj kjo për ligj, sipas gjykimit tonë, klasifikimin e tyre përkrah fjalive të tjera rrjedhimore. Kështu, për ne janë rrjedhimore edhe periudhat me fjali të varur si: *Ishte aq i fuqishëm, sa të tërë ia kishin frikën*, ashtu edhe të bashkërenditurat e jolidhëzoret *Ishte i fuqishëm dhe (si rrjedhim) të tërë ia kishin frikën; Ishte i fuqishëm, ndaj të tërë ia kishin frikën; Ishte i fuqishëm, (si rrjedhim) të tërë ia kishin frikën*.

Pavarësisht nga struktura e tyre sintaksore, për sa i përket kuptimit, këto periudha janë sinonime me njëra-tjetrën. Kjo gjë për ligj trajtimin e tyre si një grup i vetëm nga autorë të ndryshëm, ashtu siç do ta shohim në vijim.

3.3.1 Shprehja e marrëdhënieve rrjedhimore në fjali të thjeshtë

Tradicionalisht në sintaksën shqiptare nuk ka qenë i përhapur emërtimi "*fjali (e thjeshtë) rrjedhimore*".

Kjo me gjasë ka ndodhur jo vetëm ngaqë nuk është bërë ndonjë klasifikim sistemor i fjalive të thjeshta sipas raporteve funksionale-kuptimore (ose qoftë edhe formale) ndërmjet gjymtyrëve të tyre, por edhe sepse është menduar, siç vërehet në *Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa)* të Akademisë së Shkencave (f. 493), se në këto fjali nuk ka raporte rrjedhimi, gjë që, sipas autorëve të kësaj vepre, dëshmohet nga mungesa e plotësve (rrethatorëve) të rrjedhimit, përkundër qenies së fjalive të varura rrjedhimore.

Por ne jemi të mendimit se edhe në shqip ka njësi sintaksore që mund të thuhet se kryejnë funksionin e rrethatorëve të rrjedhimit. E tillë, sipas gjykimit tonë, është për shembull fraza *për vdekje* në "rrah (godas, qëlloj) **për vdekje** (dikë)", frazë e cila është sinonime me fjalinë e varur rrjedhimore (*aq sa e vdes*).³²¹

Sidoqoftë, për mendimin tonë marrëdhëniet rrjedhimore ekzistojnë edhe në ndërtimet ku ato nuk janë të shprehura posaçërisht nga ana leksikore, domethënë ku ka fraza - kryesisht në rolin e rrethatorëve - që mendohet se shprehin në fjali raporte të tjera, sipas të cilave edhe emërtohen.

³²¹ Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për ndërtimet e tipit "mërzis (bezdis) (dikë) për vdekje", ku për *vdekje* përdoret në kuptim jo të drejtpërdrejtë dhe luan rolin e një rrethatori sasie a mënyre.

Kështu, për shembull, kuptim rrjedhimor mund të themi se kemi edhe në ato fjali ku si gjymtyrë e dytë del një rrethanor shkak, ndonëse në to sigurisht raportet rrjedhimore ndërthuren me raportet shkakore. Në këtë mënyrë, ndërtimet me rrethanorë të shprehur me emër me parafjalë, me emër në rrjedhore a me folje në përcjellore si: *U mek nga të qeshurit (së qeshuri; duke qeshur)* mund të perifrazohen qoftë me një periudhë me fjali të varur shkakore konstatuese (*U mek ngaqë qeshi*), qoftë edhe - duke tingëlluar mbase më natyrshëm - me një periudhë me fjali të nënrenditur rrjedhimore (*Qeshi sa u mek.*).

Po kështu, edhe ndajfolja *copash* e lokucioni i barasvlershëm me të *copa-copa* në *E thyej xhamin copash (copa-copa)*, që tradicionalisht do të interpretoheshin si rrethanorë mënyre, mund të themi se janë rrethanorë rrjedhimi dhe këtë sërish e provon perifrazimi me periudha rrjedhimore: *E thyej xhamin aq shumë (aq keq), sa e bëj copash (copa-copa)* ose *E thyej xhamin sa e bëj copash (copa-copa)*. Perifrazimi mund të shërbejë shumë mirë si një letër lakmusi për të përcaktuar së ç'loj raportesh shprehen në fjali ose të paktën llojin e rrethanorit që përmban ajo.

Kështu, ndonëse fjalia *E bëj xhamin copash (copë-copë)* është sinonime me *E thyej xhamin copash (copë-copë)*, ajo nuk mund të perifrazohet me periudha rrjedhimore: s'mund të themi, për shembull, **E bëj xhamin aq shumë (aq keq), sa e thyej copash (copa-copa)* ose **E bëj xhamin sa e thyej copash (copa-copa)*.

Ndaj mund të arrijmë në përfundimin se *copash (copë-copë)* tek *E bëj xhamin copash (copë-copë)* tregon shkallën e ndryshimit të gjendjes së realies që shënon emri në funksionin e kundrinës (*xhamin*), prandaj mund të cilësohet si rrethanor mënyre.

3.3.2 Shprehja e marrëdhënieve rrjedhimore në periudha me bashkërenditje

Nga pikëpamja pragmatiste, kodifikimi i rrjedhojës me anë të nënrenditjes ndryshon nga bashkërendimi prej llojit të veprimit gjuhësor që përmbushet prej folësit.

Periudha me nënrenditje rrjedhimore shpreh një marrëdhënie rrjedhimore mes dy fakteve të një pohimi të vetëm. Në të kundërt, duke përdorur dy fjali që nuk janë të renditura në mënyrë hierarkike, folësi realizon dy pohime, i dyti prej të cilëve vendoset si përfundim kundrejt të parit.

Periudhat me fjali të bashkërenditur që shprehin marrëdhënie rrjedhimore janë zakonisht ato përmbyllëset. Te këto periudha me fjali të bashkërenditura me strukturë detyrimisht dykryegjymtyrëshe, fjalia e dytë shpreh diçka që del si rrjedhim, përmbyllje e fjalisë së parë dhe lidhet me fjalinë e parë me anë të lidhëzave të specializuara: *andaj, ndaj, pra, pa*.

Dalëkadalë pulës neëjsën t'i eren sepje e po mpakeshe, ndaj ju lut en një erë.

(Proza popullore I, f. 95)

...Tha se ishte i sëmurë, prandaj at ditë nuk mund të shkonte me dhenë.

(Proza popullore I, f. 412)

Ka bërë shumë ftohtë, **ndaj** rruga është e ngrirë.

Lidhja rrjedhimore mes dy fjalive mund të jetë e vlefshme edhe në mungesë të mjeteve të specializuara lidhëse:

Ka bërë shumë ftohtë dhe rruga ka ngrirë.

Në shembullin e mësipërm interpretimi rrjedhimor bëhet nëpërmjet faktorëve enciklopedikë.

3. 3. 3 Shprehja e marrëdhënieve rrjedhimore në periudha me fjali asindetike

Dihet se për nga ana e raporteve kuptimore midis fjalive në bashkimet asindetike mund të shprehen si raportet e barazisë, pra të bashkërenditjes, ashtu edhe raportet e varësisë, pra të nënrenditjes.

Në periudhat me fjali asindetike me marrëdhënie rrjedhimore fjalia e parë përmban shkakun, ndërsa e dyta rrjedhimin a pasojën e këtij shkak.

Siç vërehet në Gramatikën e Akademisë,³²² ka periudha asindetike që për nga kuptimi dhe për nga intonacioni mund të vihen në lidhje edhe me periudha me fjali të bashkërenditura lidhëzore, edhe me periudha me fjali të varura lidhëzore, si p.sh. disa raste periudhash me marrëdhënie rrjedhimore ose përmbyllëse.

Atij ju dhimbs qerosi, nuk e goditi.

(Proza popullore V, f. 136)

Ai djalë ishte aq i bukur, baba nuk e qiste jasht.

(Proza popullore III, f. 127)

U shtriva që u shtriva, po bëj një sy gjumë.

Midis fjalive asindetike me marrëdhënie rrjedhimore zakonisht vendoset presje, në disa raste edhe dy pika.

Ka bërë shumë ftohtë: rruga ka ngrirë.

³²² Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Sintaksa*, Malaka, Tiranë, 2002, f. 624.

3.3.4 Ngjyrim rrjedhimor në periudha me fjali të tjera të nënrenditura

Ngjyrim rrjedhimor ngërthejnë edhe fjali të tjera të nënrenditura, si periudha me fjali të nënrenditur përcaktore, kohore e qëllimore. Kështu, siç vërehet në *Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa)* të Akademisë së Shkencave (f. 534), bashkëlidhja e brendive reale konkrete të fjalive të periudhës mund t'i japë fjalisë së nënrenditur përcaktore ngjyrim rrjedhimor. Për këtë ka edhe disa tregues formalë gramatikorë në fjalinë kryesore.

Paraprijës është një togfjalësh emëror, i përbërë prej një emri të përgjithshëm të shoqëruar nga përemra dëftorë të cilësisë, si kësi, ai, i (a) tillë. Prania e përemrit dëftor shkakton një lidhje shumë të ngushtë midis fjalive; fjalia e nënrenditur është pjesë e domosdoshme e fjalisë kryesore nga pikëpamja gramatikore dhe kuptimore.

Përemrat dëftorë i japin emrit një cilësim në mënyrë më të përgjithshme, por gjithmonë pa e emërtuar atë cilësi. Kjo cilësi e pashprehur zbulohet vetëm nëpërmjet asaj që thuhet në fjalinë e nënrenditur, d.m.th. zbulohet nëpërmjet rrjedhimit, pasojës:

Fytyra i mori një pamje të tillë që e gëzoi vajzën.

Paraprijës mund të jetë një emër i vetëm, i pashoqëruar nga ndonjë përemër dëftor, por semantika dhe trajta e këtyre kërkojnë doemos një karakteristikë, të cilën në të vërtetë e jep fjalia e nënrenditur nëpërmjet diçkaje që është rrjedhim i saj. Paraprijësi emër është rëndom një emër i vetëm në trajtë të pashquar, i shoqëruar nga fjalët një a disa (ca):

Kishte ca piktura që ta prishnin mendjen.

Ngjyrim rrjedhimor shprehin edhe fjalitë e nënrenditura kohore me rend të prapavendosur me lidhëzat *derisa*, *gjersa* dhe me foljet kallëzues në kohën e kryer të thjeshtë. Në këtë rast fjalia e nënrenditur tregon një veprim, që është rezultat i veprimit të fjalisë kryesore, dhe jo aq çastin e shtjellimit të veprimit të fjalisë kryesore; marrëdhënies kohore i mbishtohen nuanca rrjedhimore:

Ay trembej e s'kuxonte, po loni e shtrëngoji edhe s'e lëshoi gjersa e goditi në kurrin e e përgjaku.

(Proza popullore I, f. 26)

Por ajo bërtite edhe ma të madhe, der qi e pa tue ardhë katundarin me një shkop në dorë.

(Proza popullore I, f. 55)

Vazhdoja ti thoja dokrra të tjera derisa u skuq në fytyrë.

Marrëdhëniet rrjedhimore mund t'u mbishtohen fjalive qëllimore me lidhëzat *që* dhe lokucionin lidhëzor *në mëyrë që*, sidomos kur fjalia drejtuese pas foljes kallëzues ka ndonjë gjymtyrë të shprehur me ndajfolje mënyre, ndajfolje sasive ose me mbiemër:

Arousha u akat shoumë, ç'i ta rronte e ta vejënte përmeëjs Drinin, po s'oundi.

(Proza popullore II, f. 100)

3.3.5 Marrëdhëniet rrjedhimore në nivel teksti

Kur vendoset përtej kufijve të fjalisë a periudhës, marrëdhënia e rrjedhojës siguron një lëvizje teksti që lejon të organizohet ligjërimi në bazë të nevojave të veçanta arsyetuese:

*I shtron plaka butë e e mblon butë e per gjith ditë i bjen thuper shpinës, por vetëm në të paren ditë i qiti një pare, pse ndër dit tjera s'i qiti veç hardhuca, gjarpij e coftina. **Kështu qi u disprue plaka, mbyti micën e vetë plasi prej idhnimit.***

(Proza popullore I, f. 93)

*Do i them popullit që “ja e shihni vetë qi ki s'di gjë dhe s'bën për prift”. **Kështu që të iki ki këtej dhe ne të kem edhe ca kohë punë.***

(Proza popullore VI, f. 409)

Kur vanë brenda, gjellët ishin bërë me farmak. Djali ja hodhi maces dhe ajo ngordhi.

(Proza popullore I, f. 409)

3. 4. Klasifikimi i fjalive rrjedhimore

Fjalitë rrjedhimore shprehin, në vija të trasha, marrëdhënien ndërmjet një shkakut dhe pasojës a rrjedhimit të tij. Ato mund të klasifikohen në bazë të kriterëve formale dhe kriterëve semantike. Ato mund të ndahen, në fjali të thjeshta dhe në periudha.

Ndërtimet rrjedhimore janë vënë re fillimisht nga Hallideji (Halliday) në artikullin e tij “Notes on Transitivity and Theme in English. Part I” (Shënime për kalimtarinë dhe temën në anglisht. Pjesa I), të botuar në vitin 1967. Hallideji i quan ato “cilësorë (atributivë) rrjedhimorë”, por pas tij nisi shkallë-shkallë të marrë qytetarinë emërtimi “ndërtime rrjedhimorë”, i përhapur gjerësisht sot ose edhe thjesht “rrjedhimorë”. Në cilësorët rrjedhimorë Hallideji përfshin ndërtime të tilla të gjuhës angleze me fraza³²³ mbiemërore e ndajfoljore si:

(1) a. *He painted the door green.*

“Ai e leu derën **me të gjelbër.**” (fjalë për fjalë: “Ai e leu derën **të gjelbër.**”)

b. *She washes them clean.*

“Ajo i lau.” (fjalë për fjalë: “Ajo i lau **të pastër/të pastra.**”)

c. *She became friendly.*

“Ajo u bë **miqësore** (ose **e dashur**).”

Më shumë se një dhjetëvjeçar më vonë, Simpsoni (Simpson, 1983)³²⁴ bën një klasifikim disi të ndryshëm të ndërtimeve rrjedhimore, duke cilësuar si të tilla shprehjet që përmbajnë një folje që shpreh veprim dhe një frazë që përshkruan gjendjen e shkaktuar nga folja. Mbështetur në një konceptim të tillë, fjalitë (1a) dhe (1b) janë rrjedhimore, por jo edhe fjalia (1c), e cila përshkruan vetëm që ka ndodhur një kalim në një gjendje të caktuar (në këtë rast të të qenit miqësor), por jo edhe se si ndodhi kjo.

Ndërsa sipas Washios (Washio),³²⁵ fjalitë e thjeshta, duke u mbështetur në kuptimin e foljes kryesore, mund të klasifikohen më tej në të *dobëta*, të *forta* dhe të *rreme* ose *pseudorjedhimore*.

³²³ Termin “frazë” e përdorim me atë kuptim që e hasim në literaturën gjuhësore bashkëkohore, veçanërisht atë në gjuhën angleze, pra si një “njësi gramatikore që mund të përbëhet prej një a më shumë fjalësh dhe që është një nga klasat e përbërësve në të cilat mund të ndahen fjalitë e thjeshta” [Liç (Leech), 2006, f. 8].

³²⁴ Simpson, J. (1983). “Resultatives”. Në L. Levin, M. Rappaport, A. Zaenen (redaktorë). *Papers in Lexical-Functional Grammar*. Bloomington: Indiana University Linguistics Club, f. 143-157.
Talmy, L. (1991). “Path to Realization: A Typology of Event Conflation”. Në *Proceedings of BLS 17*, f. 480-519.

³²⁵ Shih më shumë: Washio, R. (1997). “Resultatives, Compositionality, and Language Variation”. *Journal of East Asian Linguistics* 6: 1, f. 7.

Në fjalitë rrjedhimore të dobëta, si për shembull në japonisht:

(2) *John-wa niku-o yawarakaku ni-ta.*

“Xhoni e zjeu mishin **derisa u zbut**” (fjalë për fjalë: “Xhoni mishin **të butë** zjeu.”)

semantika e foljes kryesore përcakton se si do të jetë kundrina në përfundim të veprimit të shprehur nga folja, ndërsa në *të fortat* - si ndërtimet e anglishtes.

(3) a. *The dog barked the neighbours awake.*

“Qeni i **zgjoi** fqinjët me të lehura.” (fjalë për fjalë: “Qeni lehu fqinjët **të zgjuar**.”)

b. *She danced into the room.*

“Ajo hyri **në dhomë** duke kërcyer.” [fjalë për fjalë: “Ajo kërcëu **në** (parafjala *në* këtu tregon zhvendosje e jo vendndodhje) **dhomë**”] kuptimi i foljes dhe kuptimi i mbiemrit janë të pavarur nga njëri-tjetri dhe “është e pamundur ta parashikosh se në ç’lloj gjendjeje do të jetë pësuesi si rrjedhojë e veprimit të shënuar nga folja”³²⁶.

Një pjesë studiuesish janë shprehur se të tilla mund të jenë vetëm fjalitë që kanë në gjirin e tyre një frazë ndajfoljore, si për shembull në shqip “E mbylla derën **fort**”, e cila nuk mund të perifrazohet **“E mbylla derën duke e bërë të fortë”*.

Në fjalitë rrjedhimore të dobëta, si për shembull në anglisht: *She painted the house red* (“Ajo e leu shtëpinë **me të kuqe**”; fjalë për fjalë: “Ajo leu shtëpinë **të kuqe**”), semantika e foljes kryesore përcakton se në çfarë gjendjeje do të jetë kundrina në përfundim të veprimit të shprehur nga folja, ndërsa në *të fortat* - si fjalitë po të anglishtes *The dog barked the neighbours awake* (“Qeni i **zgjoi** fqinjët me të lehura”; fjalë për fjalë: “Qeni lehu fqinjët **të zgjuar**”) dhe *She danced into the room* [“Ajo hyri **në dhomë** duke kërcyer”; fjalë për fjalë: “Ajo kërcëu **në** (parafjala *në* këtu tregon zhvendosje e jo vendndodhje) **dhomë**”] - “kuptimi i foljes dhe kuptimi i mbiemrit janë krejtësisht të pavarur nga njëri-tjetri”.³²⁷

Nga ana tjetër, pseudorjedhimoret, siç e thotë edhe emri, nuk vlerësohen si fjali të vërteta rrjedhimore, për shkak se vetëm në sipërfaqe u ngajnë atyre, ngaqë nuk përputhen me skemën “X-i shkaktoi bërjen e Y-it Z”

Një pjesë studiuesish janë shprehur se të tilla mund të jenë vetëm fjalitë që kanë në gjirin e tyre një frazë³²⁸ ndajfoljore, si për shembull *I closed the door tight* në anglisht dhe barasvlerësja e saj në shqip: “E mbylla derën **fort**”, të cilat nuk mund të perifrazohen përkatësisht **I closed the door causing it to become tight* dhe **“E mbylla derën duke e bërë të fortë”*.

³²⁶ Washio, R. (1997). “Resultatives, Compositionality, and Language Variation”. Journal of East Asian Linguistics 6: 1, f. 9.

³²⁷ Washio, R. (1997), “Resultatives, Compositionality, and Language Variation”. Journal of East Asian Linguistics 6: 1, f. 7.

³²⁸ Termin “frazë” e përdorim me atë kuptim që e hasim në literaturën gjuhësore bashkëkohore, veçanërisht atë në gjuhën angleze, pra si një “njësi gramatikore që mund të përbëhet prej një a më shumë fjalësh dhe që është një nga klasat e përbërësve në të cilat mund të ndahen fjalitë e thjeshta” [Liç (Leech)] (2006, f. 86 - përkth. ynë).

Ndonëse - siç shihet nga dy shembujt e mësipërm - mund të thuhet pa mëdyshje se të dyja gjuhët kanë ndërtime të rreme rrjedhimore, më tej do të shohim se si anglishtja, ashtu edhe shqipja kanë edhe fjali të thjeshta me fraza ndajfoljore rrjedhimore “të vërteta”.

Sidoqoftë, këtu mund të themi përmbledhtazi se gjuhë të ndryshme kanë tipa të ndryshëm fjalish e ndërtimesh rrjedhimore: disa prej tyre kanë fjali të thjeshta rrjedhimore si të forta, ashtu edhe të dobëta, ndërsa të tjerat mundësojnë përdorimin vetëm të fjalive rrjedhimore të dobëta, meqenëse në këto të fundit ka një lidhje logjike mes kuptimeve të foljes-kallëzues dhe të frazës rrjedhimore, çka bën që nga ana mendore ato të kërkojnë më pak mundim prej folësit për t’u përpunuar.³²⁹

Natyra leksiko-gramatikore e frazës rrjedhimore në fjalitë e thjeshta mund të shërbejë gjithashtu si një tjetër kriter për klasifikimin e këtyre fjalive.

a) Fjali me fraza rrjedhimore mbiemërore:

(gjerm.) *Er trank das Glas leer.*

“Ai e piu gotën të gjithën.” (fjalë për fjalë: “Ai piu gotën të zbrazët.”)

b) Fjali me fraza rrjedhimore ndajfoljore, të cilat u përmendën edhe më sipër, si:

(angl.) *She painted the house beautifully.*

“Ajo e leu shtëpinë **bukur.**”

c) Fjali me fraza rrjedhimore parafjalore:

(spanj.) *Juan fue/vino a la tienda.*

“Huani shkoi/erdhi **në shitore.**”

ç) Fjali me fraza rrjedhimore përcaktuese³³⁰:

(angl.) *John painted the barn a fiery red.*

“Xhoni e leu stallën **me një të kuqe të ndezur.**” (fjalë për fjalë: “Xhoni leu stallën **një të kuqe të ndezur.**”)

e) Fjali me fraza rrjedhimore emërore³³¹:

(angl.) *Sally painted the room a beautiful shade of blue.*

“Selli e leu dhomën **me një nuancë të bukur të kaltre**” (fjalë për fjalë: “Selli leu dhomën **një nuancë të bukur të kaltre.**”)

³²⁹ Për më tepër, lidhur me tipologjinë e ndërtimeve rrjedhimore shih Washio, R. (1997), “Resultatives, Compositionality, and Language Variation”. *Journal of East Asian Linguistics* 6: 1-49.

³³⁰ Jo të gjithë studiuesit i përfshijnë këto ndërtime në taksonomitë e tyre të ndërtimeve me fraza rrjedhimore. Sidoqoftë, lidhur me arsyen përse ato janë të rralla dhe përse zakonisht kanë në përbërje terma që shënojnë ngjyrë, shih Simpson (1983, p. 153).

³³¹ Mendojmë se edhe për ndërtimet me fraza rrjedhimore emërore vlen e njëjta vërejtje si ajo e sipërpërmendur për ndërtimet me fraza përcaktuese e bërë nga Simpsoni.

Sërish mund të themi se në gjuhë të ndryshme mund të ekzistojnë një, dy a që të tre këta tipa fjalish, por nga një vështrim i shpejtë ndërgjuhësor i tyre, siç do ta vërejmë edhe gjatë punimit, mund të arrihet në përfundimin që, në qoftë se një gjuhë ka fjali të thjeshta me fraza rrjedhimore mbiemërore, ajo zotëron edhe fjali të njërit prej dy tipave të tjerë ose të të dyve, por e anasjella mund të mos jetë e vërtetë: analiza e gjuhëve të studiuara ka treguar se në asnjë prej tyre nuk ekzistojnë vetëm fraza rrjedhimore mbiemërore.

Një klasifikim tjetër që mund t'u bëhet fjalive të thjeshta rrjedhimore, është ai që mbështetet në atë çka po e quajmë *kalimtari* të foljes-kallëzues të tyre. Mbi këtë bazë këto fjali mund të ndahen në dy lloje: *fjali me kallëzues një folje kalimtare* dhe *fjali me kallëzues një folje jokalimtare*.

Në një ndërtim rrjedhimor me folje kalimtare, fjalitë rrjedhimore hyjnë në marrëdhënie kallëzuesore dytësore me kundrinën dhe jo me kryefjalën ose, më saktë, me të ashtuquajturin argument jashtësor të kallëzuesit. Ky quhet shpesh “Ligji i Simpsonit” ose “Kufizimi i kundrinës së drejtë”.

Në qoftë se hyn në marrëdhënie kallëzuesore me kryefjalën, ajo nuk është rrjedhimore. Për shembull, (1a) do të thotë se metali u shtyp si pasojë e rrahjes prej Xhonit; nëse do të donim të thoshim që Xhoni u lodh ngaqë rrahu metalin, këtë nuk mund ta shprehim me anë të fjalisë *John hammered the metal tired* (“Xhoni e rrahu metalin i lodhur”), sepse këtu *tired* (“i lodhur”) lidhet me kryefjalën *Xhoni* dhe fjalia ka një të ashtuquajtur kuptim përshkrues (domethënë Xhoni ishte tashmë i lodhur kur filloi të rrihte metalin dhe jo se u lodh duke rrahur metalin).³³²

Megjithatë, ka pasur studiues (si p. sh. Rappaport Hovav e Levin) që e kanë vënë në pikëpyetje “Ligjin e Simpsonit”, ndërsa të tjerë, si Ji e den Dikken, janë munduar të provojnë se asnjë nga shembujt e dhënë prej gjuhëtarëve të mësipërm nuk përbën thyerje të këtij ligji. Por sidoqoftë, duhet thënë se vetë Simpsoni³³³ thekson se ligji që ka marrë emrin e saj, nuk është në fuqi në të gjitha gjuhët: ai nuk gjen zbatim në varlpiri. Për shembull, në këtë gjuhë mund të thuhet:

(5) a. *Puluku-rlu kapu-lu marna nga-rni kuntukuntu-karda.*

“Mëzetërit do të hanë bar sa do të shëndoshen.” (fjalë për fjalë: “Mëzetërit bar do të hanë të shëndoshë.”)

³³² Në të vërtetë, fjalia *John hammered the metal tired* mund të ketë edhe një interpretim rrjedhimor të figurshëm “të pranueshëm”: hekurin mund ta personifikojmë. Në këtë rast përkthimi i drejtpërdrejtë në shqip i kësaj fjalie do të ishte “*Xhoni e rrahu metalin të lodhur”, ndërsa përkthimi i saktë do të ishte me periudhën “Xhoni e rrahu metalin derisa e lodhi”.

³³³ Simpson, J. (1983). “Resultatives”. Në L. Levin, M. Rappaport, A. Zaenen (redaktorë). *Papers in Lexical-Functional Grammar*. Bloomington: Indiana University Linguistics Club, f. 143-157.
Talmy, L. (1991). “Path to Realization: A Typology of Event Conflation”. Në *Proceedings of BLS 17*, f. 480-519.

Pra, në këtë shembull, ndërtimi rrjedhimor mbiemëror *kuntukuntu-karda* (“të shëndoshë”) lidhet me kryefjalën *puluku-rlu* (“mëzetërit”) dhe jo me kundrinën e drejtë *marna* (“barin”). Për Simpsonin, fjalitë rrjedhimore në varlpiri janë adjuncts, ndërsa strukturalisht janë të njëjta me fjalitë përshkruese, ashtu si edhe në mjaft gjuhë të tjera. Gjuhët e ndryshme të botës dallohen pikërisht edhe nga kjo: nëse frazat rrjedhimore janë adjunksione³³⁴ ose plotës; anglishtja nuk mundëson vendosjen e marrëdhënieve të kallëzuesisë ndërmjet frazave rrjedhimore dhe argumenteve të jashtme³³⁵ të foljeve, ndërsa varlpiri nga ana e tij e lejon një gjë të tillë.

Fjalitë me kallëzues një folje jokallimtare ndahen më tej në fjali me folje kallëzore dhe në fjali me folje jokallëzore. Fjalitë me folje kallëzore dhe fjalitë me folje jokallëzore dallojnë jo vetëm nga ana sintaksore, por edhe prej asaj që quhet strukturë argumenti. Kryefjala e fjalive me folje kallëzore përkapet si bërësi i veprimit të shënuar nga folja, ndërsa kryefjala e fjalive me folje jokallëzore ka qenë në zanafillë kundrinë dhe shihet si pësuese e veprimit.

Kësisoj, ndërsa në gjuhën angleze folje, si *die*, *arrive* etj. janë jokallëzore dhe marrin foljen ndihmëse *to be* (jam), përgjegjëset e tyre në shqip (*vdes*, *mbërrij*) janë kallëzore dhe i formojnë kohët e përbëra me *kam*. Foljet jokallëzore i formojnë normalisht fjalitë rrjedhimore, teksa foljeve kallëzore u nevojitet një e ashtuquajtur “kundrinë e rremë” për ta bërë një gjë të tillë.

Kështu, folja-kallëzues e fjalisë angleze *The river froze solid* (“Lumi ngriu”; fjalë për fjalë: “Lumi ngriu **i fortë**”) është jokallëzore dhe këtë mund ta provojmë duke hequr mbiemrin - ose, siç quhet në këtë rast, kallëzuesin dytësor rrjedhimor - *solid*; çka mbetet nga kjo fjali është përsëri gramatikore (*The river froze* “Lumi ngriu”). Nga ana tjetër, folja *shouted* në *They shouted themselves hoarse* (“Thirrën **sa u ngjirën**”; fjalë për fjalë: “E thirrën veten **të ngjirur**”) është kallëzore; nëse lëmë jashtë kallëzuesin dytësor *hoarse* ose përemrin vetvetor *themselves*, fjalia është e pakuptimtë. Qoftë **They shouted themselves*, qoftë **They shouted hoarse*, nuk janë fjali të plota.

Nga pikëpamja *semantike*, periudhat me fjali të nënrenditura rrjedhimore mund të ndahen në periudha me *fjali të nënrenditura rrjedhimore ekzoforike* dhe periudha me *fjali të nënrenditura rrjedhimore endoforike*³³⁶ sipas parametrave në vijim: lloji i shkakut nga vjen rrjedhoja, kushtezimi logjik (mjaftueshmëri ose domosdoshmëri) mes të fjalive dhe marrëdhënia kohore ndërmjet të dy ngjarjeve ose gjendjeve të kodifikuara.

Për sa i përket llojit të shkakut, *fjalitë e nënrenditura rrjedhimore ekzoforike* kodifikojnë një pasojë që vjen nga një proces i shprehur më parë: ka ngrënë aq shumë, sa që u ndie keq.

³³⁴ Kemi menduar të ruajmë gjegjësin në shqip, sipas përkthimit nga prof. E. Lika të veprës së Xhon Lljajensit (John Lyons) (2001), të termit anglez “adjunct”. Shih po aty (f. 320-321) për dallimin ndërmjet adjunksioneve dhe plotësorëve (plotësave).

³³⁵ Argument i jashtëm quhet argumenti i foljes që përfshin kryefjalën.

³³⁶ Për më tepër shih: Cuzzolin, Pierluigi (1996), *La proposizione consecutiva dell'italiano*, «Studi italiani di linguistica teorica e applicata» 25, 1, pp. 103-151.

Për sa i përket llojit të shkakut, periudhat me *fjali të nënrenditur rrjedhimore ekzoforike* shprehin një pasojë që vjen nga një proces i shprehur më parë:

Ka ngrënë aq shumë, saqë u ndje keq.

Ndërsa në periudhat me *fjali të nënrenditur rrjedhimore endoforike* rrjedhimi vjen nga përforcimi i një cilësie:

Sokoli është aq naiv, sa beson në gjithçka që thuhet.

Kushti logjik i vendosur prej marrëdhënieve të rrjedhimit është domosdoshmëri te periudhat me *fjali të nënrenditur rrjedhimore ekzoforike* dhe mjaftueshmëri te periudhat me *fjali të nënrenditur rrjedhimore endoforike*.

Në fjalinë *Ka ngrënë aq shumë, saqë u ndje keq*, dhembja e barkut është në marrëdhënie domosdoshmërie me faktin e të ngrënit shumë, ndërsa në fjalinë *Sokoli është aq naiv sa beson në gjithçka që thuhet*, naiviteti i Sokolit është kusht i mjaftueshëm, në mënyrë që ai të besojë gjithçka që i thuhet.

Dallimet mes periudhave me *fjali të nënrenditur rrjedhimoreve ekzofore* dhe periudhave me *marrëdhënie rrjedhimoreve endofore* pasqyrohen në marrëdhëniet kohore mes fjalisë kryesore dhe fjalisë së nënrenditur.

Në periudhat me *fjali të nënrenditur rrjedhimore ekzoforike*, rrjedhoja përmbushet vetëm në çastin pasues pas përmbushjes së gjendjes, kusht i së cilës ajo është në fjalinë *Ka ngrënë aq shumë, saqë u ndje keq* (dhembja e barkut ndodh pas të ngrënit shumë).

Ndërsa te periudhat me *fjali të nënrenditur rrjedhimore endoforike* dy gjendjet janë shoqëruese të njëra-tjetrës (në fjalinë *Sokoli është aq naiv sa beson në gjithçka që thuhet*, Sokoli është treguar aq naiv, saqë beson gjithçka që i thuhet).

Ashti si në periudhat me fjali të tjera të nënrenditura, periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore mund të kenë vlerë metaligjërimore.³³⁷

Apartamenti është kaq në rregull sa aty duhet të ketë qenë pastruesja.

Në fjalinë e mësipërme gjendja e pohuar në drejtuese (apartamenti në rregull) nuk është shkak më vete i ngjarjes së kodifikuar në rrjedhimore. Në të vërtetë, marrëdhënia e rrjedhojës vendoset mes përmbajtjes së kryesores dhe aktit gjuhësor të formuar nga rrjedhimorja:

Apartamenti është kaq në rregull sa (them se) aty duhet të ketë qenë pastruesja.

³³⁷ Shih për më shumë: Lombardi Vallauri, Edoardo (2000), *Grammatica funzionale delle avverbiali italiane*, Roma, Carocci, f. 84.

Për sa i përket dallimit në llojin formal, realizimet e marrëdhënies së rrjedhojës mund të klasifikohen në varësi të asaj që pasoja të shprehet me anë të nënrenditjes ose të bashkërendimit. Marrëdhënia e rrjedhojës mund të vihet mes dy fjalish të vendosura në të njëjtin parashtrim, mes dy parashtrimeve ose dy pjesëve tekstuale.

KREU IV

TIPAT SEMANTIKO-STRUKTURORË TË PERIUDHËS ME FJALI TË NËNRENDITUR RRJEDHIMORE NË PROZËN POPULLORE

Nga analiza e lëndës së shqyrtuar në prozën popullore, ashtu si në gjuhën standarde, në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore sipas përbërjes së tyre strukturore dallojmë dy nëntipa strukturorë³³⁸: 1. Fjali rrjedhimore *e bashkëlidhur* (korrelative). 2. Fjali rrjedhimore *jo e bashkëlidhur* (jokorrelative).

1. Fjali rrjedhimore *e bashkëlidhur* (korrelative), ku lidhëzës i përgjigjet në fjalinë kryesore një fjalë emërtuese (korrelative) e bashkëlidhur (si *aq, kaq* etj.)³³⁹.

Në gramatikat e gjuhëve të huaja këto elemente gjuhësore (fjalët korrelative) emërtohen “*fjalë shkallë*”.³⁴⁰ Por sipas mendimit tonë, pavarësisht terminologjisë së ndryshme, funksioni i tyre është i njëjtë në të dyja gjuhët. Ato dëftojnë pa e konkretizuar sasinë e një sendi, masën e shkallën e një cilësie a intensitetin e një procesi.

Sasia (masa, shkalla, intensiteti) e dëftuar nga korrelatët *aq, kaq*, mund të ketë të bëjë me anë të ndryshme të sendeve e të dukurive:

a) Me cilësinë e shprehur nga mbiemri, sipas tipit *aq i madh* etj.

Nga tiatra anë urinë e kish *aqë të madhe, sa s'duronte dot pa ngrënë*.

(*Proza popullore I, f. 173*)

b) Me një rrethanë të shprehur nga një ndajfolje: *aq mirë, aq shumë* etj.

E ushqente këtë macenë *kaq mirë, sa* ish bërë nji qen i math.

(*Proza popullore I, f. 36*)

Aq shumë u zbukurua, **sa** s'ia gjenjej shoqen...

³³⁸ Për terminologjinë e përdorur, si dhe për tipat e fjalive të nënrenditura rrjedhimore jemi mbështetur në Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa), të Akademisë së Shkencave.

³³⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, vëllimi II (Sintaksa), Tiranë, 2002, f. 426: Përemrat dëftorë dhe ndajfoljet dëftore që përdoren përbrenda fjalisë kryesore, në bashkëlidhje me lidhëzat e fjalët lidhëse, quhen fjalë të bashkëlidhura korrelative ose dhe korrelatë.

³⁴⁰ C. L. Baker, *English Syntax*, Cambridge, MA: MIT Press, 1989, f. 317.

(Proza popullore VI, f. 113)

c) Me sende konkrete ose abstrakte të shprehura me emra: *aq studentë, aq trimëri* etj.

Ani kur i vate diali, e pritën të gjithë të mëdhenjt e pallatit, sa edhe ajo vetë me aqë nder, e me aqë kashkariqe, *sa u kënaq ay tepër.*

(Proza popullore I, f. 172)

Fjalët *aq, kaq* rrallë mund të funksionojnë dhe vetëm, por në të shumtën e rasteve ato përcaktojnë një emër, një mbiemër ose një ndajfolje. Zakonisht ato përcaktojnë mbiemra cilësorë (duke përfshirë këtu dhe mbiemrat me kuptimin figurativ), të cilët kanë aftësinë për t'u shkallëzuar. Kuptimi i këtyre mbiemrave cilësorë lejon që tipari i emërtuar prej tyre të shprehet në masë të ndryshme. Me fjalë të tjera, kuptimi i këtyre mbiemrave cilësorë lejon që cilësia e shprehur prej tyre të shkallëzohet (*i bukur, më i bukur, shumë i bukur*). Ndër ta, më të përdorshmit janë mbiemrat që tregojnë një cilësi më të përgjithshme, si *i bukur, i dashur* etj.

Ky na kish nji nuse t'bukur shumë. Aq t'bukur e kishte, qi e mbante myllë në 12 oda.

(Proza popullore IV, f. 223)

Ish një djalë i ri; po her'e herë dukej i shëmtuam, me një si edhe i shklepur; e her' e herë benej **aqë i bukur**, **sa** ngë mënd t'ish më.

(Proza popullore IV, f. 59)

...i dyti e goditi djalin me aq sillmë, sa e copëtoi fare.

(Proza popullore I, f. 157)

Ndërsa nga ana e fjalëformimit, më të përdorshëm janë mbiemrat e parmë, por nuk mungojnë dhe mbiemrat e prejardhur.

*...i shtati kish sytë **kaqë të çelur**, sa shihte edhe nënë dhe gjer ndë fund.*

(Proza popullore I, f. 160)

Pas pak, u vjen e u del përpara një grua **aqë e shëmtuar**, **sa** atyre u hyri një drithmë në shpirt e mezi qëndronin.

(Proza popullore VI, f. 64)

Te ndajfoljet këtë aftësi e kanë, fillimisht, ndajfoljet përcaktore e, brenda tyre, kryesisht ndajfoljet e mënyrës që afrojnë me mbiemrat, po dhe ndajfoljet rrethimore, sidomos ato që shprehin rrethana vendore.

Hangrën **aq lehtë**, **sa** miku nuk u ngop aspak.

(Proza popullore V, f. 126)

Kishte ikur **aq larg**, **sa** mezi dallohej.

(Proza popullore II, f. 120)

2. Fjali rrjedhimore *jo e bashkëlidhur* (jokorrelative), domethënë pa ndonjë fjalë bashkëlidhëse në fjalinë kryesore. Në këto periudha, në fjalinë kryesore nuk ka dhe nuk mund të ketë ndonjë fjalë korrelative që t'i përgjigjet mjetit të lidhjes. Kjo shkakton një lidhje të dobët ndërmjet fjalive nga ana gramatikore e kuptimore. Fjalja kryesore është përgjithësisht e plotë nga struktura dhe ndërtimi. Si tregues i lidhjes është intonacioni. Fjalja e nënrenditur tregon një rrjedhim të thjeshtë pa ndonjë nuancë suplementare, që del si një rezultat logjik i brendisë së gjithë fjalisë kryesore.

Ky tip dallohet edhe për mjetet e lidhjes së fjalisë së nënrenditur me fjalinë kryesore, si lidhëza *që*, e cila s'mund të marrë korrelat në kryesoren dhe ndahet në fragmente me karakter afektiv. Zakonisht fjalitë rrjedhimore pa fjalë korrelative dalin në ato raste kur në fjalinë drejtuese ka një mbiemër a ndajfolje të shkallës pohore nga ndërtimi, por me vlerë krahasore ose sipërore për nga kuptimi, ose nënkuptohet një ndajfolje apo mbiemër i tillë, ose kur fjalja rrjedhimore është rezultat i thjeshtë i gjithë përmbajtjes së fjalisë drejtuese, pa u lidhur me shkallën e një tipari apo masën e një veprimi a gjendjeje:

Sufra bëri bujë të madhe, **sa e muarre vesh të gjithë**.

(Proza popullore VI, f. 285)

Çika ishte e bukur, **qi kurrkund shoqja mos me iu gjetë**.

(Proza popullore I, f. 153)

Në këtë grup periudhash përdoren edhe mjete lidhëzore relativisht të reja, si lokucioni lidhëzor *kështu që*, si dhe lidhëza e përbërë *aq(ë) sa, kaq(ë) sa*.

Më në fund dolli edhe mbreti në grikë të graves; ndenji pak e i përcolli gjilpinjte, **kështu që** u hamnë e muarre dunjane.

(Proza popullore VI, f. 16)

4.1 Tipi me fjali rrjedhimore të bashkëlidhur (korrelative) në prozën popullore

Në prozën popullore formuesit kryesorë të fjalive rrjedhimore korrelative dalin lidhëzat: **sa**, **saqë**, **që**, të cilave u përgjigjet në fjalinë kryesore një fjalë korrelative.

Fjalja e nënrenditur tregon rrjedhimin, që është rezultat i një mase, sasie, intensiteti a cilësie të shprehur në fjalinë kryesore.

Le të shohim më poshtë të gjitha rastet e identifikuara të tipit të parë gjatë shqyrtimit të materialit në prozën popullore. Do të ndalemi në mënyrë specifike te secila prej këtyre lidhëzave, për të sjellë një analizë më të detajuar të marrëdhënieve që shprehin.

4.1.1 Fjalja rrjedhimore e bashkëlidhur (korrelative) me lidhëzën *sa*.

Funksioni i lidhëzës *sa* (si lidhëz mbarëgjuesore) nuk është i mjaftueshëm për të kuptuar nëse marrëdhënia që shprehet është rrjedhimore, pasi me anë të saj lidhen edhe fjalitë me marrëdhënie krahasore. Është pikërisht tërësia e mjeteve strukturore, si edhe bashkëlidhja e brendive reale të fjalive të periudhës që specifikon llojin e marrëdhënies së realizuar me anë të lidhëzës **sa**.

Siç vërehet edhe në *Gramatikën e Akademisë*³⁴¹, në fjalinë rrjedhimore kemi rrjedhim, si pasojë e një sasie të madhe që paraqitet si shkak, kurse te fjalja krahasore kemi përshtatshmërinë në mes një sasie të parashtruar në fjalinë kryesore dhe një tjetre që paraqet në të varurën të shprehur me kallëzues që kanë kuptim leksikor të njëjtë, të afërt a të kundërt, p.sh.:

E ushqente këtë macenë kaq mirë, sa ish bërë një qen i math.

(*Proza popullore I, f. 36*)

Në nëntipin me fjali rrjedhimore të bashkëlidhur (korrelative), ku lidhëzës *sa* i përgjigjet në fjalinë kryesore një fjalë emërtuese korrelative (e bashkëlidhur), fjalja e nënrenditur tregon një rrjedhim si rezultat i një sasie, shkalle, intensiteti të madh ose i një cilësie të shprehur në kryesoren. Lidhja midis fjalive është e ngushtë.

Në prozën popullore ky lloj ndërtimi ka një përdorim të gjerë.

E leoni, siç ishte porositur, e rrëmbeu sakaqë plakën edhe kaqë fort e shtrëngoi, sa gatish e bëri kruspullë.

(*Proza popullore I, f. 129*)

³⁴¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, vëllimi II (Sintaksa), Tiranë, 2002, f. 574.

*Nji ditë u xunë nder vedi, s'dij se për shka, e **kaq** u idhnue, **sa** u danë nji herë e përgjithmonë.
(Proza popullore I, f. 91)*

*Edhe djali tamburanë e kish me vetëhe, po kish një tambura **aqë** të vogël, sa e fshehënej nënë
shetull...
(Proza popullore I, f. 323)*

*Bakçej'e bret ish **aq** e larta, **saqë** as zogu i malit nuku hij dot.
(Proza popullore I, f. 43)*

Lidhëzës **sa** i përgjigjen zakonisht fjalët e bashkëlidhura (korrelative) **aq(ë)**, **kaq(ë)** si **ndajfolje** (kur janë pranë foljeve, mbiemrave dhe ndajfoljeve):

*E ajo, posa e pa që po vinte, **aqë** u zemërua, **sa** u tha trimavet, ta rrahën, pa ta dëbojnë.
(Proza popullore I, f. 172)*

*Nga tiatra anë urinë e kish **aqë** të madhe, **sa** s'duronte dot pa ngrënë.
(Proza popullore I, f. 173)*

*...Ishte **aq** e bukur kjo Marua, sa mbretit i mbetën sytë.
(Proza popullore III, f. 49)*

I par' i këtyre diemave kish dhuratën të flytyrojnë gjer ndë qiell, i dyti hithte çomangën gjer në qiell, edhe goditënte, i treti kish veshët **kaqe** të kthiellët **sa** gjegjej edhe gjer nënë dhe, i katërti kish një puterkë të hekurt, me të cilën, kudo që goditënte, bëhej mb'atë vend një pallas, i pesti kish supet **kaqë** të fortë, **sa** munt të ngrinte me ta të tërë dhenë...

(Proza popullore I, f. 160)

Dy vëllazër kishin një motër që e duanin **kaqë** fort, **sa** çdo që u lypënte, s'ja kursenin.

(Proza popullore I, f. 130)

Ajo u tremb **aç** shoumë e bërteëjti **aç** fort, **sa** i duëlën prej goje disa xharpj.

(Proza popullore II, f. 30)

edhe si **përemra** (kur janë pranë emrave):

Ani kur i vate diali, e pritën të gjithë të mëdhenjt e pallasit, **sa** edhe ajo vetë me **aqë** nder, e me **aqë** kashkariqe, **sa** u kënaq ay tepër.

(Proza popullore I, f. 172)

Këtë konstrukt të formuar nga fjalët *aq*, *kaq* dhe fjalët e përcaktuara prej tyre, S. Floqi e ka quajtur bërthamë përemërore³⁴² [korrelat + *aq* emër (*aq i mirë*), korrelat + ndajfolje (*aq mirë*), korrelat + emër (*aq njerëz*)]. Duke u mbështetur në argumentin se fjalia e nënrenditur nuk tregon sasinë reale të përmbajtjes së fjalëve *aq*, *kaq*, por rrjedhimin, rezultatin e sasisë së sendeve, të masës a të shkallës së një cilësie ose të intensitetit të një veprimi, me të drejtë ai nuk i emërton si “*fjali sasiore*”.³⁴³

Mbiemri e tregon tiparin e emrit edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, nëpërmjet foljeve. Konstrukti ndajfolje *aq*, *kaq* + *mbiemër* ka rend të lirë ndaj foljeve:

Aq e lumtun ishte e Bukra e Dheut, **sa**, kur u kthye plaka nesret, i flet kjo përpara.

(Proza popullore VI, f. 59)

³⁴² S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 57- 58.

³⁴³ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 80-81.

*Pas pak, u vjen e u del përpara një grua **aqë** e shëmtuar, **sa** atyre u hyri një drithmë në shpirt e mezi qëndronin.*

(Proza popullore VI, f. 64)

*Nga tiatra anë urinë e kish **aqë** të madhe, **sa** s' duronte dot më pa ngrënë.*

(Proza popullore I, f. 173)

*Ish një djalë i ri; po her' e herë dukej i shëmtuam, me një si edhe i shklepur; e her' e herë bënej **aqë** i bukur, **sa** ngë mënd t'ish më.*

(Proza popullore IV, f. 59)

Në fjalitë rrjedhimore korrelative me konstruktin përemër *aq*, *kaq* + *emër* tregohet se sasia e madhe e sendeve ose sasia e lartë e cilësisë së emrit abstrakt është rrjedhim i asaj që shprehet në fjalinë e nënrenditur:

*Ani kur i vate diali, e pritën të gjithë të mëdhenjt e pallasit, **sa** edh' ajo vetë me **aqë** nder, e me **aqë** kashkariqe, **sa** u kënaq ay tepër.*

(Proza popullore I, f. 171)

Emrat mund të jenë pa parafjalë dhe në funksion të kundrinës:

*I thotë mbreti që “ku gjenden **kaq** lëkurë, **sa** të shtrohen të gjitha odat e pallatit”.*

(Proza popullore I, f. 287)

***Kaqi** darsëm të modhe boni Sulejmoni, **sa** i erdhi siraja me thirrë edhe gjarpnin.*

(Proza popullore VI, f. 210)

*E mbreti, kur dëgjoi shpëtimin e së bijës, **kaqë** tepër u gëzua **sa**, urdhëroi e u duallën përpara t'i presin me nder të math **kaq** parësi, e buljarë e ushtëri, **sa** rrodhën njerëz nga gjith' anët të bëjn sehir.*

(Proza popullore I, f. 161)

Por shka, se ai qi shterrte lumin, qe aq shumë ujë prej zgrofët, sa i fikë furrat e i ngrinë akull...

(Proza popullore II, f. 445)

Fjalët korrelative *aq*, *kaq* mund të përdoren rrallëherë edhe pa u shoqëruar nga një *emër*, një *mbiemër* a një *ndajfolje* në fjalinë kryesore:

***Kaqe** qe vëllazëria jonë, **sa** do të ikësh e do na lësh?*

(Proza popullore I, f. 142)

***Aq** e ndoqa që ta zë, **sa** rashë këmbësh.*

(Proza popullore I, f. 166)

*Ndë një fshat atje për anë këtyrevet rrinte e Bukur' e Dheut, e djal' i math i peshkatarit posa e nxu atë, u shti **kaqe** pas asaj, **sa** taksi të vejë e ta marrë për grua.*

(Proza popullore I, f. 128)

*Nji ditë u xunë nder vedi, s'dij se për shka, e **kaq** (shumë) u idhnuen, **sa** u danë nji herë e përgjithmonë.*

(Proza popullore I, f. 91)

Në këto ndërtime fjala që mungon mund të shtihet në fjalinë kryesore pa sjellë ndonjë ndryshim në marrëdhëniet midis fjalive dhe në strukturën e saj:

*...e **kaq** (shumë) i rëndoi me fjalë, **sa** m'u prishë me ta.*

(Proza popullore VI, f. 160)

*E ajo, posa e pa që po vinte, **aqë** (shumë) u zemërua, **sa** u tha trimave, ta rahën, pa ta dëbojnë.*

(Proza popullore I, f. 172)

Kur fjalët korrelative *aq*, *kaq* kryejnë funksionin e ndajfoljes dhe shoqërohen nga një mbiemër, cilësia e sendeve që shënohen nga emrat shprehet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë përmes foljes këpujë *jam* a foljeve gjysmëkëpujore:

***Kaqë** e pakë qenka vëllezëria jonë, **sa** ta jep zemra të ikësh, e të na lesh neve?*

(Proza popullore I, f. 135)

*Me këto të këqia pra i hyri një ah **kaq** i madh djalit, **sa** i u mërzit vetëheja atij, e s' e donte më të gjallët.*

(Proza popullore I, f. 173)

Ndajfoljet *aq*, *kaq* mund të bashkohen dhe me një togfjalësh që ka si gjymtyrë kryesore një emër dhe si gjymtyrë të varur një ndajfolje sasive (*shumë*, *pak*):

*Tuë shkouë oudhës u poç me një qetër ç'i peënte **aç** shoumë ujë, **sa** e thante një gjol të tanë me një të theëjthun.*

(Proza popullore II, f. 19)

***Aq** shumë u zbukurua, **sa** s'ia gjenjej shoqen...*

(Proza popullore VI, f. 113)

Kur emri abstrakt shoqërohet nga parafjala *me*, kryen funksionin e rrethanorit të mënyrës dhe së bashku me ndajfoljen *aq* tregojnë sasinë e madhe të cilësisë së procesit, ashtu si dhe ndajfolja e mënyrës:

Ani kur i vate diali, e pritën të gjithë të mëdhenjt e pallasit, sa edh' ajo vetë me **aqë** nder, e me **aqë** kashkariqe, **sa** u kënaq ay tepër.

(Proza popullore I, f. 171)

Shkojnë dy desht, njeni në krye të livadhit e tjetri në fund e, mbas shejit qi u ep ujku, lshohen **kaq me** turr në ujk, **sa** e llomisin brinjsh e e lanë çrangël në tokë, pa mujt me luejt vendit.

(Proza popullore IV, f. 60)

Ma në found gjali i kërcëlloi dhambët pi inatit en ju tour kulçedrës me **aç forcë**, **sa** ja feëjti shpatën moun në zembër e ja çiti an'e mb'anë.

(Proza popullore II, f. 2)

Në këto raste ndajfolja **aq**, **kaq** pozicionohet midis parafjalës **me** dhe emrit **abstrakt**.

Në prozën popullore fjalët e bashkëlidhura **aq**, **kaq** në fjalinë kryesore mund të bashkohen edhe me ndajfolje, zakonisht **sasie** e **mënyre**, por dhe **vendi**.

En asqerët i raftën **aç shounë**, **sa** pelat e mëzat menxeëj çëndrojshin në këmbë e dridheshin si njerin ç'i e zanë ethe të forta.

(Proza popullore I, f. 115)

Kishte ikur **aq larg**, **sa** mezi dallohej.

(Proza popullore II, f. 120)

Në rastin kur fjalët korrelative ndajfoljore **aq** **kaq** bashkohen me ndajfolje **mënyre**, në fjalinë kryesore shprehet shkalla e lartë e cilësisë së veprimt që konkretizohet nga pasoja e shprehur në fjalinë e nënrenditur:

Na e ushqente këtë macenë **kaq mirë**, sa ish bërë si një qen i math.

(Proza popullore I, f. 36)

Hangrën **aq lehtë**, sa miku nuk u ngop aspak.

(Proza popullore V, f. 126)

Ngarendte **aç vreëjk**, sa s'kishte njeri ci mound t'i dilte përpara.

(Proza popullore II, f. 120)

Veprimi të shprehur nga folja kallëzues mund t'i jepet një tipar sasior edhe me anë të ndajfoljes *shumë*, ndajfoljes së cilësisë dhe sasisë *fort* dhe ndajfoljes së sasisë *tepër*. Në përdorimin e ndajfoljeve *shumë* dhe *fort* në disa raste vihet re një diferencim i paktë semantik, aq sa ndonjëherë përdoren njëra në vend të tjetrës:

Po en e ema e Kanberit qau **aq shoumë**, sa u qorouë seëjsh e nuk sheëjfte ma.

(Proza popullore II, f. 124)

En asqerët i raftën **aç shoumë**, sa pelat e mëzat menxeëj çëndrojshin në këmbë e dridheshin si njerin ç'i e zanë ethe të forta.

(Proza popullore I, f. 115)

Aq shumë ish qepur nga pas, sa nuk dinej ku të futej e ku të fshihej.

(Proza popullore VI, f. 34)

Ndajfolja *fort* përdoret zakonisht pranë foljeve që mund të karakterizohen nga pikëpamja e intensitetit të shtjellimit të veprimi. Ndër foljet më të përdorshme janë: *shtrëngo*, *bërtas*, *ulëras* etj.

*E leoni, siç ishte porositur, e rrëmbeu sakaqë plakën edhe **kaqe fort** e shtrëngoi, **sa** gatish e bëri kruspullë.*

(Proza popullore I, f. 129)

*Ajo u tremb aç shoumë e bërteëjti **aç fort**, **sa** i dualën prej goje disa xharpij.*

(Proza popullore II, f. 30)

Në disa raste, ndajfolja *fort* merr kuptimin e ndajfoljes *shumë*, duke hyrë në korrelacion semantik jo me mbiemrin *i fortë*, *i fuqishëm*, por me mbiemrin *i madh* ose me ndonjë mbiemër tjetër që tregon cilësi sasiore:

*Dy vëllazër kishnin një motër që e duanin **kaqë fort**, **sa** çdo gjë që u lypte, s'ja kursenin.*

(Proza popullore I, f. 130)

Me kuptimin e ndajfoljes *shumë* në prozën popullore ndeshim dhe ndajfoljen *tepër*³⁴⁴:

*E mbreti, kur dëgjoi shpëtimin e së bijës, **kaqë tepër** u gëzua, **sa** urdhëroi e u duallën përpara t'i presin me nder të math kaq parësi, e buljarë e ushtëri, sa rrodhën njerëz nga gjith' anët të bëjn sehir.*

(Proza popullore I, f. 161)

Folja kallëzues e fjalive të nënrenditura rrjedhimore mund të jetë në mënyrën dëftore dhe në mënyrën lidhore. Kur folja kallëzues është në mënyrën dëftore, marrëdhëniet rrjedhimore janë reale:

³⁴⁴ Në rastin e ndajfoljes së sasisë *tepër* mund të themi se ajo ka përdorim të kufizuar si në gjuhën popullore, ashtu dhe në gjuhën e shkruar, sepse kuptimi i sasisë së tejmasës në gjuhën shqipe tregohet me anë të ndajfoljes *shumë*. Si rrjedhim, kjo përbën shkelje të normës e duhet shmangur.

Hangrën **aq** lehtë, **sa** miku nuk u ngop aspak.

(Proza popullore V, f. 126)

Kur veprimi paraqitet joreal, folja kallëzues është në mënyrën lidhore. Në këtë rast, marrëdhëniet rrjedhimore u mbishtrohen ngjyime rrjedhimore.

I thotë mbreti që “ku gjenden **kaq** lëkurë, **sa** të shtrohen të gjitha odat e pallatit”.

(Proza popullore I, f. 287)

Në prozën popullore nuk kemi ndeshur raste kur në vend të ndajfoljes *shumë* të përdoren ndajfoljet e tipit *marrisht*, *tmerrësisht*, të cilat janë bërë pronë e gjuhës standarde, veçanërisht pronë e stilit të letërsisë artistike.

Në prozën popullore nuk kemi gjetur as raste të përdorimit të ndajfoljes *mjaft* në vend të korrelatit *aq*, *kaq*. Me të drejtë S. Floqi vëren se përdorimi i ndajfoljes *mjaft* në vend të korrelatit *aq*, *kaq* nuk është veçori e prozës popullore, por e gjuhës standarde, e përhapur në ndikimin e gjuhëve të huaja.³⁴⁵

Fjalët korrelative *aq*, *kaq* mund shoqërohen edhe me më shumë se një ndajfolje, ashtu si edhe mbiemra. Në këtë rast fjalët korrelative përsëriten përpara tyre:

Ajo u tremb **aç** shumë e bërteëjti **aç** fort, sa i dualën prej goje disa xharpij.

(Proza popullore II, f. 30)

Epo djali, kur u nkthye prapë te plaka, me gjith'ato që pësoi te çupa, ishte **kaq** i pikëlluar e **kaq** i ndezur për të vajtur përsëri atje, **sa** nuk mbahej dot.

(Proza popullore I, f. 170)

³⁴⁵ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 74.

Në prozën popullore nuk kemi hasur edhe ndërtimet rrjedhimore me lidhëzën rrjedhimore *sa* dhe me korrelatin *i tillë, e tillë* në fjalinë drejtuese. Ndërtimet në fjalë janë pronë e gjuhës standarde.

4.1.2 Fjalja rrjedhimore e bashkëlidhur (korrelative) me lidhëzën **saqë** (*sa qi*)

Saqë është lidhëz specifike rrjedhimore dhe shpreh vetëm marrëdhënie rrjedhimore reale. Ashtu si në gjuhën letrare, edhe në prozën popullore ajo del me të njëjtën vlerë që ka dhe lidhëza *sa*. Si fjalë korrelative në fjalinë kryesore në fjalitë e lidhura me këtë lidhëz përdoren *aq, kaq*, të pasuara ose jo nga ndajfolje e mbiemra. Përemrin dëftor *i tillë, e tillë* nuk e kemi hasur në prozën popullore.

*Edhe ish kanë **aq** e hijshme, **saqë** në atë sheher nuk kish pasë shoqe.*

(Proza popullore VI, f. 170)

*...Po e donte **kaq** shumë djalin babai, **saqë** çdo saba ngrihesh pa larë sitë, pa ngrënë, pa pirë dhe vente i puthte të di sitë djalit.*

(Proza popullore IV, f. 277)

*Bakçej'e bret ish **aq** e larta, **saqë** as zogu i malit nuku hij dot.*

(Proza popullore VI, f. 43)

*Ishte **aq** e bukur, **saqë** desh i ra të fiket kur e pa.*

(Proza popullore VI, f. 210)

Pjakat iu vunë **aq** fort nonës së djalit qi të shifshin atë kutinë e vogël, **saqi** kjo u gabu edhe e hapi.

(Proza..., VI, f. 103)

... E pret **aq** mirë, **saqi** djali i mretit çuditet me gjithë ato stolina e bukurina, qi s'i kishte pa kurrë.

(Proza popullore VI, f. 119)

Edhe ky e dojte **aqi** fort, **saqi** s'ia prishte qefin kurrë.

(Proza popullore VI, f. 58.)

E trashi **kaq** fort muhabetin me të Bukrën e Dheut, **saqë** ia mushi menen qi të flete atë natë aty, masi ishte vonë e s'kishte ku të shkote.

(Proza popullore VI, f. 59.)

...U zemërua **kaqë** shumë, **saqë** iku vate prap në vesh të vajzës dhe u shushat më tepër.

(Proza popullore IV, f. 427)

4.1.3 Fjalja rrjedhimore e bashkëlidhur (korrelative) me lidhëzën **që**

Siç dihet, lidhëza nënrenditëse **që** është me prejardhje përemërore³⁴⁶ dhe ka denduri të lartë përdorimi si në gjuhën standarde, ashtu dhe në prozën popullore. Denduria e përdorimit të saj rrjedh nga fakti se ajo është ekonomike në të folur e në të shkruar. Meqë lidhëza **që** ka përdorime dhe kuptime të ndryshme semantike e sintaksore, në fjalitë e nënrenditura rrjedhimore marrëdhënia bëhet e qartë nga konteksti, modaliteti i fjalisë drejtuese, si edhe nga prania e mjeteve leksikore.

³⁴⁶ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 404.

Nga shqyrtimi i lëndës në prozën popullore, na del se lidhëza **që** nuk është shumë e përdorshme në fjalitë rrjedhimore jokorrelative.

Lidhëzës **që** i përgjigjet në fjalinë kryesore korrelati **aq** (më rrallë **kaq**), që shoqëron të shumtën e herës një *ndajfolje* ose një *mbiemër* të shkallës krahasore të barazisë:

Aq t' bukur e kishte, qi e mante myllë në 12 oda.

(Proza popullore IV, f. 233)

Aq her e kam lith me litar- thot qo- qi nuk kam goj ta dëftej.

(Proza popullore IV, f. 233)

Çika ishte kaq e bukur, qi kurrkund shoqja mos me iu gjetë.

(Proza popullore VI, f. 167)

Si një lloj korrelati i lidhëzës **që** ndonjëherë mund të përdoret dhe ndajfolja *shumë*. E bashkuar me ndonjë *mbiemër*, ndajfolja *shumë* tregon se sasia, masa e cilësisë së shprehur nga *mbiemri* është shumë më e madhe dhe rrjedhimi pengohet, në rast se kallëzuesi i fjalisë kryesore është mohor ose nuk mund të ndalohet, kur kallëzuesi i fjalisë së nënrenditur është mohor. Tipar karakteristik i periudhës është trajta e lidhës së foljes kallëzues të fjalisë së nënrenditur:

Po pusi nuk ish shum i thellë me uj, **që** të mbitej djali...

(Proza popullore V, 312)

Edhe në këtë ndërtim në prozën popullore nuk kemi gjetur raste të përdorimit të ndajfoljes *mjaft* në vend të korrelatit *aq, kaq*.

Nuk kemi hasur as ndërtimet rrjedhimore me lidhëzën rrjedhimore **që**, e cila ka si korrelat në fjalinë kryesore përemrat dëftorë *i tillë, e tillë*, por kemi ndeshur, edhe pse me përdorim të kufizuar, lidhëzën **tek** me vlerë rrjedhimore:

Po pasi u shtrëngua kaq nga an' e peshqit, i cili nxorri urdhër edhe për të vrarë, tek bëri me kokë të fortë, u ngrit e vajt me gjithë fëmijënë.

(Proza popullore V, f. 165)

Ndërtimi rrjedhimor me mjetin lidhës përkatës është shumë i rrallë në përdorim,

4.2 Tipi me fjali rrjedhimore të bashkëlidhur (jokorrelative) në prozën popullore

Në prozën popullore fjalitë e nënrenditura rrjedhimore jokorrelative lidhen me fjalinë e nënrenditur me lidhëzat: *sa, aq sa, kështu që, që*. Këto lidhëza kryejnë jo vetëm funksion lidhëzor, por janë gjithashtu dhe tregues të marrëdhënies. Fjalitë e nënrenditura rrjedhimore në periudhat jokorrelative shprehin një përfundim logjik, si rezultat i brendisë së fjalisë kryesore.

4.2.1 Periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën *sa*

Ashtu si në gjuhën standarde, në këtë tip periudhe ndërtimet me lidhëzën *sa* i hasim edhe në prozën popullore. Këto periudha paraqiten të tipit korrelativ mungesor³⁴⁷.

Korrelati që mungon, mund të shtihet në fjalinë kryesore pa shkaktuar ndryshime në marrëdhëniet midis fjalive, si edhe në strukturën e tyre. Mungesa e korrelatëve plotësohet me mjete leksikore e mjete gramatikore.

Kështu, në këtë tip fjalië njëfarë shkalle a intensiteti i shtjellimit mund të shprehet nga kuptimet leksikore të vetë foljeve në fjalinë kryesore dhe të fjalëve që i shoqërojnë këto folje. Pra, këtu foljet kallëzues me vetë brendinë e tyre semantike shprehin intensitet të lartë të shtjellimit të veprimit. Folje, si *ulërin* (te njeriu), *zemërohem* (me kuptimin zemërohem shumë), kanë kuptimin e tyre leksikor dhe një shkallë të madhe të intensitetit të veprimit. Mund të përmendim këtu shprehje e fjalë, si *tretim, ulërin, ndrit, rrah, shkëlqej, mallëngjej, rëndo me fjalë, bërtet, gjëmon* etj.

Filloi me u toundë dinjaja prej tërmetit, sa u hini linxhira të xhithëve.

(Proza popullore II, f. 20)

Mas pak kohë u nis një gjamë e madhe, sa shungulloi pylli gjithë...

(Proza popullore VI, f. 117)

³⁴⁷ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime Filologjike, Nr. 2, 1965, f. 75.

Ajo bërteëjste e xhëmonte sa s'boesh ma.

(Proza popullore II, f. 76)

Fiteëjmi ishte shoumë i madh, sa paret nëëjsën me i grambëlloue në vizme të kaves, se s'i meëjrshin arkat.

(Proza popullore II, f. 124)

Sufra bëri bujë të madhe, sa e muarre vesh të gjithë.

(Proza popullore VI, f. 285)

...Edhe arapi me djalë lëftojën me palla, sa u thienë të dia pallat edhe nonjë nga di nuk u plagos...

(Proza popullore II, f. 296)

Folja kallëzues e fjalive të nënrenditura rrjedhimore të këtij tipi mund të jetë në mënyrën *dëftore* dhe *lidhore*. Në fjalitë rrjedhimore që shprehin marrëdhënie reale folja-kallëzues është në mënyrën *dëftore*.

Kur veprimi paraqitet jo real folja-kallëzues është në mënyrën *lidhore*.

Ay kish me vetëhe rrusht' e bardhë, të shtypur e të gatuar si të lym, sa të mos njiheshin ata seç ishin.

(Proza popullore I, f. 287)

Thirr në dhe të tre vëllazënit dhe iu afruan Lubisë që gërriste sa të këlliste datkën.

(Proza popullore VI, f. 67)

Megjithatë, shprehja e njëfarë intensiteti të veprimit në fjalinë kryesore nuk e bën të plotë këtë tip fjalie, sepse nëpërmjet rrjedhimit i atribuohet një shkallë të madhe veprimit, kështu që në fjalinë kryesore mund të vendoset jo korrelati aq (kaq), por një togfjalësh ndajfoljor (*aq shumë, aq fort* etj.).

Kur pa se shërbëtorët i kishin thënë të vërtetën uluriti, sa gjithi shpia kumboi e u shkund.

(Proza popullore VI, f. 67)

Kështu, në shembullin e mësipërm mund të vendosim pas foljes togfjalëshin ndajfoljor (ulëriti *kaq shumë* sa...).

Shkak për rrjedhimin e shprehur në fjalinë e nënrenditur mund të bëhet dhe përsëritja e së njëjtës trajtë foljore të së njëjtës folje me bashkimin e tyre nëpërmjet lidhëzës bashkërenditëse këpujore.

Shprehja e intensitetit të madh të shtjellimit të veprimit te këta kallëzues foljorë është *kaq shumë* e lartë, sa nuk kërkon asnjë korrelat në fjalinë kryesore. Ndërtime të tilla, sipas Floqit, qëndrojnë midis tipit korrelativ mungesor dhe tipit jo korrelativ.³⁴⁸ Shih, p.sh.:

Merr një skop e në at idhnim ta rreh e ta rreh sa s'e mbyt.

(Proza popullore IV, f. 354)

4.2.2 Periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore me lokucionin lidhëzor³⁴⁹ **aq sa**

Aq sa është një lokucion rrjedhimor, i formuar nga bashkimi i fjalës lidhëse *aq* me ndajfoljen *sa*. Siç pohon Floqi, korrelatët *aq(ë)*, *kaq(ë)*, të vetëm, duke u zhvendosur prej pozicionit para foljes pas saj, arriten të ndodhen menjëherë përpara lidhëzës *sa*.³⁵⁰ Fjalitë e bashkuara me lokucionin lidhëzor ***aq sa*** kanë të bëjnë zakonisht me një fjali kryesore, tek e cila shkalla, masa, sasia a cilësia është shprehur konkretisht dhe fjalia e varur tregon më fort njëfarë përfundimi të nxjerrë nga gjithë brendia e fjalisë kryesore. Fjalitë e nënrenditura rrjedhimore të lidhura me lokucionin ***aq sa*** dalin po me atë vlerë me fjalitë e mësipërme. Në këtë lloj ndërtimi, fjalia kryesore nuk karakterizohet as për ndonjë veçori kuptimore, as për ndonjë

³⁴⁸ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike Nr. 2, 1965, f. 77.

³⁴⁹ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, f. 1012: **Lokucion** - grup fjalësh që nga ana gramatikore e leksikore është i barasvlershëm me një fjalë të vetme dhe që ka në përbërjen e tij të paktën një fjalë emërtuese.

³⁵⁰ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike Nr. 2, 1965, f. 78-79.

veçori strukturore; tërë përmbajtja e saj shërben si shkak për rrjedhimin që e përmban fjalia e nënrenditur:

*E pa pritur më, u shti ay ndë mes të të dyvet, të Yllit të Detit e i pushtoi mirë të dy, me të dy krahët, edh' u hoth me gjith' ata mb'atanë pa ndonjë rëndësirë, **aqë sa**, kur i panë gjith' ay allauz, që ish atje, u mahnitën.*

(Proza popullore I. f. 135)

*Këta dielmat e places kishin gjithsecili dhuratën e tij mbi vete, po rronin të shtatë veç e veç panjojtur njeriatrin, **aqë sa**, as njihte i vëllai të vëllanë, as dinte ndonjë nga ata se ka të tjerë vëllezër.*

(Proza popullore I, f. 160)

*Des mbreti e e merr sundimin maxharri, e sundon me urti e me dije të madhe, **aq sa** i del zani anë e kand botës, se dihte me shndishë sytë.*

(Proza popullore II, f. 410)

*Në një kohë të shkurtër jeta e princeshës u lidh ngusht me jetën e djalit, **aq sa** as ajo as ay s'mund të rronin larg njëri-tjetrit.*

(Proza popullore VI, f. 92)

4.2.3 Periudhat rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën **saqë (saqi)**

Fjalia e varur rrjedhimore e ka kallëzuesin në mënyrën dëftore me rend të prapavendosur. Periudha shpreh intensitetin e madh të shtjellimit të veprimit, që sjell pasojën e përmendur të fjalia e nënrenditur. Fjalia kryesore a drejtuese kumton një situatë reale si shkak për rrjedhimin që përmbahet në fjalinë e nënrenditur. Kur rrjedhimi është situatë reale, folja kallëzues e saj shprehet me një formë të dëftores.

*Masanej skilja shkoi në pyll, aty ku ishte mjalti ene u ngop mir' e mirë **saqi** nuk deshti ma ene u kthye prap erth te ujku.*

(Proza popullore I, f. 48)

*Sapo e odhi këtë në det, filloi të bënte një dallgë dhe një furtunë e madhe, **saqë** vapori humbi drejtimin e nuk dinte nga t'ja mbante...*

(Proza popullore IV, f. 426)

*Skilja kur u liru nga goj' e ujkut, filloi me fugu me i shpejtsi t' madhe **saqi** ujku s' mujt me e zanë ma, se kishte met gardhit; dërsa t' kapërcejte ujku gardhin, skilja u bo er e s' u pa ma me sy ene ujku punën e vet qi i kishte hongër mjoltin.*

(Proza popullore I, f. 49)

*...edhe e gërgufi fytyrën e trupin **sa qi** më të shti bubaraqën.*

(Proza popullore VI, f. 54)

*Mirëpo, gocës i jipshin fort msimet, **sa qi** ky, efeniu, kur ikte, linte kte në kamën e tij.*

(Proza popullore IV, f. 189)

*Mbreti, me pasurinë që kish, ndërtoi një xhami të bukur, **sa që** habiti tërë popullin e qitetit.*

(Proza popullore I, f. 393)

4.2.4 Periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lokucionin **kështu që** (*kështu qi*)

Lokucioni lidhëzor **kështu që** është relativisht i ri. Ai e ka prejardhjen nga ndajfolja e mënyrës *kështu*, e ndjekur nga lidhëza ftilluese **që**. Ndajfolja *kështu* ka humbur kuptimin e përmes të mënyrës dhe mbart nuanca rrjedhimi. Në një kontekst të caktuar, *kështu* mund të tregojë në analizë të fundit një konkluzion, një rrjedhim. Duke mbështetur tërësisht faktin e shprehur nga fjalia, *kështu* e shndërron këtë fakt në një rrethanë të fjalisë, rrethanë që merr nuancën e një rrjedhimi. Në këtë mënyrë ndajfolja *kështu* mbingarkohet me një nuancë rrjedhimi dhe humb mjaft nga kuptimi i saj i përmes të mënyrës. Ky proces i ka dhënë shkak formimit të lokucionit të ri rrjedhimor **kështu që**, tek i cili nuanca e mënyrës është shuar. Siç vëren dhe Floqi³⁵¹, ky lloj ndërtimi karakterizohet nga këto tipare:

a) Fjalia kryesore nuk ka dhe nuk mund të ketë ndonjë korrelat apo fjalë mbështetëse të mjetit të lidhjes.

³⁵¹ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 80-81.

- b) Fjalja kryesore është relativisht e plotë nga struktura dhe nga kuptimi.
- c) Fjalja kryesore nga pikëpamja intonacionore është pothuajse e mbaruar.
- d) Fjalja e varur tregon një rrjedhim pa ndonjë nuancë suplementare, si një rezultat logjik i brendisë së fjalisë kryesore.
- e) Lidhja midis fjalisë kryesore dhe asaj të nënrenditur është shumë e dobët, aq sa këtu mund të shohim një nga rastet kalimtare të lidhjes nënrenditje-bashkërenditje, por fjalia e dytë nuk mund të quhet ende e bashkërenditur. Lidhja e dobët gramatikore e fjalisë së varur me kryesoren, karakteri i intonacionit dhe sidomos pauza e gjatë, bëjnë që në të shkruar fjalia drejtuese të ndahet jo vetëm me presje, po edhe me pikëpresje dhe shpeshherë edhe me pikë. Lidhja midis fjalisë së nënrenditur dhe asaj kryesore është më e dobët sesa në fjalitë me lidhëzën *aq sa*.

Në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore me lokucionin *kështu që* tregohet jo një rrjedhim që del nga ndonjë shkallë sasiore e madhe e nga ndonjë cilësi e përmendur në fjalinë kryesore, por një përfundim disi objektiv i gjithë brendisë reale të fjalisë drejtuese.³⁵²

Është vetë lokucioni *kështu që* mjeti që e bën më të qartë kuptimin rrjedhimor, prandaj, së bashku me lidhëzat *sa, saqë, aq sa*, M. Totoni e përfshin në grupin e lidhëzave me kuptim të diferencuar, të cilat janë të specializuara të shprehin një marrëdhënie rrjedhimore që është reale, ku fjalia drejtuese përmban një situatë reale si shkak për rrjedhimin që përmbahet në fjalinë e nënrenditur.³⁵³ Folja kallëzues e fjalisë së nënrenditur është në mënyrën dëftore.

Ashtu si në gjuhën standarde, edhe në prozën popullore, në periudhat me lidhëzën *kështu që* fjalia e nënrenditur përmban një situatë që është përfundim a përmbyllje e arsyetimit që përmban fjalia kryesore. Ky kuptim mbështetet nga bashkëlidhja kuptimore e fjalive dhe bëhet e qartë nga lidhëza. Lidhja midis fjalisë së nënrenditur dhe fjalisë së varur është mjaft e dobët.

Më në fund dolli edhe mbreti në griqë të graves; ndenji pak e i percolli gjilpinjte, kështu që u hamnë e muarre dunjane.

(Proza popullore VI, f. 16)

Djali vehet me kujdes me i ba punët e shpisë, tuj shi e tuj dliirë, kështu qi u jinë në hatër....

(Proza popullore VI, f. 200)

³⁵² Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1996, f. 577.

³⁵³ M. Totoni, *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, Studime filologjike, 1984/4, f. 61.

Kur arriti djali në shtëpinë e tij, kishin kaluar tre vjet, tre muaj dhe tre ditë, **kështu që** vajza atë ditë ishte martuar me një tjetër.

(Proza popullore VI, f. 95)

Kah mbramje u pret të gjithave buzën e sipërme e u then nga një kambë, **kështu që** dukeshin dhinë, sikur ishin tue qeshë e tue kërcye.

(Proza popullore VI, f. 108)

Qeli at' botë nisi me i trashë fjalët, **kështu qi** i hini friga të zotit të shpish e kje ngushtue me e lanë.

(Proza popullore II, f. 328)

Merr e ve në fund të babunes një pet dyll, **kështu qi** kur e çoi e lypi vllau i vogë matit paret me të, u një për dyll një pare e verdhë.

(Proza popullore II, f. 358)

Në prozën popullore kemi ndeshur dhe lidhëzën **ani** si një variant i lidhëzës **kështu që**, e cila paraqitet me të njëjtat karakteristika si kjo e fundit, megjithëse me përdorim mjaft të kufizuar. Ndërtimi rrjedhimor me këtë lidhëz në prozën popullore është i kufizuar.

Edhe vate tek i ati të marrë jeë, harmë etj., po i ati mezi e la, (tuk) me pasqyrën e të parit, frikamanit. **Ani** mori dhe ay gjith ato sa lypi dhe vate të ruajnë ftuan.

(Proza popullore I, f. 146)

E afërme për nga kuptimi me lokucionin lidhëzor **kështu që** është edhe lokucioni **në mënyrë që**. Këtë lloj ndërtimi rrjedhimor nuk e kemi ndeshur në prozën popullore.

Lokucioni **në mënyrë që** është krijuar kohët e fundit. Ai gjen përdorim më shumë në stilin publicistiko-shkencor.

4.2.5 Periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën *që* dhe variantet e saj dialektore *qi*, *ci*

Nga shqyrtimi i lëndës së vjelë në prozën popullore, ashtu si edhe në gjuhën standarde, ndeshim ndërtime me lidhëzën nënrenditëse *që* në fjalitë rrjedhimore, të cilave nuk u përgjigjet e nuk mund t'u përgjigjet ndonjë korrelat në fjalinë drejtuese. Fjalja kryesore e periudhës rrjedhimore jokorrelative është relativisht e plotë për nga struktura dhe kuptimi. Ky tip periudhe, përveçse në letërsinë artistike, përdoret dendur edhe në prozën popullore e në gjuhën e folur. Fjalja e nënrenditur tregon një rrjedhim logjik që del nga brendësia e fjalisë kryesore. Lidhja midis fjalive është më e çlirët. Fjalja e nënrenditur që lidhet drejtpërdrejt me fjalinë drejtuese pa fjalë korrelative, shpreh rrjedhimin si pasojë e një intensiteti të lartë të shtjellimit të veprimit:

Atje nek ai vendi ishin dyzet hajdutë edhe atë vend e kishnë zaptuar, që nuk shkonej nonjë njeri andej.

(Proza popullore I, f. 327)

Në fjalinë e nënrenditur mund të shprehet edhe rrjedhim, si pasojë e shkallës së lartë të veprimit të një tipari, të një sendi, të një personi a të veprimit. Në të tilla ndërtime nuk përdoren korrelatë në fjalinë kryesore, prandaj nuk i përkasin tipit mungesor.³⁵⁴

Në at gjol jetonte një gërshetë, qi gjë ma e bukur se ajo nuk ishte n'u pa mbi ftyrë të tokës.

(Proza popullore II, f. 138)

Çika ishte e bukur, qi kurrkund shoqja mos me iu gjetë.

(Proza popullore I, f. 153)

Mbas do kohe po nis Katallani me vikatë në kupë të qiellit, që me tu dridhë shtati.

(Proza popullore II, f. 250)

³⁵⁴ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, Nr. 2, 1965, f. 58-58.

- *More vllazën, u tha - sa herë qi i çoj delet në kullotë, kam për të parë në një gjol të madh një grua të hishme, qi kurrkuni shoqja nuk mund i gjendej.*

(Proza popullore II, f. 138)

Në të tilla ndërtime si paraprijës, përgjithësisht, është një emër në trajtë të pashquar, shoqëruar nga nyja e pashquar *një* (nji). Semantika e këtij emri kërkon doemos një karakteristikë, të cilën në të vërtetë e jep fjalia e nënrenditur ndërmjet diçkaje që është rrjedhim i saj.

Në at gjol jetonte një gërshetë, qi gjë ma e bukur se ajo nuk ishte n'u pa mbi ftyrë të tokës.

(Proza popullore II, f. 138)

Në periudhat rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën *që* foljet kallëzues përgjithësisht dalin në mënyrën *dëftore* e *lidhore*. Përdorimi i tyre varet si nga mënyra e foljes në fjalinë drejtuese, ashtu dhe nga vetë modaliteti i fjalisë së varur.

Vëmë re se *mënyra dëftore* është më e përdorshme për këtë tip fjalish. Fjalia e nënrenditur në këtë rast shpreh rrjedhim real, pra marrëdhënia rrjedhimore është **reale**.

I thotë ajo, që “u gjeta një tjetër zanat” që s’digjem më, kurdo që të bij bukë.

(Proza popullore I, f. 279)

Atje gjenë një lum shumë të madh: ai lum kish një urë me di fletë, që njëra fletë varej nga kjo anë lumit dhe tjetra matan.

(Proza popullore I, f. 297)

Ku i ke çue me kullotë, mika, qi paskanë hanger kaq mirë?

(Proza popullore II, f. 259)

Dallojmë dy lloje fjalish sipas modalitetit të fjalisë kryesore:

a) Fjalja drejtuese është *pyetëse e drejtë a e zhdrejtë* dhe përmban një shkak të dyshimtë, të supozuar, të pasigurt për një rrjedhim të njohur.

Fjalja drejtuese është *pyetëse*, çka i vë vulën gjithë periudhës, e cila përfshihet e tëra nga intonacioni i pyetjes. Midis fjalive bëhet një pauzë e ndjeshme, duke vendosur presje. Fjalja e nënrenditur përmban *një fakt real*, i cili bëhet shkas për të pyetur për shkakun e panjohur të këtij fakti real nëpërmjet fjalisë kryesore³⁵⁵. Brenda e fjalisë së nënrenditur përmban një fakt real të njohur ose që është konstatuar nga folësi.

Kësisoj, fjalja e nënrenditur nuk përmban shkakun i cili, në të vërtetë, nuk është i pranishëm në periudhë. Brenda e fjalisë së nënrenditur që përmban një fakt real, konceptohet prej folësit si rrjedhim i një shkakun të panjohur prej tij dhe për atë shkak ai pyet me fjalinë kryesore. Shkakun ndodhet në përgjigjen e bashkëfolësit, kur pyetja ka qenë pyetje e mirëfilltë dhe këtë e tregojnë qartë edhe shembujt e mëposhtëm:

Ç'ke kështou *çi sonte qenke kaç e vranët?*

(Proza popullore II, f. 259)

Ku i ke çue me kullotë, mika, qi paskanë hanger kaç mirë?

(Proza popullore II, f. 259)

Ti të më gjesh një vesh rrush, qi të frejë dymdhetë taborre asqerë.

(Proza popullore II, f. 450)

Shka ke, mor njeri, që rrin ashtu në mendim?

(Proza popullore III, f. 33)

Shka ke, more vlla, qi s'kjan e flet?

(Proza popullore II, f. 301)

Kush je ti ç'i guxon me hi ne oden time?

(Proza popullore VI, f. 158)

³⁵⁵ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 33.

Ç'të xhet, more njeri ç'i u sëmourne?

(Proza popullore II, f. 78)

A ka dele në ket grigjë, qi i kanë gjallë kingjat e tetë pjellave?

(Proza popullore f. 348)

b. Fjalja pyetëse mund të jetë edhe e tërthortë (e zhdrejtë), edhe retorike. Kur fjalja drejtuese është pyetëse retorike, ajo është baras me një fjali dëftore mohore, prandaj thënia e fjalisë drejtuese mohohet si shkak për rrjedhimin e shprehur në fjalinë e varur³⁵⁶.

Por pyetja nuk mund të bëhet gjithmonë si më sipër vetëm për ndonjë shkak të brendshëm (ç'ka...) në mënyrë të padiferencuar, por mund të përmbajë pyetje për subjektin, kallëzuesorin, për rrethana të ndryshme (pyetje e pjesëshme) a për vetë veprimin (pyetje e përgjithshme) dhe kjo jepet me përdorimin e përemrave pyetës, ndajfoljeve pyetëse (përveç ndajfoljes përse dhe pse), si dhe pjesëzave pyetëse (sidomos pjesëza pyetëse e dyshimit mos) dhe me vetë intonacionin e pyetjes, pa ndonjë fjalë pyetëse.

Ky është nëntipi më i përdorur ndër të gjithë nëntipat lidhëzorë jokorrelativë.³⁵⁷

- Ç'ke kështou ç'i sonte qenke kaç e vranët?

(Proza popullore II, f. 18)

- Ç'ke - i thotë e shoqja - që je kaq i sikëlldisur?

(Proza popullore III, f. 45)

Këto lloj periudhash dalin shumë në prozën popullore, ashtu si dhe në gjuhën standarde. Në fjalinë e nënrenditur përmbahet shkaku i pyetjes së bërë në fjalinë drejtuese. Fjalja e nënrenditur arsyeton kështu pyetjen që përmban fjalja drejtuese, prandaj në gramatikat e shqipes këto lloj periudhash janë trajtuar si *fjali shkakore motivuese e pyetjes, por edhe si fjali e varur rrjedhimore*³⁵⁸.

³⁵⁶ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 85.

³⁵⁷ S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 86.

³⁵⁸ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 2002, f. 570.

Ne jemi të mendimit se në këto lloj fjalish të nënrenditura kemi marrëdhënie shkakore. Këtu marrëdhëniet rrjedhimore dalin në plan të dytë, kështu që ne priremi t'i trajtojmë përgjithësisht si *fjali shkakore motivuese e pyetjes*.

Shumë të përhapura si në folklor dhe në letërsinë artistike ndeshim periudhat me fjali kryesore të shprehur me përemrin pyetës **ç'** dhe variantet e tij dialektore *çka, shka, qish*.

*Shka keni ju **qi** po haheni nërmjet vedi?*

(Proza popullore II, f. 142)

*Ç'të xhet, more njeri **çi** u sëmoune?*

(Proza popullore II, f. 78)

Edhe të vëllezërit, take parë çehren e asaj të vrarë e dita me ditë po tretej, po mentoheshin edhe e pyesnin gjithënjë: "ç'ke, motër, që po trete kështu?"

(Proza popullore I, f. 157)

Në periudhat që shprehin **marrëdhënie rrjedhimore të mundshme**, fjalia drejtuese përmban një veprim, tipar a rrethanë në një sasi të lartë, një situatë të mohuar, të panjohur, të domosdoshme, të dëshiruar, të supozuar a të dyshuar, që paraqitet si shkak për rrjedhimin që përmban fjalia e nënrenditur. Fjalia drejtuese dallohet për një larmi kuptimesh modale dhe formash.

*T'shkojsh e t'ma bish ni bukë **çi** krejt asqeri t'hanë...*

(Proza popullore I, f. 46)

*Ku mund t'i gjej un tri bukë, **qi** t'i dalin krejt ushtrisë e të teprojnë edhe njaqë?*

(Proza popullore II, f. 143)

*- Çajre s'ke pa m'i gjetë tre kutë cohë, **qi** të më dalin me veshë ushtrinë e të teprojnë edhe njaqë, përndryshej të ka shkue kryet.*

(Proza popullore II, f. 142)

Me foljen-kallëzues në mënyrën lidhore, fjalia e nënrenditur rrjedhimore mbart tipare të fjalisë qëllimore. Megjithatë, marrëdhëniet midis fjalive janë rrjedhimore, me veçantinë se në fjalinë kryesore mungon ai tipar që do të sillte rrjedhimin në fjalinë e nënrenditur. Kështu që rrjedhimi në fjalinë e nënrenditur paraqitet si i mundshëm, si i realizueshëm, në qoftë se është i pranishëm si tipar që mungon në fjalinë kryesore. Nga kjo pikëpamje do të dallonim dhe lidhjet shkak-pasojë midis fjalive, lidhje të cilat diktohen më tepër në rrafshin kuptimor. Në periudhat e këtij lloji, para së gjithash, shprehen marrëdhënie rrjedhimore:

I thotë djali, “që unë jam një djal’ i varfër, s’kam takat me zotërinë rënde, që të marr vajzën tënde”.

(Proza popullore I, f. 323)

Në prozën popullore kemi hasur edhe periudha rrjedhimore që kanë elemente strukturore të fjalisë qëllimore, në të cilat folja-kallëzues e fjalisë kryesore ka kuptimin leksikor të një veprimi konkret, ndërsa fjalia e nënrenditur tregon një veprim që është rrjedhim i shkakut real të përmendur në fjalinë kryesore, i cili është i ndryshëm nga ai që mund të pritej nga synimi a qëllimi i veprimit të fjalisë kryesore. Kësisoj, marrëdhënia që vendoset midis fjalive nuk është qëllimore, por *rrjedhimore*.

Veprimi i shprehur nga fjalia e nënrenditur nuk lidhet me synimin e vërtetë, por është një pasojë objektive e domosdoshme, një fakt që i shmanget synimit të vërtetë dhe këtë e tregojnë qartë edhe shembujt e mëposhtëm:

Ti më bën njimilë, po unë të bij dimilë që të mos gjendet nishani asgjekunt.

(Proza popullore I, f. 396)

Ashty kërceu përpara i madhi, edhe vete vate në fund të detit dhe dolli prapë siprë; e si e nakatosej me duar e me këmbë që të mbitej, i thon ata të tjerët, që “ç’thotë vëllai inë tani që dolli siprë?”

(Proza popullore I, f. 338)

Si element strukturor i periudhave të këtij tipi është intonacioni i tyre dhe pikërisht ajo anë që ka të bëjë me pauzën: fjalia e nënrenditur rrjedhimore ndahet nga kryesorja me pauzë, kurse fjalia qëllimore që varet nga e njëjta kryesore, nuk ndahet me pauzë. Në të shkruar vihet gjithmonë presje.

Kjo lloj periudhe ka një përhapje të gjerë si në prozën popullore, ashtu dhe në gjuhën standarde.³⁵⁹

Nga materiali i shqyrtuar në këtë lloj ndërtimi kemi ndeshur edhe fjali të varura rrjedhimore me kallëzues paskajoren geqe të tipit [*me + pjesoren e foljes*] (*me gjetë*) me lidhëzën *që*. Këtu hasim dy lloj strukturash:

1. Lidhëza *që* lidhet drejtpërdrejt me paskajoren:

Ai kish pasë një breshkë, prej asaj breshkës i kishte dalë një nuse e bukur qi me t'lanë hajran, po tash si e bajmë me e mytë?

(*Proza popullore III, f. 440*)

2. Lidhëza *që* lidhet jo drejtpërdrejt me paskajoren, p.sh.:

Çika ishte e bukur, qi kurrkund shoqja mos me iu gjetë.

(*Proza popullore I, f. 153*)

Këto lloj ndërtimesh shprehin zakonisht një intensitet të lartë të veprimit, shkallë të lartë të tiparit të sendit a personit.

Në prozën popullore kemi ndeshur, edhe pse me përdorim të kufizuar, lidhëzën *tek* me vlerë rrjedhimore:

Po pasi u shtrëngua kaq nga an' e peshqit, i cili nxorri urdhër edhe për të vrarë, tek bëri me kokë të fortë, u ngrit e vajt me gjithë fëmijënë.

(*Proza popullore V, f. 165*)

³⁵⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002, f. 578.

4. 3. Mjetet e lidhjes

Siç shihet edhe në punim, mjetet e lidhjes të fjalisë së nënrenditur rrjedhimore me fjalinë kryesore, ashtu si në gjuhën letrare, edhe në prozën popullore nuk janë shumë të larmishme. Së bashku me variantet e tyre, numri i lidhëzave rrjedhimore që kemi ndeshur në prozën popullore arrin në pesë: *sa, sa që, aq sa, që, kështu që*.

Lidhëzat e thjeshta *sa* e *që*, e para me kuptim sasior dhe e dyta me kuptim fillues, janë dy mjetet kryesore lidhëse.

Funksioni i lidhëzës *sa* (si lidhës mbarëgjuhësore) nuk është i mjaftueshëm për të kuptuar nëse marrëdhënia që shprehet është rrjedhimore, pasi me anë të kësaj lidhëze lidhen dhe fjalitë me marrëdhënie krahasore. Është pikërisht tërësia e mjeteve strukturore, si dhe bashkëlidhja e brendive reale të fjalive të periudhës, që specifikon llojin e marrëdhënies së realizuar me anë të lidhëzës *sa*.

Nga vëzhgimet tona del se në prozën popullore kjo lidhëz ka denduri përdorimi më të lartë krahasuar me lidhëzat e tjera.

Lidhëza *që* me kuptim fillues në gjuhën shqipe përdoret edhe si lidhëz që shpreh marrëdhënien rrjedhimore. Zakonisht, e pozicionuar në mes të fjalive, lidh fjali ku brendia e fjalisë së varur përmban një fakt real, i cili konceptohet prej folësit si një rrjedhim i një shkakut të panjohur prej tij dhe për atë shkak ai pyet me fjalinë kryesore.

Në at gjol jetonte një gërshetë, qi gjë ma e bukur se ajo nuk ishte n'u pa mbi ftyrë të tokës.

(Proza popullore II, f. 138)

Kështu, në shembullin e mësipërm bëhet fjalë për një fjali rrjedhimore, ndërsa në fjalinë *Sa i trembet ujkut, aq i trembet edhe barrës*, bëhet fjalë për një fjali krahasore.

Prej lidhëzave *sa* e *që* është formuar lidhëza *saqë*, e cila del me të njëjtën vlerë që ka edhe lidhëza *sa*:

Sapo e odhi këtë në det, filloi të bënte një dallgë dhe një furtunë e madhe, saqë vapori humbi drejtimin e nuk dinte nga t'ja mbante...

(Proza popullore IV, f. 426)

Lokucioni *aq sa* është formuar nga bashkimi i korrelatit *aq* dhe lidhëzës *që*.

Fjalitë me lokucionin lidhëzor **aq sa** kanë të bëjnë zakonisht me një fjali kryesore tek e cila shkalla, masa, sasia e cilësia është shprehur konkretisht dhe fjalia e varur tregon më fort njëfarë përfundimi të nxjerrë nga gjithë brendia e fjalisë kryesore.

Është e qartë që në një marrëdhënie të tillë nuk kemi të bëjmë me marrëdhënie të pastër rrjedhimore, pasi këtu ruhet ende disi marrëdhënia sasiore.

Kështu që është thjesht lokucion rrjedhimor dhe ndërtimi rrjedhimor me këtë shprehje lidhëzore dallohet më qartë, nga vetë mjete i lidhjes, por edhe nga bashkëlidhja kuptimore e fjalive. Në periudhat e lidhura me lokucionin lidhëzor **kështu që** fjalia e nënrenditur shpreh marrëdhënie të mirëfillta rrjedhimore, tregon një përfundim objektiv të asaj që thuhet në pjesën kryesore. Pozicionimi në mes të fjalisë nuk është pozicioni i zakonshëm i tij, por e hasim lokucionin edhe në krye të fjalisë. Lidhja e dobët gramatikore e fjalisë së nënrenditur me kryesoren, karakteri i intonacionit dhe sidomos pauza e gjatë, bëjnë që në të shkruar fjalia kryesore të ndahet jo vetëm me presje, por edhe me pikëpresje dhe ndonjëherë edhe me pikë.³⁶⁰

Dihet se në organizimin e periudhës me nënrenditje, krahas mjeteve të tjera, si mjete të rëndësishme të lidhjes sintaksore midis fjalive janë dhe fjalët lidhëse. Së bashku me lidhëzat, ato janë më kryesoret për të shprehur raporte kuptimore e sintaksore të fjalive. Fjalët lidhëse, në dallim nga lidhëzat, nuk kryejnë vetëm funksionin e lidhjes midis fjalive; ato funksionojnë në të njëjtën kohë edhe si gjymtyrë kryesore ose si gjymtyrë të dyta të fjalisë ku bëjnë pjesë. Lidhja e tyre kuptimore dhe gramatikore në togfjalësh realizohet brenda fjalisë dhe jo jashtë saj. Në këtë kuptim, në rrafshin sintaksor është i përligjur edhe emërtimi i tyre si fjalë lidhëse, emërtim i cili shpreh plotësisht natyrën e tyre të dyanshme.

Në prozën popullore, ashtu si dhe në gjuhën standarde, si fjalë lidhëse ndeshim përemrin lidhor **që**, i cili bashkon fjalinë e nënrenditur përcaktore me një emër në fjalinë kryesore dhe mbi kuptimet e përcaktimit shtohet nuanca rrjedhimore.

Fjalia e nënrenditur karakterizohet nga prania e përemrit lidhor **që**, i cili paraqitet më shpesh në funksionin e kryefjalës a atë të kundrinorit:

Ama kishte një kalë ç'i s'ja xhinje shokun.

(Proza popullore II, f. 21)


Djali dhe vajza ishen të bukur, që shokë s'kishin në faqe të dheut.

(Proza popullore VI, f. 148)


³⁶⁰ S. Floqi, *Vepër e cituar*, f. 82.

4. 4 Grafiku i shpërndarjes së lidhëzave në periudhat me fjali të nënrenditura rrjedhimore në prozën popullore

Denduria e përdorimit të lidhëzave në prozën popullore



Përqindja që zënë lidhëzat rrjedhimore në prozën popullore



Duke parë shterueshëm dendurinë e përdorimit të fjalive të nënrenditura me lidhëza e fjalë lidhëse në vëllimet 1, 2, 3, 4, 5, 6 të prozës popullore, të cilat sipas nesh arrijnë shifrën 723 herë, del se vendin e parë e zënë fjalitë e nënrenditura rrjedhimore me lidhëzën sa të përdorura 235 herë, të cilat i gjejmë më shumë në tipin rrjedhimor jokorrelativ.

Më pas, me një diferencë jo shumë të dukshme vijnë fjalitë e nënrenditura rrjedhimore me lidhëzën *që* të përdorura 197 herë.

Periudhat me fjali të nënrenditura rrjedhimore të bashkuara me lidhëzën *që* gjenden të përdorura më shpesh në tipin rrjedhimor jokorrelativ.

Menjëherë pas tyre renditen periudhat me fjali të nënrenditura rrjedhimore me lokucionin lidhëzor *aq sa* me denduri përdorimi 122 herë.

Me pak diferencë renditen fjalitë e nënrenditura rrjedhimore me lidhëzën *saqë* të përdorura 107 herë.

Pas tyre renditen me një denduri të vogël përdorimi, 62 herë, periudhat e nënrenditura rrjedhimore me lokucionin lidhëzor *kështu që*.

Pothuajse me ato funksione e përdorime që vumë re në prozën popullore, dalin edhe lidhëzat nënrenditëse me vlerë rrjedhimore *që, sa, aq sa* që nga “*Meshari*” i Buzukut,³⁶¹ çka dëshmon se që në shekullin XVI shqipja e shkruar kishte një sistem lidhëzor të plotë, të aftë për të shprehur llojet kryesore të raporteve sintaksore e veçanërisht të raporteve rrjedhimore.³⁶²

Përdorimi i rregullt i këtyre lidhëzave nënrenditëse në prozën popullore, duke e krahasuar me inventarin e plotë të atyre që gjenden te Buzuku, dëshmon jo vetëm për atë vijë afrimi në fushë të sintaksës midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar edhe në periudhën parakombëtare, por edhe për një strukturë sintaksore të caktuar për kohën.³⁶³

Gjithashtu, mund të pohojmë se struktura e periudhave me fjali të nënrenditur rrjedhimore është pasuruar më tej nëpërmjet krijimit të lidhëzave të reja, si p.sh. *në mënyrë që*, lidhëz që nuk e hasim në prozën popullore.

Sipas statistikave tona, tipi me fjali rrjedhimore të bashkëlidhur (korrelative) në prozën popullore na rezulton më prodhimtari. Në një korpus prej 723 fjalish të nënrenditura rrjedhimore, 519 prej tyre i përkasin tipit me fjali rrjedhimore të bashkëlidhur korrelative.

Në prozën popullore, ashtu si edhe në gjuhën letrare, vëmë re praninë e korrelatëve në fjalinë drejtuese, praninë e disa treguesve leksikorë për qartësimin e saktësimin e marrëdhënieve sintaksore të fjalive, tipare tashmë të rrënjosura e tipare të përbashkëta si për prozën popullore, ashtu edhe për gjuhën standarde shqipe.

³⁶¹ Shih më tepër: E. Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike, 1971, Nr. 4.

³⁶² E. Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike, 1971, Nr. 4, f. 154.

³⁶³ E. Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike, 1971, Nr. 4, f. 156.

KREU V

RENDI I GJYMTYRËVE NË FJALINË RRJEDHIMORE DHE RENDI I FJALIVE NË PERIUdhËN ME FJALI TË NËNRENDITUR RRJEDHIMORE NË PROZËN POPULLORE

5.1 Vështrim i përgjithshëm për studimet gjuhësore mbi rendin në gjuhën shqipe

Nëpër gramatikat e shqipes, rendi i fjalive përbërëse të periudhës me fjali të nënrenditur, si edhe vetë rendi i gjymtyrëve në këto fjali është trajtuar pak. Spiro Floqi pohon se të paktën deri në kohën kur ka shkruar ai, çështja e rendit të fjalëve në fjali dhe të fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur nuk është trajtuar fare nga sintaksologët shqiptarë ose është trajtuar shumë pak³⁶⁴.

Le t'u hedhim një vështrim trajtesave e punimeve në lidhje me rendin e fjalive përbërëse të periudhës me fjali të nënrenditura, si edhe vetë rendit të fjalëve në këto fjali në përgjithësi dhe atyre të fjalive rrjedhimore në veçanti.

A. Xhuvani në sintaksën e tij³⁶⁵, në bazë të rendit të gjymtyrëve të fjalisë, i ndan fjalitë në fjali *me hartim të drejtë*, që sipas tij “i kanë pjesët të vume në një radhë të natyrshme, d.m.th. përpara vjen kryefjala, pastaj kallzuesi e mbrapa vijnë kundrinat a plotësorët: p.sh. Skënderbeu ka qenë ma trim i gjithë Shqiptarëvet” dhe në fjali *me hartim të zhdrejtë*, “që i kanë pjesët të vume në një radhë të përkundërtë me të sipërmen; p.sh. ma trimi i të gjithëve ka qenë Skënderbeu”.³⁶⁶ Pra, autori dallon fjalitë me rend të zakonshëm: *kryefjalë + kallzues + kundrinor + rrethanor (plotësor)* dhe fjalitë me rend jo të natyrshëm, të anasjellë.

Xhuvani nuk trajton veçmas rendin e përbërësve të periudhës me fjali të varur rrjedhimore. Më thukët e trajton çështjen e rendit Ilia Dilo Sheperi³⁶⁷. Ashtu si prof. A. Xhuvani, ai dallon fjalitë me rend të zakonshëm nga ato me rend jo të zakonshëm dhe bën vërejtje me rëndësi për rendin e fjalive të varura. Ilia Dilo Sheperi thekson: *Fjalitë e varme fillojnë kurdoherë me lidhëzat e tyre, në mënyrë që çdo fjalë që shkon përpara lidhëzës nuk i përket fjalisë së varme, po mund të nënkuptohet dhe në të. P.sh.: Djalin, tek shkonja udhës, e pashë që po vente në shkollë. Përyjashtohet, përemri lidhor, i cili, kur përdoret si plotës me gjëndore shkon pas fjalës që plotëson. Lidhëzat e bashkëlidhjes rregullisht nuk ndahen nga folja e tyre, në mënyrë që kryefjala në fjali të varme vjen nevojisht pas foljes. P.sh.: Kur punon tjetri nuk duhet ta shqetësojmë.*³⁶⁸

Siç e kemi përmendur edhe më parë në këtë punim, Ilia Dilo Sheperi në sintaksën e tij nuk përmend dhe nuk trajton as periudhën me fjali të nënrenditur *rrjedhimore*, kështu që nuk flet në veçanti për rendin e fjalive në këtë tip periudhe.

³⁶⁴ S. Floqi në “Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme”, Studime filologjike, Tiranë, 1969, Nr. 2, f. 125.

³⁶⁵ A. Xhuvani, *Njohunit`e para të sintaksës shqipe, pjes`e parë për klasët e nalta të fillores*, Vlorë, 1922.

³⁶⁶ *Po aty*, f. 22.

³⁶⁷ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927.

³⁶⁸ *Po aty*, f. 179.

Justin Rrota në tekstin e vet shkollor³⁶⁹, ashtu si edhe prof. A. Xhuvani, flet për rendin në fjalinë e thjeshtë dhe dallon rendin *e drejtë* nga rendi *i zhdrejtë*, që, sipas tij, përcaktohen nga pozicioni i kryegjymtyrëve subjekt - predikat. Sipas tij, “quhet i drejtë rendi më i natyrshëm, kur në vend të parë rri kryefjala, dhe përmbas kallëzuesi. Ky rend i drejtë i kryegjymtyrëve shkon sidomos ndër fjali, ku kallëzohet a dëftohet ndonjë gjâ (*ffjali* në përgjithsi dhe në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore në veçanti, *dëftore*); mandej edhe ndër fjali pyetse, ku kryefjala zakonisht është një përemën pyetës. Rendi i kryegjymtyrëve të fjalisë quhet i zhdrejtë, kur folja e mënyrës skajore rri para kryefjalës. Ky rend i zhdrejtë bahet zakonisht ndër fjali pyetse, ku pritet një përgjegje për po, a për jo; ase nuk pyetet gja për kryefjalë, por për ndonjë pjesë tjetër të fjalisë; mandej përdoret edhe ndër fjali, ku shprehet një dëshir (*f. dëshirore*), një urdhër (*f. urdhërore*), jase një habi (*f. habitore*).”³⁷⁰

Pra, me fjalë të tjera, kemi rend të drejtë, kur kryefjala qëndron përpara kallëzuesit, teksa bëhet fjalë për rend të zhdrejtë të fjalëve në fjali, kur kallëzuesi vjen pas kryefjalës. Gjithashtu, autori flet dhe për rendin e gjymtyrëve të dyta të fjalisë, duke përmendur edhe rendin e trajtave të shkurtra të kundrinës ose të përemrave vetorë (*grimsimeve përemërore*, siç i quan ai³⁷¹) të cilat, siç vëren ai, vendosen pas foljes, po qenë të vetës së parë njëjës ose shumës, por mund të vendosen edhe përpara foljes pa prishur semantikën e fjalisë.

Sipas J. Rrotës, fjalitë e zgjeruara mund të kenë një rend tjetër fjalësh, sepse këtu dalin edhe gjymtyrët e dyta të fjalisë. Kështu atributi zakonisht shkon pas emrit. Numërorët vendosen gjithnjë para emrit, kur janë themelorë, ndërsa numërorët rreshtorë vendosen pas emrit. Nga ana tjetër, vendi i kundrinës ose i kundrinave është gjithnjë pas foljes-kallëzues, kuptimin e së cilës e plotësojnë më mirë. Ndërsa rrethanorët gjithnjë vendosen prapa foljes-kallëzues, të cilën e konkretizojnë më tej.

Lidhur me rendin e fjalive të nënrenditura, J. Rrota thekson se në gjuhën shqipe topika është mjaft e lirë dhe fjalitë e nënrenditura mund të dalin në tri pozicione kundrejt fjalisë kryesore:

- 1) Pas fjalisë kryesore, dhe ky është rendi më i zakonshëm; për shembull: *Mate vrapin, sa të kesh hapin.*
- 2) Para fjalisë kryesore; për shembull: *Kush ec kahdalë, shkon shëndosh e larg.*
- 3) Fjalitë e nënrenditura mund të hyjnë midis gjymtyrëve të fjalisë kryesore; si për shembull: *Mali, si t’i thuesh, të përgjegjë.*³⁷²

³⁶⁹ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes, për klasat II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, 1942.

³⁷⁰ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes, për klasat II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, 1942, f. 56.

³⁷¹ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes, për klasat II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, 1942, f. 56; At J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, AShRSh, IGJL, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 489: Grimësimet përemnore - të cilat shpesh nuk janë tjetër, veç të përsrituna të kota, pleonastike, të kundrinës shkojnë fill mbas foljes. Në mënyrën urdhërore por, këto grimcime, kur janë të thjeshta, rëndohen këso dore: po qenë të vetës së parë, njëjës a shumës mund të shkojnë si para, si mbas foljes. P.sh. “Piqmë Zot, n’at Ramada’n”. Falna dhe një herë. - Jase “Mpiq, o Zot” etj.

³⁷² Shih më shumë: J. Rrota, *Sintaksi i shqipes, për klasat II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, 1942, f. 57.

Sa i përket vendit që zënë fjalitë e nënrenditura rrjedhimore, J. Rrota vëren se ato vendosen zakonisht pas fjalisë kryesore, por mund të gjenden dhe para saj³⁷³.

Në sintaksën e tij, S. Prifti, pasi thekson rëndësinë e rendit si një mjet i rëndësishëm për të shprehur lidhjet sintaksore në fjali, bën disa përgjithësime teorike, duke e parë rendin edhe nga ana funksionale. Edhe pse, siç vëren Prifti, lidhur me rendin e fjalëve në gjuhën shqipe nuk ka ndonjë studim të veçantë, autori është përpjekur të parashtrojë edhe disa rregulla për rendin e fjalëve dhe fjalive të nënrenditura.³⁷⁴ Me interes për ne është rregulla 11: “...Për sa u përket fjalive të varura, vendi i tyre në periudhë përcaktohet në tërësi nga pozita që ka pjesa e fjalisë nga varet. Kështu a) fjalitë ndajshtimore, fjalitë lidhore dhe pyetëse të zhdrejta rrinë rregullisht pas emrit apo pas foljes nga e cila varen. P. sh.: Thonë se në Mars ka jetë. etj. b) Fjalitë qëllimore dhe **rrjedhore** rrinë rregullisht pas foljes nga e cila varen, kurse fjalitë kushtore përpara fjalisë nga varen. P.sh.: U tremba, **sa u bëra dyllë**. ...”³⁷⁵

Për rendin e fjalisë së nënrenditur në periudhën **rrjedhimore** Prifti pohon se ajo “vitet rregullisht pas fjalisë nga varet, por rrallë për theksim, ajo mund të vitet edhe përpara dhe ndërmjet”³⁷⁶. Këtu ai sjell shembujt: 1) *Foli sa u lodh.* 2) *Ky m'i hiqte veshët, kur isha i vogël, sa më dhembin edhe sot.* 3) *Sa të shkëlqejë si dritë, do ta pastroj biçikletën.*³⁷⁷

Edhe Mahir Domi në tekstet e tij shkollorë³⁷⁸ flet për rendin e fjalëve dhe gjymtyrëve në fjali. Ai vë në dukje se ky rend mund të jetë i drejtë dhe i zhdrejtë.

Rendi i parë është rendi i zakonshëm: *kryefjalë - kallëzues - kundrinor - rrethanor* që karakterizon fjalitë dëftore dhe fjalitë pyetëse, të cilat e kanë të shprehur kryefjalën me përemër pyetës.

Sipas prof. Domit, në qoftë se në fjalitë pyetëse kryefjala nuk është përemër pyetës, ajo vendoset pas kallëzuesit, ndërsa kundrina mund të dalë përpara kallëzuesit a kryefjalës ose edhe në fillim të fjalisë. Rrethanorët, sipas tij, mund të vendosen në vende të ndryshme, në varësi të asaj që duam të theksojmë.

Më pas Mahir Domi trajton disa pjesë të fjalisë a fjalë, rendi i të cilave nuk ndryshon. Pra, bëhet fjalë për njësitë me rend të ngulitur dhe si të tilla profesor Domi përmend plotësit e dallimit³⁷⁹ (ai e përkufizon plotësin e dallimit si emrin a përemrin që përdoret për të përcaktuar një emër a përemër tjetër, për të kufizuar kuptimin e përgjithshëm të tij), të cilët vendosen zakonisht pas emrit ose përemrit që përcaktojnë. Plotësi i dallimit, vë në dukje prof. Domi, vjen përpara emrit që paracakton kur është përemër lidhor. Si fjalë me rend të ngulitur përmenden ndajfoljet mohore, të cilat vendosen gjithmonë para foljes ose parafjalët, që vendosen gjithmonë para emrit.

Fjalitë rrjedhimore, thekson Domi, vendosen pas fjalive që plotësojnë, si për shembull: *Shtegu i hapur në mes të borës ishte shumë i ngushtë, aqë sa dy veta nuk mund të kalonin andej krah për krah.*

³⁷³ Shih më shumë: J. Rrota, *Sintaksi i shqipes, për klasat II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, 1942, f. 89.

³⁷⁴ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë “Rilindja”, 1971.

³⁷⁵ Shih më shumë: S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë “Rilindja”, 1971, f. 29.

³⁷⁶ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë “Rilindja”, 1971, f. 420-421.

³⁷⁷ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë “Rilindja”, 1971, f. 421

³⁷⁸ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe Pjesa II, Sintaksa, Tekst për shkollën 7-vjeçare*, Tiranë, 1955; M.

Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa për shkollat e mesme*, Prishtinë, 1969; M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.

³⁷⁹ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe Pjesa II, Sintaksa, Tekst për shkollën 7-vjeçare*, Tiranë 1955, f. 82.

Për Domin, raportet rrjedhimore i gjejmë të shprehura edhe me një ndërtim - të cilin mund ta quajmë kalimtar - midis lidhjes sintetike dhe lidhjes asindetike. Në këtë rast, fjalia që tregon rrjedhimin vendoset përpara pa ndonjë lidhëz nënrenditjeje; fjalia tjetër vjen pas saj duke pasur në krye një ndajfolje, si *aq* dhe *kaq*: *Më vinte të flija aty në tavolinë, aq të këputur e ndjeja veten.*

Lidhur me pikësimin e periudhës me fjali të varur rrjedhimore, vëren autori, nuk ka një qëndrim të vetëm; disa studiues janë të mendimit se fjalitë e kësaj periudhe duhen ndarë me presje, kurse të tjerë mendojnë se nuk duhen ndarë. *Kur janë të gjata si fjalia drejtuese si fjalia rrjedhimore, del e nevojshme ndarja me presë*³⁸⁰, sugjeron ai.

Nga gjerësia dhe thellësia e trajtimit janë padyshim studimet e S. Floqit. Floqi në trajtesat e tij³⁸¹ thekson se studimi i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe ka rëndësi të madhe. Në artikullin *“Mbi një çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme”*³⁸², ai hedh poshtë tezën e studiuesit të huaj Klaus Hebler për karakterin e huazuar të rendit të fjalive kohore dhe lidhore në gjuhën shqipe³⁸³, si dhe kundërshton argumentet që mbrojnë këtë tezë. Duke bërë krahasimin me rendin e fjalëve në greqisht, Floqi hedh poshtë argumentet për huazimin e rendit të fjalëve në fjalitë lidhore të shqipes nga greqishtja.³⁸⁴

Duke kritikuar tezën e Heblerit, S. Floqi me të drejtë vë në dukje se vendosja e kallëzuesit pas mjetit lidhës në fjalitë kohore e përcaktore është e rëndomtë për gjuhën e përrallave³⁸⁵, se ky rend kushtëzohet nga gjymtyrëzimi aktual dhe përcaktohet nga veçoritë stilistike të kësaj gjinie, ku karakteristikë është veprimi dhe fjalitë e shkurtra. Kurse gjuha letrare, sipas tij, duke shprehur përmbajtje shumë më të thellë e më të gjithanshme, ka përpunuar forma më të ndërlikuara e më të larmishme të rendit të fjalëve.

Edhe pse përgjithësisht Floqi është përqendruar te rendi i gjymtyrëve në fjalitë kohore dhe lidhore, ai shtron edhe një sërë çështjesh teorike që kanë të bëjnë me rendin e gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura në përgjithësi e konkretisht:

³⁸⁰ M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 110.

³⁸¹ S. Floqi në *“Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme”*, Studime filologjike, Tiranë, 1969, Nr. 2; S. Floqi, *“Disa vrojtme për rendin e fjalive në periudhë”*, Studime filologjike, Tiranë, 1976, Nr. 3.

³⁸² S. Floqi në *“Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme”*, Studime filologjike, Tiranë, 1969, Nr. 2.

³⁸³ C. Haebler (në punimin e tij *“Eine albanische worstellungsregel”*, Munchener studien zur spracheissenschaft, 1957, Heft 11, f. 49-61, cituar nga S. Floqi në *“Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme”*, Studime filologjike, 1969, Nr. 2, f. 125-141) duke shqyrtuar një material të nxjerrë nga proza popullore, pohon se në gjuhën shqipe në fjalitë kohore dhe lidhore kallëzuesi vjen pas mjetit lidhës dhe e sheh këtë rend të ndikuar nga greqishtja.

³⁸⁴ S. Floqi, *Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1969, Nr. 2, f. 140: *“Prandaj greqishtja e re nuk ka mundësi të ketë ndikuar mbi rendin e fjalëve “kallëzues-kryefjalë” etj. te fjalitë e varura kohore dhe lidhore të shqipes, sepse dhe për vetë greqishten një rend i tillë nuk është i ngulitur, jo vetëm për gjithë tipat semantiko-strukturorë të periudhave me fjali të varura, por edhe përbrenda nëntipave të fjalive të varura kohore dhe lidhore.”*

³⁸⁵ S. Floqi, *Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1969, Nr. 2, f. 129: *“Në përrallat popullore shqiptare rendi i fjalëve ose vendi i kallëzuesit etj. është pikërisht ashtu siç thotë K. Hebleri, por në variantet e tjera stilistiko-gjinore të gjuhës shqipe, në gjuhën letrare të shkruar dhe të folur, rendi i fjalëve nuk është i fiksuar, është më i lirshëm.”*

1) Kur shqyrtohet rendi i fjalëve në fjalitë e nënrenditura, nuk duhet parë pozicioni i kallëzuesit ndaj mjetit lidhës, por pozicioni i gjymtyrëve kryesore dhe i gjymtyrëve të dyta, duke u nisur nga tipat më të thjeshtë *kryefjalë - kallëzues* deri tek tipat më të ndërlikuar. Pra, duhen parë të gjitha kombinimet e mundshme të gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur.

2) Rendi i gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur kushtëzohet nga tri arsye kryesore: a) nga arsye thjesht strukturore (në fjalitë përcaktore); b) nga arsye të peshës kumtesore të një gjymtyre a të një grupi gjymtyrësh gjatë zbërthimit aktual të fjalisë; c) nga nuancat e reja kuptimore që i mbishtohen kuptimit themelor të një tipi të caktuar periudhe me fjali të varur.

3) Në fjalitë lidhëzore pozicioni i kallëzuesit dhe i kryefjalës nuk ka varësi të drejtpërdrejtë me mjetin lidhës. Megjithatë, një palë lidhëza mund të ushtrojnë një ndikim të tërthortë mbi rendin e fjalëve nëpërmjet semantikës së tyre, siç janë lidhëzat rrjedhimore me prejardhje nga ndajfoljet, ndërsa lidhëzat filluese, të cilat janë të zbrazëta nga ana semantike, nuk e kanë këtë ndikim.

Në artikullin “*Disa vrojtme për rendin e fjalive në periudhë*”³⁸⁶ S. Floqi vëren se disa tipa periudhash kanë rend të ngulitur, kurse disa tipa të tjerë kanë rend të lirë. Ai arrin në përfundimet e mëposhtme:

1. Në periudhën me fjali të varur përcaktore, rendi i fjalisë së varur varet nga vendi i fjalës paraprijëse në fjalinë kryesore, pra ka pozicion të ngulur për arsye të strukturës.

2. Në raste të tjera pozicioni i fjalisë së varur është kushtëzuar për arsye të marrëdhënieve kuptimore, si te fjalia e varur rrjedhimore etj. ose për arsye të shprehjes së ndonjë nuance të veçantë të marrëdhënieve, si në rastin e ndonjë nëntipi të periudhës me fjali të nënrenditur shkakore ose të periudhës me fjali të nënrenditur qëllimore.

3. Rastet e vendosjes së vetë fjalisë kryesore në mes të së varurës kanë të bëjnë ose me ruajtjen në periudhë të rendit të fjalëve të fjalisë së pavarur (periudha vetëm me dy fjali), ose me pozicionin e mjetit lidhës (te periudhat me së paku tri fjali), i cili, si përemër ose ndajfolje lidhore që është, ka pozicion të caktuar. Këta dy tipa periudhash përmbajnë variante të ndërtimeve me fjali ndërmjetëse dhe janë një mjet i ri shprehës që krijojnë “fjali ndërmjetëse drejtuese” me të cilën lidhet një fjali e varur dhe jep mundësi për një ngjeshje më të madhe të shprehjes së mendimit.³⁸⁷

Siç u tha edhe më lart, Floqi u njeh fjalive të nënrenditura rrjedhimore vetëm rendin e prapavendosur. Pra, sipas tij, fjalia e nënrenditur *rrjedhimore* qëndron gjithmonë pas fjalisë kryesore. Floqi kundërshton mendimin e Rrotës, Priftit e Domit se fjalia e nënrenditur rrjedhimore mund të qëndrojë përpara fjalisë kryesore. Sipas tij, faktet gjuhësore të shqipes e hedhin poshtë një gjë të tillë.³⁸⁸

Në të njëjtën hulli me S. Floqin ecën dhe M. Totoni duke i thelluar dhe zgjeruar studimet mbi rendin. Në artikullin e tij “*Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura dhe problemi i ndikimit të greqishtes*”³⁸⁹ autori trajton jo vetëm probleme të rendit të gjymtyrëve në fjalitë përcaktore dhe kohore, por edhe në fjalitë e tjera të nënrenditura. Për Totonin, parimet dhe rregullat që ndjek Floqi janë në thelb të drejta dhe zbatimi i tyre do të jepte rezultate të

³⁸⁶ S. Floqi, *Disa vrojtme për rendin e fjalive në periudhë*, Studime filologjike, 1976, Nr. 3.

³⁸⁷ S. Floqi, *Disa vrojtme për rendin e fjalive në periudhë*, Studime filologjike, 1976, Nr. 3, f. 51-52.

³⁸⁸ Shih më shumë: S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2, f. 95-97.

³⁸⁹ M. Totoni, *Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura dhe problemi i ndikimit të greqishtes*, Kumtesë e mbajtur në seminarin për gjuhën dhe kulturën shqiptare, Tiranë, gusht-shtator 1997.

rëndësishme si në rrafshin sinkronik, ashtu edhe në rrafshin diakronik, por, sigurisht, sipas tij, ato mund të saktësohen dhe thellohen më tej³⁹⁰.

Ashtu si Floqi, edhe Totoni kundërshton tezën e Heblerit. Sipas Totonit, me të drejtë Floqi vë në dukje se vendosja e kallëzuesit pas mjetit lidhës në fjalitë kohore e në fjalitë përcaktore është e rëndomtë për gjininë e përrallës, se ky rend kushtëzohet nga gjymtyrëzimi aktual dhe përcaktohet nga veçoritë stilistike të kësaj gjinie, ku sundon veprimi dhe fjalitë e shkurtra, kryesisht foljore. Por nuk është e njëjta situatë në gjuhën letrare, e cila, duke shprehur përmbajtje shumë më të thellë e më të gjithanshme, ka përpunuar forma më të ndërlikuara e më të larmishme të rendit të fjalëve.

Edhe në mbështesim mendimin e Floqit dhe Totonit se në renditjen e gjymtyrëve të fjalisë së nënrenditur veprojnë rregullsi të shpjegueshme brenda shqipes dhe të kushtëzuara nga veçoritë morfologjike, sintaksore e stilistike të saj. Gjatë zhvillimit të saj gjuha shqipe ka shfrytëzuar e shfrytëzuar mjetet e veta të brendshme dhe nuk është ndikuar nga jashtë. Funkcioni kryesor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe, të paktën që nga Buzuku, është funksioni aktualizues-stilistik; renditja e gjymtyrëve në fjali bëhet sipas peshës që kanë në tërësinë e thënies që përmban një frazë. Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura, qoftë në gjuhën e folur e të përrallave, qoftë në stilet e ndryshme të gjuhës letrare, rregullohet në përshtatje me këtë funksion.

Hebleri do të kishte të drejtë, po të vërente shmangie nga ky rregullim, shmangie që do të ishin të ngjashme me rregullat specifike të renditjes së gjymtyrëve në greqisht. Por as njëra, as tjetra nuk është e vërtetë. Ngjashmëria në rendin e fjalëve të shqipes me greqishten nuk mund të mbahet si ndikim, meqë ky rend në gjuhën shqipe dokumentohet shumë më vonë se në greqisht. Nuk mund të quhet huazim një rend i caktuar ose edhe një gjedhe që është në përshtatje me rregullsitë e sotme të shqipes.³⁹¹

Risia që sjell Totoni është se rendin e ngulitur të kallëzuesit ai e argumenton me distribucionin që përcakton funksionin e ndryshëm të disa fjalëve si lidhëza ose si ndajfolje (si për shembull, **si, sa, tek, posa, nga** etj.) Ky rend i ngulitur i kallëzuesit pas këtyre fjalëve ka qenë i detyruar për të mënjeluar dykuptimësinë që mund të krijohej në raste të tjera.³⁹² Për sa i përket rendit të fjalive të nënrenditura në periudhën *rrjedhimore*, ashtu si Floqi, edhe M. Totoni thekson se fjalia e nënrenditur rrjedhimore ka rend të ngulitur pas fjalisë kryesore³⁹³.

R. Përnaska³⁹⁴ vë në dukje se rendi i gjymtyrëve është i lidhur ngushtë me perspektivën funksionale, me gjymtyrëzimin aktual. Ai flet për rend të drejtë, kur rendi është *kryefjalë + kallëzues foljor ose emëror; kallëzues + kundrinë; kallëzues + rrethanor* dhe rend të zhdrejtë, kur kemi, p.sh. *kallëzues foljor a emëror + kryefjalë*. Edhe ai thekson se funksioni themelor i

³⁹⁰ M. Totoni, *Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura dhe problemi i ndikimit të greqishtes*, Kumtesë e mbajtur në seminarin për gjuhën dhe kulturën shqiptare, Tiranë, gusht-shtator 1997, f. 642.

³⁹¹ M. Totoni, *Vepër e cituar*, f. 648-649.

³⁹² Shih më shumë: M. Totoni, *Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura dhe problemi i ndikimit të greqishtes*, Kumtesë e mbajtur në seminarin për gjuhën dhe kulturën shqiptare, Tiranë, gusht-shtator 1997, f. 643-644.

³⁹³ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Tiranë, 2012, f. 211.

³⁹⁴ R. Përnaska, *Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1979/1; R. Përnaska, *Trajtat e shkurtra dhe gjymtyrëzimi aktual në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1986/2; R. Përnaska, *Gjymtyrëzimi aktual dhe mjetet e shprehjes së tij në gjuhën shqipe* në "Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë", Nr. 16, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 1987.

rendit të gjymtyrëve në gjuhën shqipe ka të bëjë me gjymtyrëzimin aktual të thënies. Theksi logjik luan rol të madh në hetimin e gjymtyrëzimit aktual në organizimin e perspektivës funksionale, po një gjë e tillë, sipas tij, meriton një hulumtim të veçantë.³⁹⁵

Po në këtë artikull R. Përnaska përcakton edhe mjetet gjuhësore (leksikore dhe gramatikore) që shërbejnë për të shprehur zberthimin e thënies. Ndër to, përveç pyetjes që bëhet për të gjetur **remën**, përmenden edhe rendi i gjymtyrëve të fjalisë, intonacioni, emrat (sipas llojit, të përgjithshëm a të përveçëm, konkretë apo abstraktë), mbiemrat, përemrat e pacaktuar (**të gjithë, të tërë, diçka** etj.), pjesëzat (përforcuese-shtuese a veçuese, përcaktuese-saktësuese, mohore), disa ndërtime sintaksore të specializuara, trajta e emrit dhe trajtat e shkurtra të përemrave vetorë etj.

Një vend të veçantë i ka kushtuar dukurisë së rendit edhe Th. Rushi në punimet e tij³⁹⁶. Në artikullin “*Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore*”, autori trajton në mënyrë të zgjeruar çështje të rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore, duke folur lidhur me faktorët që kushtëzojnë rendin e gjymtyrëve në fjalinë e thjeshtë dëftore me kryefjalë, kallëzues dhe kundrinor të drejtë.³⁹⁷

Autori pohon se rendi i gjymtyrëve të fjalisë dëftore në gjuhën shqipe është i lirë, por kjo duhet kuptuar në mënyrë relative. Në raste të rralla, ky rend mund të jetë edhe i ngulitur: në fillim vendoset kryefjala, pas saj kallëzuesi e në fund kundrinori i drejtë. Lidhur me këtë të fundit, Th. Rushi përmend rastin e fjalive në të cilat kryefjala dhe kundrinori shprehen me forma të njëjta, që janë të përbashkëta për rasat emërore e kallëzore dhe ku mungojnë treguesit e tjerë gramatikorë, leksikorë dhe kontekstualë, të cilët mund të ndihmojnë për të përcaktuar funksionet e tyre³⁹⁸. Në këtë rast është rendi i gjymtyrëve që përcakton këtë funksion, pra që vendos se cila është kryefjala dhe cili është kundrinori i drejtë. Kësisoj, ai nxjerr në pah një nga rastet e funksionit sintaksor të rendit të fjalëve kur mungojnë treguesit e tjerë gramatikorë për ta kryer këtë funksion.

Funksion tjetër i rëndësishëm i rendit në gjuhën shqipe është ai që lidhet me gjymtyrëzimin aktual të fjalisë. Sipas tij, roli i rendit në këtë rast është se gjymtyra ose gjymtyrët që përbëjnë temën, vendosen në fillim të fjalisë; ndërsa, nga ana tjetër, gjymtyra ose gjymtyrët që bëjnë pjesë në remë vendosen në fund. Këtë funksion të rendit të fjalëve Th. Rushi e sheh të lidhur ngushtë edhe me intonacionin, sidomos me theksin logjik. Më pas Rushi paraqet rastet e rendit të gjymtyrëve në mënyrë skematike.

Në Gramatikën e Akademisë³⁹⁹ studimi i rendit është trajtuar më gjerësisht. Për rendin e gjymtyrëve në fjali në këtë vepër thuhet: “*Vendi i gjymtyrëve të fjalisë përcaktohet nga faktorë të ndryshëm: kryesisht nga gjymtyrëzimi aktual, nga arsyet stilistike dhe, më rrallë, nga funksioni i tyre sintaksor.*”⁴⁰⁰ Duke qenë se gjymtyrëzimi aktual përcakton edhe rendin e gjymtyrëve në fjali, ashtu sikurse mund të nisemi nga rendi i gjymtyrëve për të përcaktuar në

³⁹⁵ R. Përnaska, *Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1979/1, f. 158.

³⁹⁶ Th. Rushi, “*Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore*”, Studime filologjike, 1983/1; Th. Rushi, “*Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe*”, Studime filologjike, 1983/4; Th. Rushi, “*Rendi i gjymtyrëve të shkallës së dytë në gjuhën shqipe*”, Studime filologjike, 1988/1; Th. Rushi, “*Çështje të normës letrare në rendin e fjalëve në shqipen e sotme*”, Studime filologjike, 1985/1.

³⁹⁷ Th. Rushi, “*Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore*”, Studime filologjike, 1983/1, f. 46.

³⁹⁸ Th. Rushi, “*Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore*”, Studime filologjike, 1983/1, f. 29.

³⁹⁹ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997.

⁴⁰⁰ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 415.

fjali *temën* dhe *remën* e saj, në disa raste të ndihmuar edhe nga theksi logjik, që bie gjithnjë mbi *remën* dhe është shënjuar apo edhe nga tregues të tjerë si: pjesëzat përforcuese, veçuese e mohuese, përdorimi a mospërdorimi i trajtës së shkurtër të kallëzores, përdorimi i përemrave vetorë të vetës së parë e të dytë, trajta dhe kuptimi i emrave etj., më tej do të përdoret pikërisht terminologjia që ka të bëjë me gjymtyrëzimin aktual: *temë*, *remë*, *rend i drejtë* (*kryefjalë* + *kallëzues*, *kallëzues* + *kundrinë*, *kallëzues* + *rrethanor*), *rend i anasjellë* (*kallëzues* + *kryefjalë*, *kundrinë* + *kallëzues* etj.), *rendi neutral* (*temë* + *remë*) apo *rendi emfatik afektiv* (*remë* + *temë*).⁴⁰¹

Në këtë vepër vihet në dukje se fjalia *rrjedhimore* ka *rend* të ngulitur dhe fjalia e nënrenditur ndjek fjalinë kryesore, si për shembull: *Korridori qe mbushur plot, aq sa të zihej fryma nga vapa*. Kur disa fjali rrjedhimore kanë të bëjnë secila me gjymtyrë homogjene të fjalisë kryesore, gjithë të tjerat, përveç të fundit, hyjnë në mes të fjalisë kryesore: Në të hyrë të kooperativës ka një rrap të madh, të moçëm, *sa s' mbahet mend*, me një trung të trashë, *sa as dy vetë nuk mund ta pushtojnë dot*.⁴⁰²

Edhe ne jemi të mendimit se *rendi* i gjymtyrëve në fjali shihet dhe merret parasysh me synimin e përcaktimit të temës dhe të remës, që janë përkatësisht e njohura dhe e panjohura, e reja e thënies. Në këtë aspekt, kur të vështrojmë pozicionin e fjalisë së nënrenditur rrjedhimore në raport me fjalinë kryesore a drejtuese, do të marrim parasysh, sipas rastit, mjetet e lartpërmendura leksikore ose gramatikore që mund të na vijnë në ndihmë për të përcaktuar llojin e *rendit* të fjalisë së nënrenditur në periudhë.

Si përfundim, mund të themi se në gramatikat e studimet e shqipes është folur për *rendin*, edhe pse nuk ka gjetur trajtim të veçantë. Ajo që i bashkon këto trajtime ka të bëjë me funksionet kryesore të *rendit* të fjalëve dhe gjymtyrëve në fjali, *rendi* relativisht i lirë i fjalëve dhe gjymtyrëve në gjuhën shqipe, lidhja e *rendit* me gjymtyrëzimin aktual dhe ngarkesën emocionale të një ndërtimi të caktuar, ndikimi i tipit të fjalisë sipas kumtimit që përcjell, si dhe rimarrja ose jo e kundrinës me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në ndërtime të caktuara në varësi të *rendit*.

Është i drejtë dallimi *rend i drejtë* (*kryefjalë* + *kallëzues*, *kallëzues* + *kundrinë*, *kallëzues* + *rrethanor*) dhe *rend i anasjellë* (*kallëzues* + *kryefjalë*, *kundrinë* + *kallëzues* etj.) nga njëra anë dhe *rend neutral* (*temë* + *remë*) apo *rendi emfatik afektiv* (*remë* + *temë*) nga ana tjetër. Në të dy termat jemi në rrafshin funksional të analizës së fjalisë, pra kemi të bëjmë me *renditjen* e gjymtyrëve funksionale të fjalisë: kryefjalë, kallëzues, kundrinor e kështu me radhë. Në rastin e dytë jemi në rrafshin e gjymtyrëzimit aktual të fjalisë në diçka të njohur dhe të panjohur, pra kemi të bëjmë me rrafshin e komunikimit.

Është pranuar përgjithësisht se në gjuhën shqipe *rendi* është relativisht i lirë, pra gjymtyrët mund të vendosen në pozicione të ndryshme pa ndryshuar funksionin e tyre sintaksor.

Rendi relativisht i lirë i gjymtyrëve në fjali duket se është një karakteristikë e përgjithshme e gjuhës shqipe, e cila ka një eptim të zhvilluar, prandaj përgjithësisht *rendi* nuk luan ndonjë rol të veçantë në aspektin sintaksor apo kuptimor të fjalisë a të periudhës në tërësi. Edhe E. Çabej lidhur me topikën e fjalëve në fjali niset gjuhësisht nga parimi i drejtë se, sa më e pasur të jetë një gjuhë në sistemin e eptimit (fleksionit), aq më e lirë është topika e fjalëve në fjali. Dhe,

⁴⁰¹ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 414.

⁴⁰² Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 578.

anasjelltas, sa më i varfër është eptimi, aq më e shtrënguar, më e detyrueshme, më e ngulët është topika. Si shembull ai merr shprehjen latine: *Civis diligit patriam* (Qytetari do atdheun). Sipas autorit, këtu është e qartë që *civis* është një emërore dhe *patriam* një kallëzore.

Edhe nëse përmbysset kjo topikë: *Patriam civis diligit*, kuptimi nuk ndryshon.⁴⁰³

Këtu dallon ai gjuhët balto-sllave, që kanë një eptim shumë më të pasur, e më pas, sipas tij, vjen gjuha shqipe etj.

Lidhur me prirjen e përgjithshme të shqipes për paravendosje të kallëzuesit ndaj kryefjalës, Çabej, duke bërë krahasime me gjuhë të tjera, thotë: “*Në gjuhët e vjetra indoeuropiane fjala që bart kuptimin kryesor zakonisht vihet në krye. Greqishtja e vjetër ka një tendencë që foljen ta vejë në mjedis të fjalisë, ndërsa shqipja para kryefjalës, pra shpeshherë në krye të fjalisë*”. Këtë konstatim për shqipen ai e mbështet nga gjuhëtari grek F. Kieckero, i cili flet edhe për rendin e fjalëve të gjuhës shqipe, në bleun e katërt të Gramatikës historike të greqishtes, si edhe nga studiuesi austriak Wolfgang Dresler, që ka vënë në dukje se shqipja ka prirje ta vërë foljen shpeshherë para kryefjalës.⁴⁰⁴

Sipas E. Çabejt, në gjuhën e folur, për dallim nga gjuha e shkruar, topika mund të jetë më e lirë, pasi në të folur mund të theksojmë fjalën kryesore, t’i japim një ton më të fortë, pra e ka intonacionin e vet si element që nuk është i pranishëm në gjuhën e shkruar. Prandaj kjo e fundit ka tendencë më të madhe për fiksimit të topikës.⁴⁰⁵

Lidhur me rendin e gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura rrjedhimore, mund të thuhet se nuk ka gjetur ndonjë trajtim të veçantë në gramatikat apo studimet për gjuhën shqipe, ndërsa rendi i fjalive përbërëse të periudhës rrjedhimore është vështruar në kuadrin e studimit të rendit në përgjithësi. Në to është pohuar se rendi i fjalive në periudhën me nënrenditje **rrjedhimore** është përgjithësisht i ngulitur, fjalia e nënrenditur pason fjalinë kryesore, duke iu përgjigjur rendit të gjërave në realitetin jashtëgjuhësor, ku shkaku ose fakti vjen përpara pasojës a rrjedhimit.

5.2 Rendi i gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore në prozën popullore

Në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën nënrenditëse **sa** në prozën popullore spikatin këto mënyra të renditjes së gjymtyrëve të fjalisë në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore:

Lidhëz + kryefjalë + kallëzues:

⁴⁰³ E. Çabej, *Hyrje në Indoeuropeanistikë, Leksionet e Prishtinës*, Botimet Çabej, Tiranë, 2008, f. 223-224.

⁴⁰⁴ E. Çabej, *Hyrje në Indoeuropeanistikë, Leksionet e Prishtinës*, Botimet Çabej, Tiranë, 2008, f. 224.

⁴⁰⁵ E. Çabej, *Studime gjuhësore VI*, Prishtinë, 1976, f. 125.

Fiteējmi ishte shoumë i madh, **sa** paret neëjsën me i grambëlloue në vizme të kaves, se s'i meëjrshin arkat.

(Proza popullore II, f. 124)

Lidhëz + kallëzues + kryefjalë:

...Edhe arapi me djalë lëftojën me palla, **sa** u thienë të dia pallat.

(Proza popullore II, f. 296)

Mas pak kohë u nis një gjamë e madhe, **sa** shungulloi pylli gjithë...

(Proza popullore VI, f. 117)

Lidhëz + kallëzues + kryefjalë + kundrinor i zhdrejtë:

Filloi me u toundë dinjaja prej tërmetit, **sa** u hini linxhira të xhithëve.

(Proza popullore II, f. 20)

Lidhëz + kallëzues + kryefjalë + përcaktor:

Mas pak kohë u nis një gjamë e madhe, **sa** shungulloi pylli gjithë...

(Proza popullore VI, f. 117)

Lidhëz + përcaktor + kryefjalë + kallëzues + përcaktor:

Kur pa se shërbëtorët i kishin thënë të vërtetën uluriti, **sa** gjithi shpia kumboi e u shkund.

(Proza popullore VI, f. 67)

Lidhëz + kallëzues në formën mohore:

Gjeti atie për çudi një kapë, që posa e vu mbë kryet humbi nga syt' e s'ëmës, **sa** nuk shihej me sy.

(Proza popullore I, f. 171)

Në periudhat me lidhëzën **sa**, ndonjëherë mes lidhëzës nënrenditëse dhe fjalisë së nënrenditur mund të futet ndonjë pjesëz.

Lidhëz + pjesëz + kallëzues + kundrinor i drejtë:

Prandaj u tremb ajo, **sa** ment harrohej friket.

(Proza popullore I, f. 173)

Lidhëz + kundrinor i drejtë (shprehur me trajtë të shkurtër + kallëzues në formën mohore:

Merr një skop e në at idhnim ta rreh e ta rreh, **sa** s'e mbyt.

(Proza popullore IV, f. 354)

Lidhëz + kallëzues i shprehur me folje në formën mohore + kryefjalë:

Ay kish me vetëhe rrusht' e bardhë, të shtypur e të gatuar si të lym, **sa** të mos njiheshin ata seç ishin...

(Proza popullore I, f. 287)

Siç mund të shihet nga shembujt e sjellë më sipër, në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën **sa**, rendi i gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore është i lirë dhe nuk ka asnjë kushtëzim nga lidhëza **sa**; ai është i lirë për të gjitha gjymtyrët dhe kushtëzohet vetëm nga gjymtyrëzimi aktual.

Kryefjala ose kallëzuesi mund të vendosen lirisht pas lidhëzës herë njëri, herë tjetri, sipas peshës kumtuese në fjali.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore korrelative me lidhëzën **sa**. Kryefjala ose kallëzuesi mund të vendosen lirisht pas lidhëzës.

Lidhëz + kryefjalë + kallëzues në mohore:

Hangrën **aq** lehtë, **sa** miku nuk u ngop aspak.

(Proza popullore V, f. 126)

...Ishte **aq** e bukur kjo Marua, **sa** mbretit i mbetën sytë.

(Proza popullore III, f. 49)

Lidhëz + kallëzues + kryefjalë + rrethanor sasie:

Ani kur i vate diali, e pritën të gjithë të mëdhenjt e pallatit, sa edhe ajo vetë me **aqë** nder, e me **aqë** kashkariqe, **sa** u kënaq ay tepër.

(Proza popullore I, f. 172)

Lidhëz + kundrinor i zhdrejtë + kallëzues:

Pas pak, u vjen e u del përpara një grua **aqë** e shëmtuar, **sa** atyre u hyri një drithmë në shpirt e mezi qëndronin.

(Proza popullore VI, f. 64)

Në këtë rast kryefjala në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore është e pashprehur.

Lidhëz + kundrinor i drejtë (i shprehur me trajtë të shkurtër) + kallëzues + kryefjalë + kundrinor i zhdrejtë:

Me këto të këqia pra i hyri një ah kaq i madh djalit, **sa** i u mërzi vetëheja atij...

(Proza popullore I, f. 173)

Lidhëz + kundrinor i drejtë + kallëzues:

Dy vëllazër kishin një motër që e duanin **kaqë** fort, **sa** çdo që u lypënte, s'ja kursenin.

(Proza popullore I, f. 130)

Lidhëz + kundrinor i drejtë (i shprehur me trajtë të shkurtër) + kallëzues + kryefjalë:

Sufra bëri bujë të madhe, **sa** e muarre vesh të gjithë.

(Proza popullore VI, f. 285)

Lidhëz + kallëzues + rrethanor vendi:

Ajo u tremb **aç** shoumë e bërteëjti **aç** fort, **sa** i duëlën prej goje disa xharpij.

(Proza popullore II, f. 30)

Atere xhandërmatë i vuunë drunë e e raftën **aç** fort, **sa** s'oun ngrëjshite pi vendit.

(Proza popullore II, f. 77)

Në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore korrelative me lidhëzën **sa**, ndonjëherë mes lidhëzës nënrenditëse dhe fjalisë së nënrenditur mund të futet ndonjë trajtë e shkurtër kundrinori (sidomos të drejtë) apo ndonjë pjesëz mohuese.

- Tuë shkouë oudhës u poç me një qetër ç'i peënte **aç** shoumë ujë, **sa** e thante një gjol të tanë me një të theëjthun.

(Proza popullore 2, f. 19)

Nga tiatra anë urinë e kish **aqë** të madhe, **sa** s'duronte dot pa ngrënë.

(Proza popullore I, f. 173)

Aq shumë ish qepur nga pas, **sa** nuk dinej ku të futej e ku të fshihej.

(Proza popullore VI, f. 34)

Epo djali, kur u nkthye prapë te plaka, me gjith'ato që pësoi te cupa, ishte **kaq** i pikëlluar e **kaq** i ndezur për të vajtur përsëri atje, **sa** nuk mbahej dot.

(Proza popullore I, f. 170)

Në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën nënrenditëse rrjedhimore **saqë** kemi vënë re këto mënyra të renditjes së gjymtyrëve të fjalisë në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore:

Lidhëz + kryefjalë + kallëzues:

Pjakat iu vunë **aq** fort nanës se djalit që ta shifnin atë kutinë e vogël, **saqë** kjo u gabu dhe e hapi.

(Proza popullore VI, f.103)

Lidhëz + kryefjalë + kallëzues + kundrinor i drejtë:

Sapo e odhi këtë në det, filloi të bënte një dallgë dhe një furtunë e madhe, **saqë** vapori humbi drejtimin e nuk dinte nga t'ja mbante...

(Proza popullore IV, f. 426)

Lidhëz + kallëzues + kundrinor i drejtë:

...edhe e gërgufi fytyrën e trupin **sa qi** më të shti bubaraqën.

(Proza popullore VI, f. 54)

Lidhëz + kallëzues + kundrinor i drejtë + përcaktor:

Mbreti, me pasurinë që kish, ndërtoi një xhami të bukur, **sa që** habiti tërë popullin e qitetit.

(Proza popullore I, f. 393)

Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e renditura me këtë lidhëz është i lirë për të gjitha gjymtyrët.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për periudhat me fjali të nënrenditur korrelative me këtë lidhëz, ku spikatin këto mënyra të renditjes së gjymtyrëve të fjalisë në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore:

Lidhëz + kryefjalë + kallëzues:

Pjakat iu vunë **aq** fort nonës së djalit qi të shifshin atë kutinë e vogël, **saqi** kjo u gabu edhe e hapi.

(Proza popullore VI, f. 103)

Lidhëz + rrethanor vendi + kallëzues emëror:

Edhe ish kanë **aq** e hijshme, **saqë** në atë sheher nuk kish pasë shoqe.

(Proza popullore VI, f. 170)

Lidhëz + rrethanor kohe (i shprehur me togfjalësh) + kallëzues + rrethanor mënyre:

...Po e donte **kaq** shumë djalin babai, **saqë** çdo saba ngrihesh pa larë sitë, pa ngrënë, pa pirë dhe vente i puthte të di sitë djalit.

(Proza popullore IV, f. 277)

Siç mund ta shohim, edhe në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore korrelative me lidhëzën **saqë** rendi i gjymtyrëve në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore është i lirë. Ai nuk kushtëzohet nga lidhëza.

Edhe në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore, ku fjalitë bashkohen me lidhëzën nënrenditëse **që**, rendi i fjalëve në fjalinë e nënrenditur del në përgjithësi i lirë. Paraqiten këto mënyra të renditjes së gjymtyrëve të fjalisë në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore:

Lidhëz + kryefjalë + kallëzues + rrethanor vendi:

Atje gjenë një lum shumë të madh: ai lum kish një urë me di fletë, **që** njëra fletë varej nga kjo anë e lumit dhe tjetra matan.

(Proza popullore I, f. 297)

Lidhëz + kallëzues + kryefjalë:

Po pusi nuk ish shumë i thellë me uj, **që** të mbitej djali...

(Proza popullore V, f. 312)

Lidhëz + kundrinor i drejtë (i shprehur me trajtë të shkurtër) + kallëzuesor + rrethanor vendi:

Aq t' bukur e kishte, **qi** e mante myllë në 12 oda.

(Proza popullore IV, f. 233)

Lidhëz + kallëzues në mohore + kryefjalë + rrethanor vendi:

Atje nek ai vendi ishin dyzet hajdutë edhe atë vend e kishnë zaptuar, **që** nuk shkonej nonjë njeri andej.

(Proza popullore I, f. 327)

*Ti më bën njimilë, po unë të bij dimilë **që** të mos gjendet nishani asgjëkunt.*

(Proza popullore I, f. 396)

Në ndërtimet **me forma të pashtjelluara** që shprehin raporte rrjedhimore, nga shembujt e mbledhur del se fjalia e nënrenditur fillon me formën e pashtjelluar foljore që është zakonisht një paskajore e tipit *me + pjesoren e foljes*, që përdoret në vend të lidhores dhe pjesores së foljes:

*Mbas do kohe po nis Katallani me vikatë në kupë të qiellit, **që** me tu dridhë shtati.*

(Proza popullore II, f. 250)

*Ai kish pasë një breshkë, prej asaj breshkës i kishte dalë një nuse e bukur **qi** me t'lanë hajran, po tash si e bajmë me e mytë?*

(Proza popullore III, f. 440)

Në periudhat me fjali të nënrenditur rrjedhimore me lidhëzën nënrenditëse rrjedhimore **kështu që** në prozën popullore kemi vënë re këto mënyra të renditjes së gjymtyrëve të fjalisë në fjalinë e nënrenditur rrjedhimore:

Lidhëz + kallëzues (shprehur me folje në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore, në formën pohore) + kryefjalë:

*I shtron plaka butë e e mblon butë e për gjith ditë i bjen thupër shpinës, por vetëm në të paren ditë i qiti një pare, pse ndër dit tjera s'i qiti veç hardhuca, gjarprinj e cofina; **kështu qi** u disprue plaka, mbyti micën e vetë plasi prej idhnimit.*

(Proza popullore I, f. 93)

*Kah mbramje u pret të gjithave buzën e sipërme e u then nga një kambë, **kështu që** dukeshin dhitë, sikur ishin tue qeshë e tue kërcye.*

(Proza popullore VI, f. 108)

Fjalia e nënrenditur rrjedhimore është e prapavendosur.

Lidhëz + kryefjalë + rrethanor kohe + kallëzues + kundrinor me paraafjalë:

Kur arriti djali në shtëpinë e tij, kishin kaluar tre vjet, tre muaj dhe tre ditë, **kështu që** vajza atë ditë ishte martuar me një tjetër.

(Proza popullore VI, f. 95)

Fjalja e nënrenditur rrjedhimore është e prapavendosur.

Lidhëz + kallëzues + rrethanasor vendi:

Do i them popullit që “ja e shihni vetë qi ki s’di gjë dhe s’bën për prift”, **kështu që** të iki këtej dhe ne të kem edhe ca kohë punë.

(Proza popullore VI, f. 409)

Fjalja e nënrenditur rrjedhimore është e prapavendosur.

Lidhëz + kundrinor i zhdrejtë + kallëzues + kundrinor i drejtë:

Më në fund dolli edhe mbreti t’i në grikë të graves; ndenji pak e i percolli gjilpinjte **kështu që** u hamnë e muarre dunjane.

(Proza popullore VI, f. 166)

Fjalja e nënrenditur rrjedhimore është e prapavendosur.

Në periudhat me lokucionin lidhëzor **kështu që**, ndonjëherë mes lidhëzës nënrenditëse dhe fjalisë së nënrenditur mund të futet ndonjë trajtë e shkurtër kundrinori:

Djali vehet me kujdes me i ba punët e shpisë, tuj shi e tuj dlië, **kështu qi** u jinë në hatër....

(Proza popullore VI, f. 200)

Siç mund të vihet re nga shembujt e sjellë më sipër për këtë lidhëz, rendi i gjymtyrëve nuk ka ndonjë kushtëzim nga lidhëza, ai është i lirë për të gjitha gjymtyrët dhe kushtëzohet vetëm nga gjymtyrëzimi aktual.

5.3 Rendi i fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore

Si në gjuhën e sotme letrare, ashtu edhe në prozën popullore rendi i zakonshëm i fjalive të nënrenditura rrjedhimore është pas fjalisë kryesore; fjalia e nënrenditur ndjek fjalinë kryesore, shkaku i prin pasojës⁴⁰⁶:

Erdh' i hyri ky dëshir sa zuri të shtrëngonjë të vëllazërit nat e ditë për të marrë një çupë.

(Proza popullore I, f. 130)

Masanej skilja shkoi në pyll, aty ku ishte mjalti ene u ngop mir' e mirë saqi nuk deshti ma ene u kthye prap erth te ujku.

(Proza popullore I, f. 48)

Fjalitë rrjedhimore të tipit jo të bashkëlidhur (jokorrelative) me lidhëzat **sa**, **aq sa**, **saqë**, **kështu që**, **që** si në gjuhën standarde, ashtu dhe në prozën popullore dalin me rend të ngulitur, të prapavendosur.

Ay kish me vetëhe rrusht' e bardhë, të shtypur e të gatuar si të lym, sa të mos njiheshin ata seç ishin.

(Proza popullore I, f. 174)

Në një kohë të shkurter jeta e princshës u lidh ngusht me jetën e djalit, aq sa as ajo as ay s'mund të rronin larg njëri-tjetrit.

(Proza popullore VI, f. 92)

Sapo e odhi këtë në det, filloi të bënte një dallgë dhe një furtunë e madhe, saqë vapori humbi drejtimin e nuk dinte nga t'ja mbante...

(Proza popullore IV, f. 426)

Më në fund dolli edhe mbreti t'i në griqë të graves; ndenji pak e i percolli gjilpinjte, kështu që u hamnë e muarre dunjane.

(Proza popullore VI, f. 166)

⁴⁰⁶ Në analizën që u është bërë shembujve të ndryshëm me lidhëza të ndryshme, periudhat me fjali të nënrenditura rrjedhimore, të marra si shembuj, janë analizuar herë një nga një ose herë janë grupuar në bazë të të përbashkëtave.

*I shtron plaka butë e e mblon butë e për gjith ditë i bjen thupër shpinës, por vetëm në të paren ditë i qiti një pare, pse ndër dit tjera s'i qiti veç hardhuca, gjarprinj e coftina; **kështu qi** u disprue plaka, mbyti micën e vetë plasi prej idhnimit.*

(Proza popullore I, f. 93)

*Në at gjol jetonte një gërshetë, **qi** gjë ma e bukur se ajo nuk ishte n'u pa mbi ftyrë të tokës.*

(Proza popullore II, f. 138)

*Mbas do kohe po nis Katallani me vikatë në kupë të qiellit, **që** me tu dridhë shtati.*

(Proza popullore II, f. 250)

*- More vllazën, u tha - sa herë qi i çoj delet në kullotë, kam për të parë në një gjol të madh një grua të hishme, **qi** kurrkuni shoqja nuk mund i gjendej.*

(Proza popullore II, f. 138)

Njësoj është rendi i fjalive edhe në periudhat me fjali të nënrenditur me përemrin lidhor **që**:

*Ama kishte një kalë **ç'i** s'ja xhinje shokun.*

(Proza popullore II, f. 21)

*Djali dhe vajza ishen të bukur, **që** shokë s'kishin në faqe të dheut.*

(Proza popullore VI, f. 148)

Në prozën popullore, ashtu si edhe në gjuhën standarde, fjalitë rrjedhimore të tipit të bashkëlidhur (korrelativ) me lidhëzat *sa, aq sa, që*, të cilat marrin fjalë korrelative, rëndom vijnë pas kryesores.

***Aq** shumë ish qepur nga pas, **sa** nuk dinej ku të futej e ku të fshihej.*

(Proza popullore VI, f. 34)

*Thirr në dhe të tre vëllazënit dhe iu afruan Lubisë që gërriste **aq** shumë **sa** të këlliste datkën.*

(Proza popullore VI, f. 67)

Siç vërehet në *Gramatikën e Akademisë*,⁴⁰⁷ në periudhën rrjedhimore jokorrelative me lidhëzën **që**, rendi i prapavendosur kushtëzohet nga marrëdhëniet kuptimore midis fjalive të periudhës. Në këtë rast rendi është i ngulitur dhe i kushtëzuar nga nevoja për të shprehur një marrëdhënie të caktuar. Për shembull, me foljen-kallëzues në lidhore, fjalia e nënrenditur

⁴⁰⁷ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002.

rrjedhimore me lidhëzën **që** mbart tipare të fjalisë qëllimore, për shkak se këto fjali kanë të njëjtën strukturë.

Kështu, me fjalitë qëllimore mund të krijohet dykuptimësi. Fjalja mund të marrë dy vlera të ndryshme, një vlerë qëllimore dhe një vlerë rrjedhimore sipas rendit të paravendosur a të prapavendosur që zë në periudhë. Në periudhën “Del si laskënder pazari, **që** të tallen bota me ty”⁴⁰⁸, fjalia e prapavendosur nuk tregon qëllim, por të tallurit është një rrjedhim objektiv i faktit që ai ose ajo për të cilën bëhet fjalë del në pazar i/e veshur keq.

Në këtë rast fjalia e nënrenditur, e cila ndjek gjithmonë fjalinë kryesore, tregon rrjedhimin e sasisë së madhe të sendeve, të sasisë së madhe të cilësisë, të sasisë së madhe të tiparit të foljes, si *korrelat + emër*:

*I thotë djali, “që unë jam një djal’ i varfër, s’kam takat me zotërinë tënde, **që** të marr vajzën tënde”.*

(Proza popullore I, f. 323)

Fjalja e nënrenditur i referohet tërë togfjalëshit, pra nuk lidhet drejtpërdrejt me këto ndajfolje.

Fjalja e nënrenditur rrjedhimore në më të shumtën e rasteve ndodhet në periudha dykryegjymtyrëshe, domethënë në periudha që ndërtohen nga fjalia kryesore dhe fjalia e varur:

*Kishin qenë fukara tepër, **sa** me nxejë mbaheshin.*

(Proza popullore VI, f. 35)

*Filloi me u toundë dinjaja prej tërmetit, **sa** u hini linxhira të xhithëve.*

(Proza popullore II, f. 20)

*Në at gjol jetonte një gërshetë, **qi** gjë ma e bukur se ajo nuk ishte n’u pa mbi ftyrë të tokës.*

(Proza popullore II, f. 138)

Krahas këtyre ndërtimeve, fjalia e nënrenditur rrjedhimore përdoret dendur edhe në periudha shumëgjymtyrëshe, ku, veç fjalisë së nënrenditur rrjedhimore, hyjnë në lidhje dhe marrëdhënie edhe fjali të tjera me të njëjtat raporte sintaksore apo dhe me raporte të tjera.

*Aq e lumtur ishte e Bukura e Dheut, **sa**, kur u kthye plaka nesret, i flet kjo e para.*

(Proza popullore VI, f. 59)

Në rastin e mësipërm, fjalia e nënrenditur vendoset në mes të një fjalie kohore.

⁴⁰⁸ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë, 2002, f. 435.

Në mjaft raste në një periudhë mund të vijnë njëra pas tjetrës dy a më shumë fjali të varura rrjedhimore, që varen po nga ajo fjali kryesore dhe janë të bashkërenditura homogjene.

Fjalitë e bashkë-nënrenditura nga e njëjta gjymtyrë e fjalisë kryesore vendosen njëra pas tjetrës:

*Me këto të këqia pra i hyri një ah **kaq** i madh djalit, **sa** i u mërzi vetëheja atij, e s'e donte më të gjallët.*

(Proza popullore I, f. 173)

*Aq shumë i ish qepur nga pas, **sa** nuk dinej ku të futej e ku të fshihej.*

(Proza popullore VI, f. 34)

Fjalitë e bashkë-nënrenditura janë të bashkuara midis tyre me lidhëza bashkë-nënrenditëse; lidhëza nënrenditëse e rrjedhimit përdoret vetëm një herë dhe nuk përsëritet përpara fjalive të tjera rrjedhimore:

*Po en e ema e Kanberit qau **aq** shoumë, **sa** u qorouë seëjsh e nuk sheëjfte ma.*

(Proza popullore I, f. 124)

Nga sa u trajtua më sipër, mund të thuhet se rendi i zakonshëm i fjalive të nënrenditura rrjedhimore edhe në prozën popullore është pas fjalisë kryesore. Ky rend i ngulitur i fjalive në periudhë kushtëzohet nga rrjedha logjike e ngjarjeve të paraqitura në të dyja fjalitë e periudhës. Dihet se çdo shkak ka një pasojë, rrjedhim, përfundim, i cili rrjedhimisht vjen pas shkakut. Fjalitë e nënrenditur rrjedhimore del si rrjedhim, përfundim, përmbyllje e asaj që thuhet në fjalinë kryesore. Këtu rendi nuk mund të ndryshohet, sepse marrëdhëniet janë të renditura në rendin **shkak - rrjedhim**, kështu që rrjedhimi mund të realizohet vetëm nëse realizohet shkak. Fjalitë e nënrenditur rrjedhimore vjen pas fjalisë kryesore.

a. *Ishte **aq** e bukur kjo Marua, **sa** mbretit i mbetën sytë.*

(Proza popullore III, f. 49)

b.*⁴⁰⁹ sa mbretit i mbetën sytë, aq e bukur ishte Marua.

Një kufizim i tillë shpjegohet duke zbatuar parimin ikonoik, në bazë të të cilit fjalitë e nënrenditur rrjedhimore do të pasqyrojnë në mënyrë ikonoike pasardhjen kronologjike të rrjedhojës.

Pamundësia për t'ia paravendosur fjalitë e nënrenditura rrjedhimore fjalisë kryesore a drejtuese përcakton edhe *gjymtyrëzimin aktual të fjalisë*, ku fjalitë e nënrenditura rrjedhimore

⁴⁰⁹ * jo gramatikore.

janë **remë** e thënies, kështu që do të prireshin të vendoseshin pas **temës**, domethënë pas fjalisë kryesore a drejtuese.

Kësisoj, pamundësia për t'ia paravendosur fjalinë e nënrenditur rrjedhimore fjalisë kryesore lidhet me ndërtimin e veçantë “*diptik*” të fjalive të formësuara nga *fjali kryesore + fjali e nënrenditur rrjedhimore*. Fjalja e nënrenditur rrjedhimore është, në fakt, përbërësja e dytë e një ndërtimi korrelativ.

Në fjalitë jokorrelative rendi i anasjellë është i pamundur nga prania e një lidhëze (*kështu që* etj.) Ndaj, fjalja e nënrenditur rrjedhimore e tipit jo të bashkëlidhur (jokorrelativ) ka rend të ngulitur: fjalja e nënrenditur vjen pas fjalisë kryesore.

Që pasvënia e detyrueshme e fjalive të nënrenditura rrjedhimore varet nga një faktor sintaksor, duket se provohet prej faktit që rastet e rralla të inversionit ndikojnë gjithnjë në fjalitë rrjedhimore jo korrelative me mbivendosjen, si në fjalinë që vijon:

Hanin si ujq dhe nuk ishte e mundur as t'u shërbeje sipas rregullit, aq shumë ishin të padurueshëm e trazues.

Në fjalinë e mësipërme rrjedhimi i pararend shkakut, por mes dy përbërësve nuk përcaktohet ndërlidhja, që në vend të kësaj kundërdallon një fjali të nënrenditur rrjedhimore të veçantë (Ishin shumë të padurueshëm e trazues, sa nuk ishte e mundur as t'u shërbeje në rregull).

Po të kemi parasysh edhe faktin se rendi i prapavendosur i fjalive të nënrenditura është më i zakonshëm edhe në gjuhën letrare, atëherë dalim në përfundimin se vendosja pas fjalisë kryesore është një dukuri e përgjithshme për gjuhën në tërësi.

Edhe pse nuk kemi ndeshur në prozën popullore ndonjë rast të paravendosjes së fjalisë së nënrenditur rrjedhimore, ne mendojmë se, meqë gjuha nuk është një kopje e zbehtë e realitetit, ndonjëherë ky rend mund të jetë i ndryshëm.

KREU VI

VËSHTRIM KRAHASUES I NDËRTIMEVE RRJEDHIMORE NË GJUHË TË NDRYSHME

Në dy-tre dhjetëvjeçarët e fundit gjuhëtarët u kanë kushtuar vëmendje të madhe mënyrave dhe mjeteve të ndryshme të shprehjes së rrjedhimit, veçanërisht në anglisht e në gjuhë të tjera gjermanike, por edhe në gjuhët neolatine e në gjuhët sllave, si edhe në kinezishte, japonishte, koreanishte etj. [Shiko, ndër shumë të tjerë, Dowty⁴¹⁰, Simpson⁴¹¹, Hoekstra⁴¹², Nedjalkov⁴¹³, Talmy⁴¹⁴, Carrier e Randall⁴¹⁵, Napoli⁴¹⁶, Goldberg⁴¹⁷, Levin e Rappaport Hovav⁴¹⁸, Wechsler⁴¹⁹, Rappaport Hovav e Levin⁴²⁰, Boas⁴²¹ dhe Goldberg e Jackendoff⁴²².]

Fjalitë rrjedhimore janë të zakonshme në shumicën e gjuhëve, por këto gjuhë e konceptualizojnë kuptimin e rrjedhimit në mënyra të ndryshme, ndaj ka si ngjashmëri, ashtu edhe dallime qoftë ndërmjet familjeve të ndryshme gjuhësore, qoftë edhe brenda së njëjtës familje. Kjo është e vërtetë sidomos sa u përket gjuhëve që fliten jashtë kontinentit euroaziatik, por edhe për gjuhë brenda këtij areali, duke përfshirë këtu edhe shqipen.

Megjithatë, fjala e fundit ende nuk është thënë e ka, nga ana tjetër, edhe shumë gjuhë të tjera ku këto mjete e mënyra ende nuk janë studiuar sa duhet, duke përfshirë këtu edhe shqipen. Do të nisim me një tipologji të shkurtër të këtyre fjalive në gjuhë të ndryshme, duke u ndalur veçanërisht me një përshkrim të tyre në anglisht (si gjuhë ndërkombëtare, por edhe si gjuha e parë me të cilën shqipja përballet sot në çdo çast dhe në çdo fushë të jetës shkencore, ekonomike, kulturore, politike, ushtarake etj.); do të japim edhe disa sugjerime që i

⁴¹⁰ Dowty, D. R. (1979), *Word Meaning and Montague Grammar*. Dordrecht: Reidel.

⁴¹¹ Simpson, J. (1983), "Resultatives". Në L. Levin, M. Rappaport, A. Zaenen (redaktorë). *Papers in Lexical-Functional Grammar*. Bloomington: Indiana University Linguistics Club, f. 143-157.

⁴¹² Hoekstra, T. (1988), "Small Clause Results". *Lingua* 74, f. 101-139.

⁴¹³ Nedjalkov, V. (botues) (1988), *Typology of Resultative Constructions*. Amsterdam: Benjamins.

⁴¹⁴ Talmy, L. (1991), "Path to Realization: A Typology of Event Conflation". Në *Proceedings of BLS 17*, f. 480-519.

⁴¹⁵ Carrier, J., J. H. Randall (1992), "The Argument Structure and Syntactic Structure of Resultatives". *Linguistic Inquiry* 23: 2, f. 173-234.

⁴¹⁶ Napoli, D. J. (1992), "Secondary Resultative Predicates in Italian". *Journal of Linguistics* 28, f. 53-90.

⁴¹⁷ Goldberg, A. (1995), *Constructions. A Construction Grammar Approach to Argument Structure*. Chicago: University of Chicago Press.

⁴¹⁸ Levin, B., M. Rappaport Hovav (1995), *Unaccusativity. At the Syntax-Lexical Semantics Interface*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.

⁴¹⁹ Wechsler, S. (1997), "Resultative Predicates and Control". Në *Proceedings of the 1997 Texas Linguistics Society Conference*, f. 307-321.

⁴²⁰ Rappaport Hovav, M., B. Levin (2001), "An Event Structure Account of English Resultatives". *Language* 77, f. 766-797.

⁴²¹ Boas, H. C. (2003), *A Constructional Approach to Resultatives*. Stanford, California: Center for the Study of Language and Information.

⁴²² Goldberg e Jackendoff, "The English resultative as a family of constructions" *Language* 80, (2004). f. 532-567.

mendojmë si të dobishme për një shprehje sa më të saktë formale të kuptimeve rrjedhimore në këto dy gjuhë.

6.1 Tipologji e mjeteve dhe e mënyrave të shprehjes së rrjedhimit

Vlerësohet se nga afro gjashtë mijë gjuhë që fliten në botë, vetëm rreth një e dhjeta e tyre janë studiuar qoftë edhe deri në njëfarë mase, prandaj, si për çdo dukuri tjetër gjuhësore, edhe për ndërtimet rrjedhimore nuk mund të bëhen përgjithësime absolute e as të mëtohet të krijohet një tipologji e plotë e tyre. Por, sidoqoftë, ne mendojmë se një vështrim i shprehjes së rrjedhimit në gjuhë të ndryshme do të na ndihmonte jo vetëm për të krijuar një ide të përgjithshme mbi natyrën e tyre, por edhe do të na jepte mundësinë për të ngritur një varg çështjesh me rëndësi teorike.

Koncepti filozofik i marrëdhënies shkak-pasojë nuk ekziston në të gjitha kulturat, ndaj si rrjedhim jo çdo gjuhë e kodifikon këtë koncept, çka do të thotë se ka gjuhë që nuk kanë ndërtime rrjedhimore. Megjithatë, mund të thuhet se ndërtimet rrjedhimore janë të zakonshme në shumicën e gjuhëve, por këto gjuhë e konceptualizojnë kuptimin e rrjedhimit në mënyra të ndryshme, ndaj ka si ngjashmëri, ashtu edhe ndryshime qoftë ndërmjet familjeve të ndryshme gjuhësore, qoftë edhe brenda së njëjtës familje.

Dahli (Dahl)⁴²³ vëren se termin “rrjedhojë” mund ta përdorim në dy kuptime, një të gjerë dhe një të ngushtë. Në kuptimin e gjerë, gjithçka çka shkakton një ngjarje mund të themi se është rrjedhojë a pasojë e kësaj ngjarjeje. Kështu, për shembull, gëzimi që mund të ndiejmë, ka gjasa të ketë ardhur si pasojë e një suksesi që kemi arritur; mërzia a trishtimi mund të jenë rrjedhojë e një dështimi a e një humbjeje etj. Kurse në kuptimin e ngushtë, një gjendje shihet si pasojë e një ngjarjeje që, si të thuash, ka një lidhje të brendshme me këtë gjendje.

Kështu, për shembull, shërimi i një njeriu sjell gjendjen e të qenit të tij “i shëruar”.⁴²⁴ Ne mund të shtonim më tej se është e mundur të dallohet edhe një dikotomi tjetër në kuptimet e rrjedhimit, ajo ndërmjet një kuptimi që po e quajmë “të brendshëm” dhe një kuptimi “të jashtëm”. Për ta pasqyruar mendimin tonë le të marrim tri fjalitë e mëposhtme në gjuhën angleze:

(1) a. *John hammered the metal flat.*

Xhoni **shtypi** (ose **petëzoi**) metalin. (fjalë për fjalë: Xhoni rrahu metalin të shtypur.)

b. *John hammered the metal; consequently, the metal became flat.*

Xhoni rrahu metalin; si rrjedhim, metali u bë i shtypur.

⁴²³ Dahl, Osten. 1985. *Tense and Aspect Systems*. Oxford: Basil Blackwell.

⁴²⁴ Në dallim nga mjaft gjuhë të tjera, shqipja e dallon formalisht këtë kuptim nëpërmjet paranyjëzimit të pjesores e kësioj mbiemërzimit të saj, ndonëse edhe vetë pjesorja mund të ketë një kuptim rrjedhimor, përveç atij “përshkrues”. Gjithashtu, duhet shtuar se një gjendje që ka ardhur si pasojë e një ngjarjeje, mund të jetë vetë një ngjarje që shërben si shkak i një rrjedhoje në kuptimin e gjerë. Kështu, për shembull, vdekja e një njeriu mund të vijë prej një sëmundjeje, një aksidenti etj. dhe nga ana tjetër mund të sjellë si pasojë hidhërimin e të afërmeve etj.

c. *John hammered the metal; consequently, the neighbors woke up.*

Xhoni rrahu metalin; si rrjedhim, fqinjët u zgjuan.

Siç mund të shihet, fjalia (1b) është strukturalisht e ngjashme me fjalinë (1c), por kuptimisht është sinonime me fjalinë (1a): si fjalia (1a), ashtu edhe ajo (1b) tregojnë gjendjen ku përfundon realja e shënuar nga emri në funksionin e kundrinës *metal* (“metal”) si pasojë e veprimit të shprehur nga folja *hammer* (“rrah”).

Ndërsa në fjalinë (1c) tregohet se çfarë pëson një element “i jashtëm” (*neighbours* “fqinjët”), që nuk bën pjesë në strukturën e argumentit të foljes së fjalisë kryesore. Ndaj mund të themi se kuptimet rrjedhimore të dy fjalive të para janë të *brendshme*, ndërsa fjalia e tretë ka një kuptim rrjedhimor të *jashtëm*.

Sipas studiuësve, trajta tipike a e mirëfilltë e pasqyrimin të rrjedhimit janë format e foljeve jovicimësore (jodurative) që shënojnë një proces dhe përfundimin e tij e që quhen *folje rrjedhimore* ose edhe *folje të përfundimit, të realizimit, të përmbylljes, të kryerjes* etj., si *shemb, djeg, hap* etj. Kështu, për shembull, fjalia *Iliriana hapi derën* mund të interpretohet sikur pikërisht veprimi i Ilirianës ishte shkak që solli si pasojë gjendjen e të qenit të derës e hapur.

Megjithëse me një strukturë argumenti të ndryshme, po rrjedhimore është folja *hap* në *Indriti hapi një gropë*. Si rrjedhimore mund të interpretohen edhe folje të tipit *vdes, gëzohem* etj. që i përmendëm më parë, të cilat, edhe në qoftë se nuk e kanë të shprehur, e kanë të nënkuptuar se kanë një shkak përse ndodhin, pra janë pasojë e tij.

Por, përveç foljeve të thjeshta, gjuhët e ndryshme të botës kanë një larmi mjetesh e mënyrash semantike e sintaksore për të shprehur marrëdhënien shkak-pasojë. Këto mund të jenë parashtesat, kallëzuesit e përbërë etj., por mjetet kryesore, të paktën në gjuhët kryesore evropiane e në një numër gjuhësh që fliten në Azi, janë të ashtuquajturat ndërtime rrjedhimore kallëzuesore ose ndërtime rrjedhimore me kallëzues dytësor, si edhe periudhat rrjedhimore.

6.2 Një vështrim i shkurtër ndërgjuhësor i ndërtimeve rrjedhimore

Studiuesit e kanë zgjeruar shkallë-shkallë fokusin e vëmendjes së tyre nga analiza e mënyrës së shprehjes së rrjedhimit në gjuhë të veçanta ose në dy gjuhë, duke i përjasur me njëra-tjetrën (prej të cilave njëra zakonisht është anglishtja) në një shqyrtim ndërgjuhësor të ndërtimeve rrjedhimore për të kapur më mirë mekanizmin e funksionimit të këtyre ndërtimeve.

Siç u theksua edhe më sipër, ndërtimet rrjedhimore janë të zakonshme në shumicën e gjuhëve, por këto gjuhë e konceptualizojnë kuptimin e rrjedhimit në mënyra të ndryshme, ndaj ka si ngjashmëri, ashtu edhe dallime si ndërmjet familjeve të ndryshme gjuhësore, ashtu edhe brenda së njëjtës familje.

Po t'u hedhim një vështrim ndërtimeve rrjedhimore në gjuhë të ndryshme, mund të nxjerrim si përfundim se disa prej tyre kanë ndërtime rrjedhimore të forta e të dobëta, ndërsa gjuhë të tjera mundësojnë vetëm përdorimin e fjalive të dobëta rrjedhimore. Kjo do të thotë se nuk ka gjuhë vetëm me fjali rrjedhimore të forta.

Nga ana tjetër, frazat rrjedhimore mund të jenë ose mbiemërore (FM) dhe parafjalore (FP) në disa gjuhë, ose vetëm parafjalore në të tjera. Sërish mund të nxjerrim përfundimin se nuk ekziston ndonjë gjuhë që të ketë vetëm fraza rrjedhimore mbiemërore.

Cuzuki (Tsuzuki) [i cituar nga Çisuga (Chisuga)]⁴²⁵ na jep një pasqyrë të përndarjes së frazave rrjedhimore në pesë gjuhë të ndryshme, si më poshtë:

Tabela 1

	Anglisht	Gjermanisht	Holandisht	Frëngjisht	Italisht
Fjali rrjedhimore të dobëta	FM, FP	FP	FM, FP	FP	FP
Fjali rrjedhimore të forta	FM, FP	FM, FP	FM, FP	Nuk ka	Nuk ka

Siç shihet nga tabela e mësipërme, anglishtja ka një gamë të gjerë modelesh rrjedhimore, bashkë me gjuhë të tjera gjermanike, si gjermanishtja dhe holandishtja, ndërsa dy gjuhët neolatine të pasqyruara në tabelë, frëngjishtja e italishtja, nuk kanë ndërtime rrjedhimore të forta dhe as fraza rrjedhimore mbiemërore. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shqipen.

Ndërsa Xhou (Zhou)⁴²⁶ jep një pasqyrë disi më të plotë tipologjike të ndërtimeve rrjedhimore mbështetur te Vashio, duke përfshirë edhe dy gjuhë aziatike, si japonishtja e koreanishtja, si edhe kriterin e kalimtarisë:

⁴²⁵ Chisuga, M. "A Crosslinguistic Observation on Resultative Constructions". Në [wwwsoc.nii.ac.jp/elsj/2009forum/Morita\(final_abstract\).pdf](http://wwwsoc.nii.ac.jp/elsj/2009forum/Morita(final_abstract).pdf). Comrie, B. (1976). Aspect. Cambridge: C. U. P.

⁴²⁶ Changyin Zhou, *Causativity Expression and Cross-linguistic Variation of Resultative Constructions*, Journal of Chinese Language and Computing 17(4):189-210.

Tabela 2

		Anglisht gjermanisht	Japonisht koreanisht	Frëngjisht italisht
Ndërtime rrjedhimore kalimtare	a) të rreme	po	po	po
Ndërtime rrjedhimore jokalimtare	b) të dobëta	po	po	?
	c) të forta	po	*	*
	ç) të forta	po	*	*

Tabela 2 tregon përsëri se gjuhët gjermanike (anglishtja dhe gjermanishtja) janë më të pasura se gjuhët e tjera të pasqyruara në tabelë, kur vjen fjala te mjetet e shprehjes së rrjedhimit, duke zotëruar si ndërtime rrjedhimore kalimtare, ashtu edhe jokolimtare, përkundër gjuhëve neolatine, si frëngjishtja e italishtja (por edhe spanjishtja etj.), të cilat, ndonëse gjeografikisht më të afërta dhe historikisht në kontakt me gjuhët gjermanike, për sa u përket veçorive tipologjike të ndërtimeve rrjedhimore janë më të ngjashme me gjuhët që fliten në Lindjen e Lartë, koreanishten dhe japonishten, me të cilat janë të palidhura gjenetikisht.

Sidoqoftë, siç mund të dallohet edhe nga tabela, teksa koreanishtja dhe japonishtja lejojnë vetëm formimin e ndërtimeve të dobëta dhe të pseudorjedhimoreve, por jo të forta, qoftë edhe me folje jokolimtare, kjo nuk mund të thuhet edhe për gjuhët neolatine, për të cilat është e qartë vetëm se kanë pseudorjedhimore, ndërsa për sa u përket ndërtimeve të dobëta, mendohet se ato hasen ndonjëherë në italisht, por jo edhe në frëngjisht e në spanjisht. Nga ana tjetër, edhe vetë anglishtja e gjermanishtja, dy gjuhë që kanë edhe ndërtime të forta, kanë dallime mes tyre⁴²⁷

Gjuhëtarët janë munduar të mos mjaftohen vetëm me përshkrimin e ndryshimeve ndër-gjuhësore në formimin e ndërtimeve rrjedhimore, por kanë bërë përpjekje për të gjetur shpjegimin përse disa gjuhë lejojnë përdorimin e disa tipa ndërtimesh dhe disa të tjera jo.

Pyetjes se çfarë i bën gjuhët të ndryshojnë për sa i përket mënyrës se si paraqesin nga ana strukturore ndërtimet rrjedhimore, i janë dhënë përgjigje të ndryshme, por ndikim më të madh kanë pasur ato që mbështeten në klasifikimin që u bën semantikani njohës Leonard Talmi

⁴²⁷ Shih për këtë: Toshiaki Oya, *Reflexives and resultatives: some differences between English and German*. *Linguistics: an interdisciplinary journal of the language sciences*; September 1, 2002.

(Talmy)⁴²⁸ të ashtuquajturave ngjarje të përbëra dhe në ndarjen pasuese ndërmjet *gjuhëve të shprehjes satelitore* (angl. “satellite-framed languages”) dhe *gjuhëve të shprehjes foljore* (angl. “verb-framed languages”), për të cilat do të flasim pak më hollësisht më poshtë.

Talmi është munduar ta shpjegojë dallimin ndërmjet gjuhëve të ndryshme duke u mbështetur në zbërthimin e ngjarjeve të përbëra në gjashtë elemente semantike, të emëruara *lëvizja* (ekzistenca në vetvete e ngjarjes së lëvizjes ose e vendndodhjes), *figura* (subjekti që lëviz a zë një vendndodhje të caktuar), *baza* (subjekti që vepron si një pikë referimi e caktuar në hapësirë për lëvizjen ose vendndodhjen e figurës), *rruga* (rruga që përshkon figura gjatë lëvizjes dhe vendi që zë ajo në lidhje me bazën), *mënyra* (e lëvizjes së figurës përgjatë rrugës) dhe *shkaku* (i lëvizjes).

Ai përqendrohet veçanërisht në atë se si një gjuhë e caktuar kodon nga ana gramatikore *rrugën* dhe *mënyrën* për shprehjen e lëvizjes, duke e shtrirë analizën e tij edhe në ndërtimet rrjedhimore të llojeve të ndryshme.

Talmi i ndan gjuhët e botës në dy grupe, mbështetur mbi modelin si projektohet struktura konceptore në strukturën sintaksore. Këto dy grupe përbëhen përkatësisht nga gjuhët që e shprehin ngjarjen kryesore me anë të foljes dhe ato që e shprehin nëpërmjet satelitëve⁴²⁹ të foljes.

Në disa gjuhë *lëvizja* shkrihet shpesh me *mënyrën*, ndërsa *rruga* shprehet kryesisht me anë të satelitëve, ndaj këto gjuhë quhen, siç e përmendëm, gjuhë të shprehjes satelitore. Në to, sipas Talmit, përfshihen të gjitha gjuhët indoevropiane, me përjashtim të gjuhëve neolatine,⁴³⁰ gjuhët e familjes fino-ugre, kinezishtja, varlpiri etj. Kështu, në gjuhën angleze thuhet:

a. *The bottle floated into the cave.*

Shishja hyri **në shpellë** (duke pluskuar). (fjalë për fjalë: Shishja pluskoi **për në shpellë**.)

b. *Mary ran into the house.*

Meri hyri **në shtëpi** (duke vrapuar). (fjalë për fjalë: Meri vrapoi **për në shtëpi**.)

Ndërsa gjuhë të tjera, si gjuhët neolatine, japonishtja, koreanishtja, gjuhët semitike, gjuhët polineziane, gjuha tamile etj., klasifikohen si gjuhë të shprehjes foljore, ku *lëvizja* shpesh shkrihet me *rrugën* e jo me *mënyrën*, e cila shprehet si një adjunksion, siç mund të shihet nga përkthimi i fjalive *tw mwposhtme*, përkatësisht në gjuhën spanjolle dhe në gjuhën koreane:

a. (spanj.) *La botella entró a la cueva (flotando).*

Shishja hyri në shpellë (duke pluskuar).

b. (korean.) *Mary-ka cip-ey (ttwi-e) tul-e-ka-(a)ss-ta.*

Meri hyri në shtëpi duke vrapuar.

⁴²⁸ Talmy, L. (1991). “Path to Realization: A Typology of Event Conflation”. Në *Proceedings of BLS 17*, f. 480-519; Talmy, L. (2000). *Toward a Cognitive Semantics*, Vol. 2: *Typology and Process in Concept Structuring*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.

⁴²⁹ Sipas Talmit, satelit quhet “kategoria gramatikore e çdo përbërësi, me përjashtim të plotësit emëror ose të plotësit të shprehur me frazë parafjalore, që është në marrëdhënie simotërie me rrënjën foljore” (2000, f. 222). Kështu, “satelitë janë pjesëzat foljore të anglishtes, parashtesat foljore të ndashme dhe të pandashme të gjermanishtes, parashtesat foljore të latinishtes dhe të rusishtes, plotësit foljorë të kinezishtes, ... ndajshesat polisintetike qark rrënjës foljore të gjuhës acugevi etj”. (po aty)

⁴³⁰ Më pas do të shohim se edhe shqipja, ndonëse një gjuhë indoevropiane joneolatine, është në të vërtetë një gjuhë e shprehjes foljore.

Siç mund të shihet, përbërësi i *rrugës*, i shprehur kryesisht me frazë parafjalore në anglisht (*into* “për në”), shkrihet me foljen e lëvizjes në gjuhën spanjolle (*entró* “hyri”), ndërsa në gjuhën koreane *rruga* e lëvizjes shprehet me anë të njëjës prej foljeve të një vargu të tillash (*tul* “hyj”). Gjithashtu, është e qartë nga përkthimi që u kemi bërë në gjuhën shqipe fjalive spanjolle dhe koreane se ka njëjtësi semantiko-strukturale të ndërtimeve rrjedhimore në këto tri gjuhë. Ndaj mund të thuhet pa mëdyshje se edhe shqipja, ashtu si spanjishtja e koreanishtja, u përket gjuhëve të shprehjes foljore.

Mënyra e lëvizjes si në spanjisht, ashtu edhe në koreanisht e në shqip shprehet si një adjunksion, meqë nuk është pjesë e foljes kryesore në ndërtimet e ashtuquajtura të lëvizjes së drejtuar dhe mund të hiqet.

6.3 Fjalitë rrjedhimore në anglisht

Sipas Veçslerit (Wechsler)⁴³¹, nëse do të na duhej të pasqyronim një situatë rrjedhimore, si për shembull atë në të cilën një farkëtar ka rrahur me çekan një copë metali dhe e ka bërë petë, gjuha angleze na mundëson tre tipa themelorë strukturash sintaksore. Së pari, shkaku dhe rrjedhoja mund të shprehen secila me fjalitë e veta, si në (1)a; nëpërmjet një periudhe rrjedhimore lidhëzore, si në (1)b-(1)f; ose fjalitë kryesore mund të shprehë rrjedhojën dhe e nënrenditura shkakun, siç është (1)g:

1)

a. *John hammered the metal; consequently, the metal became flat.*

Xhoni e rrahu metalin; **rrjedhimisht, metali u bë i shtypur.**

b. *John hammered the metal, resulting in the metal becoming flat.*

Xhoni e rrahu metalin, **duke çuar në bërjen e metalit të shtypur.**

c. *John hammered the metal, thereby flattening it.*

Xhoni e rrahu metalin, **kësisoj duke e shtypur.**

e. *John hammered the metal until it was flat.*

Xhoni e rrahu metalin **derisa u bë i shtypur.**

f. *John hammered the metal, causing it to flatten.*

Xhoni e rrahu metalin, **duke e bërë të shtypet.**

g. *John flattened the metal by hammering it.*

Xhoni e **shtypi** metalin duke e rrahur.

Por me gjasë, në vend të periudhave përkatëse në (1), në anglisht ne do t'i drejtoheshim një varianti më të shkurtër, ndërtimit rrjedhimor me kallëzues dytësor; siç është fjalitë e thjeshtë me frazë rrjedhimore mbiemërore *John hammered the metal flat* (Xhoni **shtypi** metalin; fjalë

⁴³¹ Wechsler, S. (1997). “Resultative Predicates and Control”. Në *Proceedings of the 1997 Texas Linguistics Society Conference*, f. 307-321; Wechsler, S., B. Noh. (2001). “On Resultative Predicates and Clauses: Parallels Between Korean and English”. *Language Sciences* 23, f. 391-423.

për fjalë: Xhoni rrahu metalin **të shtypur.**), por edhe fjalitë me fraza ndajfoljore, si *She painted the house beautifully* (Ajo e leu shtëpinë **bukur.**); parafjalore, p. sh. *The mother sang her baby to sleep* (Nëna e **vuri** foshnjën e vet **në gjumë** me këngë; fjalë për fjalë: Nëna i këndoi foshnjës së vet **të flejë.**), madje disa autorë, si për shembull Kuirk (Quirk) *et al.*⁴³², bëjnë fjalë edhe për fjali me fraza rrjedhimore emërore të tipit *Sally painted the room a beautiful shade of blue* (Selli e leu dhomën **me një nuancë të bukur të kaltre**; fjalë për fjalë: Selli leu dhomën **një nuancë të bukur të kaltre**).

Tipi i tretë i ndërtimeve rrjedhimore përbëhet nga fjalitë e thjeshta me folje jokallimtare kallëzore ose jokallëzore, si *The river froze solid* dhe *They shouted themselves hoarse*, të përmendura tashmë.

Siç mund të merret me mend, ashtu si *John hammered the metal flat*, edhe fjalitë e tjera të thjeshta të sipërpërmendura kanë periudhat e tyre gjegjëse, prej të cilave mund të kenë rrjedhur, si pasojë e prirjes së gjuhës për një shprehje më ekonomike.

Kësisoj, mund të thuhet se *The mother sang her baby to sleep* ka ardhur prej *The mother sang until her baby went to sleep*; *They shouted themselves hoarse* nga *They shouted until they became hoarse* ose *They sang so much that they hoarsened*; *The river froze solid* prej fjalive *The river froze until it became solid* ose ... *to the point it became solid* e kështu me radhë. Megjithatë, jo gjithëherë është kaq e lehtë të rikrijohet periudha burimore, siç është p. sh. rasti i *She painted the house beautifully* ose i *Sally painted the room a beautiful shade of blue*.

6. 4 Disa mendime mbi përkthimin e fjalive rrjedhimore nga anglishtja në shqip

Siç mund të vihet re nga sa u tha më sipër, shqipja ndryshon nga anglishtja, së pari sa u përket fjalive të thjeshta rrjedhimore. Për sa jemi në dijeni, shqipja nuk zotëron fjali të forta rrjedhimore, ashtu si edhe gjuhët neolatine, ndërkohë që edhe fjalitë e dobëta, veçanërisht mbiemëroret, janë më të kufizuara se në anglisht e në gjuhë të tjera gjermanike.⁴³³ Kështu, ndonëse fjalia e dobët *His sister cut her hair short* mund të përkthehet në shqip si me një fjali të dobët me frazë mbiemërore, ashtu edhe me frazë ndajfoljore (*short* e anglishtes është edhe mbiemër, edhe ndajfolje), si në (2):

2)

a. *Motra e tij i preu flokët shkurt.*

b. *Motra e tij i preu flokët të shkurtër.*

fjalisë *I filled my glass full* mund t'i gjegjet në shqip vetëm fjalia me frazë ndajfoljore *E mbusha gotën plot*, por jo ajo me mbiemëroren **E mbusha gotën të plotë*; ndërsa ajo që mund të quhet fjali me kuptim antonim, pikërisht *I drank my glass empty*, nuk mund të përkthehet as me fjali rrjedhimore mbiemërore e as ndajfoljore (**E piva gotën të zbrazët/bosh*” do të

⁴³² Quirk, R. et al. (1985). *A Comprehensive Grammar of the English Language*. London: Longman.
Rappaport Hovav, M., B. Levin (1998). “Building Verb Meanings”. Në M. Butt e W. Geuder (redaktorë). *The Projection of Arguments: Lexical and Compositional Factors*. Stanford: CSLI Publications, f. 97-133.

⁴³³ Për dallimin që qëndron në themel të këtij ndryshimi, ndërmjet të ashtuquajturave “gjuhë *satellite-framed*”, ku hyjnë anglishtja e gjuhë të tjera gjermanike dhe “gjuhëve *verb-framed*”, si gjuhët neolatine e ku ne do të renditnim edhe shqipen, shih Talmin (Talmy) (1991).

ishte jologjike dhe e pasaktë). Sidoqoftë, në shqip mund të thuhet “E piva gotën *krejt / të gjithën*”.

Ashtu si në rastin e “*E piva gotën të **zbrazët/bosh**”, një përkthim i drejtpërdrejtë i ndërtimeve rrjedhimore mbiemërore të anglishtes, ndonjëherë mund të ketë një të ashtuquajtur kuptim përshkrues në shqip, por që mund të jetë logjik, e megjithatë të mos e përcjellë saktë kuptimin e fjalisë angleze. Duhet thënë se, si frazat përshkruese, ashtu edhe ato rrjedhimore janë tipa të kallëzuesisë dytësore dhe kanë struktura sipërfaqësore të ngjashme, por interpretime të ndryshme semantike.

Frazat përshkruese tregojnë, si të thuash, një gjendje të pandryshueshme, ndryshe nga rrjedhimoret, që kanë të bëjnë me kalimin nga një gjendje në tjetrën. Ngjashmëria sintaksore e këtyre ndërtimeve jo vetëm mund të krijojë dykuptimësi në vetë gjuhën angleze, veçanërisht nëse mungon konteksti gjuhësor a jashtëgjuhësor, por edhe bën që një përkthim i drejtpërdrejtë të mos përcjellë atë çka synohet të kumtohet, edhe sikur të interpretohen drejt.

Për shembull, po të jepnim si barasvlerëse të fjalisë rrjedhimore *Tom boiled the meat soft* fjalinë shqipe “Tomi e zjeu mishin të butë” - ose qoftë edhe “Tomi zjeu mishin e butë (e jo të fortin)” - ato do të kishin një kuptim përshkrues e jo rrjedhimor: domethënë, mishi ishte i butë përpara se Tomi të niste ta ziente dhe jo që mishi u zbut ngaqë Tomi e zjeu, siç është kuptimi i fjalisë në anglisht. Përsëri një përkthim i përshtatshëm mund të ishte përdorimi i një fjalisë të nënrenditur rrjedhimore/kohore: “Tomi e zjeu mishin **derisa u zbut.**”

Edhe në rastet e fjalive me fraza parafjalore në gjuhën angleze duhet bërë kujdes ndaj përkthimit të drejtpërdrejtë. Kështu, nëse te *The mother sang her baby to sleep* frazën *to sleep* e përkthejmë duke përdorur gjegjësit e saj në shqip, paskajoren a lidhoren (*për të fjetur a të flejë*), nuk bartim kuptimin e saktë.

Si “Nëna i këndoi foshnjës për të fjetur”, ashtu edhe “Nëna i këndoi foshnjës që të flejë” shprehin qëllim, domethënë mund të parafrazoheshin “Nëna i këndoi foshnjës, me qëllim që të flejë”. Barasvlerësi më i afërt i shqipes për fjalinë *The mother sang her baby to sleep* përsëri do të ishin periudhat rrjedhimore/kohore, si “Nëna i këndoi foshnjës **derisa e zuri gjumi**” ose “Nëna këndoi **derisa foshnjën e zuri gjumi**”.⁴³⁴

Nga shembujt e mësipërm mund të arrihet në përfundimin se shqipja i përdor më shumë se anglishtja periudhat rrjedhimore ose të paktën mjaft prej fjalive të thjeshta në gjuhën angleze mund të përkthehen me periudha. Por edhe shqipja ka fjalitë e veta të thjeshta rrjedhimore, si ato që kanë në përbërje të tyre një përcjellore ose ndërtimin *folje + emër në rrjedhore*, të cilat mund të përdoren paralelisht me periudhat, si më poshtë:

3) a. *They sang themselves hoarse.*

U ngjirën duke kënduar (së kënduari). / Kënduan **sa u ngjirën**.

b. *The dog barked the neighbours awake.*

Qeni i **zgjoi** fqinjët me të lehura / prej të lehurave / duke lehur.

c. *He ran his shoes threadbare.*

Iu hëngrën këpucët nga vrapit (duke vrapuar). / Vrapoi **aq shumë, sa iu hëngrën këpucët**.

⁴³⁴ Sidoqoftë, siç thuhet edhe në *Gramatikën II* (f. 574), në disa raste të veçanta edhe paskajorja ose lidhorja mund të jenë fraza rrjedhimore në shqip, si në fjalinë: *E tashmja ishte e mjaftueshme për të ëndërruar*.

Siç mund të vihet re nga fjalitë në (3), shpesh kallëzuesi dytësor i fjalisë së thjeshtë angleze shndërrohet në shqip në kallëzues kryesor a, më saktë, në kallëzuesin e vetëm, i cili shpreh rrjedhimin (për të treguar këtë kemi përdorur gjatë gjithë këtij punimi shkronjat e zeza dhe nënvizimin), teksa shkakun e tregon fraza parafjalore, përcjellorja ose emri në rrjedhore.

Gjithsesi, jo gjithmonë lind nevoja a është e mundur të kryhet shndërrimi “kallëzues dytësor në anglisht → kallëzues (kryesor) në shqip”. Kështu, *She painted the house red* mund të përkthehet “Ajo e leu shtëpinë **me të kuqe**”, teksa fjalia që do të përfitohej po të ndiqej e njëjta rrugë si për fjalitë në (3), “Ajo e **kuqi** shtëpinë duke e lyer”, ndonëse gramatikore, do të ishte e papranueshme nga shumica e shqipfolësve.

Gjithashtu, ndonjëherë në shqip mund të mos shihet e nevojshme të tregohet mënyra se si është arritur në një gjendje të caktuar, ndaj gjatë përkthimit nga anglishtja të një ndërtimi me kallëzues dytësor rrjedhimor mund të lëmë jashtë një informacion të tillë. Për shembull, një fjali si *Mary wiped the table clean* (fjalë për fjalë: “Meri e fshiu tryezën **të pastër**”) mund të përkthehet thjesht “Meri **pastroi** tryezën” ose “Meri fshiu tryezën”, por do të tingëllonte disi e panatyrshme të thuhej “Meri e **pastroi** tryezën(.)⁴³⁵ duke e fshirë” ose “Meri e fshiu tryezën, **duke e pastruar**”.

Sa u përket periudhave rrjedhimore, siç mund të shihet nga “homologet” shqipe të fjalive në anglisht në (1), ka njëfarë bashkëpërkimi leksiko-sintaksor ndërmjet tyre, ndaj shpesh është e mundur të bëhet një përkthim pak a shumë i drejtpërdrejtë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për periudhat, fjalitë e të cilave bashkohen me anë të lidhëzave e lokucioneve *lidhëzore: so* (“*ndaj; prandaj*”); *so...(that)* (“*aq ... sa; kaq ... sa; aq ... saqë; kaq ... saqë*”); *such ... (that)* (“*i tillë ... sa; i tillë ... që*”) etj. Për shembull:

4)

a. *They were so surprised (that) they didn't try to stop him.*

Ata ishin **kaq të befasuar, saqë nuk u përpoqën ta ndalnin.**

b. *It was such a noise that we couldn't hear anything.*

Ishte një zhurmë e **tillë, sa s'dëgjonim dot gjë.**

c. *Europe was going through some very hard times during the mid 1900's so that no one was able to see a disaster such as Holocaust coming.*

Evropa po kalonte një periudhë shumë të vështirë, **kështu që askush nuk ishte në gjendje të shikonte ardhjen e një fatkeqësie si holokausti.**

Por ka dy lloje fjalish të ngjashme nga ana strukturore tek të cilat do të donim të ndaleshim pak më gjatë. Është fjala për fjalitë me kallëzues të zgjeruar me ngjyime krahasore të tipit *It is too good to be true* dhe *He is old enough to drink*, që shpesh në shqip përkthehen “të

⁴³⁵ Duhet vërejtur se në këtë rast përcjellorja mund të ketë një kuptim si mënyror, ashtu edhe rrjedhimor. Çka mund ta zhbëjë dykuptimësinë është presja: nëse vihet ajo, ndërtimi me përcjellore interpretohet si rrjedhimor, nëse jo, si mënyror.

kalkuara”, përkatësisht “Është **shumë (i,e) mirë për të qenë (i,e) vërtetë / që të jetë (i,e) vërtetë**” dhe “Është **mjaft i rritur për të pirë / që të pijë**”.

Në rastin e parë tipari i shprehur në pjesën kryesore është në një masë më të madhe sesa duhet për të sjellë rrjedhojën e shprehur në pjesën e dytë të fjalisë (a për të mos e sjellë atë, kur kjo e fundit është mohore) dhe kjo tregohet nëpërmjet ndajfoljeve të sasisë *shumë* ose *tepër*; në të dytin tipari mjafton (ose jo) për ta shkaktuar (ose jo) rrjedhojën dhe kjo shprehet me një tjetër ndajfolje sasive, pikërisht me *mjaft*. Por në shqip *mjaft*, veç kuptimit kryesor, ka edhe një të dytë sinonim me atë të *shumë* dhe *tepër*, çka i bën ndonjëherë të paqarta fjalitë me këtë ndajfolje.

Kështu, nëse thënien e njohur të Oskar Uajlldit *Life is too important to be taken seriously* do ta përkthenim “Jeta është **mjaft serioze për t’u marrë seriozisht**”, kjo mund të kishte dy interpretime antonimike: i pari, që jeta është aq sa duhet e rëndësishme, ndaj duhet marrë seriozisht; i dyti, që është edhe ajo çka dashur të thotë në të vërtetë shkrimtari, që jeta është shumë e rëndësishme, ndaj lipset ta marrim qetë e pa u shqetësuar, për të mos i koklavitur gjërat më shumë, pra jo seriozisht.

Veç kësaj, për shkak se këto fjali kanë të njëjtën strukturë edhe me fjalitë qëllimore, sërisht mund të krijohet dykuptimësi. Nëse tek *Ai ecte tepër ngadalë për të kapur autobusin*, nga përvoja e dimë që duhet të nxitosh e jo të ecësh ngadalë për të mos mbërritur pas kohës së duhur në ndalesën e caktuar, ndaj kjo fjali s’mund të jetë qëllimore, por rrjedhimore, ndonjëherë përvoja mund të mos na hyjë në punë e mund të mos e kemi as kontekstin a situatën për të bërë interpretimin e duhur.

Kështu, fjalia *Ana ha shumë për të qenë e shëndetshme* mund të lexohet në dy mënyra, si qëllimore ose si rrjedhimore: ose Ana është një vajzë e dobët e shëndetligë dhe ha shumë, me qëllim që t’i rikthehet shëndeti, ose ajo ha më shumë se ç’duhet dhe është mbi peshë, çka si rrjedhim sjell probleme për shëndetin.

Pa dashur të marrim pozicionin e gramatikanit parashkruar, mendojmë se më i përshtatshëm do të ishte në këto raste përkthimi me periudha që janë më “shqip” dhe që e shprehin më qartë rrjedhimin. Kështu *It is too good to be true* mund të kishte si gjegjëse në shqip “Është **aq (i,e) mirë, sa s’mund të jetë (i,e) vërtetë**”; *He is old enough to drink* “Është **aq i rritur sa për të pirë**” ose qoftë edhe “E ka (mbushur) moshën **që të pijë**”, ndërsa thënia e mençur e shkrimtarit anglez mund të jepej në tërë thellësinë e vet po të përkthehej “Jeta është **aq serioze, sa nuk duhet marrë seriozisht**” ose “Jeta është *tepër serioze, ndaj nuk duhet marrë seriozisht*”.

Nisur nga ky pasqyrim tipologjik i ndërtimeve rrjedhimore në gjuhë të ndryshme të botës, mund të themi se këto gjuhë përdorin mjete e mënyra të ndryshme për të shprehur gjendjet që vijnë nga një veprim i mëparshëm. Ato mund të zgjedhin së pari ndërmjet ndërtimeve të thjeshta rrjedhimore dhe periudhave, ndonëse jo çdo tip semantiko-strukturor që ekziston në njërin gjuhë, mund ta gjejmë edhe në një gjuhë tjetër.

Dallimet ndërgjuhësore sa u përket formave të shprehjes së rrjedhimit janë të mëdha, megjithatë në vija të trasha mund të nxirret një tipologji mbështetur në ndarjen e gjuhëve në

dy kategori: në gjuhë të shprehjes satelitore dhe në gjuhë të shprehjes foljore. Sa i takon shqipes, ajo i përket gjuhëve të grupit të dytë, bashkë me gjuhët neolatine e gjuhë të tjera. Ndaj ndërtimet rrjedhimore në shqip kanë mjaft ngjashmëri me ato që gjejmë në gjuhë të tilla, si frëngjishtja, italishtja e spanjishtja.

Ndërsa nga krahasimi i fjalive të ndryshme rrjedhimore në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze del se në këtë të fundit hasen dendur të ashtuquajturat ndërtime me kallëzues dytësor me kuptim rrjedhimor, të cilat janë të rralla në shqip, madje ndonjë prej tyre nuk ekziston, si për shembull fjalia e fortë rrjedhimore, në vend të së cilës shqipja përdor ndërtime të tjera, si periudhën rrjedhimore.

Nga ana tjetër, edhe gjuha shqipe zotëron për shprehjen e rrjedhimit ndonjë ndërtim të veçantë që nuk gjendet në anglisht, si ai *folje + emër në rrjedhore*. Këto dhe veçori të tjera të fjalive rrjedhimore duhen mbajtur parasysh gjatë përkthimit të tyre nga anglishtja në shqip dhe anasjellas.

PËRFUNDIME

Siç është vënë në dukje edhe në parathënie, tema e këtij disertacioni përqendrohet në vështrimin e periudhës së nënrenditur rrjedhimore në prozën popullore, duke u përpjekur të sjellim në vëmendje dhe të analizojmë veçoritë më tipike të saj. Duke i parë arritjet e studimeve të mëparshme si ndihmesa me vlerë, nëpërmjet kësaj teme jemi përpjekur t'i plotësojmë ato duke i vështruar më gjerësisht.

1. Në studime e tekste gramatikore të ndryshme ndër vite për periudhën gjejmë emërtime të ndryshme, si *fjali e përbërë*, *frazë*, shpesh bazuar e ndikuar nga drejtime të ndryshme të teorisë sintaksore, por edhe nga emërtimet e përdorura nga gramatikanë të huaj. Në gjuhësinë tonë *fjalìa* është termi që përdoret për të shënuar njësinë më themelore kumtuese-komunikative e intonacionore të ligjërit. Ndërsa njësia më e lartë se *fjalìa* është shprehur me terma të ndryshëm, si *fjali e përbërë*, *periudhë* dhe *frazë*, të cilat përdoren ndërkëmbërazi.

Pothuajse në të gjitha gramatikat e shqipes ku trajtohet periudha, ajo është përkufizuar si një ndërtim sintaksor që përbëhet prej dy a më shumë fjalish kallëzuesore dhe formon një njësi kumtuese, gramatikore dhe intonacionore. Ajo çka vërehet dhe shkakton debat midis gjuhëtarëve tanë është *emërtimi* i saj: *fjali e përbërë*, *frazë apo periudhë*. Nga këto emërtime, termi *periudhë* në gjuhësinë shqipe na rezulton fjalëtermi më i përhapur për njësinë sintaksore komunikative që shënon.

Në punimin tonë kemi parapëlqyer termin *periudhë* për të shmangur çdo lloj paqartësie e pështjellimi të panevojshëm: periudha përbëhet nga dy a më shumë njësi kallëzuesore dhe formon një unitet kumtesor, gramatikor dhe intonacionor. Ajo gjatë analizës sintaksore zberthehet në *fjali* dhe *jo në pjesë*⁴³⁶, të cilat përgjithësisht quhen *njësi kallëzuesore*. Këto njësi mund të mos kenë plotësinë kuptimore e intonacionin e mbarimit të fjalisë së mëvetësishme, por kanë predikativitetin e shprehur, si një nga tiparet e rëndësishme të fjalisë. Nga ana tjetër, nuk mendojmë se zëvendësimi i një termi me një tjetër zgjidh edhe problematikën konceptore që lidhet me to. Sipas këndvështrimit tonë, teoria e periudhës, frazës dhe fjalisë së përbërë në gjuhën shqipe ka nevojë për rishikim e rianalizim, në mënyrë që të pasqyrojë evoluimin e gjuhës shqipe dhe karakteristikat dalluese të saj.

2. Një nga çështjet më problemore të periudhave me nënrenditje është edhe çështja e klasifikimit të tyre. Ashtu si në gjuhësinë tonë, edhe në atë të huaj vërejmë mosndjekje të një kriteri *unik* për klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditur. Pjesa më e madhe e gjuhëtarëve në klasifikimin e periudhave me nënrenditje bazohen në gërshetimin e kriterëve *sintaksore* (formale), *semantike* (kuptimore) dhe *pragmatike* (përdorimi në ligjërim).

Gjuhëtarët tanë, edhe pse në periudha të ndryshme kohore bëjnë një klasifikim të periudhave duke u mbështetur në *kriterin funksional* dhe duket sikur ndajnë të njëjtin mendim. Por shpesh klasifikimi i fjalive të nënrenditura bazohet më shumë se në një kriter.

A. Xhuvani gërsheton *kriterin funksional* me *atë gramatikor-formal*, meqë ndër tipat e fjalive ai trajton edhe fjalinë *lidhore*; I. D. Sheperi, përveç kriterit funksional, duket se pleks edhe kriterin strukturor (*fjalìa përmendëse*); K. Cipo kriterin funksional e ndërthur me kriterin

⁴⁴⁶ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe* II, Tiranë, 2002, f. 60: "*Fjalìa që është pjesë e periudhës, s'i ka të gjitha tiparet e fjalisë së mëvetësishme... Si rrjedhim, njësi kallëzuesore që përbëjnë periudhën iu është mohuar karakteri i fjalisë duke u quajtur në traditat gramatikore të disa vendeve e nga disa studiues pjesë të "fjalisë së përbërë"*".

strukturor dhe me atë të modalitetit; S. Floqi dhe M. Totoni, edhe pse vënë re se në sintaksat shqipe nuk është zbatuar një kriter unik në klasifikimin e periudhave me fjali të nënrenditura dhe flasin për domosdoshmërinë e një kriteri unik,⁴³⁷ edhe ata vetë i kanë ndërthurur kriteret e ndryshme, sepse, të marrë veç e veç, asnjëri prej tyre nuk arrin të përfshijë gjithë marrëdhëniet kuptimore që dalin midis fjalive të nënrenditura të periudhës.

Pavarësisht vërejtjeve që i janë bërë, *kriteri funksional*, i cili dhe është zbatuar nga pjesa më e madhe e sintaksologëve tanë, mbetet edhe sot më i përdorshmi në gramatikat shkollore dhe në studimet sintaksore. Nëpërmjet *paralelizmit me gjymtyrët e fjalisë* pohohet ngjashmëria e rrafshëve të strukturës sintaksore dhe *tregohet kalimi nga struktura më e thjeshtë te më e ndërlikuar*⁴³⁸. Ai konsiston në përpjekjen për t'i përkur strukturat e periudhës në ato të fjalisë së thjeshtë; prandaj edhe fjalitë kryefjalore do të tregojnë njëfarë analogjie me kryefjalën, fjalitë kundrinore me plotësin kundrinor e kështu me radhë. I nisur nga një kuptim më i gjerë i strukturës së fjalisë së nënrenditur, ky kriter ka ndihmuar të depërtohet më thellë në strukturën e saj dhe, në tërësi, të shihet më mirë karakteri i marrëdhënieve që vendosen ndërmjet fjalive. Ndërsa kriteri *strukturor-semantik*, edhe pse është pranuar si më i miri, pasi ai lejon të zbulohen veçoritë strukturore dhe semantike të periudhës (mjetin e lidhjes, faktin nëse fjalia e varur i referohet një fjale a një grup fjalësh apo fjalisë drejtuese në tërësi, bashkëlidhjen e trajtave mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues, veçoritë intonacionore, raportet kuptimore themelore e dytësore të fjalisë së varur me kryesoren a drejtuesen) dhe është më i qëndrueshmi me të tjerët, ai nuk ka gjetur shtrirje në gramatikat tona.

Në punimin tonë, siç u vu në dukje dhe më lart, kemi përdorur termin *periudhë* duke u mbështetur në paralelizmin që bëhet mes fjalive të nënrenditura dhe pjesëve të ligjëratës apo gjymtyrëve të fjalisë, bazuar në *kriterin funksional*. Ky kriter na lejon të japim në mënyrë më të sistematizuar raportet sintaksore e raportet kuptimore të fjalive të varura me fjalitë kryesore drejtuese, ashtu si jepen edhe raportet e gjymtyrëve brenda një fjalie.

Paralelizmi midis fjalive të varura dhe gjymtyrëve të fjalisë mendojmë se është mjaft i përshtatshëm për të bërë përshkrimin e periudhës me fjali me nënrenditje e konkretisht të fjalisë me nënrenditje *rrjedhimore*.

Sipas mendimit tonë, te fjalia rrjedhimore nuk “thyhet paralelizmi në funksione e në emërtim i gjymtyrëve të fjalisë e të fjalive të nënrenditura”. Nëse ky kriter është “*tërësor e i plotë*”⁴³⁹ apo jo, për ne mbetet çështje e hapur. Por, ne mendojmë se nga *kriteri funksional* nuk përjashtohet fjalia rrjedhimore, pavarësisht se pohohet e kundërta.

Edhe pse në sintaksat tona rrethanori i rrjedhimit nuk përmendet si një nga gjymtyrët e dyta të fjalisë⁴⁴⁰, ne jemi të mendimit se edhe në shqip ka njësi sintaksore që mund të thuhet se kryejnë funksionin e rrethanorëve të rrjedhimit. E tillë, sipas gjykimit tonë, është për shembull fraza *për vdekje* në “*rrah (godas, qëlloj) për vdekje (dikë)*”, frazë e cila është sinonime me fjalinë e varur rrjedhimore (*aq*) *sa e vdes*.⁴⁴¹

Në klasifikimet e bëra nga gjuhëtarët tanë mund të pohojmë se në pjesën më të madhe të rasteve fjalia e nënrenditur rrjedhimore është pjesë përbërëse e nënndarjes së fjalive

⁴³⁷ S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhave me fjali të varura në shqipen e sotme*, Konferenca I e studimeve albanologjike, Tiranë, 1962, f. 226.

⁴³⁸ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000, f. 9.

⁴³⁹ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 493: *Paralelizmi midis fjalive të varura dhe gjymtyrëve të fjalisë s'është tërësor e i plotë: ka ndonjë fjali të varur që shpreh raporte që nuk dalin në fjali, si raportet e rrjedhimit (kemi fjali të varura rrjedhimore, por jo plotë të rrjedhimit...)*.

⁴⁴⁰ Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 493.

⁴⁴¹ Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për ndërtimet e tipit “*mërzis (bezdis) (dikë) për vdekje*”, ku *për vdekje* përdoret në kuptim jo të drejtpërdrejtë dhe luan rolin e një rrethanori sasive a mënyre. (Shih për më shumë në kapitullin III.)

rrethanore, pra zë vendin e një rrethanori rrjedhimi, megjithëse ky i fundit nuk përmendet si një nga gjymtyrët e dyta të fjalisë. Në disa gramatika⁴⁴² tre tipat e parë të fjalive të nënrenditura grupohen e trajtohen së bashku në termin fjali ftilluese⁴⁴³ (Th. Dhima, M. Çeliku). Si rrjedhim i kriterit semantiko-strukturor dhe atij funksional që ndjekin, S. Floqi, M. Tottoni dhe Th. Dhima bëjnë një klasifikim pak më ndryshe dhe me më tepër nëntipa periudhash me fjali të nënrenditura, por megjithatë, edhe për këta autorë, fjalia e nënrenditur rrjedhimore është pjesë përbërëse e periudhave me fjali të nënrenditura rrethanore.

3. Interesi i treguar për periudhën e nënrenditur rrjedhimore nuk ka munguar nëpër gramatika apo studimet sintaksore, por trajtimi i temës në fjalë ka qenë i paplotë. Ndërtimet rrjedhimore nuk ishin parë në tërësinë e tyre, por ishin kufizuar në trajtimin e periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore.

Në krerë të përfshirë në gramatika të përdorura si tekste mësimore për shkollat e nivelit të mesëm apo të lartë, trajtimi i kësaj njësie na ka rezultuar jo i gjerë.

Fjalitë e nënrenditura rrjedhimore janë trajtuar në kuadrin e sintaksës së periudhës me fjali të nënrenditura dhe, në veçanti, atyre rrethanore. Për trajtimin e periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore në sintaksën popullore nuk ka pasur ndonjë studim të thelluar.

4. Siç u përmend dhe më sipër, ndërtimet rrjedhimore janë trajtuar në kuadrin e sintaksës së periudhës dhe, në veçanti, të periudhave me fjali të nënrenditura rrethanore. Po, përveç periudhave me fjali të nënrenditura rrjedhimore, ndw mund të shprehen edhe me *fjali të thjeshta, periudha me fjali të bashkërenditura, periudha me fjali asidentike*, si edhe përtej periudhës, *në nivel teksti*. Ngjyrimet rrjedhimore ngërthejnë edhe një numër periudhash të tjera me fjali të nënrenditura.

Tradicionalisht në sintaksën shqiptare nuk ka qenë i përhapur emërtimi "**fjali (e thjeshtë) rrjedhimore**". Kjo, me gjasë, ka ndodhur jo vetëm ngaqë nuk është bërë ndonjë klasifikim sistemor i fjalive të thjeshta sipas raporteve funksionale-kuptimore (ose qoftë edhe formale) ndërmjet gjymtyrëve të tyre, por edhe sepse është menduar, siç vërehet në *Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa)* të Akademisë së Shkencave (f. 493), se në këto fjali nuk ka raporte rrjedhimi, gjë që, sipas autorëve të kësaj vepre, dëshmohet nga mungesa e plotësve (rrethanorëve) të rrjedhimit, përkundër qenies së fjalive të nënrenditura rrjedhimore.

Sidoqoftë, për mendimin tonë marrëdhëniet rrjedhimore ekzistojnë edhe në ndërtimet ku ato nuk janë të shprehura posaçërisht nga ana leksikore, domethënë ku ka njësi - kryesisht në rolin e rrethanorëve - që mendohet se shprehin në fjali raporte të tjera, sipas të cilave edhe emërtohen. Kështu, për shembull, kuptim rrjedhimor mund të themi se kemi edhe në ato fjali ku si gjymtyrë e dytë del një rrethanor shkaku, ndonëse në to, sigurisht, raportet rrjedhimore ndërthuren me raportet shkakore. Në këtë mënyrë, ndërtimet me rrethanorë të shprehur me emër me parafjalë, me emër në rrjedhore a me folje në përcjellore si: *U mek nga të qeshurit (së qeshuri, duke qeshur)* mund të perifrazohen qoftë me një periudhë me fjali të varur shkakore konstatuese (*U mek ngaqë qeshi*), qoftë edhe - duke tingëlluar mbase më natyrshëm - me një periudhë me fjali të nënrenditur rrjedhimore: *Qeshi sa u mek*. Po kështu, edhe ndajfolja *copash* e lokucioni i barasvlershëm me të *copa-copa* në *E thyej xhamin copash (copa-copa)*, që tradicionalisht do të interpretoheshin si rrethanorë mënyre, mund të themi se janë rrethanorë rrjedhimi dhe këtë sërish e provon perifrazimi me periudha rrjedhimore: *E*

⁴⁴² Thoma Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2008, f. 156; M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILAR, Tiranë, 2012, f. 338.

⁴⁴³ Akademia e Shkencave, *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 512: Ftilluese: një fjali e varur e cila sqaron kuptimin e foljes ose emrit në fjalinë drejtuese.

thyej xhamin aq shumë (aq keq), sa e bëj copash (copa-copa) ose E thyej xhamin sa e bëj copash (copa-copa).

Perifrazimi mund të shërbejë shumë mirë si një letër lakmushi për të përcaktuar së ç'loj raportesh shprehen në fjali ose të paktën llojin e rrethanorit që përmban ajo. Kështu, ndonëse fjalia *E bëj xhamin copash (copë-copë)* është sinonime me *E thyej xhamin copash (copë-copë)*, ajo nuk mund të perifrazohet me periudha rrjedhimore; s'mund të themi, për shembull, **E bëj xhamin aq shumë (aq keq), sa e thyej copash (copa-copa) ose *E bëj xhamin sa e thyej copash (copa-copa)*. Ndaj mund të arrijmë në përfundimin se *copash (copë-copë)* tek *E bëj xhamin copash (copë-copë)* tregon shkallën e ndryshimit të gjendjes së realies që shënon emri në funksionin e kundrinës (*xhamin*), prandaj mund të cilësohet si rrethanor mënyre.

5. Në prozën popullore periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore del me të njëjtat tipa semantiko-strukturorë që paraqitet në shqipen e sotme letrare. Në prozën popullore, ashtu si edhe në gjuhën letrare, vëmë re praninë e korrelatëve në fjalinë drejtuese, praninë e disa treguesve leksikorë për qartësimin e saktësimin e marrëdhëniesve sintaksore të fjalive, tipare tashmë të rrënjësura e të përbashkëta si për prozën popullore, ashtu edhe për gjuhën standarde shqipe.

Prania e një numri të konsiderueshëm korrelatësh të lidhëzave *sa, aq sa, saqë* dhe *që* jep mundësi për të bërë më mirë diferencimin e marrëdhëniesve dhe nuancave në këtë periudhë.

Vetëm në ndërtimet me karakter afektiv mund të gjejmë fjali kryesore pa korrelatë të lidhëzës.

Pothuajse me ato funksione e përdorime që vumë re në prozën popullore, dalin edhe lidhëzat nënrenditëse me vlerë rrjedhimore *që, sa, aq sa* që nga "*Meshari*" i Buzukut,⁴⁴⁴ çka dëshmon se që në shekullin XVI shqipja e shkruar kishte një sistem lidhëzor të plotë, të aftë për të shprehur llojet kryesore të raporteve sintaksore e veçanërisht të raporteve rrjedhimore.⁴⁴⁵

Përdorimi i rregullt i këtyre lidhëzave nënrenditëse në prozën popullore, duke e krahasuar me inventarin e plotë të atyre që gjenden te Buzuku, dëshmon jo vetëm për atë vijë afrimi në fushë të sintaksës midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar edhe në periudhën parakombëtare, por edhe për një strukturë sintaksore të caktuar për kohën.⁴⁴⁶

Nga ana tjetër, mungesa e disa lidhëzave dhe korrelatëve në prozën popullore dhe që gjenden në gjuhën letrare, tregon se struktura e periudhës së nënrenditur rrjedhimore të shqipes është perfeksionuar më tej nëpërmjet krijimit të lidhëzave të përbëra me kuptim të përcaktuar dhe sferë përdorimi.

Kësisoj, struktura e periudhave me fjali të nënrenditur rrjedhimore në gjuhën e sotme letrare është pasuruar më tej nëpërmjet krijimit të lidhëzave të reja, si p.sh. *në mënyrë që*, lidhëz që nuk e hasim në prozën popullore.

Nga shqyrtimi i lëndës sintaksore në prozën popullore na rezulton se është veçori e sintaksës popullore përdorimi i mjeteve dhe i mënyrave të ndryshme të sintaksës afektive, si dhe përdorimi i mënyrave gjuhësore-stilistike me synime të caktuara stilistike-artistike.

Këto anë të përbashkëta që i shohim si në rrafshin historik, ashtu edhe në rrafshin e sotëm (d.m.th vijat e përbashkëta midis prozës popullore dhe gjuhës së sotme letrare), tregojnë, në të njëjtën kohë, edhe për vijueshmërinë e qëndrueshmërinë e strukturës sintaksore të shqipes, të paktën që nga koha e dokumentimit e, deri në ditët tona, si gjuhë që ka mbijetuar duke u zhvilluar gjithnjë e më tej.

Parë nga prizmi i kulturës së gjuhës, ne jemi të mendimit se duhen lënë jashtë normës sintaksore ose duhet të kufizohen në përdorim ndërtime me burim të huaj, të tilla si: "*Është*

⁴⁴⁴ Shih më tepër: E. Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike, Nr. 4, 1971.

⁴⁴⁵ E. Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike, Nr. 4, 1971, f. 154.

⁴⁴⁶ E. Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike, Nr. 4, 1971, f. 156.

shumë e mirë, për të qenë e vërtetë”, ose që na duket se tingëllojnë të panatyrshme, si për shembull nëntipi me lidhëzën *në mënyrë që* e kallëzues një folje në dëftore. Nga ana tjetër, jemi për t’u dhënë më tepër vend në ligjërimin e shkruar, veçanërisht në stilin publicistik a në gjuhën e medias në përgjithësi (përfshirë këtu përkthimet e filmave, të dokumentarëve etj. nga gjuhë të huaja), periudhave rrjedhimore që hasen më dendur në gjuhën popullore a në ligjërimin e folur, të tilla si ato ku fjalia e nënrenditur lidhet me kryesoren me anë të lidhëzës *që*, qoftë me fjalë të bashkëlidhur ose jo. Mendojmë se një gjë e tillë jo vetëm do ta përfronte më tej variantin e shkruar me variantin e folur të shqipes standarde, por edhe do të vinte një gur më shumë në muret e “kështjellës” së sintaksës së gjuhës shqipe.

6. Kur flitet për rend të fjalive të nënrenditura rrjedhimore, kemi parasysh vendin e fjalisë së nënrenditur në lidhje me fjalinë kryesore. Në të gjitha gramatikat e shqipes nuk ka ndonjë trajtim të veçantë të këtij problemi.

Në to është pohuar se fjalia e nënrenditur rrjedhimore zakonisht vendoset pas fjalisë kryesore, por mund të ndodhë që ajo të gjendet edhe para fjalisë kryesore.

Si në gjuhën e sotme letrare, ashtu edhe në prozën popullore rendi i fjalive në periudhën me nënrenditje rrjedhimore është përgjithësisht i ngulitur, fjalia e nënrenditur pason fjalinë kryesore, duke iu përgjigjur rendit të gjërave në realitetin jashtëgjuhësor, ku shkaku ose fakti vjen përpara pasojës a rrjedhimit.

Ky rend i ngulitur i fjalive në periudhë kushtëzohet nga rrjedha logjike e ngjarjeve të paraqitura në të dyja fjalitë e periudhës. Dihet se çdo shkak ka një pasojë, rrjedhim, përfundim, i cili rrjedhimisht vjen pas shkakut. Fjalia e nënrenditur rrjedhimore del si rrjedhim, përfundim, përmbyllje e asaj që thuhet në fjalinë kryesore. Këtu rendi nuk mund të ndryshohet, sepse marrëdhëniet janë të renditura në rendin **shkak - rrjedhim**, kështu që rrjedhimi mund të realizohet vetëm nëse realizohet shkaku:

....*Ishte aq e bukur kjo Marua, sa mbretit i mbetën sytë.*
(*Proza popullore III, f. 49*)

b.^{*447} *sa mbretit i mbetën sytë, aq e bukur ishte Marua.*

Një kufizim i tillë shpjegohet duke zbatuar parimin ikonoik, në bazë të të cilit fjalia e nënrenditur rrjedhimore do të pasqyrohet në mënyrë ikonoike pasardhjen kronologjike të rrjedhojës. Nga pamundësia për t’ia paravendosur fjalitë e nënrenditura rrjedhimore fjalisë kryesore a drejtuese, përcaktohet edhe *gjymtyrëzimi aktual i fjalisë*, ku fjalitë e nënrenditura rrjedhimore janë **remë** e thënies, kështu që do të prireshin të vendoseshin pas **temës**, domethënë pas fjalisë kryesore a drejtuese. Kësisoj, pamundësia për t’ia paravendosur fjalinë e nënrenditur rrjedhimore fjalisë kryesore, lidhet me ndërtimin e veçantë “*diptik*” të fjalive të formësuara nga *fjali kryesore + fjali e nënrenditur rrjedhimore*. Fjalia e nënrenditur rrjedhimore është, në fakt, përbërësja e dytë e një ndërtimi korrelativ.

Në fjalitë jokorrelative rendi i anasjellë është i pamundur nga prania e një lidhëze (*kështu që* etj.) Ndaj, fjalia e nënrenditur rrjedhimore e tipit jo të bashkëlidhur (jokorrelativ) ka rend të ngulitur: fjalia e nënrenditur vjen pas fjalisë kryesore. Që pasvënia e detyrueshme e fjalive të nënrenditura rrjedhimoreve varet nga një faktor sintaksor, duket se provohet prej faktit që rastet e rralla të inversionit ndikojnë gjithnjë në fjalitë rrjedhimore jo korrelative me mbivendosjen, si në fjalinë që vijon: *Hanin si ujë dhe nuk ishte e mundur as t’u shërbeje sipas rregullit, aq shumë ishin të padurueshëm e trazues.*

⁴⁴⁷ * jo gramatikore.

Në fjalinë e mësipërme, rrjedhimi i pararend shkakut, por mes dy përbërësve nuk përcaktohet ndërlidhja, që në vend të kësaj kundërdallon një fjali të nënrenditur rrjedhimore të veçantë. (*Ishin shumë të padurueshëm e trazues, sa nuk ishte e mundur as t'u shërbeje në rregull.*)

Po të kemi parasysh edhe faktin se rendi i prapavendosur i fjalive të nënrenditura është më i zakonshëm edhe në gjuhën letrare, atëherë dalim në përfundimin se vendosja pas fjalisë kryesore është një dukuri e përgjithshme për gjuhën në tërësi.

7. Dallimet ndërgjuhësore sa u përket formave të shprehjes së rrjedhimit janë të mëdha, megjithatë në vija të trasha mund të nxirret një tipologji mbështetur në ndarjen e gjuhëve në dy kategori: në gjuhë të shprehjes satelitore dhe në gjuhë të shprehjes foljore. Gjuha shqipe i përket gjuhëve të grupit të dytë, bashkë me gjuhët neolatine e gjuhë të tjera. Prandaj ndërtimet rrjedhimore në shqip kanë mjaft ngjashmëri me ato që gjejmë në gjuhë të tilla, si frëngjishtja, italishtja e spanjishtja. Ndërsa nga krahasimi i fjalive të ndryshme rrjedhimore në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze del se në këtë të fundit hasen dendur të ashtuquajturat ndërtime me kallëzues dytësor me kuptim rrjedhimor, të cilat janë të rralla në shqip, madje ndonjë prej tyre nuk ekziston, si për shembull fjalia e fortë rrjedhimore, në vend të së cilës shqipja përdor ndërtime të tjera, si periudhën rrjedhimore.

Nga ana tjetër, edhe gjuha shqipe zotëron për shprehjen e rrjedhimit ndonjë ndërtim të veçantë që nuk gjendet në anglisht, si ai *folje + emër në rrjedhore*. Këto dhe veçori të tjera të fjalive rrjedhimore duhen mbajtur parasysh gjatë përkthimit të tyre nga anglishtja në shqip dhe anasjellas.

BIBLIOGRAFIA

1. Agostini, Francesco (1978), *Proposizioni consecutive*, in Enciclopedia dantesca. Appendice. Biografia, lingua e stile, opere, Roma, Istituto della Enciclopedia Italiana, 1970-1978, 6 voll., pp. 381-386.
2. Akademia e Shkencave, *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975.
3. Akademia e Shkencave, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.
4. Akademia e Shkencave, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.
5. Akademia e Shkencave, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
6. Akademia e Shkencave, *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984 dhe 2002.
7. Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.
8. Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Tiranë, 1996 dhe 2002.
9. Akademia e Shkencave, *Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës I*, Tiranë, 1973.
10. Auguste, D., *Manuel de la langue chkiye ou albanaise*, Paris, 1879.
11. Belluscio, G. - Rrokaj, Sh., *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë, 2011.
12. Benveriste, E. *Problèmes de linguistique générale*, Paris, 1966.
13. Blumfeld, L., *Language*, 1933.
14. Boas, H. C. (2003). *A Constructional Approach to Resultatives*. Stanford, California: Center for the Study of Language and Information.
15. Buxheli, L., *Emrat prejfoljorë të paranyjzuar me kuptimin e veprimit në gjuhën e sotme letrare shqipe*, Studime filologjike, Tiranë, Nr. 2, 1983.
16. Buxheli, L., *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008.
17. Buxheli, L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, 2007.
18. Buxheli, L., *Rreth caktimit të rasës emërore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, Tiranë, Nr. 2, 2005.
19. Buxheli, L., *Togfjalëshat me parafjalën për në gjuhën letrare shqipe*, Studime filologjike, Tiranë, Nr. 2, 1977.
20. C. F. Hocket, *A course in modern linguistics*, New York, 1958.
21. C. F. Hocket, *Two Models of Grammatical Description*, New-York.
22. Camaj, M. (1984), *Albanian grammar: with exercises, chrestomathy and glossaries*. Wiesbaden: Harrassowitz.
23. Carter, R. - McCarthy, M. (2006), *Cambridge Grammar of English*, Cambridge University Press.
24. Carrier, J., J. H. Randall (1992), "The Argument Structure and Syntactic Structure of Resultatives". *Linguistic Inquiry* 23: 2, f. 173-234.
25. Çeliku, M., *Parafjalët dhe lidhëzat e shqipes standarde vështruar në rrafshin normativ*, "Çështje të shqipes standarde", Tiranë, 2009.
26. Çeliku, M., *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILAR, 2012.
27. Çollaku, M., *Raportet kushtore në gjuhën shqipe*, Disertacion, Tiranë, 2012.
28. Chomsky, N., (1970), Remarks on nominalization. In: R. Jacobs and P. Rosenbaum (eds.) *Reading in English Transformational Grammar*.
29. Chomsky, N., *Syntactic Structures*, The Hague: Mouton, 1957.

30. Cipo, K., *Gramatika e gjuhës shqipe për klasat e V-ta, VI-ta, VII-ta të shkollave 7-vjeçare*, Tiranë, 1949.
31. Cipo, K., *Sintaksa shqipe*, Tiranë, 1952.
32. Cipo, K., *Sintaksë* (Tekst për Institutin Pedagogjik), Tiranë, 1951.
33. Cristofaro, S. (2003), *Subordination*. Oxford: Oxford University Press.
34. Cristofaro, S. (2008), Asymmetric events, subordination, and grammatical categories. In B. Lewandowska-Tomaszczyk (Ed.), *Asymmetric events*.
35. Çabej, E., “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), botim kritik, pjesa e parë dhe pjesa e dytë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, Tiranë, 1968.
36. Çabej, E., *Hyrje në Indoeuropianistikë, Leksionet e Prishtinës*, Botimet Çabej, Tiranë 2008.
37. Çabej, E., *Për pastërtinë e gjuhës*, Çështje të normës letrare, Prishtinë, 1980.
38. Çabej, E., *Studime gjuhësore VI*, Prishtinë, 1976.
39. Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
40. Dibra, K., Varfi, N., *Gjuhësi teksti*, ShBLU, Tiranë.
41. Dino, S., *Valët e detit*, Sofje, 1908.
42. Dodbiba, L., Spasse, S., *Gramatika e gjuhës shqipe, për kl. V dhe VI të shkollave shtatëvjeçare*, Tiranë, 1951.
43. Domi, M. *Probleme të sotme të gjuhës letrare dhe detyra të kulturës së gjuhës*, Gjuha jonë, 1981/1.
44. Domi, M., *Çështje të kulturës së gjuhës në fushën e sintaksës*, Gjuha jonë 3, 1983.
45. Domi, M., *Çështje të përgjithshme të sintaksës*, Studime filologjike, 1980/3.
46. Domi, M., *Disa çështje të lokucioneve*, Studime filologjike, 1985/1.
47. Domi, M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sintaksa për shkollat e mesme, Prishtinë, 1969 dhe 1971.
48. Domi, M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1968.
49. Domi, M., *Justin Rrota*, Studime filologjike, 1965, Nr. 1, f. 219.
50. Domi, M., *Mbi një tip strukturor të fjalive të varura dhe mbi disa çështje të drejtshkrimit të saj*, Kongresi i Drejtshkrimit, Prishtinë, 1974
51. Domi, M., *Probleme të sotme të gjuhës letrare dhe detyra të kulturës së gjuhës*, Gjuha jonë, Nr. 1, 1981.
52. Downing, A. and Locke, F.A. (1992): *A University Course in English Grammar*, Prentice Hall.
53. Dowty, D. R. (1979). *Word Meaning and Montague Grammar*. Dordrecht: Reidel.
54. Dhima, Th., *Disa koncepte sintaksore në gramatikat e shqipes të gjysmës së parë të shek. XX*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2004, Nr. 23/1.
55. Dhima, Th., *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000.
56. Dhima, Th., *Gjuha shqipe, Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2005 (ribotim Tiranë, 2008).
57. Dhima, Th., *Ndërtimet sintaksore dhe kultura e gjuhës*, Gjuha jonë, 1-4, 2006.
58. F. de Sosyr, *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 2002.
59. Floqi, S., *Çështje të fjalisë së përbërë në gjuhën shqipe*, BShShH, 3, 1955.
60. Floqi, S., *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative*, Studime filologjike, 1967/3.

61. Floqi, S., *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konferenca I e studimeve albanologjike, Tiranë, 1965.
62. Floqi, S., *Disa vrojtme për rendin e fjalive në periudhë*, Studime filologjike, 1976/3.
63. Floqi, S., *Konstrukte tautologjike në shqipen e sotme (dhe paralele shqip-rumanisht)*.
64. Floqi, S., *Mbi disa aspekte të zhvillimit të sintaksës së periudhës në shqipen letrare pas çlirimit*, Studime filologjike, 1970/1.
65. Floqi, S., *Mbi disa aspekte të zhvillimit të sintaksës së periudhës*, Studime filologjike, Tiranë, 1969/2.
66. Floqi, S., *Mbi disa çështje të renditjes së fjalëve në shqipe*, Studime filologjike, Nr. 2, 1969.
67. Floqi, S., *Periudha e përbërë e bashkërenditur në gjuhën e sotme shqipe*, BUShT, 2, Tiranë, 1956.
68. Floqi, S., *Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, Tiranë, 1965/ 3.
69. Floqi, S., *Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, Tiranë, 1965/4.
70. Floqi, S., *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2.
71. Floqi, S., *Periudha me fjali të varur shkakore I*, Studime filologjike, 1966/2.
72. Floqi, S., *Periudha me fjali të varur shkakore II*, Studime filologjike, 1966/3.
73. Floqi, S., *Periudha me fjali të varur shkakore III*, Studime filologjike, 1967/1.
74. Floqi, S., *Periudha me fjali të varur shkakore IV*, Studime filologjike, 1973/2.
75. Floqi, S., *Rreth disa çështjeve të fjalisë së përbërë në gjuhën shqipe*, BShSh, Tiranë, 1955/3.
76. Floqi, S., *Rreth modeleve të fjalisë në shqipen e sotme (modelet e fjalisë dëftore)*, Studime filologjike, 1978/4.
77. Floqi, S., *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, në BUShSh, Nr. 3, 1958.
78. Frashëri, S., *Shkronjëtorë e gjuhësë shqip* AshSh, Instituti i Historisë, Vepra V, Tiranë, 1988.
79. Frashëri, S., *Shkronjëtorë e gjuhësë shqip*, 1886.
80. G. Jespersen, *The Philosophy of Grammar*, London, Allen and Anwin, 1924.
81. G. Leech, *Semantics*, Penguin books, 1981.
82. Gero, M., *Ndërtime me lidhëzën se te periudha me fjali të varur kundrinore në prozën popullore*, Buletini shkencor, Shkodër, 1983/2.
83. Giusti, Giuliana (2012), *Le frasi consecutive*, in *Grande grammatica italiana di consultazione*, nuova ed. a cura di L. Renzi, G. Salvi & A. Cardinaletti, Bologna, il Mulino, 3 voll., vol. 2° (*I sintagmi verbale, aggettivale, avverbiale. La subordinazione*), pp. 825-832.
84. Givón, T., 1979, *On Understanding Grammar*. Ch. 5, Syntactization. New-York: Academic Press.
85. Givón, T., 1990, *Syntax. A Functional-Typological Approach*. Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.
86. Givon, T., *On Understanding Grammar*, published by Academic, Press, New-York, 1979.
87. Goldberg, A. (1995). *Constructions. A Construction Grammar Approach to Argument Structure*. Chicago: University of Chicago Press.

88. Goldberg, A., R. Jackendoff (2004). "The English Resultative as a Family of Construction". *Language* 8.
89. Gosturani, Xh., *Disa ndërtime të periudhës në të folmet e Elbasanit*, Studime filologjike, 1986/4.
90. Gosturani, Xh., *Mbi disa mënyra të shprehjes së raporteve lejore në gjuhën shqipe*, "Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit", Tiranë, 1986.
91. Gosturani, Xh., *Periudha me fjali të varur lejore në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1972/1.
92. Graffi, G., *Sintaksa, strukturat e ligjërit, përkthyer nga B. Topalli*, Tiranë, 2003.
93. Gjinari, J., *Dialektologjia shqiptare*, ShBLU, Tiranë, 1988.
94. Gjinari, J., *Gjuha letrare, drejtshkrimi dhe dialektet e shqipes*, KDGjSh, 1974.
95. Hahn, Johann Georg, *Albanesische studien, beitraege zu einer grammatik der toskischen dialektes* (Studime mbi shqiptarët, konstruktet për një gramatikë të toskërishtes), 1854.
96. Haiman, John & Thompson, Sandra A. (eds.), *Clause combining in grammar and discourse*. Amsterdam & Philadelphia: J. Benjamins (Typological Studies in Language, 18) in Conference on 'Clause Combining'; 1.-3.11.1985, Albany, Rensselaerville Institute.
97. Halliday, M. A. K. 1987, 'Language and the Order of Nature'. Nigel Fabb, Derek Attridge, Alan Durant and Colin MacCabe (eds.) *The Linguistics of Writing: Arguments between Language and Literature*. Manchester University Press.
98. Halliday, M. A. K. *An Introduction to Functional Grammar*, St, Edmundsbury Press Ltd Suffolk, 1991.
99. Haspelmath, Martin, 2004, Does linguistic explanation presuppose linguistic description?
100. Haxhihasani, Q., *Kontributi i Maksimilian Lambercit në fushën e folkloristikës shqiptare*, Studime filologjike, 1982.
101. Hengeveld, K. - E. H. Van Lier (2008), *Parts of speech and dependent clauses in Functional Discourse Grammar*, Studies in Language.
102. Herczeg, Gyula (1973), *Sintassi delle proposizioni consecutive nell'italiano contemporaneo*, "Studi di grammatica italiana" 3, pp. 207- 232.
103. Herczeg, Gyula (1974), *Le proposizioni consecutive in italiano classico*, «Lingua nostra» 35, 4, pp. 103-113.
104. Hoekstra, T. (1988), "Small Clause Results", *Lingua* 74, f. 101-139.
105. Hopper, Paul and Elizabeth Closs Traugott 2003, *Grammaticalization*, Cambridge: Cambridge University Press.
106. Hornby, A. S. (1989/1999/2010), *Oxford Advanced English dictionary*, Oxford University Press.
107. Huddleston, R- Pullum, G. (2008), *The Cambridge Grammar of English Language*, Cambridge University Press.
108. Hysa, E., *Ndajfolja në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1970/3.
109. Hysa, E., *Rreth përdorimit të së pakryerës së dëftores*, Studime filologjike, 1975/3.
110. Jespersen, O., *The Philosophy of Grammar*, London: Allen & Unwin, 1935.
111. Jubani, Z., *Raccolta di canti popolari e rapsodie di poemi albanese*, Trieste, 1987.

112. K. Kapllani, *Periudha me fjali krahasore korrelative të pabarazisë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1986.
113. K. Kapllani, *Periudha me fjali krahasore të barazisë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1985.
114. Kamarda, Dh., *Appendice al sargie di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866.
115. Kastrati, J., *Histori e Gramatologjisë Shqiptare (1635-1944)*, Prishtinë, Rilindja, 1980.
116. Koleci, F., Turano, G., *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, ShBLU, Tiranë, 2011.
117. Kostallari, A., *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Tiranë, 1984.
118. Kostallari, A., *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe*, Studime filologjike, Nr. 2, 1970.
119. Kostallari, A., *Përsosja e gjuhës sonë letrare dhe tiparet themelore të normës së sotme*, Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, Prishtinë, 1983.
120. Kristoforidhi, K., *Grammatikitis albanikis glossis*, 1882.
121. Lafe, E., *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike, 1971/4.
122. Lafe, E., *Maksimilian Lamberci - studiues i gjuhës shqipe*, Studime filologjike, 1982, Nr. 4.
123. Lafe, E., *Mbi disa lidhëza nënrenditëse te Gjon Buzuku*, Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12 - 18 janar), Tiranë, 1969.
124. Lambertz, M., (1914-15) Die hypotetische Periode im Albanischen, në "Indogermanische Forschungen", vëll. 34; përkthimi në gjuhën shqipe nga V. Dashi.
125. Lecch, G. - Svartvik, J. (1991), *A communicative grammar of English*, Longman.
126. Leech, G (2004), *A Gray's Anatomy on English Grammar*, English Language and Linguistics 8.
127. Leech, G. (2006), *A Glossary of English Grammar*, Edinburgh University Press.
128. Lehmann, Christian 1988, "Towards a typology of clause linkage." Haiman, John & Thompson, Sandra A. (eds.), *Clause combining in grammar and discourse*. Amsterdam & Philadelphia: J. Benjamins (Typological Studies in Language, 18).
129. Levin, B., M. Rappaport Hovav (1995), *Unaccusativity. At the Syntax-Lexical Semantics Interface*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.
130. Lyons, J., *Hyrje në Gjuhësinë teorike*, Tiranë, 2001.
131. M. Gero, *Ndërtime me lidhëzën se te periudha me fjali të varur kundrinore në prozën popullore*, Buletini shkencor, Shkodër, 1983/2.
132. Mansaku, S., *Format e shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare*, Studime filologjike, 1696/3.
133. Mansaku, S., *Funksionet sintaksore të paskajores tek autorët e vjetër*, Studime filologjike, 1983/2.
134. Mansaku, S., *Prirje të strukturës sintaksore të shqipes së sotme standarde*, Seminari XX ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe kulturën Shqiptare 20/1, Prishtinë 2002.
135. Mansaku, S., *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, Gjuha jonë, 2000, 1-2.

136. Mansaku, S., *Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare*, Gjuha jonë, 1985/1.
137. Mansaku, S., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare”, Tiranë, 2003.
138. Matthiesen, C. and Thompson, S. A. 1988. The structure of discourse and “subordination.” In *Clause Combining in Grammar and Discourse*, J. Haiman and S. A. Thompson (eds.), 275-333. Amsterdam: John Benjamins.
139. Memushaj, R., *Gjuhësia Gjenerative*, ShBLU, Tiranë, 2008.
140. Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002.
141. Memushaj, R., *Shqipja standarde. Si ta flasim e ta shkruajmë*, Tiranë, 2004.
142. Memushaj, R., *Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*, Studime filologjike, 2008/1-2.
143. Meyeri, G., *Kurzgefasste albanesische grammatik*, 1888.
144. Mikeli, G., *Gramatika e giuhës shqype*, Shtypshkronja “Nikaj”, Shkodër, 1916.
145. Mita, J., *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Prishtinë, 2005.
146. Mita, J., *Rendi i fjalëve dhe gjymtyrëzimi aktual i fjalive të varura kohore dhe vendore*, Studime filologjike, 2008/1-2.
147. Mitko, Th., *Alvannici molica (Bëleta shqypëtare)*, Aleksandri, 1978.
148. Mitko, Th., *Vepra*, Tiranë, 1981.
149. Moretti, Giovanni Battista (1982), *Riflessioni sul costrutto consecutivo esplicito in italiano*, «Annali dell’Università per stranieri di Perugia» 3, pp. 145-169.
150. N. Chomsky, *Syntaxic Structures*, The Hague: Mouton, 1957.
151. Napoli, D. J. (1992), “*Secondary Resultative Predicates in Italian*”. *Journal of Linguistics* 28, f. 53-90.
152. Nedjalkov, V. (botues) (1988), *Typology of Resultative Constructions*. Amsterdam: Benjamins.
153. P. H. Matthews, *Syntactic Relations: A Critical Survey*, Cambridge, 2007.
154. Peci, S., *Viti premtar i gramatikës*, Korçë, 1912.
155. Pedersen, H., *Albaneisiche texte mit glosar*, 1895.
156. Përnaska, R. *Gjymtyrëzimi aktual dhe mjetet e shprehjes së tij në gjuhën shqipe në “Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë”*, Nr. 16, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 1987.
157. Përnaska, R., Bubani, L., Bobrati, S., *Gramatika e gjuhës shqipe - Sintaksa (për shkollat e mesme pedagogjike)*, ShBLSh, Tiranë, 1973.
158. Përnaska, R., *Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, Nr. 4, 1983.
159. Përnaska, R., *Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1979/1.
160. Përnaska, R., *Trajtat e shkurtra dhe gjymtyrëzimi aktual në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1986/2;
161. Prifti, S., *Elipsa në sintaksën e fjalisë*, Studime filologjike, 1966/3.
162. Prifti, S., *Klasifikimi i fjalive të varura*, Studime filologjike, 1972/2.
163. Prifti, S., *Rreth disa çështjeve të fjalisë kohore*, Studime filologjike, 1966/2.
164. Prifti, S., *Sintaksa e shqipes*, Tiranë, 1962, ribotuar në Prishtinë, 1971.
165. Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Svartvik, J. (1985): *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman Group UK Limited.

166. R. G. Huddleston- G. K. Pullum et al. *The Cambridge grammar of the English language*, Cambridge, Cambridge University Press, 2002.
167. R. H. Robins. *A short History of Linguistics*, Longman Group Limited, London, 1967.
168. Rappaport Hovav, M., B. Levin (1998), "Building Verb Meanings". Në M. Butt e W. Geuder (redaktorë). *The Projection of Arguments: Lexical and Compositional Factors*. Stanford: CSLI Publications.
169. Rappaport Hovav, M., B. Levin (2001), "An Event Structure Account of English Resultatives". *Language* 77.
170. Riza, S., *Vepra 2*, botim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Prishtinë, 1997.
171. Rushi, Th., *Çështje të normës letrare në rendin e fjalëve në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1985/1.
172. Rushi, Th., *Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1983/4.
173. Rushi, Th., *Rendi i gjymtyrëve të shkallës së dytë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1988/1.
174. Rushi, Th., *Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore*, Studime filologjike, 1983/1.
175. Rushi, Th., *Vendi i fjalisë së varur përcaktore*, Gjuha jonë, 1999/2.
176. Rrokaj, Sh., *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010.
177. Rrokaj, Sh., *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë, 2000.
178. Rrokaj, Sh., *Shqipja standarde në pragun e shekullit të ri*, Seminari 19, Prishtinë, 2000.
179. Rrota, J., *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, AShSh IGjL Botimi I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
180. Rrota, J., *Syntaksa e gjuhës shqipe (ose Sintaksi i shqipes, 1942) për klasën II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, shtypshkronja At Gj. Fishta, Shkodër, 1943.
181. Saussure, Ferdinand de, *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 2002.
182. Simpson, J. (1983), "Resultatives". Në L. Levin, M. Rappaport, A. Zaenen (redaktorë). *Papers in Lexical-Functional Grammar*. Bloomington: Indiana University Linguistics Club.
183. Shehu, H., *Rreth leksikut të prozës tregimtare popullore*, (vep në dorëshkrim).
184. Sheperi, I. D., *Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927.
185. T. Givon, *On Understanding Grammar*, published by Academic, Press, New-York, 1979.
186. Talmy, L. (1991), "Path to Realization: A Typology of Event Conflation". Në *Proceedings of BLS* 17, f. 480-519.
187. Talmy, L. (2000), *Toward a Cognitive Semantics*, Vol. 2: Typology and Process in Concept Structuring. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.
188. Topalli, T., *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa e fjalisë*, Shkodër, 2011.
189. Topalli, T., *Fjali e përbërë, frazë apo periudhë?*, Gjuha jonë, 1-4/2004.
190. Totoni, M. "Fraza palidhëzore (asindetike)", Studime filologjike, Tiranë, 2002, Nr. 1-2.
191. Totoni, M. "Më shumë kujdes për strukturën sintaksore", Gjuha jonë, Tiranë, 1991, Nr. 2.
192. Totoni, M., "Çështje të kulturës së gjuhës në frazat kohore", Gjuha jonë, 1999, 1-2.

193. Totoni, M., “Çështje të studimit të sintaksës dialektore”, Studime filologjike Nr. 4, 1978.
194. Totoni, M., “Funkcionet gramatikore e stilistike të përemrit lidhor që”, Studime filologjike, 1984/1.
195. Totoni, M., “Klasifikimi strukturor-semantik i frazave me fjali të nënrenditura”, Studime filologjike, 1990/2.
196. Totoni, M., “Si duhet kuptuar njësia themelore sintaksore?”, Studime filologjike Nr. 2, 1970.
197. Totoni, M., “Struktura sintaksore e gjuhës letrare shqipe dhe probleme të normës së saj”, Gjuha jonë, 1995/1-4.
198. Totoni, M., *Fraza me nënrenditje*, Tiranë, 2000.
199. Totoni, M., *Libri i gjuhës shqipe për klasën VIII*, botimi I, Tiranë, 1971.
200. Totoni, M., “Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura dhe problemi i ndikimit të greqishtes”, Kumtesë e mbajtur në seminarin për gjuhën dhe kulturën shqiptare, Tiranë, gusht-shtator 1997.
201. Totoni, M., Hysa, E., “Rezultate në fushën e fonetikës dhe gramatikës së shqipes së sotme gjatë 25 vjetëve të Çlirimit”, Studime filologjike Nr. 4, 1969.
202. Th. Rushi, “Çështje të normës letrare në rendin e fjalëve në shqipen e Sotme”, Studime filologjike, 1985/1.
203. Th. Rushi, “Funkzioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe”, Studime filologjike, 1983/4.
204. Th. Rushi, “Rendi i gjymtyrëve të shkallës së dytë në gjuhën shqipe”, Studime filologjike, 1988/1.
205. Th. Rushi, “Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore”, Studime filologjike, 1983/1.
206. The Linguistics Encyclopedia, second edition, Routledge, London and New-York, 2002.
207. Van Valin, Robert D., Jr. and Randy J. LaPolla, 1997, *Syntax: structure, meaning and function*. Cambridge: Cambridge University Press.
208. Waltham: Ginn.; Jackendoff, Ray (1977). *X-bar-Syntax: A Study of Phrase Structure*. Linguistic Inquiry Monograph 2. Cambridge, MA: MIT Press.
209. Washio, R. (1997). “Resultatives, Compositionality, and Language Variation”. *Journal of East Asian Linguistics* 6: 1, f. 1-49.
210. Wechsler, S. (1997), “Resultative Predicates and Control”. Në Proceedings of the 1997 Texas Linguistics Society Conference, f. 307-321.
211. Xhuvani, A., *Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillores*, Tiranë, 1938.
212. Xhuvani, A., *Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për klasët e nalta të filllores*, Vlorë, 1922.
213. Xhuvani, A., *Libri i gjuhës shqipe, pjesë e dytë për klasat e nalta të filllores dhe të parat e Qytetses*, Tiranë, 1942.
214. Xhuvani, A., *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956.
215. Xhuvani, A., *Studime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1968.
216. Xhuvani, A., *Vepra I*, Tiranë, 1980.

LITERATURË E VJELË

- Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar, Proza popullore, vëllimi I, Tiranë, 1963.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar, Proza popullore, vëllimi II, Tiranë, 1966.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar, Proza popullore, vëllimi III, Tiranë, 1966.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar, Proza popullore, vëllimi IV, Tiranë, 1966.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar, Proza popullore, vëllimi V, Tiranë, 1972.
Instituti i Folklorit, Folklori shqiptar, Proza popullore, vëllimi VI, Tiranë, 1972.